

BASHKIMI EVROPIAN DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË: NJË RAST SUKSESI.

Doktoranti
STILIANO RUSHAJ

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
SHKENCA SOCIALE, me profil **MARRËDHËNIE**
NDËRKOMBËTARE, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **PHD, Odeta Barbullushi**

Numri i fjalëve: 62014

Tiranë, Dhjetor 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, i nënshkruari, Stiliano Rushaj, deklaroj se ky dizertacion doktoral është punim i imi origjinal për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e këtij programi studimor dhe nuk është dorëzuar ndonjëherë në institucione të tjera të arsimit të lartë. Gjithashtu, deklaroj se përmbajtja intelektuale dhe argumentat e përdorur janë pjesë e punimit origjinal, përveç përdorimit të burimeve të ndryshme të cilat janë të referuara në tekst dhe të përmbledhura në seksionin e bibliografisë.

Nënshkrimi

Data

Abstrakti

Ky punim doktoral, studion se si Bashkimi Evropian e legjitimon politikën e saj të promovimit e të drejtave të njeriut ndaj vendeve të treta nga një perspektivë fuqie normative. Rasti studimor i përzgjedhur është Kosova, me të cilin do të analizohet promovimin i të drejtave të njeriut përgjatë rrugëtimit të saj të integritit Evropian (2008-2014). Në këtë kontekst, pyetja kërkimore që ngre kjo tezë doktrale është sa i suksesshëm është promovimi i të drejtave të njeriut të Bashkimi Evropian - si një fuqi normative - në Kosovë në raport me ushtrimin e legjitimitetit të saj duke u bazuar kryesisht në nivel të institucioneve shtetërore dhe në nivel të angazhimit të shoqërisë civile? Kështu, vektor i kësaj teze do të ndërtohet mbi premisën se BE si një strukturë e ndërtuar mbi bazën e vlerave dhe normave të demokracisë, sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, e sheh angazhimin në arenën ndërkombëtare dhe në veçanti drejt vendeve me të ardhme në antarësim, si arritje e standardeve të caktuara në mënyrë që të vazhdohet me hapin e mëtejshëm të procesit të integritit. Legjitimimi i promovimit i të drejtave të njeriut të BE në Kosovës arrin të jetë i suksesshëm në nivel institucionesh qeverisëse ashtu dhe angazhimin e shoqërisë civile,

Në këtë mënyrë fokusi teorik i kësaj teze synon të analizojë ndërveprimin mes BE dhe vendeve të treta me të ardhme antarësimi, e qasur nga një perspektivë fuqie normative. Fokusi i politikave është studimi i legjitimitetit që BE përdor në promovimin e të drejtave të njeriut në rastin e Kosovës. Këtu promovimi i të drejtave të njeriut është kuptuar si një set standartesh që BE promovon si një aktor me fuqi normative, duke kërkuar një arritje të caktuar të pajtueshmërisë nga ana e vendit të marrë në studim. Fokusi empirik i tezës ka tre qëllime kryesore: Së pari të kuptuarit e gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë nga një prespektivë standartesh të promovuara nga Bashkimi Evropian. Së dyti, se si politika e BE mbi të drejtat e njeriut legjitimohet nga procesi i reformave të shtyrë prej elitave vendimarrëse nën të ashtuquajturën forcimi i të drejtave të njeriut nga lart-poshtë. Ndërsa së treti si i promovon BE të drejtat e njeriut në Kosovë nëpërmjet angazhimit të shoqërisë civile.

Ky punim bazohet mbi përdorimin e metodave cilësore, duke zhvilluar analizë të dokumentave dhe të përmbajtjes. Gjithashtu përdorimi i hulumtime në terren bazuar në

intervista gjysmë të strukturuar me zyrtarë të lartë të institucioneve të Kosovës, aktivistë të shoqërisë civile dhe ekspertë do të paraqesin një fokus më specifik mbi ato të drejta dhe liri themelore të marra si objekt i këtij studimi. Literatura e gjerë mbi fuqinë normative do të ofrojë njohuri për diskutimin e fenomeneve dhe aspekte të tjera që lidhen me këtë tezë, duke përfshirë artikuj, libra, punime konferencash, dhe burime të tjera dytësore.

Abstract

This thesis provides insights on how the EU legitimizes its human rights promotion policy toward third countries from a normative power perspective. The case study chosen is Kosovo, by which it will be assessed the promotion of human rights in its integration path toward the European Union between 2008 and 2014. The thesis main question asks how successful is the EU promotion of human rights – as a normative power – in relation to the exercise of its legitimacy on state institution level and on the level of the engagement of civil society organisations? Thus the vector of this thesis will be constructed on the premises that, the EU, as an Union constructed on the basis of values and norms of democracy, rule of law and human rights protection, sees the engagement in the international arena and specifically toward future new eligible countries as achievement of certain standards in order to proceed the further step of the integration process. The case of Kosovo show that the country reaches a certain degree of compliance with the standards only when in the table of negotiation is a great stake of incentive.

Thereby the theoretical focus of this thesis aims to analyze the interaction between the EU and [eligible] third countries that will join the Union, studied from a normative power perspective. The policy focus is the assessment of the legitimacy that EU uses on the promotion of human rights in the case of Kosovo. Here the promotion of human rights is understood as a set of standards that the EU promotes from its normative dimension and expects a certain degree of compliance by the respective country into study. The empirical focus of the thesis aims to explore how the EU policy on regarding human rights, is approached from the elite-driven reform process and from the civil society engagement.

The thesis is grounded into qualitative methods, by conducting desk research based on document and content analysis. This is followed by field research, based on semi-

structured interviews with senior officials of Kosovo institutions, civil society activists and experts. The vast literature over normative power Europe will provide insights for discussing phenomena and aspects of the thesis, based in articles, books, conference proceedings, internet resources on data reproduction, etc.

DEDIKIMI

Ky punim doktoral nuk do të mund të realizohej pa mbështetjen e vazhdueshme të familjes, kolegëve dhe miqve.

Marini dhe Davidi

FALENDERIME

Në radhë të parë, do të doja të falenderoja mentorin akademik, znj. Odeta Barbullushi PhD për asistencën që ka kontribuar përgjatë këtyre viteve të studimeve doktorale.

Së dyti, do të shprehja një falenderim për kolegët, në veçanti Dorinën dhe Fatrih, me të cilët kam ndarë një eksperiencë të paharrueshme konsultimi dhe bashkësidemi për punimet tona të doktoraturës.

Dhe së fundmi, një falenderim i shkon dhe stafit akademik dhe administrativ të UET gjatë këtij programi studimor, të cilët nëpërmjet asistencës dhe profesionalizmit të tyre kanë kontribuar në mënyrë indirekte në përfundimin me sukses të këtij dizertacioni doctoral.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT	XII
KAPITULLI I PARË: HYRJE.....	- 1 -
1.1 Pasqyrimi i përgjithshëm.....	- 2 -
1.1.1 Pyetja kërkimore.....	- 8 -
1.1.2 Hipoteza(t).....	- 6 Error! Bookmark not defined.
1.2. Fusha e studimit dhe debatet akademike rreth saj	- 12 -
1.3. Metodologjia.....	-12-
1.3.1. Metodologjia e përdorur në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe zhvillimit të analizës	- 19 -
1.4. Kufizimet dhe rëndësia e punimit.....	- 21 -
1.5. Përmbledhje e kapitujve.....	- 21 -
KAPITULLI I DYTË: TË DREJTAT E NJERIUT DHE FUQIA NORMATIVE E BASHKIMIT EUROPIAN: NJË KORNIZË TEORIKE	- 25 -
2.1. Hyrje.....	- 26 -
2.2 Një njohje ndaj të drejtave të njeriut	- 27 -
2.2.1. Regjimi ndërkombëtar i të drejtave të njeriut – modeli kozmopolitan i BE	- 29 -
2.3. Fuqia Normative e BE në teori dhe praktikë	- 35 -
2.3.1. Dallimi normativ i Bashkimit European.....	- 36 -
2.3.2. Promovimi dhe përhapja e normave e të drejtave të njeriut të BE	- 39 -
2.4. Një përkufizim i legjitimitetit.....	- 41 -
2.4.1 Studimin i legjitimitetit të BE mbi promovimin e të drejtave të njeriut: metodat përshkruese dhe përcaktuese.....	- 43 -
2.5. Legjitimiteti dhe fuqia normative të BE-së	- 48 -
2.5.1. Legjitimiteti si ligjshmëri.....	- 50 -
2.5.2. Legjitimiteti procedural	Error! Bookmark not defined.
2.5.3. Legjitimiteti si njohje nga jo-evropianët - "të tjerët"	- 51 -
2.6. Përfundime	- 57 -

KAPITULLI I TRETË: DIMENSIONI HISTORIK DHE INSTITUCIONAL I ZHVILLIMIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT - A ËSHTË BE NJË AKTOR NORMATIV?	59 -
3.1. Hyrje	60 -
3.2. BE dhe promovimi i të drejtave të njeriut: zhvillimet e hershme në të drejtën Evropiane.....	60 -
3.2.1. Gjykata Evropiane e Drejtësisë.....	61 -
3.2.2. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2000)	63 -
3.2.3. Parlameti Evropian si promovues i të drejtave të njeriut.....	65 -
3.2.4 Traktatet e integritetit Evropian (1953-2009): krijimi i kriterit politik për antarësim	67 -
3.3 Proçeset e Zgjerimit në KEE/BE dhe zhvillimi i kushtëzimit e të drejtave të njeriut	70 -
3.3.1 Zgjerimi i parë: rasti i Britanisë së Madhe (1973).....	71 -
3.3.2. Zgjerimi i vendeve të Evropës Jugore: Greqia (1981), Spanja dhe Portugalia (1985), dhe Turqia	73 -
3.3.3. Zgjerimi i vendeve nordike dhe Austria: impakti i kushtëzimit	76 -
3.3.4. Zgjerimi drejt Lindjes (2004-2007): ‘kthimi në Evropë’	78 -
3.4. Përfundim	84 -
KAPITULLI I KATËRT: TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË DHE ROLI I BASHKIMIT EUROPIAN	85 -
4.1. Hyrje	86 -
4.2. Bashkimi Evropian në Kosovë	87 -
4.2.1 Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian	88 -
4.2.2 Zyra e Ndërmjetësimit të Komisionit Evropian.....	90 -
4.2.3 Zyra e Eulex mbi të drejtat e njeriut	95 -
4.3 Gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë nën vëzhgimin e standarteve të BE.....	97 -
4.3.1 Liria e shprehjes.....	99 -
4.3.2 Të drejtat e grave dhe barazia gjinore.....	102 -
4.3.3 Të drejtat e komunitetit LGBTI.....	107 -
4.4. Përfundime	109 -

KAPITULLI I PESTË: TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË NGA NJË
PRESPEKTIVE INSTITUCIONALE: PROÇESI I DREJTUAR NGA LARTË-POSHTË .. -
112 -

5.1. Hyrje	113 -
5.2. Të drejtat e njeriut: kuadri ligjor, institucionet dhe mekanizmat implementuese-	114 -
5.2.1 Gjykatat.....	118 -
5.2.2. Institucioni i Avokatit të Popullit	119 -
5.2.3. Zyra për Qeverisje të Mirë.....	122 -
5.3. Reformat ndaj mbrojtjes e të drejtave të njeriut: procesit nga lartë-poshtë.....	124 -
5.3.1. Fushata e amendimeve të kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut: nisja e procesit nga lartë-poshtë.....	125 -
5.4. Ndikimi i ‘Evropianizimit’ në arritjen e standarteve të legjitimitetit	131 -
5.5. Përfundime	136 -

KAPITULLI I GJASHTË: TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË NGA NJË
PRESPEKTIVË E SHOQËRISË CIVILE: PROÇESI I DREJTUAR NGA POSHTË-
LARTË..... - 138 -

6.1. Hyrja	139 -
6.2. Kuadri ligjor, organizatat jo qeveritare dhe rëndësia e tyre në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.....	140 -
6.3. Iniciativat nga poshtë-lartë	142 -
6.3.1. Të drejta të garantuara - liri të mohuara: të drejtat e grave dhe barazia gjinore.....	142- 142 -
6.3.2 Të drejtat e komunitetit LGBTI në Kosovë nga një qasje poshtë-lartë	146 -
6.3.3 Liria e shprehjes në Kosovë nëpërmjet një prespektive nga poshtë-lartë.....	148 -
6.4. Roli i BE në forcimin e angazhimit të shoqërisë civile në Kosovë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.....	150 -
6.5. Përfundime	154 -

KAPITULLI I SHTATË: KONKULIZONET E STUDIMIT

7.1. Hyrje	158 -
7.2. Përfundime teorike dhe empirike	159 -

7.3. Rekomandime.....	- 167 -
7.4. Drejt një konceptimi të ndryshëm të promovimit e të drejtave të njeriut të BE kundrejt Kosovës	- 169 -
Bibliografia	- 173 -
Libra	- 173 -
Kapituj Libri	- 176 -
Artikuj akademik në periodik shkencor	- 178 -
Dokumenta juridike (traktate, ligje, etj.,)	- 185 -
Raporte	- 189 -
Webfaqe.....	- 196 -
Të tjera.....	- 198 -
Intervista.....	- 199 -

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

ABGj – Agjensia për Barazi Gjinore

BIRN – Rrjeti Ballkanik i Raportimeve Investiguese (*Balkan Investigative Report Network*)

CEDAW – Konventa për Eliminimin e të Gjithave Formave të Diskriminimit kundër Gruas
(*Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women*)

QESh – Qendra për Emancipim Shoqëror

GjED – Gjykata Evropiane e Drejtësisë

KEE – Komunitetit Ekonomik

EFTA – Marrëveshja Evropiane e Tregësisë së Lirë (*European Free Trade Agreement*)

PE – Parlamenti Evropian

KPE – Komunitetit Politik Evropian

BE – Bashkimi Evropian

IRJM – Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

DNj – Të Drejtat e Njeriut

KPM – Komisioni i Pavarur i Mediave

IPA – Instrumenti i Asistencës Para-Aderim (*Instrument of Pre-Accession Assistance*)

IPA I - Instrumenti i Asistencës Para-Aderim (2007-2013)

IPA II - Instrumenti i Asistencës Para-Aderim (2014-2020)

EIDHR – Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (*European Instrument for Democracy and Human Rights*)

UÇK – Ushtria Çlirimtare e Kosovës

RrGK – Rrjeti i Grave të Kosovës

LGBTI – Lesbik, Gej, Biseksual, Transgjjinor dhe Ndërseksual (*Lesbian, Gay, Bisexual, Transgender and Intersex*)

OJQ – Organizata Jo Qeveritare

MSA – Marrëveshja për Stabilizim Asociim

PSA – Proçesi i Stabilizim Asociimit

FSK – Forca e Sigurisë së Kosovës

TBE – Traktati i Bashkimit Evropian

KB – Kombet e Bashkuara

UNMIK – Misioni Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara për Adimistimin e Kosovës
(*United Nation Interim Administration Mission in Kosovo*)

KAPITULLI I PARË

HYRJE

1.1 Pasqyrimi i përgjithshëm

Bashkimi Evropian, prej më shumë se dy dekadash është shndërruar në një aktor të rëndësishëm ndërkombëtar në promovimin e të drejtave të njeriut përkundrejt vende të treta duke përdor qasje të ndryshme – që nga e drejta e antarësimit, në partneritet ekonomik dhe politik dhe deri në partneritet tregtar. Burimi i këtij roli aktiv, të aktorit ndërkombëtar, rrjedh që nga vetë konceptimi në gjenezë dhe më së shumti gjatë procesit transformues nga një komunitet ekonomik në një bashkim politik të formësuar nga struktura mbikombëtare dhe ndërqeveritare me nivele dhe magnitudë të ndryshme. Gjithashtu prej literaturës së gjërë që merret me teorizimet e integritit, ky rol kërkohet të shpjegohet nga një dimension i fuqisë normative (Manners 2002: 252; Tocci 2008), si një fuqi civile (Duchene 1972: 32) apo si një fuqi ideologjike (Galtung 1973: 51), duke bazuar vlerat dhe normat si një set standartizimi i politikave të brendshme (midis vendeve antare) dhe së jashtëmi (kundrejt vendeve të treta në prespektiva marrëdhëniesh të ndryshme). Në këtë kontekst çështja kryesore nëpërmjet së cilës, ky dizertacion doktoral kërkon të hulumtojë, lidhet me mënyrën se si promovohen të drejtat e njeriut ndaj një vendi – në studimin e rastit të Kosovës - ku progresi i të drejtave të njeriut duhet të kuptohet jo vetëm si një rezultat i dinamikave të brendshme, por gjithashtu të varur prej legjitimitetit të promovimit të jashtëm.

Qëllimi kryesor i kësaj teze është të hulumtojë mbi idenë dhe praktikën që kontribuojnë në përmirësimin akademik të hulumtimeve në lidhje me politikën e të drejtave të njeriut të Bashkimit Evropian përkundrejt një vendi me të ardhme antarësimi, siç është rasti i Kosovës. Ndërkaq, fokusi teorik ofron një perspektivë alternative për studimin e marrëdhënieve midis vendeve që gëzojnë një të ardhme antarësimi në BE - pra shtetet e Ballkanit Perëndimor ku Kosova është një prej tyre - dhe vetë Bashkimit Evropian i parë nga një raport që lidhet me 'fuqinë normative' të saj dhe mbi legjitimitetin nëpërmjet të cilit ushtron promovimin e të drejtave të njeriut. Fokusi empirik i kësaj teze, hulumton mbi legjitimitetin si një pikëpamje mjaft e rëndësishme që ndikon në suksesin apo dështimin afatgjatë e politikave e të drejtave të njeriut të BE dhe përcakton se çfarë duhet të jetë e

nevojshme për tu ndryshuar në këtë drejtim në mënyrë që të japë rezultate pozitive në kushte të reja të zhvillimit të marrëdhënieve midis BE dhe Kosovës.

Kështu, promovim të drejtave të njeriut i cili do të studiohet në kuadër të Politikës së Zgjerimit të BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshi këtu edhe Kosovën si një vend me të ardhme antarësimi. Ky prioritet brenda politikës së zgjerimit të BE-së, do të krahasohet dhe me ndërthurjen e promovimit e të drejtave të njeriut në politikat institucionale të BE-së në Kosovë, kryesisht nëpërmjet misionit të EULEX dhe politikës së jashtme të BE-së në Ballkanin Perëndimor.

Analiza empirike e hulumtimit të legjitimitetit të BE e parë nga fuqia normative e saj, do të jetë dy nivelëshe. Së pari, duke analizuar qasjen nga lartë-poshtë: dinamikën e përputhshmërisë me kërkesë-rekomandimet e Bashkimit Evropian. Dhe së dyti nëpërmjet analizimit të qasjes nga poshtë-lartë, pra rolit që merr angazhimi i organizatave të shoqërisë civile në procesin e reformave (bashkëpunim qeveri-shoqëri civile) dhe në rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Secila prej këtyre qasjeve do të analizojë përputhshmërinë e promovimit e të drejtave të njeriut të BE në lidhje me tre burimet e legjitimitetit: legjitimiteti si ligjshmëri, legjitimiteti procedural dhe legjitimiteti si njohje ndaj “të tjerëve”.

Qëllimi i këtij punimi doktoral është të shkoj përtej analizës së proceseve të reformave institucionale dhe angazhimi i ndërgjegjësimit të shoqërisë civile në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në dy qasjet e lartëpërmendura por dhe duke vëzhguar disa të drejta dhe lirive themelore në terren. Kështu në këtë punim do të përzgjidhen tre të tilla: mbrojtja e të drejtat e grave dhe zgjerimi i barazisë gjinore, mbrojtja e të drejtat e komunitetit LGBTI¹ dhe forcimi i lirisë së shprehjes. Përzgjedhja e tyre nuk është e rastësishme por ajo paraqet modelin e BE të përfshirjes së dy të ashtuquajtura gjenerata të drejtash - të drejtave politike dhe civile me të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore të individit – duke i parë ato si plotësuese të njëra-tjetrës.

Në këtë mënyrë të drejtat e përzgjedhura për studimin në këtë tezë, përfaqësojnë fokusin kryesor të të drejtave themelore ku Kosova do të duhet të përqëndrohet sipas

¹ Akronimi LGBTI do të përdoret përgjatë gjithë tekstit duke kuptuar komunitetin lezbik, gej, biseksual, transgjinnor dhe ndërseksual.

qasjes së BE-së. Kështu *liria e shprehjes* është një karakteristikë kyçe për zhvillimin e demokracisë së një vendi. Në të tilla kushte, duke mos patur liri të shprehjes, nuk do të mund të sigurojmë të drejtën tonë për të komunikuar ide pa frikën e censurës ose ndaj një mediumi të caktuar që ajo përdoret. Kësisoj, ky shtrëngim do të kufizojë parakushtet tona jetike si mendimi, shprehja apo fjala.

Barazia gjinore është një faktor kryesor në zhvillimin ekonomik dhe social dhe të drejtat e grave përmbushin fuqizimin e shoqërisë. Kështuqë, me mungesën e të drejtës së gruas dhe barazisë gjinore ne do të mund të kufizojmë përhapjen universale e të drejtave ndërmjet të gjithë antarëve të një komuniteti social. Nga ana tjetër disbalancimi i përfaqësimit gjinor në proceset vendim-marrëse e t'kurr ndërtimin e një shoqërie demokratike.

Dhe së fundmi, *të drejtat e komunitetit LGBTI* përfaqësojnë një aspekt të rëndësishëm për tolerancën sociale dhe gjithpërfshirjen në një shoqëri. Kështuqë duke limituar të drejtat e personave që janë pjesë të një orientimi seksual apo të një identiteti gjinor të ndryshëm nga ai që ata janë lindur, ne do të zvogëlojmë diversitetin e qënies njerëzore, besimet e tyre dhe mënyrën në të cilën disa qytetarë kërkojnë të identifikohen apo shprehen.

Këto tre të drejta të marra për studim kanë një rëndësi të madhe për vende të cilat i drejtohen një rrugëtimi procesesh demokratizimi dhe shtet-ndërtimi në të njëjtën kohë, të tillë si Kosova. Mbrojtja dhe forcimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore mbeten si një parakusht të një vendi që kërkon të ndërtojë një shoqëri demokratike dhe e shoh të ardhmen të integruar në atë Union i cili është i themeluar nga norma dhe vlera që respektojnë dhe mbrojnë të gjitha të drejtat e njeriut njëherazi, si BE. Duke marrë si studim rasti, Kosovën, ky punim parasheh të japë një kontribut në literaturën e munguar në shqip për studime që lidhen me procesin e zgjerimit e parë nga pikëpamja e promovimit të drejtave të njeriut të fuqisë normative të BE në raport me ushtrimin e legjitimitetit të saj. Gjithashtu do të kontribuojë në debatin akademik dhe literaturën në vazhdim në lidhje me rolin e BE si një aktor normë-formues në procesin e zgjerimit nga një prespektivë e legjitimitetit.

1.1.1 Pyetja kërkimore

Në këtë mënyrë pyetja kryesore që ngre për hulumtim kjo tezë doktrale kërkon të kuptojë është:

Sa i suksesshëm është promovimi i të drejtave të njeriut të Bashkimi Evropian - si një fuqi normative - në Kosovë në raport me ushtrimin e legjitimitetit të saj duke u bazuar në nivelin e institucioneve shtetërore, dhe duke e krahasuar në nivelin e angazhimit të shoqërisë civile?

Kjo pyetje kërkimore kërkon të hulumtojë rreth mënyrës se si legjitimohet promovimi i të drejtave të njeriut të BE, si një politikë e jashtme e saj, e cila shihet nën kontekstin e fuqisë normative. Analiza mbi promovimin e të drejtave të njeriut të BE paraqet mënyrën se si kjo politikë legjitimohet në nivel institucionesh qeverisëse të Kosovës – qasja lartë-poshtë dhe në nivel të angazhimit të shoqërisë civile – qasja poshtë-lartë. Në këtë kuptim kërkohet jo thjesht të shpjegohet mënyra e legjitimitit të promovimit e të drejtave, por si arrihet dhe sa e efektshëm është ky promovimi. Ajo parasheh të analizoj modelin ekzistues të politikës europiane mbi të drejtat e njeriut përgjatë procesit të zgjerimit në një rast studimor të Kosovës dhe në çfarë mënyrë mund të përmirësohet kjo strategji veprimi.

Për ta kuptuar më tej parashtrimin e pyetjes kërkimore, gjatë punimit të kësaj teze do të shtrojmë pyetje të tjera të cilat do të trajtojnë çështjet kryesore që do të trajtohen: Çfarë raporti ekziston midis BE dhe të drejtave të njeriut? Si e ndërton Bashkimi Evropian fuqinë e saj normative në raport me vende të treta? Çfarë mekanizmesh përdor për të promovuar të drejtat e njeriut? A mund të themi se qasja e BE mbi promovimin e të drejtave të njeriut në kuadër të procesit të Zgjerimit është legjitime dhe arrin të jetë e suksesshme? Cilat janë faktorët që e shpjegojnë kështu legjitimitet të promovimit e të drejtave të njeriut të BE në Kosovë nëpërmjet institucioneve dhe mekanizmave përfaqësuese të saj në vend? Si e ushtron BE legjitimitetin e saj në raport me institucionet qeverisëse? Dhe, sa e efektshme është angazhimi i saj përkundrejt, fuqizimit të shoqërisë civile?

1.1.2 Hipoteza(t)

Në mënyrë që të jepet një përgjigje pyetjes kërkimore dhe pyetjeve të tjera që ky punim doktoral ngre për shqyrtim tej, hipoteza kryesor mbështetet mbi premisën se ***BE si një strukturë e ndërtuar mbi bazën e vlerave dhe normave të demokracisë, sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, e sheh angazhimin në arenën ndërkombëtare dhe në veçanti drejt vendeve me të ardhme në antarësim, si arritje e standardeve të caktuara në mënyrë që të vazhdohet me hapin e mëtejshëm të procesit të integritetit. Promovimi i të drejtave të njeriut të BE në Kosovës arrin të legjitimohet pjesërisht si në nivel institucionesh qeverisëse ashtu dhe angazhimin e shoqërisë civile.***

Kështu në nivel të institucioneve qeverisëse, legjitimimi i promovimit të BE në kuadër të shpërndarjes së normave mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të jetë sipërfaqësore pasi reformat lidhur me to do të jenë të varura nga përlllogaritja e kosto-përfitimeve.

Ndërsa në nivel të angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile, legjitimimi i promovimit të BE në kuadër të arritjes së standarteve do të jetë i suksesshëm pasi BE shihet si një forcë e mirë.

Testimi i këtyre hipotezave do të arrihet nëpërmjet analizës në kapitujt empirik, të këtij studimi doktoral, përkatësisht Kapitulli IV, Kapitulli V dhe Kapitulli VI. Kështu për të vlerësuar legjitimin e promovimit e të drejtave të njeriut të BE në Kosovë në qasjen nga lartë poshtë – institucioneve qeverisëse – dhe në atë poshtë-lartë – shoqëria civile – do të përdoren tre indikatorët. Këto indikatorë do të përbëjnë edhe objektivat kryesore të këtij studimi mbi mënyrën se si BE e ushtron forcën e saj normative – pra fusha e zbatimit dhe e projektimit të kësaj fuqie – dhe mbi vlerësimin e suksesit të promovimit e këtyra të drejtave të njeriut. Kështu së pari indikator i përputhshmërisë së kuadrit ligjor, në kontekstin e legjitimitetit do të jetë legjitimiteti si ligjshmëri ose siç njihet ndryshe substancial. Me fjalë të tjera, do të vlerësohet aftësia juridiko-institucionale e Kosovës për të patur një përputhshmëri me kuadrin juridik të BE mbi mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të njeriut.

Duhet theksuar se ky vlerësim juridiko-institucional nuk kërkon të analizohet nga një kontekst konstitucionalizmi pra një studimi e së drejtës kushtetuese, por mbi aftësinë e Kosovës për të patur përputhshmëri në kuadrin ligjor të nevojshëm për tu përafruar me standartet e përgjithshme të BE mbi të drejtat e njeriut. Në analizën e nivelit të shoqërisë civile do të jetë përputhshmëria e kuadrit ligjor përkatës për të fuqizuar rolin e kësaj të fundit në pjesmarrjen

Së dyti, indikator i aftësisë për të ndërmarrë dhe miratuar politikat e nevojshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë që janë në koherencë me standartet e BE. Këtu do të ndalem në shtjellimin e pikëpamjes procedurale që merr procesi i politikave transformuese, të cilat janë në kuadrin e negociatave BE-Kosovë për MSA. Në këtë drejtim, legjitimimi i promovimit të të drejtave të njeriut të BE merr një karakter thelbësisht procedural. Ndërsa në analizën e nivelit të organizatave të shoqërisë civile do të analizohet aftësia e tyre për të influencuar në proceset e shqyrtimit të politikave dhe iniciativat e pavarura për këto politika që forcojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Analiza përgjigjet dy nivele – lartë-poshtë dhe poshtë-lartë – do të përqëndrohet në të tre të drejtat dhe liritë themelore të marra në shqyrtim në këtë tezë doktrinale: të drejtat e grave dhe barzia gjinore, të drejtat e komunitetit LGBTI dhe lirinë e shprehjes.

Së treti, indikator që vlerëson nivelin e implementimit të normave dhe vlerave të standarteve të BE mbi të drejtat e njeriut në Kosovë nëpër dy niveleve të analizës. Ky indikator do të vlerësoj legjitimitetin e promovimit të të drejtave të njeriut të BE nga aftësia e kësaj të fundit për të “ndryshuar” apo formësuar standartet e normales përkundrejt vendeve jo antare të BE. Në nivelin e institucioneve qeverisëse, do të analizohet legjitimiteti i promovimit në kuadër të mbështetjes financiare dhe infrastrukturore nga fondet IPA I dhe IPA II, Instrumentit European për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut dhe mbështetjeve të tjera *ad hoc*. Ndërsa në nivelin e aktorëve të shoqërisë civile, legjitimitetit i promovimit do të analizohet në kuadër të mbështetjes politiko-financiare të BE ndaj shoqërisë civile, duke u ndalur në fondet IPA I dhe II, Instrumentit European për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut. Gjithshtu do të analizohet raportit të ndërsjelltë midis institucioneve qeverisëse dhe këtyre aktorëve sociale në rritjen e bashkëpunimit të ndërsjelltë dhe gjithpërfshirjen përgjatë proceseve vendimarrëse që influencojnë në

përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë në kuadër të procesit të integritetit.

1.2. FUSHA E STUDIMIT DHE DEBATET AKADEMIKE RRETH SAJ

Pasi u njohëm me problematikën e këtij punim dhe me parashtrimin e pyetjes kërkimore dhe argumentit kryesor, i cili do të përbëjë vektorin e kësaj teze, do të na duhet ta vendosim studimin brenda kuadrit të fushës studimore përkatëse dhe të paraqesim debatet akademike rreth saj. Ky punim doktorial do të ndërtohet mbi një kuadër teorik të marrëdhënieve ndërkombëtare duke studiuar politikën e jashtme të Bashkimit Evropian në kuadër të rolit të saj ndërkombëtar si një fuqi normative për të promovuar standartet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në një studim rasti të Kosovës. Për të vlerësuar këtë promovim, i cili përbën dhe njësinë kryesore të analizës do të kërkohet të analizohet legjitimiteti që BE përdor në nivel të institucioneve qeverisëse të Kosovës dhe në angazhimin që marrin aktorët e tjerë të brendshëm si shoqëria civile.

Kësisoj, për kë kuptuar rreth qasjes së fuqisë normative që BE përdor ndaj promovimit e të drejtave të njeriut, së pari do të nevojitet të shpjegojmë çfarë janë të drejtat e njeriut (burimin) dhe së dyti si institucionalizohen (legjitimohet përdorimi). E thënë me fjalë më të thjeshta do të përpiqet të kuptohet pse janë të rëndësishme të drejtat e njeriut dhe në çfarë mënyrë mund ti përdorim. Në këtë kontekst do të përdoret modeli evropian i të drejtave të njeriut i ngritur mbi konceptin e demokracisë kozmopolite, i cili i përgjigjet njëherazi të dy parakushteve – burimet dhe legjitimitetit. Për këtë do të përdoren kontributet akademike të teoricintëve si Daniele Archibugi, David Held etj., – (Archibugi 2004, Held 1995, Freeman 2002, Pogge 2000, Raz 2006, Besson dhe Utzinger 2007, Besson 2003, Bellamy 2008, Habermas 2001, Chandler 2003, Goodhart 2003, 2005) – të cilët shohin në këtë model dhe formën më të mirë të aplikimit universal – por që duhet të kuptohet në kontekstin rajonal – të mbrojtjes dhe forcimit e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Ky konceptualizim dhe parashtrim modeli i shërben pikërisht teorizimit mbi fuqinë normative që BE përdor duke e kuptuar nëpërmjet legjitimitetit që ushtron. Ndaj

promovimi i të drejtave të njeriut të BE, i ka rrënjët e konceptimit politik që në fillesat e debateve teorike se çfarë llojë fuqie po ndërtohej me projektin evropian, i cili gjatë viteve 1970-ta po merrte gjithnjë e më shumë një dimension politik – zgjedhjet e para me votim të drejtpërdrejtë në Parlamentin Evropian në 1979 – si dhe proceset që do të vijë mësonin me fuqizimin e këtij dimensionit politik. Kështu njohja e parë shtrihet midis modeleve të fuqisë që Komuniteti Ekonomik Evropian (KEE) po krijonte përkundrejt vendeve që kërkonin të antarësoheshin në të dhe ndaj atyre vendeve që komuniteti kërkonte një partneritet të veçantë. Këtu bëhet fjalë për teoricienët e fashës së dytë të integritit evropian, të cilët e shihnin KEE përtej kufijve të saj gjeografik. Johan Galtung (1973) dhe Francois Duchene (1972) shihnin pikërisht te KEE një fuqi civile dhe ideologjike, ku qasjet e drejtonin në krijimin e një fuqie të butë, të elaboruar më vonë dhe nga Joseph Nye (2004) në librin e tij të njohur i cili argumenton mbi mënyrat e suksesit të fuqisë së butë në politikën botërore – ku rasti i BE shërben si model i suksesshëm.

Duke u rikthyer në modelin teorik që kjo tezë kërkon të ndërtohet duhet të theksohet një fakt mjaft i rëndësishëm që lidhet me vetë natyrën e veprimit të jashtëm të BE. Kështu, me krijimin e politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrotjes me traktatin e Maastrichtit si shtylla e tretë e KEE – BE – në 1992 e cila do të shndërrohej në Shërbimin Evropian i Veprimit të Jashtëm (SHEVJ) në 2010 do të elaborohej nga Manners (2002; 2006; 2008; 2013) dhe Nathalie Tocci (2008; 2011; 2014). Këta të fundit kanë argumentuar në tezat e tyre kryesore se si është shndërruar fuqia normative e Bashkimit Evropian. Për ta, BE është një komunitet i ndërtuar mbi vlera dhe norma të përbashkëta të cilat janë pjesë e pandalshme e vetë procesit të integritit i cili mund të kuptohet më së miri si një dikotomi midis zgjerimit të hapësirave gjeografike dhe nga ana tjetër thellimit të integritit të politikave të përbashkët në nivel mbikombëtar dhe ndërqeveritar. Vetë Manners argumentonte se Bashkimi Evropian kërkonte të vetë-identifikohet si një fuqi normative, fill pas fundit të Luftës së Ftohtë, pasi konstelacioni i mëparshëm nuk i lejonte asaj të kishte një politikë të jashtme të ndryshme nga dikotomia ideologjike “Perëndimi përkundrejt Lindjes”. Në këtë mënyrë ajo nisi një qasje të orientuar më tepër ndaj parimeve, duke e pozicionuar atë me një theks të veçantë ndaj parimeve të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit (Manners 2002: 52).

Nga ana tjetër kontributi i Niemann dhe Bretherton (2013) mbi fuqinë normative argumentojnë se cila sipas tyre nuk ka një përkufizëm që mund ti atribuohet çdo lloj aktori ndërkombëtar i cili paraqitet se shfaq një fuqi normative. Ndaj duke ardhur në kontekstin e BE ai duhet të kuptohet mbi shtrirjen dhe burimet që përdor si një aftësi për të projektuar së jashtëmi normat dhe vlerat të cilat mbarten së brendëshmi si (demokraci, të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit), dhe kështu në një mënyrë për të kuptuar se çfarë duhet të jetë normale në marrëdhëniet ndërkombëtare duke e parë nga këndvështrimi i standartizimit (Niemann dhe Bretherton 2013: 132-139).

Sërisht duke u mbështetur në kontributin e studiuesit Ian Manners, kërkohet të shpjegohet se “çfarë e bën BE të ndryshme nga pretendimi i vetë-shpallur prej saj si një fuqi normative, kur dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë si Shtetet e Bashkuara, Kina, India etj., pretendojnë se janë fuqi normative?” Sigurisht sipas, Manners ka një përgjigje ndaj saj duke argumentuar se, “BE ka qenë, është dhe gjithmonë do të jetë një fuqi normative në politikën botërore”, pasi sipas tij, ky dallimi normativ lidhet me kontekstin e saj historik, një formë shteti hibrid, dhe një kushtetutë politike ligjore (Manners 2008: 157).

Kështu së pari, fuqia normative gjendet në kontekstin historik të BE dhe në natyrën të identitetit ndërkombëtar të saj. Sipas Scheipers dhe Sicurelli (2007), “proçeset e ndërtimit të identitetit janë të përfshira në vetë krijimin dhe formësimin e BE si një fuqi normative”. Ky burim i fuqisë normative gjendet pikërisht në kontekstin juridik, politik dhe institucional të BE, për të cilin do të flitet përgjatë kapitullit të tretë.

Së dyti, fuqia normative është supozuar se është krijuar nga tendenca e BE për të vepruar si një “fuqi e mirë” në politikën ndërkombëtare, e cila formëson konceptet e ‘normales’ dhe standartit të përbashkët të sjelljes mbi mbrojtjen universale e të drejtave të njeriut. Sipas Michelle Pace (2007) ndërtimi i BE si një normë shpërndarës *vis-à-vis* partnerëve të saj të Mesdheut Jugor kishte për qëllim të formësonte dhe të modifikonte vetë sjelljen e tyre ndaj të drejtave të njeriut, demokracisë e shtetit të së drejtës.

Së treti, mungesa e instrumentave ushtarak, në fakt është konsideruar si një karakteristikë kyçe e fuqisë normative të Bashkimit European. Ky argument gjen mbështetje në konceptin e Duchene të ‘fuqisë civile Europiane’, i cili argumentonte se BE ishte një

aktor ndërkombëtar i ndryshëm, pasi ajo përdor mjete civile ‘të buta’, në vend të masave shtrënguese ushtarake, për të manaxhuar dhe zgjidhur konfliktet ndërkombëtare.

Sipas Karen Smith (2003), studiuesit bashkëkohor, i shohin këto si karakteristikat bazë të veprimit të jashtëm të BE, duke i përforcuar aftësitë politike dhe ekonomike për tu manaxhuar diferencat në mënyrë paqësore. Në këtë kuptim këto karakteristika kyçe të fuqisë normative të BE, e përshpejtojnë angazhimin për ti vendosur normat e të drejtave të njeriut në një pozicion të rëndësishëm në marrëdhëniet e brendshme të institucioneve të BE me vendet anëtare si dhe me vende të tjera. Njëherazi ato ndërtojnë strategjitë e veprimit në përdorimin e Kirtoreve të Kopenhagenit në procesin e zgjerimit, Politikën Europiane të Fqinjësisë, Politika e *DG Near*, konsultimet e të drejtave të njeriut, zhvillimet e shoqërive civile, Partneriteti Strategjik BE-Afrikë dhe shumë të tjera.

Megjithatë tema jonë është e kufizuar në strategjitë e veprimit të fuqisë normative të BE në promovimin e të drejtave të njeriut brenda procesit të zgjerimit. Ndaj ato do të shihen në lidhje me burimet e mundshme të legjitimitetit, ato të cilat janë të jashtme ndaj vetë konceptit të fuqisë normative. Përdorimi i legjitimitetit në procesin e zgjerimit mbi fuqinë normative evropiane është elaboruar së fundmi nga Gergana Noutcheva (2012) në librin e saj, “Politika e Jashtme e BE dhe Sfidat e Antarësimit të vendeve të Ballkanit – Kushtëzimi, Legjitimitetit, Përputhshmëria”. Argumenti kryesor i këtij studimi bazohet në faktin se variacioni në përputhshmërinë e sjelljes së qeverive të Ballkanit varion nga tre faktorë kryesorë. Së pari nga ushtrimi i legjitimitetit ndaj kushteve të BE, i cili mund të shihet nga aktorët e brendshëm në shtetet e antarësuar, kandidate, potencial kandidate dhe me një të ardhme në BE. Së dyti, nëpërmjet kostove që rrjedhin nga përputhshmëria e qeverive të vendeve përkatëse. E ndërsa së treti, nga aftësia dhe vullneti i BE, për të përdorur burimet e fuqisë superior të saj për të imponuar respektim kur përballet me “mos-bindje” të brendshme.

Në këtë mënyrë për të analizuar burimin e legjitimitetit që BE ushtron në rastin e Kosovës do të duhet ta shohim nëpërmjet aksesit procedural - legjitimitet procedural (Buchanan dhe Keohane 2006, Beetham 2006, Bickerton 2001, De Burca 2003, Radaelli 2000, Schimmelfennig dhe Sedelmeier 2005, Ivanov 2008, Petrov 2008, Sasse 2008, Schimmelfennig 2008, Simmons 1999) duke huazuar argumentin e Simmons se, “një

politikë e cila është koherente dhe procedurale, mundet ende ti mungojë legjitimiteti nëse nuk perceptohet si ‘e ligjshme’, e veçantë, moralisht e pranueshme apo e përshtatshme nga shoqëria” (Simmons 1999: 749). Gjithashtu për legjitimitetin si njohje nga të tjerët “jo evropianë” dhe legjitimiteti substancial (Diez 2005, Flockhart 2010, Diez dhe Manners 2007, Lord 2005, Hurd 1999), sipas elaborimit kryesor të Hurd, ky legjitimitet shihet si besim normativ nga një aktor, duke e parë një rregull të një institucioni” – në rastin tonë normat e të drejtave të njeriut ndaj Kosovës – “si detyruese” (Hurd 1999: 381). Nga ky prezantim i fushës së studimit dhe debateve akademike të parashtruara më sipër do të na lejojë të drejtojmë në elaborimin gjatë kapitullit të dytë të analizimit teorik dhe modelit analitik që do të përdoret në këtë punim doktoral.

1.3. Metodologjia

Pasi elaboruam problematikën e këtij hulumtimi dhe qëllimi e vetë tezës, në këtë seksion do të na duhet të kuptojmë aplikimin e metodologjisë që do të përdoret për të interpretuar kuptimet, shkaqet dhe implikimet e legjitimitetit në promovimin e të drejtave të njeriut të BE ndaj Kosovës në nivel elitash të institucioneve qeverisëse dhe në nivel të aktorëve të tjerë si organizata e shoqërisë civile. Përveç kësaj do të shpjegohet metodologjia e secilit kapitull si atyre konceptuale ashtu dhe empirike.

Në një vështrim të përgjithshëm, kjo tezë doktrale do të bazohet si një studim analitik, duke përfshirë teori dhe modele ekzistuese për të analizuar fenomene specifike në një studim rasti nga qasja empirike. Kështu teza do të jetë një studim cilësor, duke përdorur metoda cilësore. Në këtë mënyrë punimi do të ndahet në dy seksione kryesore. Së pari do të parashtrohet kuadri teorik, historik dhe modeli analitik. Në seksionin e dytë do të parashtrohet analiza empirike. Secili seksion do të jetë i përbërë nga tre kapituj. Metodologjia që do të përdoret për të shkruar këtë tezë doktrale do të jetë një kombinim shfletim të literaturës; analizë dokumentash, raportesh, strategji veprimi, kuadri ligjor, ligjesh, deklaratash; analizë e burimeve historike dhe përdorimin e intervistave gjysëm të

strukturuara me zyrtarë të lartë institucionesh shtetërore, specialistë, aktivistë të fushave përkatëse, etj.

Përzgjedhja e metodës, shfletim literature do të mundësojë njohjen e një kornize të gjerë të kuadrit teorike, duke identifikuar debatet kryesore akademike në teorizimet e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në kuadrin e fuqisë normative të BE, politikës së jashtme së saj, fill me nisjen e proceseve të “thellimit” të Unionit – 1999 e në vazhdim. Një kombimin e kontributeve teorike dhe empirike do të thellojnë argumentin e tezës sonë për të kuptuar fuqinë normative të BE në kuadër të promovimit e të drejtave të njeriut në një rast specifik si Kosova, mbi burimet e legjitimitetit që ushtrohet kjo politikë e jashtme e saj.

Përdorimi i analizë dokumentash si raporte, strategji veprimi, kuadri ligjor, ligjesh, deklaratash, do të shërbejë për të kuptuar dhe analizuar më në thellësi proceset që implikojnë përdorimin e legjitimitetit të promovimit e të drejtave të njeriut të BE në rastin e studimit tonë. Në rdhë të parë ato do të përdoren si citime të drejtpërdrejta në tekst për të evidentuar fenomene specifike dhe prçese të ndryshme. Dhe në radhë të dytë ato do të përdoren për të analizuar gjuhën politike në tekst.

Së fundmi përdorimi i intervistave gjysëm të strukturuara do të mundësojnë njohjen më të thelluar të fenomeneve specifike dhe rasteve të proceseve të ndryshme të cilat implikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë analizën e legjitimitetit të fuqisë normative të BE në Kosovë, e parë kjo në nivel të institucioneve qeverisëse dhe të shoqërisë civile. Gjithsej janë zhvilluar dhjetë intervista dhe të gjitha janë zhvilluar përgjatë muajt korrik 2015, me një parapërgatitje prej afro gjashtë muajsh. Të intervistuarit janë njohur me tematikën e studimit dhe kanë miratuar përdorimin e materialeve audio që janë regjistruar përgjatë saj. Përzgjedhja e të intervistuarve nuk është rastësore, por secili prej tyre përfaqëson një personalitet të rëndësishëm për fushën e tij, çka do ti japë analizës së studimit tonë një thellim dhe evidencë empirike të caktuar për çështje respektive. Kjo metodë do të përdoret së pari për të thelluar njohjen në një çështje të caktuar (psh. Zyrtare e lartë për çështjet e barazisë gjinore pranë institucionit të Avokatit të Popullit do të ofrojë një prespektivë institucionale të mbrojtjes së drejtave të grave në Kosovë). Ndërsa së dyti si evidencë empirike në argumentimin për një çështje të caktuar (e njëjta e intervistuar do të ofrojë një prespektivë për forcimin e të drejtave të njeriut në Kosovë).

Duke u përqëndruar në studimin tonë, projekte të ngjashme kërkimore mbi promovimin e të drejtave të njeriut të BE si një fushë studimore e caktuar hulumtimi ka qënë shpesh e krijuar në kontekstin e studimeve se si vepron BE ndaj vendeve kandidate dhe atyre të treta. Smith (2008), na sygjeron një kornizë hulumtimi shkencor i cili nuk fokusohet posaçërisht vetëm në proceset e politikave kombëtare ashtu dhe atyre të BE, por ai i trajton ato së bashku si procese të dy variablave të ndërlidhura. Sipas kësaj ideje projekti kërkimor për promovimin e të drejtave të njeriut të BE mund të organizohet si studim i aktivitetit të BE si kombinim i variablave të varur dhe të pavarur.

Kështu kur do të duam të analizojmë aspekte të ndryshme proceduriale të politikave të BE të cilat rrjedhin si pasojë e zhvillimeve institucionale, promovimi i të drejtave të njeriut do të shihet si variabël i varur. Kjo nuk nënkupton se aktivitetet e BE në fokus të drejtat e njeriut nuk shërbejnë thjesht si një dëshirë për të influencuar fuqinë politike. Në kuptimin praktik, përdorimi si variabël i varur do të ndodhë kur do të studioj instrumentat e politikës së BE në Kosovë (kapitulli i katërt) dhe si variabël i pavarur kur do të studioj qasjen institucionale nga lartë-poshte dhe qasjen e shoqërisë civile nga poshtë-lartë në promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë (kapitulli i pestë dhe i gjashtë).

Në procesin e përmbushjes së plotë të qëllimit të kësaj teze doktrale, analiza e legjitimitetit do të zhvillohet nëpërmjet kuadrit ‘të fuqisë normative Evropiane’. Siç u diskutua dhe në seksionin e literaturës fuqia normative e veprimit të jashtëm të BE u prezantua në lidhje me idetë e fuqisë transformuese, civile, etike, dhe të butë në analizën e sjelljes ndërkombëtare të BE. Megjithatë ekziston një mungesë në literaturë kur vjen fjala se si fuqia normative e BE ushtron ndikim ndaj vendeve të synuara (nëpërmjet zgjedhjes racionale ose socializimit), se si lidhet ndaj aspekteve më të vështira të veprimit të jashtëm të BE (si psh. interesat ekonomike) dhe si mund të matet ajo në mënyrë empirike. Ndaj është për këtë arsye përse legjitimiteti do të shtjellohet për të interpretuar rolin normativ të BE nëpër botë në gjuhën analitike të legjitimitetit. Në këtë kuptim koncepti i legjitimitetit përfshin një komponent normativ i cili nuk është i lidhur ngushtësisht ndaj konceptit tradicional të fuqisë por mund të aplikohet në të gjitha situatat politike dhe në të gjitha llojet e politikave.

Kështu diskutimi rreth projektit kërkimor për veprimin e jashtëm të BE lidhet me një debat shumë më të gjërë mbi studimet të cilat analizojnë kompleksitetin e fushave të politikës së jashtme të BE. Pra nëse pranojmë veprimin e jashtëm të BE si një sistem qeverisjeje i cili merr mekanizma, proçese dhe proçedura nga nivelet supranacionale dhe kombëtare, ajo më pas mundëson një fushë produktive për të testuar legjitimitetin si një fuqi normative kryesuese në promovimin e të drejtave të njeriut anembanë botës. Ky aspekt i veprimit të jashtëm të BE, na lejon ti shohim me kujdes normat, strategjitë dhe impaktin ndërkombëtar që krijon.

1.3.1. Metodologjia e përdorur në proçesin e mbledhjes së të dhënave dhe zhvillimit të analizës

Studimi i legjitimitetit të promovimit e të drejtave të njeriut në Kosovë do të nisë me një trajtim se si i gjejmë burimet dhe legjitimitetin për të përfutur të drejta të njeriut dhe prej këtej do të argumentohet se modeli europian nëpërmjet elaborimeve teorike të demokracisë kozmopolite plotëson këto dy parakushte. Kjo do të na ndihmojë për të thelluar argumentin teorik se si të drejtat e njeriut mund të promovohen së jashtëmi nëpërmjet fuqisë normative dhe ushtrimit të legjitimitetit përkatës. Në këtë kuadër do të zhvilloj një analizë konteksti analitik të aplikimit të fuqisë normative duke u fokusuar në variantet e ushtrimit të legjitimitetit të cilat i japin një drejtim pyetjes kërkimore specifike dhe vlerë rastit studimor të kësaj teze. Pra përdorimi i legjitimiteti substancial, proçedural dhe njohje e të tjerëve, të elaboruar tashmë në seksion e fushës së studimit dhe debatit akademik.

Metoda e aplikuar në kapitullin e dytë, pra kontekstit teorik dhe modelit analitik të studimit të promovimit e të drejtave të njeriut të BE nëpërmjet fuqisë normative në kuadër të ushtrimit të legjitimitetit do të bazohet në shqyrtim literature. Këtu literatura përbehet nga një listë e thelluar që përfshin monografe, kapituj librash dhe artikuj akademik mbi fuqinë normative të BE dhe legjitimitetin, e cila reflekton transformimet politike të integritit Europian dhe studimet e politikës së jashtme të saj nëpërmjet debateve normative përbenda disiplinës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Qëllimi është të identifikojë se si njohja akademike është thelluar me kalimin e kohës, dhe se si disa prespektiva kanë ndryshuar në lidhje aplikimin e koncepteve të fuqisë normative dhe legjitimitetit, në

operacionalizimin e rasteve empirike. Ajo përfshin studime si teorike ashtu dhe empirike në studimin multidisiplinor të debateve teorike të shkencave politike, studimeve evropiane dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare duke u ndalur në fuqinë normative dhe përdorimin e legjitimitetit. Gjithashtu do të përfshihen si studiuesit kryesor që mbështësin argumentin në seksionet përkatëse ashtu dhe kritikën ndaj tyre. Në përfundim, shfletimi literature si metodë do të ndërtojë bazën e aplikimit të marrëdhënieve BE-Kosovë përbrenda procesit të zgjerimit.

Prej këtej do të vazhdojmë të shohim aplikueshmërinë e këtij konteksti teoriko-analitik nëpërmjet një kontekstit historik të zhvillimit të kësaj politike, duke diskutuar aplikimin e të drejtave të njeriut në procesin e integritetit të BE dhe përse do të na duhet ta kuptojmë në lidhje me legjitimitetin. Kështu do të nisim duke inkuadruar promovimin e të drejtave të njeriut në literaturën e gjërë e integritetit Evropian, në mënyrë për të zhvilluar një lidhje midis zhvillimit të narrativës së të drejtave të njeriut të BE dhe se si kjo na drejton se çfarë është e pranueshme apo jo në politikën e sjelljes në arenën ndërkombëtare. Për këtë qëllim, diskutimi do të nisë duke nënvizuar zhvillimin historik të BE në fushën e të drejtave të njeriut, si së brendshmi ashtu dhe së jashtëmi. Kjo do të ndiqet me studimin se si vepron kushtëzimi me politikën e gjerë të promovimit e të drejtave të njeriut në marrëdhëniet e jashtme të BE dhe të zgjerimit në veçanti.

Ndërkaq studimi i zhvillimit historik të promovimit e të drejtave të njeriut të BE, përgjatë kapitullit të tretë do të bazohet në përdorimin e shqyrtimit të literaturës por dhe analizë dokumentash. Në mënyrë për të hulumtuar zhvillin e brendshëm dhe të jashtëm të narrativës së të drejtave të njeriut të BE, do të na duhet të zhvillojmë një analizë historike në zhvillim. Ajo në fillim do të paraqesë krijimin e normave e të drejtave të njeriut të BE dhe mekanizmave institucionale, dhe më pas elementët përkatës të politikës së të drejtave të njeriut. Kjo analizë do të na shërbejë për të ilustruar procesin e politikave në analizën tonë, pasi thekson kompetencat juridike të BE në fushën e të drejtave të njeriut, ndërveprimin e sistemit të brendshëm dhe të jashtëm e të drejtave të njeriut të BE dhe veprimet e ndryshme që marrin pjesë në institucionet e BE si Komisioni dhe Parlamenti Evropian. Këtu do të ndalemi në analizë dokumentash themelore të traktateve të Komunitetit Ekonomik

Evropian dhe BE, traktatet e antarësimit të vendeve antare, opinioneve të Komisionit Evropian, deklaratave të Këshillit të BE, rezolutave të Parlamentit Evropian etj.

Analiza e zhvillimit të politikës së të drejtave të njeriut të BE u zhvillua nga një analizë dokumentash teksteve juridike dhe dokumentave të ndryshme të saj. Përzgjedhja e kësaj metode është mjaft e rëndësishme pasi arrin të nxjerr në pah zhvillimet e një politike të caktuar, duke bërë që argumentat e saj të varen nga një shumëllojshmëri aspektesh dhe të mundësojë një rishikim të këtyre të fundit (Bell, 2010: 91). Periudha e marrë në shqyrtim është prej themelimit të Komunitetit Ekonomik Evropian në 1957 dhe deri në ditët e sotme. Të dhënat përgjatë periudhës 1950-1980 janë përzgjedhur nga aksesimi i drejtpërdrejtë në bibliotekën virtuale të Qendrës së Studimeve Ndërsipinore me bazë në Forli të Italisë dhe Sarajevë në Bosnje dhe Hercegovinë, e cila përdor fondin e përgjithshëm të bibliotekës së universitetit Alma Mater të Bolonjës. Ndërsa të dhënat e përzgjedhura prej vitit 1980 e në vazhdim janë aksesuar në uebfaqen e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Gjithashtu duhet të vë në dukje se, përfshirja e vendimeve të gjykatës Evropiane është bërë për të theksuar aplikimin e të drejtave të njeriut në BE. Kështu përzgjedhja e çështjeve të hershme përkundrejt çështjeve më aktuale është bërë për të kuptuar modelin politiko-institucional të zhvillimit të politikës së të drejtave të njeriut dhe jo për të treguar rëndësinë karshi çështjeve të mëvonshme.

Ndërkaq duke vazhduar më tej në kapitullin e katërt, pestë dhe të gjashtë do të zhvillohet analiza empirike e cila në fillim do të shtjellojë se si vepron BE në Kosovë në kuadër të promovimit e të drejtave të njeriut nëpërmjet fuqisë normative dhe ushtrimit të legjitimitetit. Këtu do të fokusohemi në instrumenta politik dhe instrumenta infrastrukturues ose financues duke argumentuar me nivelin e legjitimitetit të promovimit e të drejtave të njeriut në Kosovë – analizë për secilën të drejtë dhe liri themelore të marrë në shqyrtim nga ky studim. Më tej në dy kapitujt e mëpasshëm empirik, ky legjitimitet do të testohet në nivel institucionesh shtetërore ose qeveritare të mbrotjes, forcimit e të drejtave të njeriut në Kosovë pra qasjes nga lartë-poshtë dhe në nivelin e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë pra nga poshtë-lartë.

Kapitulli i parë empirik dhe katërt në vazhdimësi të këtij punimi doktoral do të përfshijë përdorimin e metodave kryesisht të fokusuar në analizë dokumentash, strategjish

veprimi, deklaratash të institucioneve të BE dhe përfaqësimit të tyre të jashtëm përkatës në rastin studimor të Kosovës. Progres-raportet e Komisionit Evropian për Kosovën do të zënë një dimension të vlefshëm për zhvillimin e këtij kapitulli. Këtu do të merret në shqyrtim progres-raportet prej vitit 2008 deri në 2014. Gjithashtu përdorimi i të dhënave dytësore nga raportet dhe indekset të organizatave ndërkombëtare si Freedom House do të japin një qasje më objektive se si janë promovuar të drejtat e njeriut në Kosovë nga BE. Nga ana tjetër transkriptet e dy prej interstave do të zbardhen dhe do të përdoren si burime parësore në përputhje me argumentat e analizës përgjatë këtij kapitulli

Kapitulli i pestë dhe i gjashtë do të vazhdojnë të jenë kapitujt empirik. Ku në kapitullin e parë do të analizohet qasja nga lartë-poshtë e mbrojtjes dhe forcimit e të drejtave të njeriut, pra prej kuadrit ligjor, politikave dhe strategjive që kanë influencuar institucionet e Kosovës në këtë drejtim. Përdorimi i analizë së dokumentave, strategjive kombëtare për secilin të drejtë dhe liri themelore të marrë në shqyrtim në këtë teze doktrale, kuadrit ligjor, pra analizimit të ligjeve në fuqi dhe atyre të amenduara. Ndërkaq këtyre burimeve parësore do tu shtohet dhe zbardhja e transkripteve të intervistave gjysëm të strukturuar me ekspertë dhe zyrtarë të lartë të institucioneve si Avokati i Popullit, Zyra për Qeverisje të Mirë, Ministria e Mirëqënies Sociale etj., duke përbërë kështu bazën metodologjike të këtij kapitulli.

Ndërsa në kapitullin e fundit empirik, atë të gjashtë do të fokusohet në përdorimin e intervistave gjysëm të strukturuar me aktivist dhe specialistë e të tre të drejtave të njeriut të marrë në shqyrtim. Konkluzionet e këtij punimi doktoral do të na prezantojnë së pari gjetjet e studimit teorik dhe empirik të temës dhe së dyti hapsirën metodike dhe akademike për hulumtime të mëtejshme në lidhje me rastin studimor në fjalë pra Kosovën por dhe të politikës së promovimit të drejtave të njeriut të BE e parë nga legjitimiteti. Në përfudim, disa rekomandime të cilat iu adresohen aktorëve lokalë dhe ndërkombëtar në Kosovë do ti mundësojnë këtij studimi një vlefshmëri praktike për të këshilluar aktorët e brendshëm të vendimarrjes politike mbi rëndësinë që merr kjo politike e jashtme e BE në Kuadër të përmirësimit e të drejtave të qytetarëve të tyre.

1.4. Kufizimet dhe rëndësia e punimit

Si në çdo studim analitik, empirik apo teorik rëndësia dhe kufizimet përbëjnë ndër elementët kryesor ndër të cilët parashtrohet punimi. Ndër mudësitë e reja që ofron ky studim, është zhvillimi i thelluar i politikave specifike të Bashkimit Evropian siç janë të drejtat e njeriut kundrejt një vendi potencial kandidat që është Kosova. Ajo zhvillon një këndvështrim analitik mbi debatet teorike të konceptimit të BE si një fuqi normative në raport me ushtrimin e legjitimitetit të saj.

Megjithatë rëndësia që sjell ky studim është të shpjegojë se përse do të duhet të studiohet promovimi i të drejtave të njeriut të BE ndaj një rasti studimi si Kosova. Nisur nga kjo, në këtë punim do të theksohet se është mjaft e rëndësishme të aplikohet prespektiva e legjitimitetit në politikat e të drejtave të njeriut gjatë procesit të zgjerimit. Kjo është e vlefshme pasi kërkohet të kuptohet promovimi aktual i të drejtave të njeriut të Bashkimit Evropian, pra ‘çfarë është duke bërë’ dhe potenciali më i mirë i saj, ‘se çfarë mund të bëjë’. Përdorimi i legjitimitetit transformon analizën e promovimit e të drejtave të njeriut nga një situatë që përshkruan një ushtrim negociatash të një marrëdhënie dypalëshe BE dhe institucioneve qeveritare të një vendi të caktuar si Kosova, ndaj një kuadri analitik në të cilën veprimi i të drejtave të njeriut në bazë të dinamikave lokale socio-politike duke përfshijë organizatat e shoqërisë civile mund të studiohen bashkërisht. Kjo përshtatet në agjendën e analizave të fuqisë normative të BE-së të cilat argumentojnë se ajo nuk mund të jetë një fuqi normative pa një njohje të jashtëm të legjitimitetit të saj (Noutcheva 2012: 145).

Në këtë mënyrë studimi i promovimit e të drejtave të njeriut të BE ndaj Kosovës shihet si një nevojë për tu thelluar në hulumtime të mëtejshme, përtej njohjes së zakonshme akademike - kryesisht e parë nga konteksti post-konfliktual² - pra marrëdhënia BE-Kosovë ndaj proceseve që lidhen me tranzicionin post-konfliktual, ndërtimin e paqes, shtet-

²Për më shumë shih studimet e Barnett, et al. 1999 “The politics, power, and pathologies of international organizations” (përkth. Politika, fuqia dhe patologjitë e organizatave ndërkombëtare), Fortna V. Page 2004, “Does peacekeeping keep peace? International intervention and the duration of peace after civil war” (përkth. A mund të sigurojë paqe, paqëruajtja? Ndërhijet ndërkombëtare dhe zgjatja e paqes pas luftërave civile), Kendra L. Koivu dhe Claire M. Metelits 2008, “Order and Discord in Post-Conflict Kosovo” (përkth. Rregull dhe mosmarrëveshje në Kosovën post-konfliktuale), Oya Dursun-Ozkanca 2009, “Rebuilding Kosovo: Cooperation or competition between the EU and NATO?” (përkth. Rindërtimi i Kosovës: Bashkëpunim apo konkureshmëri midis BE dhe Nato?”).

ndërtimin, ku BE është parë në rolin e promovimit të jashtëm si stabilizues duke përdorur mekanizma transformues konflikti. Së dyti, edhe pse teorizimet mbi fuqinë normative të Bashkimit Evropian paraqiten të shumtë dhe me një shumëllojshmëri tematikash, ekziston një nevojë për të qasur hulumtime më të thelluara në procesin e brendshëm që ndodhi në BE pas traktatit të Lisbonës ku të drejtat e njeriut dhe liritë themelore morën një dimension të ri duke u integruar së brendshmi dhe së jashtëmi në të njëjtën fuqi vepruese. Ndaj dhe studime të cilat fokusohen mbi promovimin e të drejtave të njeriut të BE, e parë si një fuqi normative, në raport me ushtrimin e legjitimitetit do të krijojnë baza teorike për studime të mëtejshme të dimensionit të ri Evropian. Dhe së treti, studimet që kanë në fokus rastin e Kosovës të hulumtuar së brendshmi, përqëndrohen në një nivel analize, duke mos u thelluar në aktorë të tjerë të brendshëm dhe mënyrën se si aktorë të ndryshëm ndërveprojnë me njëri-tjetrin.

Aktualisht Kosova është një vend potencial kandidat, e cila ka nisur negociatat e MSA në 2013 dhe ku është arritur firmosja e kësaj marrëveshje pas afro afro dy vjet në 2015. Nga ky këndvështrim, mund të themi se ndaj saj, ekziston një mungesë studimesh të cilat e shohin procesin e zgjerimit (integritit) në raport me mbrojtjen dhe reformat e brendshme e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të cilat nga ana tjetër përbëjnë një politikë tashmë mjaft të rëndësishme dhe të ndjeshme për BE, pasi ato janë vlerat dhe normat nëpërmjet të cilave është ndërtuar vetë identiteti politik i saj.

Nga ana tjetër ky punim paraqet disa kufizime. Kështu nëse do të hedhim një vështrim në fokusin kohor, punimi kufizohet prej vitit 2008 deri në vitin 2015. Ndërsa procesi formal i integritit të Kosovës në BE, në realitet ka nisur që prej deklaratës së Këshillit Evropian të vitit 2005, ku theksohej se edhe pse Kosova nuk ka të përcaktuar ende një status zyrtar, asaj nuk i humbet shansi për të patur një të ardhme në BE. Por ky studim ka patur qëllim që të analizoj aftësinë e institucioneve legjitime qeveritare të Kosovës dhe të shoqërisë civile nga ana tjetër dhe jo të një periudhe të mëparshme siç ishte para 2008. Në një farë mënyrë kjo mund të duket se e ka cunguar procesin, por gjatë punimit është theksuar se ky fokus kohor nuk është statik, ndaj shpesh është rikthyer në kohë për ta parë procesin të lidhur.

Një kufizim tjetër lidhet me mos diversifikimin e aktorëve të brendshëm si partitë politike, programet e tyre, qasjet e tyre ndaj të drejtave të njeriut të përzgjedhura në këtë studim si dhe një elementi etnik duke përfshirë minoritetin serb. Shpjegim për këtë kufizim në dukje, është në fakt se qëllimi i studimit është të hulumtojë mënyrën e promovimit të të drejtave të njeriut të BE në Kosovë duke analizuar qasjen e nivelit të institucioneve vendimarrëse dhe ligjzbatues si një, në këtë kontekst qeverinë dhe nga ana tjetër shoqërinë civile. Në rast se do kishte një zgjerim të tillë me aktorë të tjerë, evidencat dhe faktet e reja do ta vështirësonin vërtetimin e hipotezës sonë dhe kësaj do të duhej të shtrohej një pyetje kërkimore krejt e ndryshme.

Kufizimi i tretë dhe i fundit lidhet në fakt cilësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të përzgjedhura nga ky studim duke i testuar në terren. Të testuarit do të nënkuptonte përdorimin e metodologjie më komplekse për të përftuar të dhënat duke përdorur, pyetsorë apo metoda të tjera dhe njëkohësisht do të kërkonte detyrimisht një kufizim gjeografik, një komunë, një qytet apo një njësi administrative të caktuar. Kjo do të influenconte në krijimin e variablave të tjerë të pavarur, dhe në një farë mënyrë do të kërkohej një riformulim i fokusit studimor.

1.5. Përmbledhja e kapitujve

Përgjatë këtij kapitulli të parë u prezantua gjerësisht pasqyrimi i problematikës së këtij punimi daktoral, qëllimi, pyetja kërkimore, argumenti kryesor i cili do të përbëjë vektorin e gjithë analizës së punimit, nëpërmjet së cili do të zhvillohet analiza përgjatë kapitujve konceptual dhe atyre empirik. Kështu përgjatë këtij seksioni të fundit do të njihemi më një vështrim të përgjithshëm mbi përmbajtjen e secilit kapitull. Ky punim do të përmbajë dy kapituj teorik-konceptual dhe tre kapituj empirik. Në kapitullin e dytë në vijimësi por të parë të pjesës konceptuale do të studiohet prespektiva teorike. Kështu do të nisë të shpjegojë konceptet si të drejta të njeriut, modeli European nëpërmjet demokracisë kozmopolite, fuqia normative si koncept dhe fuqia normative si praktikë – i kuptuar si ushtrimi i legjitimitetit - nga teorizime të ndryshme. Së pari do të shpjegohen burimet dhe përdorimi ndaj të drejtave të njeriut. Këtu do të jepet një kënvështrim teoriko-konceptual se

nëpërmjet strukturave mbinacionale dhe ndërqeveritare si BE, të drejtat e njeriut mbrohen dhe zgjerohen për të gjithë. Kjo strukturë është e ngritur mbi norma dhe vlera të cilat njëherazi ajo i promovon së brendshmi dhe së jashtëmi. Prej kësaj, së dyti analizohet fuqia normative e BE. Dhe së treti burimet e legjitimitetit që ajo përdor në promovim të këtyre normave dhe vlera ndaj vendeve të treta. Ky kapitull do të vërë në dukje vlerën dhe zbatueshmërinë e këtyre tre burimeve: legjitimiteti si akses procedural (legjitimitet procedural), legjitimiteti si njohje nga të tjerët “jo evropianë” dhe legjitimiteti substancial. Ky diskutim do të pasohet nga një analizë e fuqisë normative të BE duke teorizuar se cilat hulumtime kryesore që përqëndrohen në përgjithësi mbi BE si një ‘fuqi e mirë’ dhe që ‘formëson konceptet e normales’ në sjelljen politike ndërkombëtare.

Kapitulli i tretë do të argumentojë mbi zhvillimin historik e të drejtave të njeriut në konceptualizimin juridik të saj (zhvillimi i të drejtës evropiane, traktatet formuese, vendimet e gjykatës evropiane ndër vite, institucionet e BE) duke vazhduar me studimin se si elementet e fuqisë normative të BE, të zhvilluara brenda zgjerimit nëpërmjet proceseve të ndryshme të vendeve kandidate të BE kanë arritur të influencojnë në si mbrojtjen dhe zgjerimin e brendshëm e të drejtave të njeriut të BE ashtu dhe promovimin së jashtëm. Ndër çështjet kryesore në këtë kapitull është të kuptohet se si ka arritur strategjia e BE në politikën e saj të zgjerimit ndaj vendeve kandidate apo potencial kandidate, si është edhe Kosova, duke përfshirë si qasjen nga lartë pishtë – institucionale-qeveritare – ashtu dhe atë nga poshtë-lartë, pra angazhimin e shoqërisë civile. Ky seskion do të jetë mjaft i rëndësishëm pasi do të paraqes evidencën teorike dhe strategjike që BE përdor ndaj vendeve si për të dalluar referencat kryesore të legjitimitetit në zhvillimin e politikave e të drejtave të njeriut të BE, duke na dhënë një model të zhvilluar ndër vite për ta kuptuar si zhvillohet në rastin e Kosovës.

Kapitulli i katërt do të jetë i pari në pjesën empirike të këtij punim doktoral. Kështu do të analizoj në lidhje me prezencën e BE në Kosovë duke nisur që prej vitit 2008, ku politikat mbi të drejtat e njeriut morën një dimension të rëndësishëm fushë-veprimi. Së pari do të analizohet roli i përfaqësuesit special të BE në Kosovë dhe angazhimi i tij në promovimin e të drejtave të njeriut; së dyti zyra e ndërmjetme e Komisionit Evropian dhe së treti nga zyra e EULEX mbi të drejtat e njeriut. Në të treja këto raste të përfshirjes së BE

në Kosovë do të analizohen në kuadër të modelit të legjitimitetit të elaboruar në kapitullin e mëparshëm. Gjithashtu secila e drejtë e marrë në shqyrtim përgjatë këtij punimi do të analizohet nga një prespektivë e BE nga viti 2008 deri në 2014 duke analizuar progresin e arritur në forcim dhe zgjerim e të drejtave të njeriut nga analiza e tekstit, kryesisht e bazuar në progres-raport, konferencat për shtyp, deklaratat e institucioneve të ndryshme të BE dhe duke i konfrontuar ato me burime të dyta ndërkombëtare si vlerësime të organizatave dhe institucioneve jo qeveritare dhe ekzpertizve të ndryshme.

Kapitulli i pestë dhe i gjashtë do të trajtojnë qasjen institucionale (lartë-poshtë) e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe nëpërmjet qasjes së organizatave joqeveritare të shoqërisë civile (poshtë-lartë) në secilën të drejtë dhe liri themelore të marrë në shqyrtim. Përgjatë këtyre dy kapitujve do të përdoren indikatorët që do të testojnë vërtetimin e hipotezave të parashktruara në seksionin përkatës. Në këtë mënyrë së pari do të përdoret indikator i përputhshmërisë së kuadrit ligjor, në kontekstin e legjitimitetit do të jetë legjitimiteti si ligjshmëri ose substancial. Më pas, indikator i aftësisë për të ndërmarrë dhe miratuar politikat e nevojshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë që janë në koherencë me standartet e BE. Dhe së fundmi indikator që vlerëson nivelin e implementimit të normave dhe vlerave të standarteve të BE mbi të drejtat e njeriut në Kosovë nëpër dy nivelet e analizës.

Më konkretisht Nëpërmjet këtij kapitulli – të pestë – do të paraqes së pari, kuadrin ligjor e të drejtave të njeriut në Kosovë, ndryshimet e këtij kuadri në ligje të posaçme. Më pas do të analizoj institucionet kushtetuese dhe ato ligj-zbatuese të cilat kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut në tërësi dhe në disa raste fusha të caktuara e të drejtave të njeriut, siç është rasti i Zyrës për Barazi Gjinore dhe më pas të mekanizmave implementues. Së dyti do të analizoj se si ka ndikuar procesi i reformave të ndërmarra nga institucionet qeverisëse të Kosovës në kuadër të mbrojtjes dhe forcimit e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Së treti do të krahasoj nivelin e mbështetjes financiare të fondeve IPA në Kosovë, progresin e evidentuar nga Komisioni European dhe evidencat e marra nga analizimi i të dhënave në terren.

Ndërsa në kapitullin e gjashtë do të shqyrtoj kuadrin ligjor që sot ekziston në kuadër të shoqërisë civile, rrjetin e organizatave jo qeveritare që llobojnë dhe advokojnë në mënyrë

aktive në kuadër e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore, të drejtat e komunitetit LGBTI dhe të lirisë së shprehjes. Së dyti do të analizoj qasjen nga poshtë-lartë për secilën të drejtë dhe liri themelore të marrë në shqyrtim dhe së treti qasjen e Bashkimit Evropian në këtë kuadër duke evidentuar në të dy seksionet e fundit iniciativat lobuese që kanë evidentuar ndryshim ligjesh rritje të ndërgjegjësimit qytetar dhe një përvojë më të madhe të bashkëpunimit shoqëri civile dhe institucione qeverisëse.

Kapitulli i fundit, përmbledhja e përfundimeve të këtij studimi doktoral do të vë në dukje përfundimet e analizës teorike dhe ato empirike dhe rëndësinë që ato i japin kësaj teme. Ajo do të nënvizojë rëndësinë për të adresuar disa rekomandime të cilat dalin si nevojë pas këtij studimi duke iu drejtuar dhe aktorëve kryesorë të brendshëm dhe të jashtëm të cilët influencojnë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë si dhe përmirësojnë promovimin e jashtëm të BE në këtë drejtim. Gjithashtu do të argumentohet se çfarë mund të shihet përtej këtij studimi doktoral, thellimi në studime të mëtejshme ose të parit e këtij rasti studimor në kushte të tjera.

KAPITULLI I DYTË

TË DREJTAT E NJERIUT DHE FUQIA NORMATIVE E BASHKIMIT EUROPIAN: NJË KORNIZË TEORIKE

2.1. HYRJE

Ky kapitull ka për qëllim të analizojë pjesën teorike të punimit të kësaj teze mbi promovimin e të drejtave të njeriut nga një perspektivë teorike të fuqisë normative të BE. Ndaj është e nevojshme të shpjegohen konceptet kryesore si të drejta të njeriut, modeli European nëpërmjet demokracisë kozmopolite, fuqia normative si koncept dhe fuqia normative si praktikë – e kuptuar si ushtrimi i legjitimitetit - nga teorizime të ndryshme. Për të arritur këtë kornizë teorike së pari do të duhet të kuptojmë se “çfarë janë të drejtat e njeriut?” dhe “çfarë do të thotë për ne ti kemi ato?” Kështu nëpërmjet një ballafaqimi teorik midis studiesish të shkencave sociale do të argumentohet se të drejtat e njeriut nuk i gëzojmë thjesht prej arsyes se ato burojnë nga ‘njerzoria’ jonë, por të drejtat e njeriut duhet të kuptohen si një njohje politike të mbrojtur institucionalisht në një komunitet të caktuar. Megjithatë vihet re se aplikimi i të drejtave të njeriut nuk është i njëjtë në çdo vend të botës, ndaj sërish do të shtrohet pyetja se përse nuk kemi një mbulim universal të mbrojtjes së të drejtave të njeriut? Kësaj pyetje do ti përgjigjemi se edhe pse në mungesë të instrumentave të mjaftueshëm ndërkombëtar, ekzistojnë disa struktura mbi-kombëtare me ndërveprime ndër-qeveritare si në rastin e Bashkimit Evropian, ku mund të sigurohet një mbrojtje si e brendshme – midis komunitetit të shteteve antare – ashtu dhe jashtë saj, duke promovuar vlera dhe norma që garantojnë liri dhe të drejta për çdo individ. Në këtë kuptim argumenti kryesor i kësaj pjesë do të ngrihet mbi demokracinë kozmopolite nëpërmjet BE.

Mbi këtë elaborim teorik do të vazhdohet me konceptualizimin e fuqisë normative të BE duke teorizuar se cilat hulumtime kryesore që përqëndrohen në përgjithësi mbi BE si një ‘fuqi civile’ e cila formëson sjellje “normale” në politikën ndërkombëtare në raport me të drejtat dhe liritë e individit. Pjesa e fundit do të shqyrtojë se si legjitimiteti mund të operacionalizohet për qëllime të analizës së fuqisë normative mbi promovimin e të drejtave të njeriut. Legjitimiteti në këtë kuptim, do të kuptohet si një kornizë analitike për analizën e fuqisë normative të promovimit e të drejtave të njeriut të BE-së ndaj Kosovës, të marrë në studim. Ajo ndihmon për të vlerësuar kapacitetin e BE-së dhe për të ushtruar në mënyrë efektive dhe të arsyeshme promovimin e të drejtave të njeriut, çka inkurajon një zhvillim të

tillë politik si dhe përmirësimin social ndaj vendeve të synuara duke mbetur 'në dialog' të vazhdueshëm me kontekstin e legjitimitetit të brendshëm të vendeve përkatëse.

Kësisoj përdorimi i legjitimiteti e transformon analizën e promovimit e të drejtave të njeriut, nga një situatë e parë në kontekstin e ushtrimit të negociatave ndërqeveritare BE-Kosovë, në një kornizë analitike në të cilat veprimtaria mbi të drejtat e njeriut në terren dhe dinamikat lokale socio-politike (duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile) mund të studiohen së bashku. Kjo i përshtatet axhendës së analizës së fuqisë normative të BE-së e cila argumenton se BE-ja nuk mund të jetë një fuqi normative pa një njohje të jashtme të legjitimitetit të saj. Ky kapitull do të vërë në dukje vlerën dhe zbatueshmërinë e këtyre tre burimeve: legjitimiteti si akses procedural (legjitimitet procedural), legjitimiteti si njohje nga të tjerët “jo evropianë” dhe legjitimiteti substancial. Kapitulli do të përfundojë duke argumentuar se një proces i promovimit e të drejtave të njeriut të BE-së që e krijon legjitimitetin e saj nga këto burime, ka potencialin për të kontribuar në ndryshim të qëndrueshëm për të drejtat e njeriut në Kosovë.

2.2 Një njohje ndaj të drejtave të njeriut

Të drejtat e njeriut kanë një trashëgimi të vjetër që prej konceptimit të parë prej Stoikëve, duke vazhduar me arsyetimin e Iluministëve dhe gjer në ditët e sotme. Kështu, ato paraqiten me një histori të gjatë në aspektin natyror të së drejtës nga e cila të drejtat e njeriut kuptohen si pohimi para-institucional që të gjithë individët kanë midis njëri-tjetrit, thjeshtë nga fakti se janë njerëzor (Simmons, 2001. 185). Kjo pikëpamje thekson aspektin moral e të drejtave të njeriut në kuptimin se të drejtat e njeriut janë një nëngrup të drejtash morale – një ndërmjetës midis interesave dhe detyrave – që artikulojnë një peshë të veçantë aspektesh morale, kryesisht ato të vlerave të mira materiale ose interesave që të gjithë njerëzit kanë (Cohen 2008; 581). Ky konceptim natyror mund të shpjegohet në dy elemente. Së pari, të drejtat e njeriut nuk shihen si një kontigjent ligjesh ekzistuese dhe praktikash sociale. Së dyti, konceptimi natyror i të drejtave të njeriut qëndron mbi idenë se baza për të bërë një pohim të drejtë qëndron në çdo natyrë të individëve ose status njerëzor (Beitz, 2009; 49-50).

Në këtë projektim njerëzorja e të drejtave mund të krijojë parimet morale që do të duhen të forcohen nëpërmjet një seti rregullash juridike, të afta për të rregulluar sjelljen e qeverive të shteteve ndaj qytetarëve të tyre respektiv në mënyrën kozmopolitane nëpërmjet universalizimit e të drejtave të njeriut. Ky universalizim nënkupton se e drejta për të patur dy nevoja bazike – liria dhe mirëqënia – janë të vërteta të pamohueshme, me një vlefshmëri universale dhe do të duhen të pranohen nga i gjithë njerëzimi. Pra, të drejtat janë pohime se si shoqëritë duhet të organizohen, ose më specifikisht mbi mënyrën se si individët duhet të trajtohen nga ata, nën autoritetin e një shoqërie. Kjo ndodh vetëm kur të drejtat mohohen, kur individët kanë nevojë për të drejtat e tyre. Kështu me përshpejtimin e globalizimit dhe pranimin në dukje të regjimeve e të drejtave të njeriut, si në nivel rajonal ashtu dhe atë global, do të duhet të mësohemi me faktin, se tashmë jetojmë në një botë ku institucionet e të drejtave të njeriut janë të njohura universalisht.

Kësisoj të drejtat e njeriut janë parë shpesh si një evoluim i Perëndimit, si një mjet për të mbrojtur individin relativisht të dobët nga marrëdhëniet e hershme sociale të familjes dhe komunitetit të cilat ishin më tepër statike se sa të qëndrueshme, kundrejt fuqisë së shtetit dhe tregut të botës post-industriale (Goodhart: 2003: 943). Të drejtat e njeriut janë konstrukte si një përgjigje e nevojshme mbi problemin e bashkëngjitur me fuqinë e shtetit modern dhe tregut modern. Kështuqë regjimi (Perëndimor) i të drejtave të njeriut i cili është i nevojshëm të mbrojë individët nga tejkalimi i fuqisë së shtetit është bërë një karakteristikë universale e nevojshme në virtut të faktit se modeli i organizimit politik dhe ekonomik Perëndimor është tashmë i kudondodhur anembanë botës. Ky proces “eksportimi” idesh dhe modelesh mund të mendohet se ka qënë i mundur vetëm nëpërmjet supremacisë Perëndimore në aspektin ushtarak dhe ekonomik.

Zhvillimi historik i të drejtave të njeriut na lejon të kuptojmë se një rikonceptualizim i të drejtave të njeriut sot, është i mundshëm, por aspak i dukshëm. Në kushte të tilla të drejtat e njeriut mund të marrin një karakter universalist vetëm nëse do të mund të bëhet ballw dallimeve normative sociale. Një përgjigje e mundur për këtë fakt na vjen e sygjëruar nga Rowan Cruft (2005) i cili i sheh besimet morale dhe fetare, në nivel komuniteti dhe individi, pa një rol qendror në justifikimin e të paturit të drejta të njeriut, universalisht. Kjo ndjek idenë se karakteristikat e së drejtës së justifikuar e një

individualiteti mund të jenë në mënyrë të pashmangshme epistemologjikisht të paaksesueshme. Por nga ana tjetër ky fakt e bën atë të mbetet të lidhur me të drejtat e njeriut si një praktikë universale e aftë për të mbrojtur individët nga rrisqet e dinjitetit njerëzor që vijnë nga faktorët e shtetit modern. Ky fakt nuk bie në kundërshtim me idenë se, nga dinjiteti njerëzor mund të kuptohen mënyra të ndryshme e të drejtave të njeriut dhe si një praktikë universale mund të nënkuptojë një kuptim të dinjitetit njerëzor i cili nuk është në fakt i ndarë universalisht.

Nëpërmjet kësaj qasjeje ne arrijmë ndaj së drejtës për antarësim e cila korrespondon me të drejtën e parë dhe kryesore të mendimit të Hana Arendt: “ato të drejta morale universale dhe gjithashu të drejtat ndërkombëtare juridike për antarësim janë të drejta të njeriut të cilat garantojnë përfitimet e mëtejshme e të drejtave të njeriut në secilin komunitet politik” (Cohen 2008: 595). Kështu ky komunitet politik me një kornizë juridike që parasheh ato norma ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, garanton liritë ndaj individëve nën një juridiksion të një shteti të caktuar, në njërën anë, dhe në anën tjetër ndaj aktorëve jo shtetëror – organizata ndërqeveritare ku në rastin tonë Bashkimit Evropian përbën një shembull *par excellence* - në kuadër të regjimit ndërkombëtar i të drejtave të njeriut, kryesisht të garantuara si, *erga omnes*. Sipas kësaj qasjeje të drejtat e njeriut janë politike në kuptimin se ato kanë një rol në vendosjen e standarteve ndaj marrëdhënieve ndërshtetërore dhe politikës ndërkombëtare në përgjithësi. Megjithatë, ky fokus mbi rolin e të drejtave të njeriut si një mjet i cili vendos limitet e sovranitetit dhe standartin për të legjitimuar përgjegjësinë e entiteteve post-kombëtare i mungon qëllimi ndërkombëtar i të drejtave të njeriut, në përgjithësi në legjitimitetin e brendshëm politik.

2.2.1. Regjimi ndërkombëtar i të drejtave të njeriut – modeli kozmopolitan i Bashkimit European

Debatet akademike mbi regjimin bashkëkohor ndërkombëtar e të drejtave të njeriut nisin me dyshimet mbi konsensusin e të ashtuquajturit debat mbi ‘vlerat aziatike’,³ duke

³ Debatë mbi vlerat aziatike nisi fill pas boom-it ekonomik të viteve 80-ta dhe 90-ta të shekullit të kaluar mbi mënyrën se si po i qaseshin vlerave perëndimore të drejtave të njeriut, liderat e vendeve të Azisë Juglindore duke kërkuar legjitimim ndërkombëtar dhe të brendshëm të modelit neo-liberal me masa autoritariste apo

nisur fill pas Deklaratës së Bangkokut të 1993 si një mënyrë për të paraprirë konferencën botërore të Vienës e të drejtave të njeriut. Thelbi i këtij debati ngrihej mbi mendimin e elitave politike të këtyre vendeve mbi mospërputhshmërinë e vlerave të shoqërive të vendeve respektive me ato të modelit e të drejtave të njeriut të sanksionuara në Kartën Universal e të Drejtave të Njeriut dhe nga ku individit është i nënshtruar të mirës së komunitetit dhe nga ku liritë politike dhe civile mbeten të varura ndaj lirive sociale dhe ekonomike, kështoj duke legjitimuar politikën që prioritetin zhvillimin ekonomik në disfavor të drejtave civile dhe politike (Langlois 2001:24).

Kjo mbivendosje nuk ishte e re por më tepër ndiqte debatin e hershëm mbi rëndësinë që duhet të kishin liritë politike dhe civile, të cilat merrnin karakter ‘negativ’ në rast se shteti nuk ishte i aftë t’ia siguronte shoqërisë, përkundrajt të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore që merrnin karakter ‘pozitiv’. Por në këtë rast liritë e para nënvlerësoheshin duke i favorizuar ato të rendit të dytë çka nënkuptonte një mospërputhje totale me mendimin e deriatëhershëm të vendeve me demokraci liberale dhe të bazuara mbi tregun e lirë.

Duke vijuar me analizë e krijimit të regjimeve ndërkombëtare e të drejtave të njeriut duhet të pranojmë se gjithçka nisi fill pas mbarimit të ngjarjeve të pakëndshme të Luftës së Dytë Botërore, me pasojat e Holokaustit dhe fuqia e frikës që krijoi regjimi nazist për një sërë grupesh etnike dhe sociale në vendet ku pushtoi. Kështu korniza e të drejtave të njeriut paramendon ekzistencën e funksionimit të shtetit sovran. Në këtë logjikë individët kanë të drejta kundrejt shteteve për të cilat shteti është i përgjegjshëm – vendet antare të Bashkimit Evropian ofrojnë prespektivën më të mirë. Megjithatë, Raz (2006) i sheh të drejtat e njeriut si një mënyrë për të limituar legjitimitetin e sovranitetit. Kjo në fakt ka qënë një qasje e përdorur kryesisht gjatë Luftës së Ftohtë midis dy blloqeve ideologjike pavarësisht cilën gjeneratë të drejtash ato favorizonin.

Ndërkaq, autorë si Thomas Pogge (2000) shohin një mënyrë të re për të kuptuar të drejtat e njeriut. Një ndër risitë kyçe të argumentit të tij është propozimi se, “përmbushja sesa shkelja, duhet të jetë standart nëpërmjet të cilit siguria e të drejtave të njeriut arrihet të

autoritarizmit relativ. Për më tepër rreth këtij debate akademik shih Bauer and Bell 1999:3-23; Othman 1999:171; Langlois 2001:12-45.

vlerësohet dhe nëpërmjet së cilës, kredencialet e të drejtave të njeriut të qeverive dhe institucioneve të tjera mund të gjykojnë” (Pogge 2000: 54). Ajo çfarë Pogge i referohet është fakti se *modeli institucional* që ai paraqet ndaj mbrojtjes së të drejtave të njeriut, është i ndryshëm nga *modeli ndërveprues*, i Raz (2006), duke u fokusuar në mënyrën se si të drejtat e njeriut funksionojnë, se sa mbi atë se nga çfarë ato janë të përbëra.

Modeli institucional i Pogge-s nuk është i vetmi që propozon zgjidhje dhe përmirëson qasjen empirike e kërkimit shkencor mbi të drejtat e njeriut. Kështu të kuptuarit e të drejtave të njeriut nën konceptimin e ‘demokracisë kozmopolite’ kanë qënë përcaktuar gjerësisht përgjatë zhvillimit të demokracisë liberale pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Në këtë mënyrë, demokracia nuk shihet vetëm nën kushtet e të drejtave të njeriut, por më së shumti si një skemë realizimi e këtyre të drejtave. Një qasje justifikuese instrumentaliste ose e pasojës e demokracisë i referohet faktit se demokracia mund të justifikohet nëse ajo prodhon përfundime më të kënaqshme se sa procedura vendimarrëse të tjera të vlefshme (Held 1995: 146). Megjithatë demokracia kozmopolitane shkon më tej nga ky justifikim i pasojës të demokracisë, duke sugjeruar se procedurat demokratike janë të tilla vetëm nëse ato të drejtojnë ndaj qëllimeve të dëshirueshme në kushtet e ligjit të demokracisë publike. Duke i marrë së bashku, të drejtat të cilat janë të supozuara të shndërrojnë njerëzit të jenë përfaqësues të barabartë në çështjet politike dhe sociale të shoqërisë së tyre, krijojnë atë çfarë Held e quan ‘e drejta publike demokratike’.⁴

Duke kombinuar ide universaliste, ku të gjithë qëniet njerëzore i përkasin një komuniteti moral të përbashkët me atë të demokracisë ideale, e cila është e atashuar më së shpeshti si e veçantë në kuptimin e presupozimit të përcaktimit të një komuniteti politik vetë-qeverisës, demokracia kozmopolite premton të kombinojë qasje institucionale universale e të drejtave të njeriut me demokracinë vetë-përcaktuese (Held 1995:149). Nëpërmjet këtij kuptimi, duke dashur të zgjerojë demokracinë në nivelet transkombëtare dhe përbrënda - midis shteteve - kozmopolitanizmi lidh të drejtat e njeriut me demokracinë

⁴ E drejta demokratike publike është një formë përshkruese e asaj çfarë Held parashtron të arrijë me dominimin e demokracisë kozmopolite në shkallë të gjërë botërore. Kështu duke adoptuar secili shtet të drejtën demokratike publike, një transformim i rrënjësishëm do të ndodhë në vetë të drejtën publike demokratike ndërkombëtare. Për më tepër rreth këtij argument shih Held, David. “Democracy and Global Order”, 1995.

neo-liberale si një mënyrë implementimi dhe institucionalizimi të një skeme të drejtash mjaft të gjera, fikse dhe të panegociueshme. Në këtë kuptim Held e ndërton këtë premisë nëpërmjet asaj që ai e quan ‘parimi i autonomisë’. Për ta forcuar pozicionin e tij, ai argumenton se: “çdokush ka të drejta dhe detyra të barabarta për të marrë pjesë në ndërtimin e sistemit politik i cili përcakton kushtet e tyre të jetës kolektive, duke marrë parasysh mos dhunimin e të drejtave të personave të tjerë” (ibid: 147). Nëpërmjet këtij projektimi të autonomisë, mund të kuptojmë si demokracinë ashtu dhe të drejtat e njeriut si vlera të fundme, arrijnë të mundësojnë zgjidhjen e tensionit të vazhdueshëm midis tyre. Por sërish ky konceptim i autonomisë nuk e qartëson se si arrihet përgjegjshmëria në kontekstin global.

Në këtë mënyrë duke marrë parasysh prespektivën kozmopolitane ne mund të shohim se të drejtat e njeriut dhe demokracia nuk mund të qëndrojnë dhe zgjerohen midis shtetesh dhe nivelesh transnacionale, për shkak të mungesës së një sistemi forcimi dhe llogaridhënieje në terma globale. Ndonëse projektimi i tyre duket utopik, kozmopolitanizmi e shih BE, si një formë niveli transnacional, e cila ishte organizata e parë e përbërë ekskluzivisht me regjim demokratik dhe me krijimin e institucioneve llogaridhënëse dhe forcuese. Qasja e demokracisë kozmopolite e përqëndruar në axhendën e të drejtave të njeriut në procesin post-nacional, përfaqëson vështirësi për tu përfshirë në nivelin e saj trans-kombëtar. E thënë me fjalë të tjera, konceptimi i të drejtave të njeriut i bën ato të pamundshëm për ti shërbyer qëllimeve të tyre për zhvillim politik dhe si një arbitër ku interesa dhe qëllime janë në konflikt me njëra-tjetrën. Në argumentat e Ignatieff, të drejtat e njeriut duken më së shumti si njëloj politike e cila duhet të japë përfundime të kënaqshme morale dhe institucione konkrete. Në këtë kuptim shohim një skematizim e të drejtave të njeriut që lidhet me faktin se axhendat implementohen nga komunitete politike (Ignatieff 2001: 233).

Duke kritikuar disa aspekte të demokracisë kozmopolitane, Michael Goodhart prezanton një konceptim të demokracisë transnacionale, të cilën ashtu si Held e shih demokracinë si një implementim dhe institucionalizim i një skeme të gjërë e të drejtave të njeriut. Në këtë mënyrë, Goodhart e emërton qasjen e tij ‘demokraci e të drejtave të njeriut’, e cila “e kupton demokracinë si një përgjegjësi politike ndaj emancipimit universal

nëpërmjet sigurimi të përshtatshëm të përbashkët e të drejtave themelore të njeriut” (Goodhart 2005: 150). Në këtë kuptim, Goodhart përpaket të ripërcaktojë kushtet për të kuptuar se si demokracia bëhet një mjet i institucionalizimit të drejtave të njeriut. Por nga ana tjetër problematika me këtë qasje nuk lidhet nga fakti se krijon mbivendosje të koncepteve të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, kështuqë demokracia merr kuptimin e asgjëje më shumë se sa një institucionalizim i të drejtave të njeriut.

Gjithashtu Chandler e kritikon kozmopolitanizmin, për zgjatimin e konceptit të së drejtës përtej kufijve të shtetit sovran pa patur një mekanizëm mbështetës nëpërmjet së cilës këto të drejta të reja institucionale mund të bëhen përgjegjëse ndaj subjekteve të tyre. Chandler argumenton se korniza kozmopolitane mund të legjitimohet vetëm nëse të drejtat ekzistuese të demokracisë dhe vetë-qeverisjes të zhbëhen, dhe një e drejtë e re demokratike e qytetarisë kozmopolitane mund të shndërrohet si një dukuri e parëndësishme (Chandler 2003:203).

“Në këtë kuptim, e drejta demokratike publike duhet të vendoset mbi procedurat demokratike dhe në këtë mënyrë kjo do të nënkuptojë se do ti nevojitet një sistemi qeverisës demokratik përtej modelit të shtetit-komb, pasi shteti-komb e ka humbur një pjesë të rëndësishme e autonomisë së tij politike duke rritur kështu rëndësinë e pavarësisë së institucioneve ndërkombëtare” (ibid: 208).

Nga ky elaborim i Chandler mund të kuptojmë se nëpërmjet një mungese të një qeverisje globale nuk mund të kemi një të drejtë publike demokratike universale që të jetë e aftë të përmbushi dhe përmbajë të gjithë të drejtat individuale dhe ato kolektive. Kjo, pasi nuk ekzistojnë deri më sot, mekanizma dhe instrumenta institucional të atilla, që të detyrojnë zbatimin e saj duke ditur se sjellja e shteteve në sistemin ndërkombëtar lidhet më së shumti me ndërveprimin ego-centrist të tyre. Ndaj ajo çfarë do të duhet të shikojmë përtej këtij realiteti është një proces demokratik post-nacional i cili do të mund të ofrojë një qasje shumë-dimensionale ku një organizim i ri politik-ekonomik do të jetë i aftë të veprojë midis dhe mbi entite të ndryshme. Kështu po të hedhim një vështrim nga eksperiencia empirike e deritanishme, Bashkimi Evropian përfaqëson shëmbullin më të përshtatshëm të një hapësire ku rendi i ri i të drejtës demokratike publike mund të veprojë.

Kështu studiues të ndryshëm shohin te modeli i Bashkimit Evropian kohezionin më të përshtatshëm për të integruar dhe zhvilluar parimet e demokracisë dhe të drejtave të

njeriut në epokën globale (Habermas 2001; Archibugi 2004; Held 1995).⁵ Brenda BE, vendet antare kanë një koordinim ndërkombëtar më të zgjeruar dhe kjo është e bashkëngjitur me fuqitë dhe funksionet që ka Bashkimi Evropian. Ekzistenca e së vetmes asamble ndërkombëtare që zgjidhet direkte nga votuesit e shteteve antare, Parlamentit Evropian, ofron garanci për suksesin e këtij modeli. Në fakt në Parlamentin Evropian, partitë kombëtare janë të organizuara në grupe evropiane sipas përkatësisë së programeve politike. Ky fakt tregon se institucionet formësojnë mënyrat se si interesat janë të organizuara në një nivel të përbashkët transnacional.

Nga kjo prespektivë, që nga konceptimi i hershëm i BE, asaj i janë atribuar vlerat kryesore të demokracisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, edhe pse në fazën e parë të integritimit ekzistonte një mospërputhje midis shteteve dhe institucioneve të reja të formuara, në lidhje se cili do të mbante këto përgjegjësi dhe kush do të ishte mekanizmi implementues. Megjithatë krijimi i mekanizmave trans-nacionale si Gjykata Evropiane e Drejtësisë, Karta e Lirive Themelore Evropiane, dhe mekanizmave të tjera si Agjencia Themelore Evropiane etj., do të përhapej midis të gjitha shteteve antare dhe në secilin subjekt të tyre do të përmbushej nga përgjegjësia e institucioneve supranacionale dhe zbatimin e të ashtuquajturës “e drejta publike demokratike” ose sipas studiuesit Richard Bellamy (2008), nëpërmjet të drejtës së qytetarisë së BE.

E drejta e qytetarisë së Bashkimit Evropian mund të konsiderohet si një e drejtë e njeriut, transnacionale dhe si rezultat i një përshtatshmërie midis konceptimit ndërkombëtar rreth të drejtave të njeriut – e parë kjo në fillimet e integritimit Evropian – dhe adoptimit të plotë e të drejtave të njeriut⁶ nga çdo shtet antar. Ajo çfarë bën në të vërtetë shtetësia e BE, është ofrimi i përparësive të së drejtave të qytetarisë së brendshme ndaj të gjithë qytetarëve të Bashkimit Evropian në çdo shtet antar dhe në çdo konceptim që kjo e drejtë përmbush (Besson dhe Utzinger 2007:581). Por në anën tjetër, ky qëllim i limiton në një farë mënyre ekuivalentimin e të drejtave të njeriut të brendshme. Kështu qytetaria që BE ofron gjer më

⁵ Për më tepër shih. Habermas Johan , 2001. “*Why Europe needs a constitution?*”; Archibugi Daniele, 2004. “*Cosmopolitan Democracy and its Critics*”; Held David, 1995. “*Democracy and the Global Order*”.

⁶ Siç do të ishte dhe rasti i Britanisë së Madhe me Aktin e të Drejtave të Njeriut në 2000 në mënyrë për ti paraprirë Kartës së Lirive Themelore Evropiane të kishte efekt të plotë dhe për qytetarët e saj. Megjithatë me hyrjen në fuqi të traktatit të Lisbonës në 2009, Karta mori efekte të plota ndaj dhe rëndësia e Aktit britanik ra. Për më tepër shih Amos, 2013 “*Transplanting Human Rights Norms*”,

sot nuk mundëson antarësim të plotë, për secilin individ të Unionit, rezident në një ndër vendet antare, siç mund të ishte e mundur të kishe të drejta politike kombëtare të njëjta me vendin e origjinës. Në këtë mungesë të komunitetit politik, qytetaria e BE mund të reduktohej në një grusht të drejtash individuale pa asnjë përgjegjësi të plotë në lidhje me detyrimet politike.

Në këtë mënyrë, qytetaria e BE do të duhet të bëhet plotësisht politike, dhe jo vetëm si një burim i të drejtave politike brenda aspektit të brendshëm të BE por gjithashtu si një burim i të drejtave politike në nivel të BE. Gjersa këto të drejta të njeriut dhe procese demokratike post-nacionale mbeten përbrenda kornizës së tensionit, e brendshme - e jashtme me të drejtat e njeriut ne do të duhet të kuptojmë se si vepron ushtrimi i legjitimitetit të fuqisë normative të BE në promovimin e jashtëm.

2.3. Fuqia Normative e BE në teori dhe praktikë

Një fokus mbi teorinë normative brenda disiplinës së marrëdhënieve ndërkombëtare ka qenë një fushë e rëndësishme e kërkimeve që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Megjithatë, ideja e fuqisë normative të Evropës i ka rrënjët në vetë teoritë ekzistuese të integritetit Evropian dhe të rolit të Bashkimit Evropian në sistemin ndërkombëtar. Kështu fillesat e saj i gjejmë më kuptimin e fuqisë civile, të Duchene (1972) dhe koncepti i Galtung (1973) si 'fuqi ideologjike' dhe 'fuqi idesh' (Manners 2002: 252). Në këtë drejtim koncepti i 'fuqisë normative të BE' është zhvilluar nga Manners, i cili u përpoq të kapërcej debatën normativ të politikës së jashtme të BE brenda Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Manners (2006) e justifikoi këtë koncept me argumentin se, fuqia normative e Evropës ishte e nevojshme për të formësuar një politikë të re të BE pas Luftës së Ftohtë, më shumë të orientuar ndaj një analize parimore, ku BE kishte vëmendje të veçantë ndaj parimeve të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Manners argumentoi se jo vetëm BE është e ndërtuar mbi një bazë normative, por mbi të gjitha ajo shihet se vepron në një mënyrë normative në kuadër të politikave ndërkombëtare (ibid: 190). Që prej publikimit të artikullit të tij në 2002, studiues të shumtë kanë nisur të përdorin konceptin për të zhvilluar studime

empirike dhe për të stimuluar abstraksione kritike teorike të bazës normative të politikës së jashtme evropiane dhe rolit të BE në arenën ndërkombëtare.

2.3.1. Dallimi normativ i Bashkimit European

Edhe pse nuk ka një përkufizim të përcaktuar mbi fuqinë normative të Bashkimit Evropian, ajo zakonisht pranohet si aftësia për të projektuar së jashtëmi normat dhe vlerat që i ka të integruar së brendshmi (demokracia, të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit), dhe më pas të përcaktojnë se çfarë duhet të jetë ‘normale’ në marrëdhëniet ndërkombëtare (Niemann dhe Bretherton 2013: 265). Por, çfarë e bën BE të ndryshme nga pretendimi i saj për të qënë një fuqi normative, kur edhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë si - Shtetet e Bashkuara, Kina, India - gjithashtu i përcaktojnë sjelljet e tyre respektive si normative? (Tocci 2008: 18). Manners argumenton se: ”BE ka qenë, është dhe gjithmonë do të jetë një fuqi normative në politikën ndërkombëtare” (Manners 2008: 45). Në veçanti, ai vuri re se dallimi normativ i BE mund të shihet nga konteksti i saj historik, statusit politik hibrid dhe kuadri i *acquis communautaire* politiko-juridike. Kombinimi i karakteristikave të mësipërme përshpejton angazhimin për të qasur në plan të parë normat mbi të drejtat e njeriut në një pozicion të rëndësishëm në marrëdhëniet e saj me shtetet anëtare dhe partnerët e jashtëm. Pyetja kryesore që shtrohet është, si krijohet fuqia normative?

Manners, përshkruan objektivat politike të veprimit të jashtëm të BE kryesisht të bazuara në promovimin e demokracisë, sundimit të ligjit, dhe të drejtave të njeriut. Një fuqi normative promovon parime universale (paqes, demokraci, shtetit të së drejtës, të drejtat e njeriut). Veprimet e saj mbështeten në instrumenta formale, të tilla si dialogu dhe debati, dhe veprimet joformale, të tilla si qëndrueshmëria e brendshme-jashtme. Për më tepër, ajo ndikon vendet partnere nëpërmjet socializimit, partneritetit dhe vetëaftësimit, në vend të aplikimit të vullshëm të masave shtrënguese (ibid: 57). Fuqia normative e BE, kryesisht vepron për të ndryshuar normat në sistemin ndërkombëtar dhe të përcaktojnë praktikrat dhe objektivat e sjelljeve të duhura.

Në qoftë se do të na duhet të konceptojmë sistematikisht legjitimitetin e fuqisë normative dhe veprimet e saj, është e nevojshme të përcaktojmë karakteristikat e tij identifikuese. Së pari, fuqia normative i gjen burimet e saj të hershme të rrënjësura në

kontekstin historik të BE dhe natyrën e identitetit të saj ndërkombëtar (Smith 2009: 598). Siç e vë në dukje Scheipers dhe Sicurelli: “proçeset e ndërtimit të identitetit janë përfshirë që në krijimin e BE si një fuqi normative” (Scheipers dhe Sicurelli 2007: 436). Në këtë drejtim, krijimi i BE nga një e kaluar plot me shkelje mbi të drejtat e njeriut gjatë Luftës së Dytë Botërore, rritja e supranacionalizmit, dhe zhvillimi i së drejtës Europiane bëri të mundur që ajo të vepronte në mënyrë normative. Kjo linjë e argumentit integron njohjen se fuqia normative e BE është e rrënjësuar në refuzimin e parimeve 'jo normative', apo të atyre parime të cilat aktualisht nuk janë të pranueshme sipas standarteve ndërkombëtare ligjore (konflikti, shtypja, shkeljet e të drejtave të njeriut, jo liberalizmi politik dhe ekonomik, qeverisja teokratike). Kështu fuqia normative krijohet nga karakteristikat *sui generis* të këtij sistemi politik/ekonomik, të cilat mishërojnë parimet e të drejtave të njeriut, demokracinë, shtetin e së drejtës, dhe drejtësisë sociale.

Siç u përmend më parë, formësimin i konceptimit të “normales”, përfshin promovimin e normave të BE edhe në qoftë se janë kundër interesave të saj. Diez (2013) argumenton se e ashtuquajtura bipolaritet materialist/idealist dështon të marrë në konsideratë idenë se nuk mund të ketë një dallim i qartë ndërmjet normave dhe interesave në veprim të politikave të BE. Sipas tij, “normat dhe interesat nuk mund të ndahen aq lehtë dhe të dyja influencohen nga njëra-tjetra” (Diez 2013: 201). Një shembull tipik është përfshirja e të drejtat për minoritetet në Kriteret e Kopenhagenit të 1993. Në progres-raportet vjetore që BE përgatit për vende të ndryshme në proçesin e Zgjerimit është dhe rëndësia e përafrimit të *acquis* së të drejtave të njeriut me në fokus të minoreteve, përkatësisht të “Kapitullit 35 e të Drejtave Themelore” në përputhje me Konventën Këshillit të Evropës. Nëpërmjet këtij shembulli mund të kuptojmë se interesat dhe normat strategjike janë reciprokisht krijuese, dhe se normat mund të prodhojnë implikime për interesat e BE. Si pasojë, pretendimi këtu është se ‘interesi’ ndaj marrëdhënieve të fuqisë normative të Evropës është i lidhur organikisht me normat, ndërsa në marrëdhëniet ‘jo-normative’, normat, mund të jenë të varura ndaj dinamikave të politikës së pushtetit.

Së dyti, mungesa e instrumenteve ushtarake është konsideruar si një tipar i rëndësishëm i BE në raport me fuqinë e saj normative. Ky argument i ka rrënjët në konceptin e Duchene së ‘fuqia civile’ të Evropës. Sipas këtij koncepti, BE është një aktor i

veçantë ndërkombëtar, sepse përdor mënyra civile/‘të buta’ dhe jo masa shtrënguese ushtarake, për të menaxhuar dhe zgjidhur konflikte ndërkombëtare. Studiuesit bashkëkohorë e marrin këtë karakteristikë si një tipar kryesor i veprimit të jashtëm të sotëm të BE-së, duke u mbështetur në aftësitë e saj politike dhe ekonomike për të menaxhuar raste të ndryshme në mënyrë paqësore (Rosecrance, R. 1998; Whitman, R 1998; Manners 2002). Rastet e përdorimit i gjejmë në Kriteret e Kopenhagenit për politikën e Zgjerimit, Politika Evropiane e Fqinjësisë, zhvillimin e shoqërisë civile, partneriteteve strategjike, dhe shumë të tjera. Mekanizmat materiale që BE përdor për të përhapur normat dhe praktikën e saj, krijojnë nevojën për reflektim mbi implikimet e tyre politike për fuqi normative. Siç sygjeron dhe Birchfield:

“pranimi i bazës normative të veprimtarisë së BE nuk tregon se mekanizmat e BE do të duhen gjithmonë të veprojnë në një mënyrë normative, dhe as se normat që ata kërkojnë të nxitin janë domosdoshmërisht ose gjithmonë në përputhje me vetë principet e brendshme të BE” (Birchfield 2013: 911).

E ndërsa diskutimi akademik i kuptimit të fuqisë normative të Europës vazhdon, vetë koncepti si aftësi e BE në ‘formësimin e normales’ në sjelljen ndërkombëtare ka nxitur shumë kritika në qarqet realiste dhe konstruktiviste të debateve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Nga një perspektivë realiste, fuqia normative e Evropës është kritikuar, veçanërisht nga Kagan (2003) dhe Hyde-Price (2006), të cilët argumentojnë se BE nuk ka aftësitë e fuqisë që të jetë efektive. Gjithashtu literatura konstruktiviste në marrëdhëniet e jashtme të BE ka vënë në dukje kritika në lidhje me BE. Mungesa e qëllimeve të vërteta normative dhe mungesa e angazhimit, ka krijuar një legjitimitet të kontestuar mbi veprimin e saj normativ dhe mungesës së ndikimit ose efektshmërisë (De Zutter 2006: 1112). Ndërkaq, Kavalski pohon se, koncepti i fuqisë normative është në thelb eurocentrik dhe mbështetet mbi faktin se vendet e treta mund të mos e shohin BE si një fuqi normative, veçanërisht ato në hemisferën jugore, por si një fuqi neo-ekspansioniste (Kavalski 2013: 250).

2.3.2. Promovimi dhe përhapja e normave e të drejtave të njeriut të BE

Duke krijuar një bazë konceptuale për të argumentuar se BE është një fuqi normative, na duhet të përballemi me pyetjen themelore: se si duhet të veprojë ajo? Kjo na kërkon të marrim në konsideratë politika gjithëpërfshirëse dhe burimet që BE aplikon për të formësuar ‘konceptet e normales’ në vendet partnere. Në këtë kontekst, fuqia normative fokusohet në aftësinë e BE për të krijuar institucionet dhe praktikat politike, ekonomike, dhe sociale në përputhje me normat e saj. Sipas Manners (2002), një nga tiparet më të rëndësishme të fuqisë normative është aftësia e BE për të krijuar konceptet e ‘normales’ dhe për të influencuar veprimin ndërkombëtar të sjelljes nëpërmjet fuqisë së normave. Një implikim i rëndësishëm i kësaj qasjeje është se fuqia normative lidhet ngushtësisht me aftësinë e BE për të projektuar ndikim material dhe konceptual dhe të përhap normat e saj me anë të instrumentave të politikës që kërkojnë përshtatje formale nga të tjerët. Këto përfshijnë mjetet financiare dhe teknike të tilla si ndërtimi dhe formësimi i institucioneve, transferimi i parimeve nëpërmjet kushtëzimit, asistencës financiare, konsultime mbi të drejtat e njeriut, si dhe zhvillim dhe support ndaj aktorët e shoqërisë civile (Lenz 2013: 215).

Përhapja e normave e të drejtave të njeriut mbështetet nga përforcimi nëpërmjet shpërblimit, pra, sigurimit të stimujve pozitiv dhe negativ për të synuar pajtueshmërinë e vendeve përkatëse. Kështu, aplikimi i instrumentave e të drejtave të njeriut në kuadër të zgjerimit, shpërndan norma dhe praktika nëpërmjet premtimit për anëtarësimi në BE – vendet e Evropës Juglindore. Në një mënyrë të ngjashme, ajo mund të ofrojë përfitimet ndaj një shteti në këmbim për stabilizimi të një situatë politike – Ukrainë në 2004. Për sa i përket BE mekanizmat e përhapjes së jashtme, sipas Telo: “synojnë ndryshim ekonomik dhe të strukturave sociale të palëve të treta nëpërmjet mjeteve paqësore dhe atyre klasike si negociatat diplomatike, marrëveshjet dypalëshe, sanksione, dhe kështu me radhë, të cilat mund të jenë si afat-shkurtra ashtu dhe afat-gjata” (Telo 2001: 264). Prandaj, sipas Whitman, “fuqia normative e Evropës ka implikime jo vetëm konceptuale, por implikime konkrete praktike” (Whitman 2013: 176).

Në mënyrë që, më pas, të gjendet natyra e saktë e elementit ‘normativ’ të instrumentave të politikave të BE, është e nevojshme për të diskutuar mundësinë e këtyre

mekanizmave të bazuara materialisht për të nxitur krijimin e formave demokratike të qeverisjes, mbrojtjen e qëndrueshme e të drejtave të njeriut, dhe zhvillimit të një shoqërie civile aktive. Këto objektiva janë arsyeja kryesore se përse BE është parë si një fuqi normative. BE përpiqet të nxisë një proces në vendet partnere drejt një formë ideale të qeverisjes politike dhe shoqërore në bazë të vlerave universale (të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit). Ndaj është e rëndësishme të njohim cilësinë e performancës së politikave të promovimit të drejtave të njeriut të BE, nga ku mund të adresojmë zgjidhje të reja kur përballemi me një performacë dështimi dhe nxitje të mëtejshme në raste suksesi.

Kështu konceptet e fuqisë normative mund të përdoren për të përcaktuar dhe justifikuar promovimin e normave të BE, për të vlerësuar politika të veçanta, praktikrat dhe mekanizmat dhe të përshkruajnë bashkëveprimin politik midis Europës dhe vendeve të tjera partnere. Gjithashtu mund të konsiderohet se kanë ndikim të rëndësishëm në mënyrën se si BE dhe aktorët lokalë perceptojnë njëri-tjetrin. Një agjendë hulumtim që përfshin analizën e fuqisë normative të BE na lejon për të eksploruar dhe studiuar mbi cilësitë përcaktuese ose 'normative' të BE. Ky kontekst është i aftë për të qasur promovimin e të drejtave të njeriut në kontekstin e jashtëm dhe se si cilësitë proceduriale të promovimit e të drejtave të njeriut formësojnë përgjigjësitë e aktorëve lokalë që janë të nevojshme për të zbatuar reformën e të drejtave të njeriut.

Fuqia normative nuk është apo nuk duhet të jetë akses vetëm i marrëdhënieve ndërmjet shtetesh. Roli i shoqërisë civile ka qënë i vështirë për tu adresuar në lidhje me fuqinë relative të Evropës, pavarësisht zhvillimit të shoqërisë civile duke qënë një politikë e jashtme e rëndësishme e BE. Studimet e ndryshme që kanë shqyrtuar temën e zhvillimit të shoqërisë civile në veprim të jashtëm të BE e kanë zhvilluar në kontekstin e promovimit të demokracisë së BE. Rastet studimore empirike fokusohen kryesisht në proceset me të cilat organizatat lokale përpiqen të përmbushin misionin e demokratizimit të BE-së duke vepruar si agjentë lokalë dhe promovues të normave të saj (Seeberg 2009: 90). Ata kryesisht argumentojnë se OJQ janë objektiva të pashtershme për iniciativat socializuese (Bicchi 2010: 911). Megjithatë, diskutimet rreth shoqërisë civile si pjesë e fuqisë normative të BE kryesisht mungojnë, pavarësisht faktit se përfshirja e OJQ duhet të reflektojë esencën e

fuqisë normative në mënyrë shumë më të përshtatshme se qasjet që fokusohen vetëm në aktorët e BE dhe të nivelit shtetëror (Mercer 2002: 20). Mbështetjet për OJQ, si një agjent të demokratizimit janë përshtatur shpesh, nga pikëpamjet e demokracisë liberale në të cilën forcimi i tyre shihet si i dobishëm për forcimin e shoqërisë civile dhe rritjen e legjitimitetit të BE. Por sipas Pace: “shpesh të tilla ide dështojnë për të adresuar çështjen se si dhe pse demokracitë liberale dhe zhvillimi i shoqërisë civile kanë arritur një status normativ dhe një status të marrë si të mirëqënë” (Pace 2009: 40).

Edhe pse ky nuk është qëllimi kryesor i kësaj teze - të teorizojë mbi rolin e shoqërisë civile - analiza empirike e promovimit të drejtave të njeriut në Kosovë si rast studimor do ta analizojë politikën e BE ndaj zhvillimit të shoqërisë civile për të pasqyruar kuptimin e fuqisë normative në nivel jo-shtetëror. Përfitimi i kësaj qasjeje është i dyfishtë. Së pari ndërveprimi i shtetit (potencial) kandidat me BE do të jetë më e fortë, se sa të fokusuar ekskluzivisht në agjendën normative të BE; dhe së dyti kjo do të zgjerojë njohjen tonë mbi strukturën shoqërore të vendit në studim si një i tërë dhe ndaj normave të preferuara në fushën e të drejtave të njeriut. Fokusi i diskutimit do të jetë pikërisht mbi rolin e OJQ për të drejtat e njeriut në zbatimin e normave që burojnë nga BE. Kjo kërkon marrjen në konsideratë e rëndësisë së perceptimeve ndaj legjitimitetit dhe nëse OJQ e të drejtave e njeriut njohin agjendën normative të BE ose detyrimin në përputhje me të, pavarësisht përmbajtjes së saj të veçantë. Vlen të kujtohet se OJQ luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në politikën e zgjerimit të BE-së, ku financimet e ndryshme kanalizohen përmes programit të zhvillimit të shoqërisë civile dhe të Instrumentit European për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (IEDDNJ) për kryerjen e një shumëllojshmërie të projekteve në fushën e të drejtave të njeriut.

2.4. Përdorimi i legjitimitetit

Legjitimiteti i aktorëve ndërkombëtar është perceptuar gjithnjë si aftësia e këtyre të fundit të sjellin një ndryshim ndaj një aktori tjetër, nëpërmjet disa instrumentave të buta ose që synojnë bindjen dhe ndryshimin e aktorit tjetër nëpërmjet forcës tërheqëse ose morale të aktorit që ushtron legjitimitet, pavarësisht përpjekjes së suksesshme apo rasti dështimi. Në

mendimin politik, kuptimi i tij i saktë ka krijuar gjithmonë debat midis teoricientësh të studimeve të marrëdhënieve ndërkombëtare.⁷ Më pas, ajo është parë si një besim normativ që një rregull apo një kërkesë e një institucioni duhet të jetë bindëse, jo për shkak të shtrëngimit ose interesit vetjak, por për shkak të forcës së saj plotësisht normative (Buchanan 2011: 8). Sipas Hurd, legjitimiteti kontribuon në pajtueshmëri, duke siguruar një arsye të brendshme për një aktor të ndjekë një rregull. Kur rregulli është perceptuar nga ky aktor si legjitim, ku pajtueshmëria nuk është motivuar nga frika e sanksioneve ose nga një përlllogaritja racionale kosto-përfitim, por nga një besim i brendshëm dhe obligimi moral (Hurd 2007).

Pavarësisht nga shumëllojshmëria e përdorimeve të saj, legjitimiteti përbën një dimension të rëndësishëm në praktika e veprimtarisë së institucioneve ndërkombëtare. Poashtu, rëndësia e tij mund të shihet dhe në raport me përdorimin e politikave të ndryshme të BE. Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi të ashtuquajturin ‘Librin e Bardhë’ mbi qeverisjen Evropiane, e miratuar në 2001, e vinte theksin në arritjen e ‘legjitimitetit’ duke treguar se kjo është një çështje me rëndësi në qeverisjen e BE (Komisioni Evropian 2001: 7). Ky qëndrim është shpjeguar me saktësi nga Beetham, i cili argumentoi se të gjitha strukturat e pushtetit kërkojnë legjitimitetin (Beetham 1991: 3).

Megjithatë, ajo çfarë është e rëndësishme është që të kuptohet se si BE mund të arrijë legjitimitetin e saj për promovimin e të drejtave të njeriut brenda procesit të zgjerimit. Ideja se Bashkimi Evropian është një fuqi normative që promovon të drejtat e njeriut si një ‘fuqi e mire’ ka nevojë për një vlerësim që e bën atë të mundur për të mbështetur këtë pohim. Ky seksion trajton temën e mësipërme nëpërmjet qasjes së procesit të integritetit të Kosovës në BE. Kështu do të vijohet me një shqyrtim të detajuar mbi metodat përcaktuese dhe përshkruese për diskutimin e legjitimitetit të BE-së, e ndjekur nga një diskutim mbi dobishmërinë e tyre analitike për këtë studim.

⁷ Për të parë më shumë në lidhje me kontributin e mendimit politik nga literature mbi legjitimitetin shih: Franck, T.M. ‘Legitimacy in the International System’. *American Journal of International Law*, vol.82 no: 4 (1988) p.705-759; Clark, Ian. ‘Legitimacy in a Global Order’. *Review of International Studies*, vol.29 no: 1 (2003) p. 75-95; Mulligan, S. ‘Questioning the Question of Legitimacy in IR’. *European Journal of International Relations*, vol.10 no: 3 (2004) p.475-484; Clark, Ian. *Legitimacy in International Society* (Oxford: Oxford University Press, 2005)

2.4.1 Studimi i legjitimitetit të BE mbi promovimin e të drejtave të njeriut: metodat përshkruese dhe përcaktuese

Pavarësisht nga diversiteti intelektual i hulumtimeve mbi legjitimitetin, pjesa më e madhe e studiuesve janë në gjendje të kategorizojnë metodat kryesore për vlerësimin e saj si një prej këtyre dy llojeve: të ashtuquajturat, teknika ‘Përcaktuese’ dhe teknika ‘Përshkruese’. Ky dallim përkon me një kufi të supozuar midis besimeve individuale dhe standarteve normative të pranueshmërisë dhe arsyetimit. Në studimin e tij mbi legjitimitetin e institucioneve ndërkombëtare, Hurd theksoi se, të dy konceptet e ndryshme nga të cilat vlerësimet e legjitimitetit krijohen janë, si supozimet individuale, dhe si standarte kontekstuale të përshtatshme (Hurd 1993: 557). Ndonëse këto dy koncepte janë një faktor i dobishëm, fillimi për kryerjen e hulumtimeve rreth legjitimitetit, i bën studiuesit të mbeten në dilemë se çfarë nënkupton ajo në praktikën e hulumtimit empirik.

Kur do të duam të studiojmë legjitimitetin e një politike të caktuar nga një qasje apo teknikë përshkruese do të arrijmë të vlerësojmë besimin e aktorëve lokal apo vetë individëve në lidhje me një rend të caktuar politik. Kjo i referohet në mënyrë të qartë se pse ata e pranojnë dhe e mbështesin atë rend në realitet. Objekti i analizës është mbi perceptimet e mbajtura nga elitat dhe qytetarët në lidhje me një qeveri, organizatë, apo politikë të caktuar (Hurd 1999: 389). Rezultati është vlerësim empirik se çfarë mund të jetë pak a shumë e pranueshme me pritshmëritë që ato kanë. Kjo qasje bazohet kryesisht nga perspektiva e Max Weber, ku sipas tij: “për aq kohë sa rregulli politik konsiderohet legjitim nga marrësit e saj, asnjë vendim i mëpasshmë nuk do të konsiderohet i jashtëligjshëm” (Mommsen 1989: 47).

Në mënyrë të ngjashme, Simmons argumentoi se: “një politikë e cila është koherente dhe proceduriale, mundet ende ti mungojë legjitimiteti nëse nuk perceptohet si legjitime, e veçantë, moralisht e pranueshme apo e përshtatshme nga shoqëria” (Simmons 1999: 749). Ose, siç shihet thjesht nga Hurd: “legjitimiteti është besimi normativ nga një aktor që një rregull të një institucioni e sheh si detyrues” (Hurd 1999: 381). Përgjithësisht, metodat përshkruese njohen si ‘motivuese’, sepse nëpërmjet tyre vihet theksi mbi qëllimet që motivojnë individët për pranimin e autoritetit në mënyrë të vullnetshme. Kështu në

përgjithësi, një studim përshkrues i legjitimitetit mund të pyes se, deri në çfarë mase është e ligjshme autoriteti politik në raport me marrësit e saj?

Megjithatë nevojitet të kuptohet më gjerësisht se përse kanë rëndësi teknikat përshkruese të legjitimitetit. Siç u përmend më parë, një argument klasik i studiuesve që përdorin metodën përshkruese është se, autoritetet për të zbatuar efektivisht atë çka miratohet duhet të kuptojnë se autoriteti ka 'të drejtë' për të marrë vendime dhe të imponojë detyrime. Kjo cilësi e sjelljes është e rëndësishme për studimin e promovimit të drejtave të njeriut të BE-së, për shkak se i drejton aktorët politikë për tu ndjerë të detyruar së brendshmi të implementojnë rregullat, vendimet, marrëveshjet sociale të BE (Menon dhe Weatherill 2008: 401). Kështu metoda përshkruese për studimin e legjitimitetit përfshin diskutimin nën ato kushte ku rendi politik dhe politikat e saj marrin legjitimitetin e nevojshëm (Berstein 2004: 3). Në këtë rast, kriteret për vlerësimin e rezultatit të legjitimitetit duhet të njihen si të pranueshme dhe të justifikuara politikisht. Bazat e legjitimitetit rrjedhin nga 'standartet e përshtatshmërisë kontekstuale'. Këto përfshijnë kriteret e përgjithshme të arsytimit për rregullat dhe veprimet formale të politikave.

Në rendet bashkëkohore politike institucionale, këto kriterë shpesh kanë të bëjnë me çështjet procedurale dhe shpërndarëse, nën rrënjët e vetë teorisë demokratike liberale. Në këtë këndvështrim, nëse plotësohen këto kushte për legjitimitetin, institucionet politike ushtrojnë autoritet të drejtë. Një shembull i njohur mbi studimin e legjitimitetit që adapton një metodë përshkruese është ai i Beetham dhe Lord (1998) në 'Legjitimiteti dhe Bashkimi Evropian'. Në këtë studim, autori përdori tre kriterë për vlerësimin e cilësive përshkruese të sistemit politik të BE: demokracia, identiteti, dhe performanca. Këto kriterë e vinin theksin mbi atë çka BE duhej të bëjë në mënyrë që të zbulojë bazën për legjitimitet.

Kështu teknikat përshkruese për studimin e legjitimitetit janë të rëndësishme për shkak se ata janë të bazuara në idenë e përshtatshmërisë së procedurave. Kur studiojmë institucionet dhe aktivitetet e tyre, kategoria përshkruese, përshkruan më mirë punën shkencore që përqendrohet në përmirësimin e kuadrit institucional përmes më shumë angazhimeve për të caktuar parimet thelbësore në politikë, të tilla si transparenca, një proces të rregullt, efikasitetit, pjesëmarrja, dhe respektimi i të drejtave themelore. Ky

pozicion është më pak i arritshëm me qëndrimet e komunitetit pranues dhe sheh më në fokus, cilësinë e procesit politik në përgjithësi.

Literatura bashkekohore mbi legjitimitetin e BE, zakonisht përshkruan dhe analizon format e veçanta të politikë-bërjes së brendshme të BE ashtu dhe në marrëdhëniet e saj të jashtme. Në proceset e brendshme të BE, legjitimiteti është qasur si qendër e marrëdhënieve ndërmjet sistemit politik të BE dhe qytetarëve evropiane përfituese. Ky fakt ka provuar shkallën e pranimi qytetar dhe mbështetjen ndaj politikave specifike të BE në lidhje me vlerat normative që duhet të mbështesë promovimi i të mirave publike (Klintman dhe Kronsell 2010: 315). Legjitimiteti i politikave të BE-së është shqyrtuar përmes kushte normative të qeverisjes së ligjshme. Me fjalë të tjera nëse procesi i zbatimit të politikave përputhet me idealet e barazisë, pjesëmarrjes, koherencës, efektivitetit dhe përgjegjshmërisë, atëherë ato shihen si legjitime. Për më tepër, është e vlefshme të përmendet se në studimet e legjitimitetit të BE, ndërveprimi midis kontekstit vendor dhe Evropian nuk mungon. Në një marrëdhënie asimetrike, ku BE zbaton normat e saj ndaj një qeverie dhe shoqërie të synuar, autoriteti legjitim është i njohur në mënyrë të ngjashme si i tillë nga të tjerët edhe në kontekstin e ndërveprimit midis tyre (Deroose et al. 2007: 808).

Në këtë punim do të argumentohet se ndarja midis metoda përshkruese dhe përcaktuese, është parë e dobishme të krijojë dy qasje si të lidhura ngushtë në studimin e legjitimitetit mbi promovimin e të drejtave të njeriut të BE ndaj rastit studimor të Kosovës. Kështu mund të argumentohet se nuk është e mundur të kuptohet besimi i aktorëve të brendshëm mbi kushtet nën të cilat promovimi i të drejtave të njeriut duhet të legjitimohet, derisa një model analitik, i cili i kombinon të dy qasjet do të mund të përdoret në këtë kontekst (Risse and Sikkink 1999: 11). Siç u tregua dhe më sipër, edhe në qoftë se mbështetemi në gjykimet e marrësit (qytetarit) si kriter legjitimiteti, sërish na duhet të vendosim se për cilat aspekte të rendit politik këto gjykime janë të rëndësishme.

Ndërkaq, perceptimet e legjitimitetit substancial ndikojnë mbi cilësitë përshkruese të aktivitetit të BE, përkatësisht aftësinë e saj për të marrë vendime, forcës së këtyre vendimeve, dhe aftësinë e shteteve për të ndërtuar mbështetje të brendshme për të marrë përsipër realizimin e tyre (Clark 2005: 14). Kjo krijon idenë se vlerësimi aktual i përfituesve të legjitimitetit mbi promovimin e të drejtave të njeriut të BE mund të ndikojë

në miratimin e brendshëm të normave të BE dhe kështu aftësinë për të transferuar në mënyrë efektive normat e saj ndaj kontekstit të brendshëm. Nisur nga sa u tha më lart, dy metodat që krijojnë gjykimet e legjitimiteti mund të vlerësohen më pak të pavarura se sa mund të duken.

Nga ana tjetër qasjet përcaktuese, përshkruajnë atë që duhet bërë ose se si mund të bëhet diçka më mirë. Siç u argumentua më sipër, kjo qasje nuk ka për qëllim të vetëm të shpjegojë si i promovon BE, por gjithashtu të mundësoi përgjigjen ndaj pyetjes me sa – “sa i suksesshëm është promovimi i të drejtat të njeriut të BE në Kosovë?” Ndërsa nëpërmjet metodës përshkruese karakteristikat e njohura të politikës aktuale krijojnë një bazë të dobishme të njohurive, megjithatë është e rëndësishme për të sugjeruar përmirësime në cilësinë e politikave, dhe për të argumentuar se si ajo mund të arrijë rezultatet e dëshiruara në një mjedis ku këto rezultate nuk janë hulumtuar më parë (Pridham 2007: 462). Për këtë qëllim, një metodë përcaktuese do të ndihmojë të përcaktojë se si mund të aplikohet më së miri politika e të drejtave të njeriut të BE, se çfarë duhet të jenë rezultatet e pritshme, dhe se si duhet të vlerësohet performanca e BE. Si e tillë, ajo përfshin vlerën gjykimeve se si ‘duhet’ të jetë. Këto gjykime të vlerave janë më të dukshme në përzgjedhjen e kritereve të veçanta për vlerësimin e legjitimitetit si: rëndësinë politike, pjesëmarrjen, dhe efektivitetin. Këto kritere pasqyrojnë vlerat demokratike si themeli normativ i legjitimitetit.

Megjithatë, një analizë përcaktuese e promovimit e të drejtave të njeriut nuk mund të kryhet me sukses pa një diskutim të detajuar të instrumentave përkatëse për të drejtat e njeriut. Kjo tregon se analiza përcaktuese kërkon njohuri të mjaftueshme para se të bazohet në të dhëna dhe fakte në lidhje me procesin e politikave dhe kontekstit të saj. Këto fakte janë të përshkruara dhe të shpjeguara në mënyrë që të ndërtojnë pretendimet përshkruese. Prandaj, një qasje e suksesshme normative është e bazuar në shpjegimin e ngushtë të funksionimit të instrumenteve të politikës. Për këtë qëllim, pjesën empirike të tezës do të përfshijë përshkrimin e proceseve përkatëse të politikave të BE dhe funksionimin e llojeve të ndryshme të instrumenteve e të drejtave të njeriut (asistencës financiare dhe teknike dhe zhvillimi i shoqërisë civile).

Proçesi i pranimit të normave detyruese nga jashtë, prej aktorëve të brendshëm është hulumtuar gjerësisht këto dy dekadat e fundit në literaturën mbi politikën e kushtëzimit, e

cila është aplikuar për të përshkruar dhe analizuar miratimin e rregullave mbi të drejtat e njeriut nga shtetet kandidate për antarësim në BE. Kështu mund të dallojmë dy aspekte të ndryshme të kushtëzimit për promovimin e të drejtave të njeriut: së pari e parë nëpërmjet qasjes nga ‘lartë-poshtë’, e cila fokusohet ndaj BE si një fuqi transformuese që i ofron qeverive të vendeve të Ballkanit (Kosovës) stimuj të jashtëm në përputhje me kërkesat mbi të drejtat e njeriut. Kjo qasje mund të identifikohet me bashkëveprimin e individëve në nivel elitash me homologët e tyre të BE në procesin e bisedimeve dhe negociatave për arritjen e një marrëveshje të caktuar. E dyta është qasja nga “poshtë-lart”, e cila fokusohet në proceset e pranimit të normave të BE në një dimension më të gjerë ku përfshin si sferën politike ashtu edhe atë shoqërore, përtej ndërveprimit në nivelin e elitave.

Sipas qasjes nga ‘lartë-poshtë’, ndikimi i politikës së kushtëzimit të BE dhe përfitimi të incentivave shpërblyese që një vend merr në rast se zbaton kërkesë-rekomandimet e caktuara është kryesisht depërtues (Schimmelfennig dhe Sedelmeier 2004: 663). Studime të ndryshme në këtë fushë tregojnë se BE ndikon në sjelljen e qeverisë nën fokus nëpërmjet proceseve të zgjedhjes racionale dhe proceseve të tjera sociale. Zgjedhja racionale tregon se kushti kryesor për suksesin e promovimit e të drejtave të njeriut në BE është përforcimi nëpërmjet shpërblimit, i cili funksionon nëpërmjet negociatave ndërqeveritare (Schimmelfennig 2005: 830). Kështu, baza analitike e qasjes së zgjedhjes racionale krijon një logjikë pasoje; kushtëzimi ndikon në fuqinë e pozicionit të qeverisë së synuar, ose duke rritur fuqinë e saj në bisedimeve *vis-à-vis* me aktorë të tjerë të brendshëm (elitat e kombësive të tjera në shtetet multi-etnike), ose duke i fuqizuar aktorët e brendshëm me karakter socio-politik që mund të kundërshtojnë qeverinë (p.sh. organizatat e shoqërisë civile). Një tjetër faktor që ndikon në sjelljen e zbatimit është se BE i sheh të drejtat e njeriut të përfshira në politikën e saj të zgjerimit, e cila nga ana e saj krijon një rritje të kredibilitetit të BE në kuadër të promovimit e të drejtave të njeriut nëpërmjet aktorëve të brendshëm implementues.

Ndërkaq, qasja e kushtëzimi nga lart-poshtë do të pohojë se pajtueshmëria u përshpejtua nëpërmjet njohjes sociale, e cila formon modelin ‘alternativ’ të incentivave të jashtme të BE (Checkel 2001: 568). Njohja sociale hamendëson se BE krijon një kuptim specifik se çfarë është një sjellje e përshtatshme ndërkombëtare në fushën e të drejtave të

njeriut: BE si një ‘normë-krijuese’ përkundrejt vendeve candidate si “normë-marrëse” (Risse 1999: 529). Modeli i njohjes sociale supozon një logjikë përshtatjeje, sipas së cilës, aktorët e brendshëm janë të motivuar nga ndërkombëtarizimi i vlerave dhe normave që promovohen nga BE.

Një analizë fuqie normative të BE kërkon të përcjell një qasje të ndryshme të kapacitetit transformues të saj duke e pare atë në mënyrë më të tërthortë nga se sygjerohet në nivelin e analizës së elitave dhe më shumë subjektiv ndaj dinamikave socio-politike. Përdorimi i ‘fuqisë normativ të BE’ mund të kontribuojë për një përmirësim të analizës ndaj politikës së shpërndarjes së normave përmes zhvillimit të një qasje nga poshtë-lart, e cila shqyrton: a) se në çfarë mënyrë funksionojnë politikat e BE në kuadër të realitetit të problemeve mbi të drejtat e njeriut dhe b) si pranohet standarti i legjitimitetit të ofruar nga fuqia normative e BE, e motivuar nga pozicionet e brendshme të fuqisë, ndarjeve shoqërore dhe interesave të partive politike (Risse and Sikkink 1999: 7).

2.5. Legjitimiteti dhe fuqia normative të BE-së

Fuqia normative e BE është konsideruar ti qaset në një farë mase legjitimitetit. Legjitimiteti dhe fuqia normative mund të konsiderohen që të kenë një marrëdhënie të ngushtë dhe të përcaktuar reciprokisht sepse fuqia normative e BE është e lidhur normalisht si fuqi që gëzon legjitimitet. Fuqia normative e Evropës, siç u diskutua më parë, nuk është një fuqi e çfarëdoshme. Në mënyrë të veçantë, ajo është fuqia që lejon formësimin e koncepteve të normales në sjelljen ndërkombëtare me mjete paqësore. Kjo nënkupton një marrëdhënie ndërlidhjeje midis BE dhe vendit partner. Përfshirja në BE e përcaktimit të rolit të saj ndërkombëtar është një fakt që tregon për çështjen e legjitimitetit: “politika të ‘larta’ dhe efektive mbi të drejtat e njeriut” (Parlamenti Evropian 2010: 4), “kredibilitet i politikës së zgjerimit” (Komisioni Evropian 2013: 3) dhe “legjitimiteti i normave mbi të drejtat e njeriut” (Parlamenti Evropian 2013: 2). Kështu fuqia normative nuk mund të jetë vetë-përbërëse, por kërkon politika që marrim pjesë në cilësitë e përgjithshme të legjitimitetit dhe janë perceptuar si legjitime nga ana e përfituesve direkt. Duke e thënë thjesht, fuqia normative kërkon legjitimitet.

Paralelisht me ndërtimin konceptual të fuqisë normative të Evropës, pyetjet në lidhje me aspektin normativ të saj krijon një diskutim në lidhje me legjitimitetin e veprimit të jashtëm të BE. Por, si mund të jemi të sigurt se ndjekja e normave të BE-së në veprim të jashtëm është legjitime? Meqë argumenti i fuqisë normative korrespondon shumë ngushtë me përshkrimin e rolit ndërkombëtar të saj, BE duhet të specifikohet më tej me kriteret dhe standartet e vlerësimit që e bëjnë të mundur të mbështesë pretendimin se ajo është një ‘fuqi për të mirë’. Disa studiues supozojnë një lidhje teorike midis fuqisë normative të BE dhe legjitimitetit, duke u mbështetur në argumentin se normat kryesore evropiane mund të përdoren për ti parë ato si vlera universale për të shërbyer si bazë legjitime për politikat (Eriksen dhe Fossum 2004: 441; Follesdal 2006; Hilson 2007; Bolleyer dhe Reh 2012: 473).

Në një përpjekje për të ndryshuar këtë gjendje, shumë autorë i qasen kësaj lidhjeje ‘natyrale’ midis fuqisë normative dhe legjitimitetit. Sjursen, për shembull, u përpoq të tregonte se vetëm për shkak se BE vepron në një mënyrë normative, kjo nuk i atribuon asaj një sjellje e natyrshme normative (Sjursen 2006b: 242). Për sa i përket lidhjes midis fuqisë normative dhe legjitimitetit, Leino gjithashtu vuri theksin ndaj një qëndrimi skeptik: “Ndërsa BE është sot e aftë dhe e gatshme për të qënë pozitive, shumë nga veprimet e saj shfaqen të paefektshme, të justifikuara keq ose thjesht në mënyrë arrogante dhe duhet një rivlerësim” (Leino 2008: 288). Siç u përmend më lart, një pjesë e debatit shkencor ka pohuar se duke vepruar në një mënyrë normative nuk konsiderohet automatikisht të jetë një ‘gjë e mirë’, dhe natyrshëm nuk sjell frymën normë-zbatuese të BE nëse mbetemi nën supozim se ajo është ‘fuqi e së mirës’ (Bickerton 2001: 25).

Tre konceptet kryesore të legjitimitetit nën konceptin e fuqisë normative Evropiane, janë zhvilluar në literaturën bashkëkohore: përshtatja e BE kundrejt parimeve juridike ndërkombëtar në veprimin e saj të jashtëm - ligjshmërisë (Sjursen 2002: 500); legjitimiteti i BE-së siç perceptohet nga vendet e tjera jo-Evropiane, dmth përfituesi jo-evropian i politikave të saj të jashtme - njohja nga ‘të tjerët’ (Eriksen 2006: 260), dhe përshtatshmërinë procedurale të politikave të BE, dmth lidhja e fuqisë normative ndaj performancës, rëndësi kontekstuale, qëndrueshmëri, dhe parimet e tjera që përforcojnë sistemin e vetë-qeverisjes së BE - drejtësinë procedurale (Sjursen 2006a: 247). Një diskutim i detajuar i kuptimeve të

legjitimitetit të mbajtura nga çdo konceptim, dhe që më pas do të përzgjidhen për pjesën empirike të tezës në lidhje me natyrën dhe kufizimet e promovim të drejtave të njeriut të BE për Kosovën do të analizohen në vijim.

2.5.1. Legjitimiteti si ligjshmëri

Sjursen (2006a) paraqiti një interpretim të legjitimitetit të fuqisë normative duke u bazuar në ligjshmërinë e normave ndërkombëtare e të drejtave të njeriut. Pikënisja e saj analitike ishte se BE si një promovues i normave e të drejtave të njeriut duhet të dallohet nga të ashtuquajturit aktorë të tjerë ‘normativ’ në sistemin ndërkombëtar. Për shembull, theksi në vlerat, normat, dhe të drejtat e njeriut dhe promovimi i demokracisë mund të gjendet edhe në politikën e jashtme të SHBA. Analiza e saj për politikën e zgjerimit të BE ngriti një problematikë të ngjashme: “argumentet dhe arsyet e dhëna në favor të zgjerimit duhet të jenë të një lloji që të tjerët mund të mbështetin; ato duhet të konsiderohen të ligjshme” (Sjursen 2006a: 248). Mënyra më e përshtatshme në të cilën kjo mund të ndodhë në praktikë do të jetë nëse BE promovon një sërë normash që janë të pranueshme për të gjithë. Të drejtat e njeriut do të konsiderohen si të drejta dhe legjitime kur formohen nëpërmjet dialogut në rrjedhën e kohës me disa aktorë të ndryshëm politik (Erman 2005: 12). Prandaj, sipas Sjursen: “për të vepruar në një mënyrë normative do të kërkohej të promovohen parimet juridike të pranuar universalisht mbi të drejtat e njeriut” (Sjursen 2006a: 249).

Sipas logjikës së ligjshmërisë, promovimi i të drejtave të njeriut në Kosovë do të justifikohet nëpërmjet një elementi të fortë konstitucionalizmi dhe ligjshmërisë mbështetëse të normave të BE mbi të drejtat e njeriut. Zhvillimi i së drejtës evropiane, integrimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e brendshëm ligjor të BE-së, dhe më e rëndësishmja avancimi i parimeve universale ligjore që theksojnë të drejtat e njeriut, do të shërbejë si një burim i legjitimitetit të promovimit e të drejtave të njeriut të BE. Ky konceptualizim do të analizohet në dy nivelet e analizës së punimit: Së pari nëpërmjet qasjes nga lartë-poshtë do të argumentohet se legjitimiteti i promovimit e të drejtave të njeriut të BE në Kosovë gjen burimin e saj në aspektin e ligjshmërisë duke u fokusuar në aspektet e kuadrit juridiko-insitucional që shqafet në Kosovë mbi mbrojtjen e të drejtave të

njeriut. Ndërsa në nivelin e dytë të analizës, pra qasjen nga poshtë-lartë, legjitimiteti si ligjshmëri do të operacionalizohet nëpërmjet kuadrit ligjor dhe karakterit subjektiv të organizatave të shoqërisë civile mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Kjo strategji analize, në mënyrë të ngjashme është argumentuar nga studiuesi Dunne, i cili thekson se bashkimi i ideve kozmopolitane e të drejtave universale me BE si një kapacitet institucional në zhvillim për të promovuar këto të drejta jashtë saj ka gjasa të shërbejë si një burim legjitimiteti (Dunne 2008: 14). Për këtë arsye, një tregues i fortë i BE, si një fuqi normative e ligjshme do të jetë e lidhur me legjitimitetin gjithëpërfshirës të së drejtës ndërkombëtar e të drejtave të njeriut, e promovuar kjo, nëpërmjet instrumentave të jashtëm të Bashkimit Evropian për të drejtat e njeriut. Ky argument e sheh promovimin e të drejtave të njeriut të BE të legjitimuar nga standarti universal ligjor që lidh njerëzimin në tërësi. Karakteri universal i së drejtës ndërkombëtare dhe karakteri racional-empirike i ligjbërjes janë konceptuar si një burim i legjitimitetit të promovimit të drejtave të njeriut të BE, për shkak se ajo konceptohet si e tillë në bazë të qëllimeve normative dhe jo duke iu referuar përllogaritjeve strategjike.

2.5.2. Legjitimiteti proçedural

Në diskutimin mbi fuqinë normative të BE deri më tani, burimet e legjitimitetit për promovimin e të drejtave të njeriut - ligjshmëria - janë të vendosura jashtë politikëbërjes së BE. Megjithatë, një nga argumentat kryesore të legjitimitetit të këtij studimi është se përhapja e normave e BE duhet të jetë e bazuar siç duhet në një sërë cilësish proçeduriale. Në këtë mënyrë, promovimi i të drejtave të njeriut në BE nuk është i lirshëm, por i shërben qëllimit më konkret për të ndihmuar dhe menaxhuar reformat ndaj të drejtave të njeriut në vendet përkatëse (Bickerton 2001: 33). Në argumentimin e legjitimitetit mbi promovimin e drejtave të njeriut të BE, duke analizuar metodat dhe instrumentat e fuqisë normative, analiza empirike e këtij studimi do të fokusohet në aspektin nëse politikat e BE janë të afta për të ofruar mbështetjen e duhur financiare, ekspertizën dhe infrastrukturën e nevojshme për të siguruar rezultatet e dobishme në lidhje me përmirësimin e të drejtave të njeriut në Kosovë? Në pikëpamje proçedurale veprimtaria e ligjshme institucionale duhet të jetë

bazuar në cilësinë e performancës së procesit të politikave. Në këtë drejtim, koncepti i legjitimitetit është thelbësisht procedurial: legjitimiteti i promovimit të drejtave të njeriut varet jo vetëm në baza ligjore apo relacionale, por dhe në atë të zhvillimit të efektshme që një zgjidhje kërkon praktikisht.

Legjitimitetit procedurial është diskutuar në literaturë mbi metodat dhe prioritetet e promovimit të drejtave të njeriut të BE në kuadër të zgjerimit (De Burca 2003: 698). Kjo analizon procedurat formale të BE dhe zbatimin e tyre në sistemet politike kombëtare nga perspektiva e kushtëzimit e diskutuar më herët. Këtu, kriteret e legjitimitetit të vëzhguara janë standartet e aktivitetit të duhur institucional, që rrjedhin nga vlerat demokratike themelore, duke nënvizuar politikëbërësit (koherenca, pjesëmarrja, llogaridhënia). Në disa studime empirike të kushtëzimit të BE, legjitimiteti buron nga një perspektivë e besueshme anëtarësimi në BE që lehtëson përputhshmërinë (Schimmelfennig dhe Sedelmeier 2005; Schimmelfennig 2008: 918-937).

Shumë procese politike kanë vënë theksin në mangësitë proceduriale, siç janë mospërputhjet midis promovimit të brendshëm dhe të jashtëm të BE e të drejtave të njeriut, në përgjithësi dhe paqartësia e kriterëve, mungesës së konsultimit me palët kryesore që janë të interesuara dhe përfshirja e kufizuar parlamentare e BE në veprimtari - mbikëqyrjeje parlamentare (Ivanov 2008: 153). Kur duam të diskutojmë legjitimitetin procedurial të mbështetjes së të drejtave të njeriut të BE në Kosovë ku në fokusin e studimit tonë, një shumëllojshmëri kriteresh empirike janë përdorur për qëllime të kontrollit dhe të vlerësimit. Nisur nga diskutimet më të hershme të metoda përshkruese të analizës së legjitimitetit, kriteret e zgjedhura për vlerësimin e promovim e të drejtave të njeriut të BE në Kosovë janë rëndësia e politikave, pjesëmarrjes, dhe efektiviteti të cilat do të diskutohen përgjatë kapitullit të pestë dhe atij të gjashtë – përkatësisht në dy nivelet e analizës.

Më e rëndësishme është kuadri i politikave, e cila ka të bëjë me politikën e të qënurit i vendosur në një mënyrë specifike për një problem të caktuar ose situatë të caktuar (Petrov 2008: 39). Çështjet kryesore këtu lidhet me faktin se instrumentat e promovimit e të drejtave të njeriut të BE duhe të jenë në kohë dhe koherente. Në mënyrë që të përmbushen këto kërkesa të legjitimitetit, BE duhet të orientohet duke u zhvendosur drejt një kontributi në ato fusha ku të drejtat e njeriut janë veçanërisht të diskutueshme për vendet e Ballkanit

Perëndimor. Në kontekstin e marrëdhënieve BE-Kosovë, mund të identifikohen katër mekanizmat e mundshme për një qasje të tillë: Informacioni i plotë mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, inkorporim i qartë i njohurive dhe analizës së dokumenteve të politikave të BE, përfshirja e qytetarëve dhe grupeve të shoqërisë civile në konsultime dhe debate, si dhe ushtrimet e auditimit në efektivitetin dhe ndikimin e instrumentave. Çfarë nënkuptohet në marrëdhënien midis rëndësisë së politikave dhe legjitimiteti është se, të parat mbulojnë të gjitha fazat nëpër të cilat kushtëzimi i BE është aplikuar, dhe ka funksionuar në mënyrë aktive në politikën në promovimin e të drejtave të njeriut (Sasse 2008: 850).

Së dyti, analiza mbështet një orientim pjesëmarrës për vlerësimin e legjitimitetit proçedural. Një konceptim pjesëmarrjeje e legjitimitetit ka të bëjë me cilësinë e politikave të BE që nxisin ose kërkojnë pjesëmarrjen në proçesin e zbatimit e të drejtave të njeriut nga grupet përfituese. Pjesëmarrja përfshin mënyrat (jo) formale në të cilat organizatat e shoqërisë civile, udhëheqësit lokal dhe grupet e pakicave bashkëpunojnë me elitat qeverisëse dhe i bëjnë të njohura vlerat, interesat dhe preferencat e tyre politike në një shumëllojshmëri formash dhe mjetes (Bene dhe Neiland 2006: 26). Këto forma përbëhen kryesisht nga ndarja e informacionit, dialogut dhe negociatave dhe për ndërtimin e mirëbesimit. Në mënyrë ideale, BE duhet të aplikojë strategji të cilat informojnë qytetarët – nëpërmjet publicitetit mediatic ose nëpërmjet edukimit - mbi aktivitetet e të drejtave të njeriut që arrin ndaj të gjitha grupet përkatëse. Ajo duhet të përfshijë edhe dialogun së bashku me negociatat, të tilla si ushtrimin e komisionimit të përfshirjes publike për çështjet e të drejtave të njeriut (juritë e qytetarëve, konferenca, sondazhet e opinionit, takime interactive, etj.). Për më tepër, BE mund të ketë nevojë për të ndërtuar kapacitetet dhe besimin e ndërsjelltë. Kjo do të përfshijë zhvillimin e komunitetit dhe mbështetjen për grupet përkatëse.

Për më tepër, pjesëmarrja lidhet me Parlamentin Evropian dhe metodat e shqyrtimit parlamentar, efektivitetin, dhe të performances së tij. Sipas Beetham, një metodë sistematike e mbikëqyrjes mund të realizohet nga komisionet ndër-parlamentare BE - vende të treta. Këto komisione duhet të kenë ekspertizën e duhur, duke e ndjekur punën e departamenteve të veçanta, hetimin mbi aspektet e politikave të caktuara, dhe një

mekanizëm kontrolli të efektshëm të shpenzimeve buxhetore (Beetham 2006: 141). Për promovimin e të drejtave të njeriut të BE ndaj Kosovës, aktori institucional përgjegjës është Komisioni i Përbashkët Parlamentar i Delegacionit për Kosovën, e udhëhequr nga Ulrike Lunacek. Mekanizmat e mundshëm për mbikqyrjen janë shqyrtimet e veprimtarisë parlamentare dhe raportet e rregullta që kërkojnë përputhshmëri të politikave. Kontrolli parlamentar rrit legjitimitetin procedural e parë si një pikë hyrëse, nëpërmjet përgjegjësisë që ushtron BE në kryerjen e detyrimeve që kërkojnë për të zbatuar rregullat e të drejtave të njeriut. Si e tillë, ajo siguron pajtueshmërinë e pranueshmërisë minimale morale dhe përfitimin e kushteve të krahasueshme (Buchanan dhe Keohane 2006: 422).

Së treti, është e nevojshme për të gjetur legjitimitet për promovimin e të drejtave të njeriut të BE në vlerësimin e rezultateve. Sipas Andreassen dhe Sano, qëllimi kryesor i vlerësimit të rezultati në fushën e të drejtave të njeriut është që të shqyrtojë se si një politikë ndikon situatën e përgjithshme e të drejtave të njeriut në një komunitet lokal apo kombëtar (Andreassen dhe Sano 2007: 277). Supozimi është se promovimi i të drejtave të njeriut dhe politikat përkatëse, do ta ofrojnë një drejtim rezultatesh substanciale - reduktimin e shkeljeve së të drejtave të njeriut. Kjo krijon nevojën për të verifikuar ndikimin pozitiv, ose dokumentimin e dështimeve për të arritur ndikimin e pritur, në çështje dhe dimensione të ndryshme të cikleve të politikave. Pjesa empirike e tezës do të identifikojë treguesit për politikat përkatëse. Në terma të përgjithshme, treguesit kryesore janë si më poshtë: rritja e nivelit të fuqizimit qytetar mbi të drejtat e njeriut; ndryshim në sjelljen e politikave shtetërore; përmirësimin e kapaciteteve institucionale, të tilla si forcimi i organizatave të shoqërisë civile; dhe ndryshimi shoqëror i favorshme për normat e të drejtave të njeriut, të tilla si mos-diskriminimi. Konceptimi i legjitimitetit është domosdoshmërisht një nga funksionet efektive të legjitimitetit të promovimit e të drejtave të njeriut i cili varet nëse instrumentet përkatëse tregojnë kapacitet për të pranuar kushtet e ndryshimit ndaj të drejtave të njeriut.

Pavarësisht qasjes së caktuar shkakësore, teza kërkon të hulumtojë se legjitimiteti ndihmon reformat e të drejtave të njeriut, edhe pse pasojat e saj nuk mund të jenë të pavarura nga faktorët e tjerë ndihmës. Ai kontribuon në zbatimin e të drejtave të njeriut duke nxitur një strukturë më të qëndrueshme për zgjidhjen e problemeve që lidhen me to,

duke krijuar perceptimet e praktikës së mirë në marrëdhëniet Kosovë-BE si dhe zhvillimin e normave të përbashkëta si një mënyrë për të shqyrtuar problemet e të drejtave të njeriut.

Kështuqë, qëllim empirik i këtij studim është adresimi i pyetjes se nëse mund të flasim për një fuqi normative Evropiane të legjitimuar në rastin e Kosovës ose jo. Kjo pyetje do të analizohet nga dy prespektiva. Së pari do të shqyrtohet shkalla nëpër të cilën aktorët kryesorë politikë (në rastin e Kosovës, institucionet qeverisëse) e perceptojnë një përafrim ideal midis normave e të drejtave të njeriut të promovuara nga BE dhe pozicioni i politikës së tyre të brendshme. Ky indikator do të operacionalizohet nëpërmjet një analize e cila do të shohë përputhshmërinë e institucioneve të Kosovës me normat e BE, nëpërmjet një procesi i cili kërkon të ndryshojë botëkuptimin institucional ndaj të drejtave të njeriut në Kosovë. Legjitimiteti, kështu, do të burojë dhe nga perceptimi i tyre i drejtë në lidhje me konsistencën e promovimit e të drejtave të njeriut të BE.

Së dyti, ky burim legjitimiteti i promovimit e të drejtave të njeriut të BE në Kosovë do të operacionalizohet nëpërmjet rolit aktiv të organizatave të shoqërisë civile, me përpjekjet e tyre nga poshtë-lartë për të ndryshuar dhe përmirësuar njëherazi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Legjitimiteti nuk do të ofrojë thjeshtë funksionin e normave e të drejtave të njeriut mbi atë të një ideali shoqëror; më shumë, ajo do të mbështesë ato si vlera të cilat kanë një zbatueshmëri të drejtpërdrejt dhe aktuale. Në përgjithësi, promovimi i të drejtave të njeriut të BE duhet të jetë jo thjeshtë në baza të gjëra morale apo ligjore, por për arsye se ka diçka të veçantë në lidhje me zbatimin e aplikuar nga BE dhe për proceset e veçanta të politikave të instrumentave të saj të veçantë. Për këtë qëllim, analiza e legjitimitetit procedurial do të rritet nga tiparet e politikës së BE. Ndërtimi i analizës së bashku një sferë të zgjeruar që mbulon zhvillimin e fuqisë normative të BE, karakteristikat e tij proceduriale, faktorët që ndikojnë në mbrojtjen kontekstuale e të drejtave të njeriut në vendet respektive, dhe dilemat e brendshme politike të zbatimit, do të jenë një ndër qëllimet kryesore të argumentimit për legjitimitetin e politikës së BE ndaj rastit të Kosovës, si në aspektin procedurial ashtu dhe atë substancial.

2.5.3. Legjitimiteti si njohje nga jo-evropianët - "të tjerët"

Legjitimiteti i fuqisë normative të BE në këtë studim, në veçanti për promovimin e të drejtave të njeriut, ka qenë e një rëndësie kyçe: njohjen e fuqisë normative të BE nga vendet e tjera jo-evropian. Fuqia normative e BE ka qenë e trajtuar si një konstrukt marrëdhëniesh midis 'vetë' evropianëve dhe jo-evropianëve të tjerë (Diez 2005: 615). Prandaj, ndërtimi i BE, si një fuqi normative ka implikime të rëndësishme për mënyrën se si promovimi i të drejtave të njeriut i trajton 'të tjerët', dhe kjo rezulton në krijimin e një kufiri midis saj dhe shteteve jo-antare, përfituese. Flockhart, "të qenurit 'normal' të BE e sheh nën kontekstin e një agjendë të caktuar që përfshin marrëdhënie fuqie (Flockhart 2010: 793). Roli i fuqisë normative e shtyn BE përtej të qenurit thjesht pjesë në sistemin ndërkombëtar por për të qenë një normë-shpërndarës aktiv, ku ushtron përpjekje për të ndryshuar të tjerët nëpërmjet përhapjes së normave të caktuara dhe për të riformuar 'të tjerët' në një dimension të ri (Diez dhe Manners 2007: 174).

Megjithatë, për shkak se identiteti është racional, imazhi i vetë fuqisë normative të BE është (ose duhet të jetë) i varur nga perceptimet që aktorët përfitues kanë në axhendën dhe praktikën e saj. Edhe pse vlerat 'evropiane' janë gjithë-përfshirëse, aktorët jashtë kufijve të BE nuk kanë të njëjtin konceptim të 'normales' me të. Ndikimi i fuqisë normative mund të ekzistojë vetëm kur vendet jo antare të BE perceptojnë normat e fuqisë si të pranueshme për miratim dhe sjelljen sipas standarteve të legjitimitetit të tyre. Prandaj ky konceptim i legjitimitetit për fuqinë normative duhet të bazohet në një vlerësim të jashtëm të veçantë si për vlerat ashtu dhe për normat e BE dhe harmonizimin e standarteve socio-politike të legjitimitetit brenda vendit pranues.

Përdorimi i këtij burimi të tretë të legjitimitetit të promovimit e të drejtave të njeriut të BE ndaj Kosovës do të argumentohet nëpër dy nivelet e analizës së punimit. Kështu në qasjen nga lartë-poshtë, legjitimiteti si njohje ndaj jo-evropianëve do të operacionalizohet nëpërmjet një analize që vlerëson rolin e BE në Kosovë nga një qasje që kërkon të formësojë njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nëpërmjet instrumentave lehtësuese dhe inkurajuese të forndeve IPA kryesisht por dhe të programeve të tjera financiare, legjitimiteti i promovimit do të krahasohet me nivelin e përputhshmërisë së vendit nga normave dhe vlerave Evropiane të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

Me vijimin e kësaj analize në nivel institucionesh, burimi i legjitimiteti do të vlerësohet dhe në aksesueshmërinë e promovimit të të drejtave të njeriut të BE, si një fuqi që kërkon të formësojë standartin e normales në rastin e Kosovës nga roli i aktorëve të tjerë të brendshëm – shoqëria civile. Pikërisht nëpërmjet instrumentave financiar, por jo vetëm, që BE përdor në rastin e Kosovës, ky indikator i legjitimitetit do të vlerësojë promovimin e të drejtave të njeriut duke u bazuar në aftësinë transformuese që BE përdor për të forcuar rolin e shoqërisë civile. Ai do të përdoret në kuadër të zgjerimit të rolit të tyre karshi proceseve vendimarrëse – pra rritja e ndërveprimit midis shoqërisë civile dhe institucione qeverisëse – si dhe vetëaftësimit të brendshëm dhe rolit që duhet të marrë ky aktor i rëndësishëm lokal në zgjerimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

Në këtë kuptim, kjo përpjekje e BE mund të implikojë një legjitimitet të dyfishtë duke e kapërcyer atë të brendshëm, ku ajo ndan legjitimitet me aktorët lokalë duke u qasur kështu me dy standarte: një herë si bashkë-legjitimues për kohezion të brendshëm dhe një herë si një legjitimitet-kërkues për procesin e integritetit të vendeve të synuara, që për rastin tonë është Kosova.

Por para se të studiojmë qasjen e legjitimitetit të BE ndaj Kosovës në dy nivelet e marra për hulumtimin tonë, do të duhet të thellohem se si është formësuar kjo fuqi normative mbi të drejtat e njeriut dhe si zbatohet ajo në proceset dhe marrëdhëniet e ndryshme që BE krijon me vendet antare ose shtetet e treta.

2.6. Përfundime

Ky kapitull elaboroi një kornizë teorike mbi të drejtat e njeriut dhe fuqinë normative e BE nëpërmjet konceptit të legjitimitetit. Duke u njohur me konceptualizimin e të drejtave të njeriut u shtjellua më tej se si mund ti shohim këto drejta të cilat na garantohen në një komunitet të caktuar – shtet – në një dimension më universal. Pikërisht këtu modeli teorik i demokracisë kozmopolite shërbeu për të ilustruar Bashkimin European si struktura e vetme që favorizon një proces post-nacional, nëpërmjet të cilit me përmbushjen e disa kushteve si demokraci publike, autonomi individuale dhe të drejta të qytetarisë, individët do të arrijnë ti gëzojnë të drejtat në mënyrë të njëjtë. Kapitulli elaboroi të kuptuarit e fuqisë normative të

Bashkimit European në kontekstin e promovimit të të drejtave të njeriut të BE, si një politikë e saj, shfaq disa paqartësi të cilat mund të justifikohen vetëm në kushte të caktuara - e referuar kjo dhe nga disa studiues të cilët e kanë vënë theksin se ajo që BE promovon si 'normale' në sjelljen politike ndërkombëtare nuk mund të jetë normale për të gjithë të tjerët. Në këtë kuptim ky kapitull, solli një analizë mbi promovim e të drejtave të njeriut të BE në lidhje me legjitimiteti e fuqisë normative, dhe hulumtoi se si kjo qasje e re mund të kontribuojë në mbrojtjen e përmirësuar e të drejtat e njeriut në vendet e synuar kur kërkohet ndërhyrja. Ajo sugjeroi përmirësimin e kapacitetit procedural për politikat e BE, së bashku me një 'ripërcaktimi' të termave evropianë së bashku më përfshirëse dhe të barabarta.

Rëndësia politike, pjesëmarrja, dhe efektiviteti kanë bërë të mundur vlerësimin e legjitimitetit. Çdo burim i legjitimitetit tërheq vëmendjen mbi një të kuptuar të ndryshëm të promovimit të drejtave të njeriut, e cila sinjalizon mungesën themelore të qartësisë në lidhje me përkufizimin dhe prioritetet e vizionit të qeverisjes së BE nëpërmjet normave të saj. Nga ky këndvështrim u përpoqa të thelloj studimin duke i'u përgjigjur pyetjes, se në çfarë mënyre BE e gjen ushtrimin e legjitimitetit për të arritur këtë mbrojtje si së brendshmi ashtu dhe së jashtëmi. Për këtë qëllim argumentuam se nëpërmjet fuqisë normative të Evropës do të mund të kuptonim këto dimensione dhe një model analitik mbi mënyrat përshkruese dhe përcaktuese për të kuptuar se si e formëson legjitimitetin për arritjen e këtyre dimensioneve. Ajo që u pa ishte se ekzistojnë tre mënyra për të arritur legjitimitetin dhe ato janë legjitimitetit procedural, legjitimitetit substancial dhe legjitimiteti ndaj të tjerëve 'jo evropianë'.

E ndërsa ky model studimi i legjitimitetit mbi fuqinë normative të BE në promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë do të analizohet në kapitujt e mëpasshëm empirik, tashmë në kapitullin e tretë do të diskutohet se si janë zhvilluar të drejtat e njeriut në të drejtën evropiane pra këndvështrimi historik nëpër institucionet, *aquis communautaire*, traktatet dhe proceset e ndryshme të zgjerimit për të kuptuar fuqinë normative të BE në kuadër e të drejtave të njeriut.

KAPITULLI I TRETË

DIMENSIONI HISTORIK DHE INSTITUCIONAL I ZHVILLIMIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT - A ËSHTË BE NJË AKTOR NORMATIV?

3.1. Hyrje

Ky kapitull do të trajtojë një nga pyetjet kryesore që lindin në lidhje me fuqinë normative të BE: si e ka zhvilluar BE fuqinë normative, si një aktor që promovon të drejtat e njeriut në arenën botërore, dhe çfarë referencash kryesore mund të dallojmë nga legjitimiteti mbi veprimtarinë e saj ndaj të drejtave të njeriut? Një analizë e zhvillimit të BE si fuqi normative në marrëdhëniet ndërkombëtare do të jetë e lidhur teorikisht në marrëdhëniet BE-Kosovë në fushën e të drejtave të njeriut. Ky kapitull argumenton se zhvillimi historik i BE në kuadër e të drejtave të njeriut i ka dhënë asaj një dimension të ri, ku nëpërmjet karakteristikave thelbësore që formësojnë identitetin e saj ajo është shndërruar në promovuesin kryesor të normave dhe vlerave në skenën ndërkombëtare si liria, demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut, dhe shtetit të së drejtës.

Për të kuptuar zhvillimit historik e të drejtave të njeriut e parë nga ‘standardet e legjitimitetit’ ndërkombëtar të BE-së do të shërbejë literatura që ka në fokus kuadrin e së drejtës së brendshme dhe të politikës së Zgjerimit të BE. Analiza në këtë kapitull do të fokusohet në integrimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në të drejtën e BE-së dhe politikat, dhe mbi efektin e saj ‘përhapës’ të mëvonshëm ndaj politikës së Zgjerimit dhe Veprimit të Jashtëm të BE. Në mënyrë të veçantë, analiza do të fokusohet në mënyrën se si politika e brendshme ndaj të drejtave të njeriut ka kontribuar në zhvillimin e qëllimeve dhe mekanizmave që përdor politika e kushtëzimit mbi të drejtat e njeriut dhe ndaj marrëdhënieve të jashtme. Për më tepër, analiza do të prezantojë burimet kryesore të legjitimitetit që i ndërton BE si një fuqi normative.

3.2. BE dhe promovimi i të drejtave të njeriut: zhvillimet e hershme në të drejtën Evropiane

Një nga parimet kryesore të fuqisë normative të BE është se ajo është e predispozuar për të vepruar në një mënyrë normative në politikën botërore për shkak të kontekstit historik të saj, formimit politik hibrid, dhe një *acquis communautaire* të gjerë. Kështu një nga faktorët kryesorë që kanë shërbyer për të zhvilluar promovimin e të drejtave të njeriut është konstitucionalizmi i Bashkimit Evropian: zhvillimi i së drejtës evropiane,

integrimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e brendshëm juridik të BE, dhe aftësia e veprimit të jashtëm të saj. Zhvillimi ligjor i brendshëm i BE në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe përpjekjes së BE që synon të zhvillojë politikë të jashtme në përputhje me angazhimet ekzistuese e të drejtave të njeriut, e kanë shndërruar në një ‘organizatë’ *sui generis*. Ajo që bën diferencën është se të drejtat e njeriut janë shndërruar në një ‘standart legjitimiteti’ të BE: thelbi i marrëdhënieve të saj me vendet anëtare dhe partnere, dhe parimi thelbësor që mbështet politik-bërjen e saj.

Nga ajo çfarë mund të vëzhgojnë në politikën e të drejtave të njeriut të BE, është se në dekadat e fundit, sipas Alston dhe Weiler: “dimensioni i mbrojtjes së brendshme dhe asaj të jashtëm e të drejtave të njeriut ngjan si me dy anët e së njëjtës monedhë” (Alston dhe Weiler 1999:8). Mbrojtja e brendshme të drejtave të njeriut është favorizuar nga një narrativë mbi të drejtat e njeriut, nëpërmjet Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), traktatet integruese të BE, mandatit të Parlamentit Evropian dhe nga Karta e të Drejtave Themelore Evropiane. Ndërkaq mbrojtja e jashtme e të drejtave të njeriut është zhvilluar nëpërmjet politikës së kushtëzimit e të drejtave të njeriut ndaj vendeve që aspirojnë ose janë në proces të qënurit vende (potencialisht) candidate siç është rasti i Kosovës. Kjo qasje konsideron se politika e jashtme e të drejtave të njeriut të BE është zhvilluar si pasojë e mbrojtjes së të drejtave të brendshme, të lidhur së bashku me sistemin e brendshëm të BE mbi të drejtat e njeriut me qëllimet e politikave të saj ndërkombëtare. BE i ka zhvilluar vlerat e saj themelore globale - të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit - nëpërmjet qëllimit gjithëpërfshirës të brendshëm të rregullimeve të duhura institucionale për një sistem efektiv e të drejtave të njeriut.

3.2.1. Gjykata Evropiane e Drejtësisë

Marrëdhënia midis Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED) dhe politikës së BE mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut është me rëndësi për të kuptuar zhvillimin e hershëm të BE-së si një fuqi normative. Rastet ligjore të GJED zgjeruan fushëveprimin dhe kontekstin e shqyrtimit e të drejtave të njeriut nga Bashkimi Evropian në mungesë të një kuadri të mirëfillt kushtetues dhe një mungese të dispozitave mbi të drejtat e njeriut në traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian (KEE), atë të Romës në 1957. Në

kuadrin e brendshme të BE, Gjykata Evropiane e Drejtësisë miratoi obligimet shtesë përpos atyre morale dhe juridike ekzistuese për vendet antare në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të tyre (Barnard 2007). Ndërsa në kuadrin e jashtëm GJED vuri theksin mbi rëndësinë e të drejtave të njeriut, si një forcë veprimi e rëndësishme të fushës së ‘lirisë, sigurisë dhe drejtësisë’ - që më pas do të merrte emërtimin si politika e përbashkët e mbrojtjes dhe sigurisë dhe politika e çështjeve të brendshme dhe drejtësisë – që kontribuoi me zhvillimin e kushtëzimit politik në politikat ndërkombëtare të tregtisë, zhvillimit, dhe të zgjerimit të BE. Komisioni Evropian konfirmoi se: “GJED ka arritur gjatë viteve, të kontribuojë në rritjen e parimet e përgjithshme - të drejtave themelore - në një shumëllojshmëri praktikash ligjore” (Komisioni Evropian 2015).

Rasti i parë ligjor që u bë shkas për implementimin e të drejtave e njeriut në KEE ishte çështja juridike ndërkombëtare e *Handelsgesellschaft* në 1970 (Craig dhe De Burca 2003:320). GJED vendosi se “mbrojtja e të drejtave, e frymëzuar nga traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare, duhet të sigurohet brenda kuadrit të strukturave dhe objektivave të Komunitetit” (ibid:322). Ndaj sot mund të themi se ekzistojnë një sere arsye që e shohim zhvillimin e të drejtave të njeriut të GJED në një parim të përgjithshëm të aspektit juridik të BE. Këto arsye janë si politike ashtu dhe juridike për nga natyra. Arsyeja më e zakonshme e cituar është se GJED, që përbën pjesën juridike të një sistemi integrimi politik dhe ekonomik, lipset të garantojë të drejtat e njeriut së brendshmi dhe së jashtëmi si një kontribut për një ekonomi sociale dhe tregu të qëndrueshme dhe për një qytetari demokratike (Weiler 1995: 59).

Në lidhje me politikën e zgjerimit, Doğan pohon se proçesi i pranimit të shteteve me një përvojë të shkurtër të demokracisë, të tillë si Greqia, Spanja dhe Portugalia, iu lips GJED të ndërmerre një rol aktiv në harmonizimin e ligjit themelor e të drejtave në KEE, në mënyrë që të përfronte atë shkallë mbrojtjeje në ato vende në të njëjtën linjë me atë të parashikuar në shtetet anëtare ekzistuese (Doğan 2009: 56). Në të njëjtën mënyrë, Torres Perez argumenton se:

“parimi i epërsisë së ligjit të BE-së në mënyrë efektive do të thotë se rendi ligjor i BE ka pasur formën e së drejtës kushtetuese duke përfshirë si shtetet ashtu dhe vetë qytetarët e saj. Rrjedhimisht, në qoftë se koherenca e BE si një rend ligjore i njëjtë

me atë të shteteve anëtare duhej të ruhej, atëhere të drejtat themelore duhet të trajtohen në nivelin Evropian” (Torres Perez, A 2009: 5).

Ashtu si me mbrojtjen e brendshme të drejtave të njeriut, KEE/BE fillimisht kishin një mungesë të qartë baze ligjore për zhvillimin e një politike të jashtme e të drejtave të njeriut. Burimi kryesor i këtij kuadri ligjor për të drejtat e njeriut në rendin juridik të BE ishin parimet e përgjithshme të së drejtës Komunitare dhe traditat juridike të shteteve anëtare. Jurisprudenca e GJED nuk arriti të shtrijë veprimtarinë e saj të jashtme, por shërbeu si burim frymëzimi për dispozitat e traktatit të *Maastrichti*-it i cili paraqiti objektivat e jashtme që BE kërkonte të prezantonte në faktorizimin e saj ndërkombëtar, të tilla si “zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë dhe shtetit ligjor, dhe respektimit i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.⁸ Kombinimi efektiv i dispozitave të traktatit dhe rasteve-ligjore ndër vite të GJED mbi të drejtat e njeriut si parime të përgjithshme juridike të BE, në mënyrë progresive i dhanë një dimension mjaft të rëndësishëm të drejtave të njeriut mbi objektivin e saj të jashtëm. Nga vitet 1990 e më vonë, me kombinimin e mëtejshëm të amendamenteve të Traktatit të Maastricht-it dhe juridiksionin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, kompetencat e BE mbi të drejtat e njeriut e zgjeruan fushë-veprimin e saj të jashtme në politikat e Zgjerimit, Azilin, Emigracionin, Bashkëpunimin e Gjyqësorit, Mjedisit, Tregtisë, dhe Zhvillimin (Doğan 2009: 56). Ndaj në përfundim mund të themi se GJED ka formësuar në mënyrë efektive dispozitat e traktatit në aktivitetin e saj të jashtëm mbi të drejtat e njeriut dhe ka zgjeruar *acquis communautaire* nëpërmjet përfshirjes së Kartës së të Drejtave Themelore.

3.2.2. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2000)

Karta e të Drejtave Themelore është konsideruar jetike mbi ligjshmërinë detyrues të BE-së dhe institucioneve të saj për të drejtat e njeriut në marrëdhëniet e brendshme dhe ato të jashtme. Vendimet e Këshillit Evropian në Nicë në dhjetor 2000, shpallën zyrtarisht

⁸Për më tepër shih traktatin e Bashkimit Evropian, Maastricht 7 Shkurt 1992 http://europa.eu/eu-laë/decision-making/treaties/pdf/treaty_on_european_union/treaty_on_european_union_en.pdf (Aksesuar më 18 Mars 2015)

Kartën si një faktor i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në BE.⁹ Pas një mungese fillestare të statusit ligjor, Karta u bë e detyrueshme nëpërmjet Nenit 6 të Traktatit të Lisbonës.¹⁰ Karta është konsideruar si e vetmja mënyrë për të hapur shtigje të reja mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut në BE dhe se qëllimi i saj inspirues ishte për të sjellë të drejtat e njeriut në krye të politikave të BE (Wetzel 2003: 2840). Ajo artikulon vlerat e përbashkëta të Bashkimit Evropian që janë të njëjta për të gjitha shtetet anëtare dhe çdo vend që dëshiron të bëhet anëtar i BE-së. Sipas Ward burimet mbi të cilat BE mbështetet për të përcaktuar të drejtat e njeriut nuk janë të kufizuara në instrumenta ligjorisht detyruese. GJED, për shembull, e vë fokusin mbi instrumentat ndërkombëtare në lidhje me të cilat shtetet anëtare kanë bashkëpunuar, të tilla si Karta, edhe nëse ata nuk janë ligjorisht detyruese (Ward 2004: 127).

Diskutimi i studiuesve mbi Kartën, lokalizon përdorimin e saj në zvogëlimin e disa nga aspektet ‘shqetësuese’ të promovimit e të drejtave të njeriut në politikën e jashtme dhe të zgjerimit në veçanti. Në mënyrë të veçantë, ajo adreson ndarjen e brendshme e të jashtme midis qëllimit e të drejtave të njeriut të mbrojtura në BE dhe shtrirjen e reformave që lipsen nga shtetet e reja antare, së bashku me mungesën e qartësisë dhe dallueshmërisë në kërkesat mbi të drejtat e njeriut (Eeckhout 2002: 946). Gjithashtu Karta është parë si një zgjidhje e pjesshme të përshkruar më parë si çështja e ‘standarteve të dyfishta’ në mbrojtjen e brendshme dhe të jashtme e të drejtave të njeriut. Integrimi Evropian i vendeve të Ballkanit Perëndimor ka përfshirë këtë kontradiktë të dukshme, siç do të diskutohet më tej me rastin e Kosovës. Në analizën e Ficchi (2011) vihet re një interpretim i tillë. Pikënisja e saj ishte fakti se Karta ka një ndikim të rëndësishëm në shqyrtimin e detajuar që i bën GJED mbi mbrojtjen e brendshme e të drejtave të njeriut kur vlerëson seriozitetin e shkeljes së kryer nga një shtet anëtar (neni 7 i TBE). Sipas, Eeckhout:

“një Kartë detyruese do të kontribuojë në zhvillimin e një politike të mirëfilltë të BE mbi të drejtat e njeriut; një politikë horizontale dhe proaktive që lejon përshkrimin e të gjitha politikave të tjera të BE, të cilat mund të justifikojnë veprimet dhe përfshirjen e saj të jashtme” (Eeckhout 2002: 990).

⁹ Për më shumë shih Amendimi i Traktatit të Bashkimit Evropian, Nizë 26 Shkurt 2001 <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/ET/TXT/?uri=URISERV:xy0017> (Aksesuar më 11 Shkurt 2015)

¹⁰ Për më tepër shih Traktatin e Lisbonës, 13 Dhjetor 2007 <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:C:2007:306:FULL&from=EN> (Aksesuar më 17 Mars 2015)

Si pasojë, besueshmëria e BE në arenën ndërkombëtare do të rritej nga një politikë më koherente ndaj shteteve anëtare dhe shteteve që synojnë anëtarësimin, e realizueshme nëpërmjet Kartës. Vlera e saj për fuqinë normative të BE-së qëndron në reduktimin e problemit të standarteve të dyfishta, duke krijuar konvergjencë të brendshme/të jashtme dhe duke përshpejtuar procesin e sjelljes me uniformitet midis politikave të brendshme dhe të jashtme e të drejtave të njeriut.

3.2.3. Parlamenti Evropian si promovues i të drejtave të njeriut

Parlamenti Evropian si i vetmi institucion i BE i zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë perceptohet se luan një rol mjaft kyç në zhvillimin e një axhende e të drejtave të njeriut (Smith 2004: 1). Paragrafët e mëposhtëm do të na japin një këndvështrim mbi rolin e Parlamentit Evropian në të tri fushat e veprimtarisë mbi të drejtat e njeriut: mbrojtjen e brendshëm, Zgjerimin, dhe marrëdhëniet e jashtme.

Në mbrojtjen e brendshëm e të drejtave të njeriut, Rack dhe Lausegger (1999) nënvizonin se: “kjo ka qenë një nga arritjet kryesore të Parlamentit Evropian ku sot të drejtat e njeriut merren në konsideratë në mjaft sfera të ndryshme aktiviteteve” (Rack dhe Laussegger 1999: 802). Gjithashtu PE angazhohet në një gamë të gjerë aktiviteteve që monitorojnë dhe zhvillojnë konsulta për mbrojtjen e të drejtave të njeriut së brendshmi, duke vendosur vëmendjen në zonat apo vendet anëtare ku ajo e percepton se të drejtat e njeriut rrezikohen, dhe bën rekomandime politikash.

Ndërkaq, në procesin e Zgjerimit, Parlamenti Evropian jep pëlqimin për traktatet pranuese të Zgjerimit të BE për të përfshirë anëtarët e rinj, duke ushtruar kontroll parlamentar mbi politikën e Zgjerimit. Në praktikë, miratimi parlamentar kërkon një shumicë të cilësuar për arritjet në kuadër të drejtave të njeriut dhe demokracisë ndaj shteteve në proces antarësimi (Lord 2005: 121). PE ka të drejtë të ushtrojë fuqinë e vetos në rast të shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut gjatë negociatave për anëtarësim. Përveç miratimit të pranimeve të antarëve të rinj, ai luan një rol aktiv në marrëveshjet e asociimit, dhe krijon Komisionet e përbashkëta parlamentare me shtetet candidate. Kështu Komisionet Parlamentare BE-vendet e Ballkanit Perëndimor merren me rastet konkrete të

shkeljeve të supozuara e të drejtave të njeriut, si dhe shkëmben informacion dhe ekspertizë për rastet e veçanta e të drejtave të njeriut.¹¹ Për më tepër, PE harton raporte vjetore për vendet (potenciale) kandidate duke vlerësuar rekordin e tyre e të drejtave të njeriut. Këto bëhen për të inkurajuar Komisionin dhe Këshillin për të rregulluar strategjitë përkatëse të politikës së Zgjerimit në rast të problematikave që hasen në kuadër e të drejtave të njeriut. Në përgjithësi, kontributi i Parlamentit Evropian për politikën e Zgjerim është frymëzuar nga përgjegjësia e saj si një organ i zgjedhur për të treguar përtej BE, rolin e saj aktiv në përkrahjen e të drejtave të njeriut në mënyrë konstruktive.

Në marrëdhëniet me jashtë, Parlamenti Evropian ka krijuar nënkomitetin për të Drejtat e Njeriut që prej vitit 2004, një platformë evropiane për debat dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut nëpër botë. Ky nënkomitet është kryesisht përgjegjëse për zhvillimin e debatit dhe monitorimit konstruktiv e të drejtave civile dhe politike, të drejtat e pakicave, dhe për promovimin demokratik të BE. Kjo i jep mundësinë për të publikuar raporte dhe rezoluta mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në mbarë botën dhe në cilësinë e mekanizmave përkatëse të BE, në të cilën ajo bën rekomandime politikash.¹² Sipas Camporesi, PE ka luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e klauzolës e të drejtave të njeriut në bashkëpunimin zhvillimor dhe tregtar me vendet jo antare të BE nëpërmjet kërkesave të vazhdueshme ndaj Komisionit Evropian (Camporesi 2011: 80). Për më tepër, PE ishte arkitekti i Instrumentit Evropian të Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR), një instrument financimi për demokracinë dhe të drejtat e njeriut në mbarë botën që përdoret dhe nga procesi i Zgjerimit ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor. Nëse përdoret për të ushtruar kontroll parlamentar mbi promovimin e të drejtave të njeriut të BE apo për të shprehur dënimin kolektiv të abuzimeve në mbarë botën, Parlamenti Evropian konsiderohet në përgjithësi të jetë një aktor i besueshëm në promovimin e të drejtave të njeriut, forcimin e mbështetjes juridiko-institucionale të fuqisë normative të BE (Pace 2007: 1050).

¹¹Shih për shembull Komisionin e Parlamentit Evropian BE-Kosovë. Për më tepër shih: https://polcms.secure.europarl.europa.eu/cmsdata/upload/83519997-b621-4594-9d03-a869585c05d4/att_20090811ATT59534-32834469860954250.pdf (Aksesuar me 3 Mars 2015)

¹²Shih për shembull, Nën Komunitetin e të Drejtave të Njeriut, 'Raporti Vjetor për të drejtat e Njeriut dhe Demokracinë nëpër Botë 2013' Bruksel, 23 Korrik 2014 http://eeas.europa.eu/human_rights/docs/2013_hr_report_en.pdf (Aksesuar mw 12 Prill 2015)

3.2.4 Traktatet e integrimit Evropian (1953-2009): krijimi i kriterit politik për antarësim

Mbështetja ligjor-institucionale e fuqisë normative të BE është forcuar nga traktatet e integrimit evropian dhe përfshirja progresive e të drejtave të njeriut si kusht për anëtarësim në BE. Specifikimi i kriterëve politike për anëtarësim mund të shihet si një kontribut në ndërtimin e BE si një fuqi normative dhe si një katalizator i politikbërjes kolektive. Në këtë mënyrë kushtëzimi politik është vendimtar për të krijuar një komunitet ligjor dhe një kulturë identiteti të përbashkët në të cilën legjitimiteti i fuqisë normative gjen mbështetje. E thënë ndryshe, identifikimi i idealeve të përbashkëta politike për vendet anëtare të BE mund të jetë i lidhur me një potencial të qëndrueshëm angazhimi ndaj normave të një çështjeje të caktuar dhe performancës koherente në drejtim të formulimit dhe të ofrimit të këtyre politikave.

Rastet e shfaqjes së hershme të kushtëzimit e të drejtave të njeriut në zgjerimin e BE, mund të gjenden që prej vitit 1953, kur draft-traktati themelues i Komunitetit Politik Evropian (KPE) i u nënshtrua të drejtës për anëtarësim vendeve respektive vetëm me përmbushjen e kriterëve mbi të drejtat e njeriut.¹³ Projekti ambicioz i KPE nuk u materializua asnjëherë me hryjen në fuqi të traktatit nënshkrues, por kushtëzimi politik qëndroi në rendin politik dhe juridik të Komunitetit, duke vendosur fillimin e një praktike të gjatë në lidhje me pranueshmërinë e shteteve të reja (Hillion 2004: 4). Ndërkaq duhej të kalonin afro katër dekada që konceptimi i një traktati Evropian që materializonte të drejtat e njeriut si një kushtëzim politik kryesor për vendet antare dhe ato të reja do të bëhej i mundur vetëm me traktatin e Amsterdimit në 1999.¹⁴

Në lidhje me kriteret mbi të drejtat e njeriut, Traktati i Romës (1957) e vinte theksin në domosdoshmërinë e organizimit politik të shteteve aplikuese, që duhej të ishte e formës demokratike dhe të përgatitur për të hyrë në një marrëdhënie më të afërt politike në të ardhmen. Mund të themi se, traktati i Romës nuk kishte një qëndrim të caktuar mbi kriterin e të drejtave të njeriut për anëtarësimin e shteteve të reja, por shërbeu më shumë në

¹³Draft Traktati i krijimit të Komunitetit Politik Evropian 1953, neni 116. I aksesueshëm në: http://aei.pitt.edu/991/01/political_union_draft_treaty_1.pdf (parë më 13 Mars 2015)

¹⁴Traktati i krijimit të Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian (tekst i konsoliduar) 2006, neni 49 OJ C 321 E/1. I aksesueshëm në: <https://www.ecb.europa.eu/ecb/legal/pdf/ce32120061229en00010331.pdf> (parë më 10 Mars 2015)

kuadër të integritit duke e lënë të hapur mundësitë për zhvillim të mëtejshëm. Duke pasur parasysh rëndësinë që mbarte traktati për KEE gjatë një periudhe prej katër dekada (1957-1993), formulimi dhe specifikimi i mëvonshëm i kriterëve politike ndodhi në mënyrë graduale përgjatë raundeve të ndryshme të zgjerimit (1973, 1981 dhe 1985), dhe jo i menjëhershëm nëpërmjet ligjit Komunitar. Impakti i këtyre raundeve të zgjerimit do të analizohet në pjesën e fundit të kapitullit ndaj paragrafëve të mëposhtëm do të shqyrtojë në fillim rëndësinë kronologjike të traktateve të Maastrichtit (1992), Amsterdam (1997), Nicës (2000), dhe Lisbonë (2009).

Kështu traktati i Maastrichtit (1992) prezantoi në mënyrë të qartë konceptin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në përbërjen e traktateve dhe e lidhi atë me instrumenta ligjore ekzistuese të mbrojtjes ndërkombëtare e të drejtave të njeriut. Neni F (2), për shembull, thekson se:

“Unioni do të respektojë të drejtat themelore, siç garantohet nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950 dhe siç rezultojnë nga traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare, si parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare” (Traktati Maastricht-it 1992: 9).

Në fakt Maastrichti i referohej kriterit politik për anëtarësim në nenin (2) në një mënyrë disi abstrakte që: “kushtet e pranimit dhe rregullimet e Traktateve mbi të cilat Unioni është themeluar, do të të jenë subjekt i një marrëveshje midis shteteve anëtare dhe atyre aplikante”.¹⁵ Kështu vetëm nëpërmjet traktatit të Amsterdamt, të nënshkruar në 1997 dhe hyrë në fuqi në vitin 1999, të drejtat e njeriut u theksuan si një kriter të anëtarësimit duke e adresuar në mënyrë të qartë. Kriteret politike dhe ekonomike për anëtarësim në BE ishin të rregulluara në nenin 49 të Traktatit të Amsterdamt.¹⁶ Sipas këtij neni, çdo shtet evropian që respektonte parimet e përcaktuara në nenin 6 (1) të Traktatit mbi Bashkimin Evropian do të mund të aplikonte për t'u bërë një anëtar i BE-së. Neni 6 (1) deklaroi se këto parime ishin, “liria, demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si

¹⁵Traktati i themelimit të Bashkimit Evropian 1992, Neni O(2), f.15. Për më tepër shih në: http://europa.eu/eu-law/decision-making/treaties/pdf/treaty_on_european_union/treaty_on_european_union_en.pdf (parë më 11 Janar 2015)

¹⁶ Për më tepër shih traktatin e Amsterdamt, 2 Tetor 1997 <http://www.europarl.europa.eu/topics/treaty/pdf/amst-en.pdf> (parë më 17 Janar 2015)

dhe sundimin e ligjit, parime të cilat janë të përbashkëta për shtetet anëtare” (Traktati i Amsterdami 1997:59). Sakaq, neni 7 (1) shtonte se: “çdo shkelje e vazhdueshme e të drejtave pas aderimit do të sillte sanksione të imponuara nga Këshilli”.¹⁷

Kështu ekzistonin si arsye të brendshme ashtu dhe të jashtme të cilat shtynin mbi zhvillimin e kriterëve të anëtarësimit mbi të drejtat e njeriut në periudhën midis traktatit të Maastricht-it dhe atij të Amsterdami. Presionet e integritetit dhe sfidat e zgjerimit nxitën hartuesit e Traktatit të Amsterdami të miratojnë një konceptim mbikombëtar mbi të drejtat e njeriut për BE si një set vlerash përbërëse dhe unifikuese të komunitetit politik evropian. Vëmendje të veçantë iu kushtua të drejtave të njeriut dhe për parimet e lirisë, demokracisë dhe shtetit të së drejtës, si karakteristikat e një “unioni gjithnjë e më të përbashkët” mbikombëtar. Kjo arritje duhet gjithashtu të shihet në dritën e bashkimit të strukturës organizative të BE nga ana e traktatit të Amsterdami (Von Bogdandy 2000: 39). Sipas parimit të përgjithshëm të konsistencës në nenin 3, të drejtat e njeriut gjejnë aplikim të qartë ndaj të gjitha akteve të institucioneve të BE. Që prej konceptimit e të drejtave të njeriut dhe demokracisë janë pjesë përbërëse dhe funksionale të BE, riformulimi i kushtëzimit politik u bë në përputhje me nevojën për të riorganizuar shtetet kandidate sipas normave të BE dhe në përputhje me rrethanat e brendshme. Si rrjedhojë, kushtëzimi politik në Traktatin e Amsterdami ishte riformuluar sipas konceptit e të drejtave të njeriut dhe demokracisë, si pjesë e normave të institucioneve dhe strukturave sociale të BE.

Traktati i Amsterdami u amendua nga Traktati i Nicës (2000). Në prag të sfidës së zgjerimit të Madh të 2004. Ndërkaq, risia që ai solli në fushën e të drejtave të njeriut ishte shpallja e Kartës Themelore e të Drejtave të Njeriut, e cila u shtua si një shtojcë e traktatit. Siç u përmend dhe më lart, traktati i Nicës nuk vlerësoi statusin zyrtar detyrues të Kartës, por hapi rrugën për implementimin e saj në *aquis communautaire*.

Traktati i Lisbonës, solli ndryshime të mëtejshme dhe u nënshkrua në dhjetor 2007 duke hyrë në fuqi dy vite më pas. Lisbona nuk e ndryshoi konceptimin e kriterëve politike për anëtarësim, megjithatë, vuri theksin në mënyrë të qartë ndaj të drejtave të pakicave për herë të parë në një traktat të BE-së, duke rritur kështu angazhimin për mbrojtje e të drejtave

¹⁷ Traktati i Amsterdami 1997, Neni 7(1) f. 70. Për më tepër shih në:
<http://www.europarl.europa.eu/topics/treaty/pdf/amst-en.pdf> (parë më 17 janar 2015)

të mbështetura dhe përshtatura ato me Kriteret e Kopenhagenit (1993). Në nenin 6, i Traktati siguron rritjen e angazhimit të Unionit për mbështetjen e të drejtave të njeriut, duke i dhënë fuqi detyruese në bazë të Kartës Themelore e të Drejtave (me disa përjashtime për Mbretërinë e Bashkuar dhe Poloninë), dhe duke parashikuar hyrjen në fuqi të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nëpërmjet Lisbonës, gjithashtu u krijua një Komisioner i ri i të drejtave themelore. Për më tepër, Lisbona themeloi shërbimin e Veprimit të Jashtëm Evropian, e cila në mënyrë të qartë i vendoste të drejtat e njeriut si pararoja e kushtëzimit të zhvillimit dhe bashkëpunimit tregëtar përtej BE (Wolff 2012: 76). Në përgjithësi, Traktati i Lisbonës koordinon një qasje të përbashkët për të gjitha programet e të drejtave të njeriut të BE dhe përmirëson ndikimin dhe efikasitetin e tyre të përgjithshëm.

Traktatet kryesore të integritetit evropian në mënyrë progresive zhvilluan kriteret e të drejtave të njeriut për anëtarësim në parimet themelore ligjore të BE, dhe i përshtatën ato në mënyrë retorike në proceset politike të BE dhe të identitetit të vetë komunitetit. Megjithatë, në mënyrë që të sigurohet një kuptim më i gjerë midis historikut të zhvillimit e të drejtave të njeriut të BE dhe karakterizimit të tij si fuqi normative, është e rëndësishme të diskutohet zhvillimi i kriterëve të drejtave të njeriut përmes ndërveprimit të zgjerimit dhe të BE me shtetet kandidate specifike. Pjesa në vijim do të diskutojnë zhvillimin e kushtëzimit të drejtave të njeriut të BE përmes një analize të raundeve të procesit të zgjerimit.

3.3. Proceset e Zgjerimit në KEE/BE dhe zhvillimi i kushtëzimit i të drejtave të njeriut

Qëllimi i këtij seksioni është, së pari, të shqyrtojë elementët e fuqisë normative të BE të zhvilluara brenda zgjerimit nëpërmjet proceseve të ndryshme të vendeve kandidate të BE dhe së dyti, për të dalluar referencat kryesore të legjitimitetit në zhvillimin e politikave e të drejtave të njeriut të BE. Proceset e mëposhtme sollën shfaqjen e një politike e të drejtave të njeriut të bazuar: në negociata ndërqeveritare lidhur me dobishmërinë e krijimit të një kornize të përgjithshme të kriterëve të pranimit (Zgjerimi i 1973); proceset vendimmarrëse, si me bazë ndërqeveritare ashtu dhe të vendeve përkatëse, duke siguruar argumenta në favor të krijimit të kriterëve mbi të drejtat e njeriut (zgjerimi i 1981 dhe

1986); si dhe, nevoja e një strategjie institucionale e të drejtave të njeriut e rrënjësuar në vlerat evropiane, dhe një konceptim i mbrojtjes së të drejtave të njeriut të drejtuar nga identiteti (zgjerimi i 2004 dhe i 2007). Analiza tregon disa çështje në praktikën e politikës së të drejtave të njeriut të BE. Çdo raund zgjerimi zhvilloi një bazë parimesh që vazhdojnë të mbështesin zbatimin e të drejtave të njeriut të BE dhe në ditët e sotme.

3.3.1 Zgjerimi i parë: rasti i Britanisë së Madhe (1973)

Në 1973 çështja e të drejtave të njeriut nuk përbënte një faktor përcaktues për axhendën e zgjerimit. Kjo ishte për shkak se Britania e Madhe, Irlanda dhe Danimarka, nuk kishin shkelje shqetësuese dhe mungesë të një standarti të drejtave të njeriut në krahasim me *acquis communautaire* e deriatëhershëm. Interesi kryesor pas Zgjerimit të parë u fokusua në zhvillimet ekonomike që priteshin të ndodhnin në Britaninë e Madhe. Pavarësisht dhunës politike në Irlandën e Veriut, vlerësimet mbi të drejtat e njeriut mungonin në mënyrë të dukshme nga kërkesat e KEE. Megjithatë, procesi i pranimi të Britanisë së Madhe, sigurisht hodhi bazat e asaj që përbën mënyrën e përgjithshme të zbatimit të kushtëzimit të BE – ‘metodën klasike të Komunitetit’ - që gjithashtu nënvizon faktorin e politikës mbi të drejtat e njeriut. Negociatat e pranimi me Mbretërinë e Bashkuar, dhe gjithashtu Danimarkën dhe Irlandën, e bënë të qartë se kushtet e anëtarësimit dhe zbatimin e plotë të tyre ishin të patjetërsueshme. Kriteret e anëtarësimit duhej të pranoheshin dhe nuk ishin të hapura për negociim të mëtejshëm. Pranimi i plotë i rendit ligjor dhe politik i BE pa përjashtime u bë dhe mbeti një parim bazë mbi anëtarësimin dhe në ditët e sotme.

Rasti i Irlandës së Veriut si një shembull i konfliktit etnik në kuadër të anëtarësimit është i rëndësishëm ndaj qasjes së KEE mbi të drejtat e njeriut gjatë procesit të zgjerimit të parë. Në vitet 1960 dhe fillim të viteve 1970, KEE luajti një rol thuajse të papërfillshëm në kuadër të përmirësimit e të drejtave të njeriut në Irlandën e Veriut. Në mënyrë të ngjashme, qeveritë irlandeze dhe britanike nuk e shihnin KEE si një ‘palë të tretë’ e mundshme, në zgjidhjen e konfliktit midis tyre (Hayward dhe Wiener 2008: 41). Në të tilla kushte nuk egzistonte një qasje strategjike apo vizion për të drejtat e njeriut në kuadër të zgjerimit. Edhe, Komisioni Evropian sipas Tannam: “nuk luajti ndonjë rol si një aktor normativ në

çështjet e politikës së brendshme të shteteve të reja pasi ende nuk ishte i rëndësishëm sa është në ditë e sotme” (Tannam 2007: 345). Në analizën e procesit të pranimi të Britanisë së Madhe, mund të vërejmë qartësisht se prej zgjerimit të parë, mos-negociueshmëria e kushteve të KEE ishte mjaft e theksuar. Mënyrat kryesore në të cilat Britania sfidoi *acquis communautaire* ishte me dëshirën e saj për të mbajtur të qëndrueshme preferencat e Komonuellthit në aspektin tregtar dhe një regjimi tregtar te hapur me ish partnerët e saj të Marrëveshjes Evropiane të Tregtisë së Lirë (METL) (Preston 1995: 452).

Megjithatë, edhe pse ky proces i analizuar më sipër, nuk shërbeu plotësisht për të stimuluar një standart të qartë e të drejtave të njeriut, rëndësia e zgjerimit të parë për ndërtimin e BE si një fuqi normative qëndron në zhvillimin e ‘metodës klasike të Komunitetit’ asaj të kushtëzimit, e cila vë theksin e saj në dimensionet, duke përfshirë të drejtat e njeriut, deri në ditët e sotme. Metoda klasike e Komunitetit ka të bëjë me kuadrin e përgjithshëm që BE përdor në ndjekjen e objektivave të saj të politikave dhe zbatimit e të drejtave të njeriut. Duke marrë argumentimin e Preston (1997) i cili e sheh atë si “një model të vazhdueshëm të procedurave formale të pranimi”, mund të identifikojmë pesë pika kryesore në metodën klasike të cilat ndërtojnë një mjedis të politikës për zbatimin e ardhshëm e të drejtave të njeriut:

“a) kushtet e anëtarësimit duhet të pranohen në mënyrë të plotë dhe pa përjashtime të përhershme, b) bisedimet e pranimi të përqëndrohen në praktikën e pranimi të kriterëve të anëtarësimit, c) nëse instrumentet ekzistuese janë të pamjaftueshme, ata adresojnë krijimin e strukturave të reja zëvendësuese, d) anëtarët e rinj janë të integruar në strukturat institucionale të KEE nëpërmjet adaptimit të kufizuar, dhe e) KEE preferon të negociojë me grupet e shteteve që kanë një nivel të ngjashëm të zhvillimit politik” (Preston 1997: 11).

Në përmbledhje mund të themi se, zgjerimi i parë e përshkruan BE si një aktor efektiv që frymëzon një mjedis politikash të favorshme për zhvillimin e ardhshëm të një kornize të politikave për promovimin e të drejtave të njeriut. Në këtë mënyrë, normat e të drejtave të njeriut të BE nuk do të qëndrojnë *apriori*, por do të mbështeten në një grup parimesh konkrete që garantojnë zbatimin e tyre efektiv. Pesë parimet e lartpërmendura mbeten në praktikën aktuale të BE dhe përcaktojnë se kriteret e të drejtave të njeriut, si të gjitha dimensionet e *acquis*, janë të detyrueshme për shtetet candidate, dhe duhet të

plotësohen para antarësimit, dhe mbi të gjitha nuk mund të negociohen. Ky fakt na tregon se si duhet të ndiqet një proces zbatimi i të drejtave të njeriut nga shtetet kandidate duke pranuar tërësinë e detyrimeve dhe përgjegjësi që nis nga vetë shtetet anëtare ekzistuese. Gjenerata e dytë dhe e tretë e zgjerimeve, të përshkruara më poshtë si zgjerimet 'e Evropës Jugore', panë antarësimin e Greqisë në 1981 dhe Spanjës dhe Portugalisë në vitin 1985.

3.3.2. Zgjerimi i vendeve të Evropës Jugore: Greqia (1981), Spanja dhe Portugalia (1985), dhe Turqia¹⁸

Zgjerimi mesdhetar solli në vëmendje kryesore çështjet mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut të cilat kishin qenë më parë thjesht të nënkuptuara në kushtet e anëtarësimit. Karakteristika kryesore e fuqisë normative të BE që doli qartë nga ky zgjerim, ishte përparësia në zhvillim e një grupi kërkesash politike, duke përfshirë demokracinë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit, duke tejkaluar për herë të parë nga zgjerimi i fundit, çështjet ekonomike. Rastet e Greqisë, Spanjës dhe Portugalisë janë kuptuar përgjithësisht se kanë patur një dimension politik që ishte në thelb i dallueshëm nga vendet e zgjerimit të parë. Të gjithë aplikantët e vendeve të Evropës Jugore, duke përfshirë dhe Turqinë kishin dalë nga sundime autoritare dhe kërkonin mundësi që të vendoseshin brenda një kuadri institucional që do të lehtësonte zhvillimin e institucioneve të tyre demokratike.

Proçesi i Zgjerimit të Evropës Jugore zbuloi disa tendenca në praktikën e kushtëzimit politik në vitet 1970 dhe 1980. Formulimi i parë dhe i qartë i kushtëzimit e të drejtave të njeriut u aplikua në këtë rast. Përveç dimensionit ekonomik, profili politik i një shteti aplikantit u shfaq i rëndësishëm në përcaktimin e suksesit të aplikimit për anëtarësim, dhe respektimi i demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit u shfaqën si fusha me rëndësi kyçe. Proçesi i Zgjerimit të Evropës Jugore zbuloi se në praktikë vetëm shtetet me institucionet demokratike u ofrohej një marrëveshje asocim/anëtarësimi. Kjo u bë mjaft e dukshme në rastin e marrëveshjeve të asocimit të Greqisë dhe Turqisë të cilat në fazën e parë u pezulluan dhe rasti i Spanjës mbeti i ngrirë.

¹⁸ Turqia merret si pjesë e negociatave për zgjerim të vendeve të tjera të Evropës Jugore pasi sëbashku me ato ndan një të shkuar të përbashkët autoritariste. Gjithashtu ajo tregon rastin e mospërputhshmërisë me kushtete që u vendosën nga Këshilli i BE për tu antarësuar, ndryshe nga vendet e tjera të cilat i pranuan.

Kështu në 1975, Greqia dhe Turqia nuk dukeshin si kandidatë premtues për anëtarësim. Niveli i tyre i zhvillimit politik dhe ekonomik u bë shkak që qeveritë evropiane dhe autoritetet e KEE të ishin në dilemë për vazhdimin e këtij procesi. Nga njëra anë, ata nuk mund të linin pas dore mundësinë e mbështetjes të zhvillimit politik dhe ekonomik që ata kërkonin arritje prej këtyre shteteve. Por nga ana tjetër, nuk mund të anashkalohej fakti se ofrimi për anëtarësim do të nënkuptonte se dimensionin politik ishte i një rëndësie të pjesshme e kriterëve për anëtarësim në KEE.

Komisioni Evropian dhe Parlamenti në përgjithësi ishin aktorët kryesorë dhe më të qëndrueshme që ngrinin zërin për të mbajtur një qëndrim të kundërt ndaj autoritarizmit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut në Greqi. Ngjarjet e 1967, e çuan Komisionin të aplikonte ngrirjen e pjesës kryesore të Marrëveshjes së Asocimit KEE-Greqi të 1961. Parlamenti Evropian, në një rezolutë të posaçme të majit 1967 deklaronte se Marrëveshja e Asocimit, e cila gjithashtu kishte funksionuar si një formë e marrëveshjes së para-anëtarësimit për Greqinë, do të mund të zbatohet vetëm nëse institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut do të rivendoseshin (Coufoudakis 1977: 118). Gjithashtu Parlamenti kërkoi që vëndi të respektonte aplikimin e Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dhe kërkonte që të drejtat civile dhe politike mbi të burgosurit politikë të riaplikoheshin. Greqia aplikoi për anëtarësim të plotë në 12 qershor 1975 pas rënies së diktaturës ushtarake (ibid: 119). Negociatat filluan në 1976 dhe Greqia u bë anëtar me të drejta të plota në 1981.

Paralelisht me përpjekjen e Greqisë për të aderuar në KEE, Turqia gjithashtu kërkoi të anëtarësohej. Aplikimi i saj i parë u parashtrua në 31 korrik 1959. Në vend të anëtarësimit, modeli i bashkëpunimit që KEE ofroi asokohe ishte një marrëveshje asociimi tregtar të veçantë, e nënshkruar në Ankara më 12 shtator 1963. Kjo marrëveshje nuk parashikonte ndonjë arritje ndaj mbrojtjes e të drejtave të njeriut dhe demokracisë, pavarësisht nga fakti se kriteret e Birkelbach¹⁹ ishin miratuar një vit më parë dhe gjendja e të drejtave të njeriut në Turqisë ishte e paqëndrueshëm. Sipas Faucompret dhe Könings: “qëllimi i KEE ishte për të krijuar një marrëveshje të thjeshtë tregtare, duke pasur parasysh

¹⁹ Raporti i Willi Birkelbach i vitit 1961 përcaktonte kushtet politike dhe institucionale në të cilat duhet të drejtohej një vend kandidat për tu antarësuar. Për më tepër shih: http://www.ena.lu/report_willi_birkelbach_political_institutional_aspects_accession_association_with_community_december_1961-020006013.html (Aksesuar më 10 Shkurt 2015)

se problemet politike dhe ekonomike të Turqisë ishin aq të mëdha sa që transformimi që ata do të kërkonin mund të tejkalonte dhe qëllimin” (Faucompert dhe Könings 2008: 25).

Në fakt, kaosi dhe destabiliteti që Turqia u përball në fund të viteve 1960, rezultoi me shkelje të rënda e të drejtave të njeriut midis qytetarëve por dhe me memorandumin ushtarak të 1971, nuk pati ndonjë efekt të dukshëm ndaj marrëdhënieve KEE-Turqi. Grushti ushtarak i vitit 1980 i ndërpreu marrëdhëniet KEE-Turqi dhe vuri theksin në rëndësinë që kishin marrë të drejtat e njeriut mbi marrëdhënien midis tyre. Të dy institucionet e KEE dhe shtetet anëtare mbështetën idenë se regjimi ushtarak kishte kryer shkelje të hapura dhe sistematike e të drejtave të njeriut ndaj qytetarëve turq (ibid: 47). Ky fakt implikoi në mosmarrjen parasysh të aplikimit të Turqisë për tu antarësuar në KEE.

Megjithatë, Këshilli i BE vendosi ta mbajë “të hapur” [“efektive”], Marrëveshjen e Ankarasë duke menduar se regjimi ushtarak do të përfundonte dhe një qeveri civile do të zgjidhej - eksperiencë kjo e fituar nga vendeve e tjera të Evropës Jugore që tashmë e kishin kaluar dhe ishin në procesin e integritimit në KEE. Ndërkaq Parlamenti Evropian kërkoi ngrirjen e Marrëveshjes në 1981 dhe kaloi një rezolutë një vit më vonë duke pezulluar marrëdhëniet me komitetet e përbashkëta parlamentare KEE-Turqi (Zurcher 2007: 323). Madje disa shtete anëtare, me një orientim normativ në politikën e tyre të jashtme, të tilla si Holanda dhe Danimarka, insistuan në dëbimin e Turqisë nga Këshilli i Evropës, një hap që nuk u materializua me një vendim politik të forumit (ibid: 327).

Më 14 prill 1987, Turqia ri-aplikoi për anëtarësim në KEE. Megjithatë, elita qeverisëse e Turqisë dështoi të realizonte një ndryshim me rëndësinë mbi të drejtat e njeriut dhe demokracisë. Sipas Kahraman, ata besonin se reformat liberalizuese ekonomike që ishin zbatuar gjatë viteve të 1980 do të ishin të mjaftueshme për të siguruar pranimin në Komunitet. Kështu ndryshe nga pritshmëritë e vendit, Komisioni në 20 dhjetor 1989 nuk i rekomandoi hapjen e negociatave me Turqinë. Ndërkohë si alternativë, Komisioni propozoi hapjen e negociatave për një marrëveshje për bashkimin doganor të cilat përfunduan në 1996 (Kahraman 2000: 13).

Spanja dhe Portugalia patën të njëjtin ngurrim nga KEE në lidhje me të drejtat e njeriut. Gjatë viteve 1950 dhe 1960, të dy vendet qeveriseshin nga regjime autoritare dhe strukturim ekonomik të prapambetur, çka e bënë të pamundur antarësimin e tyre (Royo dhe

Manuel 2003: 3). Në 1959 Spanjë nisi një proces liberalizimi ekonomik të kufizuar, e cila më pas rezultoi me nisjen e negociatave për një Marrëveshje Asocimi tre vite më vonë. Kërkesa e Spanjës u pranua përfundimisht dhe Marrëveshja e Asocimit zgjati deri në 1970. Megjithatë, në 1975, kur një kërkesë e Spanjës u paraqit për një rinegocim të marrëveshjes, Komuniteti e pezulloi atë, për shkak të shkeljeve të rënda që vendi paraqiste në kuadër e të drejtave të njeriut dhe mungesës së demokratizimit, ndonëse vendi sapo kishte nisur një proces tranzicioni pas vdekjes së Frankos (Bartels 2005: 51). Ndërkohë në 1977 qeveria e sapo krijuar demokratike aplikoi zyrtarisht për anëtarësim. Për një periudhë dy vjeçare vendi u monitorua për përmbushjen e kriterëve politike, kryesisht në demokratizim, sigurimin e të drejtave të njeriut për qytetarët spanjoll dhe liberalizimin e mëtejshëm të ekonomisë. Vetëm në 1979, negociatat nisën zyrtarisht dhe kulmuan me nënshkrimin e traktatit të aderimit në KEE më 12 qershor 1985.

Rasti i Portugalisë ishte jo shumë i ndryshëm nga ai i fqinjit lindor. Vendi ishte kryesisht i izoluar si nga zhvillimet ekonomike ashtu dhe ato politike që Evropa Perëndimore dhe kryesisht KEE po ndërmerrnin (Preston 1997: 64). Në 1970 qeveria autoritare paraqiti një kërkesë për një marrëveshje asociimi me KEE, por do të duheshin ndryshime politike të nevojshme të vendit që KEE ta merrte në konsideratë nisjen e negociatave. Kështu me fundin e regjimit të Kaetano në 1974 dhe humbjen e kolonive të saj në Afrikë, Portugalia hyri në një periudhë tranzicioni dhe e ktheu vëmendjen e saj tërësisht nga prespektiva e KEE (Birmingham 1993: 191). Aplikimi i Portugalisë u pranua në mars 1977 dhe nënshkrimi i traktatit për anëtarësim u arrit më 12 qershor 1985. Ndërtimi i fuqisë normative të Europës në proceset e zgjerimit të Evropës Jugore evoluoi rreth një pikë qendrore. Për herë të parë në një proces zgjerimi, kishte diskurs institucional dhe publik që theksonte integrimin e vlerave dhe normave në projektin Evropian. Vetë-përfaqësimi i BE-së si një ‘fuqi e së mirës’ mbetet fuqimisht e pranishme në fuqinë normative të BE sot, siç do të tregohet në seksionin që vijon.

3.3.3. Zgjerimi i vendeve nordike dhe Austria: impakti i kushtëzimit

Në kushtet e implementimit të kriterëve mbi të drejtat e njeriut, procesi i Zgjerimit në 1995 antarësoi tri vende të reja në Unionin e sapo formuar politik (BE) - Finlanda,

Suedia dhe Austria. Në të njëjtën linjë Kriteret e Kopenhagenit të adaptuara në 1993, nisën të implikonin një qasje shumë më shtrënguese për kushtëzimin politik dhe respektimin e detajuar me *acquis communautaire*, ku shtetet kandidate në fjalë duhej të përmbushnin pa asnjë rezervë të dyja kriteret, ato të karakterit politik (ku demokracia dhe të drejtat e njeriut ishin primare) dhe ato që lidheshin me ekonominë (financat, politikat monetare, financat publike, etj). Ndërkaq implikimi më i rëndësishëm gjatë procesit të Zgjerimit të tretë mbi praktikën e kushtëzimit ishte prezantimi i kushtëzimit mbi kriterin e ‘të drejtave të njeriut’. Gjithashtu impakti i kushtëzimit tregon për një ndikim mjaft negativ të BE-së mbi disa aspekte të mbrojtjes së të drejtave individuale në vendet nordike. Kjo pati ndikim veçanërisht në fushën e të drejtave sociale. Me fjalë më të thjeshta, nëpërmjet BE, këto vende u detyruan të ishin në të njëjtën linjë me vendet e tjera të Unionit, dhe kështu u detyruan të ulnin standartet e tyre të mëparshme (Këist 2004: 312).

Kur Austria, Suedia dhe Finlanda aplikuan secila prej tyre për tu antarësuar në BE - respektivisht në 1989, 1991, dhe 1992 - ata ishin anëtare të METL me një standard të lartë ekonomik, dhe nënshkrues të Marrëveshjes së Zonës Ekonomike të Përbashkët Evropiane (Miles 1996: 66). Megjithatë, politika sociale ishte një fushë në të cilën vendet kandidate, me përjashtim të Austrisë, ruanin një standart më të lartë se ai në BE, ku Suedia përbënte rastin kryesor. Kështu secili vend kandidat u lejua të mbante të lartë nivelin e mbrojtjes për një periudhë prej katër vitesh (deri në 31 Dhjetor 1998). Në të njëjtën kohë, Traktatet e Asocimit që hynë në fuqi për secilin vend, përfshinte një strategji politike nga BE për të rishikuar standartet ekzistuese të BE me qëllim të rritjes së tyre në nivelin e shteteve të reja antare dhe atyre aplikante (Kwist 2004: 313).

Ndërkaq Bashkimi Evropian hasi një paradoks të papritur si rezultat i Zgjerimit të ri në 1995 me tre vendet e reja, duke thelur divergjencat e brendshme dhe të jashtme në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe nevojën për të implementuar një strategji të re. Paradoksi qëndronte në faktin se niveli i mbrojtjes e të drejtave të njeriut në këto vende do të duhej të reduktohej pas anëtarësimit, në mënyrë që të ishte në të njëjtën linjë me pariminet mbizotëruese të së drejtës së BE dhe presioneve të tjera rregulluese. Në fushat e mësipërme ku BE kishte kompetenca të pakta ose të paqarta, efekti i përgjithshëm i

kushtëzimit mbi të drejtat e njeriut krijonte mundësinë e përkeqësimit të niveleve ekzistuese të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

3.3.4. Zgjerimi drejt Lindjes (2004-2007): ‘kthimi në Evropë’

Proçesi i Zgjerimet Lindor në BE që përfshinte ish-vendet komuniste prej Evropës Qëndrore dhe Lindore, nga ku Bullgaria dhe Rumania u perceptuan si një gur themeli në zhvillimin e një politike mbi të drejtat e njeriut në kuadër të zgjerimit. Së pari, u prezantua hartimi i mekanizmave të politikave, qëllimi i të cilave ishte për të arritur qëllimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të BE nëpërmjet instrumentave normë-depërtuese. Proçedurat e institucionalizuara i dhanë aftësinë BE për t'i dhënë formë dhe menaxhuar praktikën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në shtetet kandidate sipas perspektivave të veta. U theksua përfshirja e elementeve normativë në programet financiare të asistencës, kushtëzimit, dhe masave të synuara teknike si një mjet i fuqishëm për të promovuar reformën dhe për të siguruar stabilitetin. Pranimi i normave e të drejtave të njeriut ishte e lidhur edhe me sanksione të mundshme; një shembull i kohëve të fundit ishte pezullimi i përkohshëm i negociatave të pranimit me Turqinë për shkak të brutalitetit të policisë gjatë protestave Gezi Park të 2013.

Së dyti, BE elaboroi një diskurs e të drejtave të njeriut duke krijuar një identitet të saj, dhe duke i shndërruar vendet jo historikisht partnere në ‘të tjerë’. Zgjerimi Lindor në vetvete ishte një përpjekje dhe detyrim i BE për të kthyer vendeve të EQL në ‘familjen Evropiane’ pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Ideja e ‘kthimit në Evropë’ ishte një argument i fortë që lidhej me promovimin e të drejtave të njeriut ndaj EQL (Sjursen 2002: 504).

Formulimi i Kriteve të Kopenhagenit (1993) përbën një moment përcaktues në zhvillimin e mëtejshëm të politikave e të drejtave të njeriut të BE në kuadër të zgjerimit. Për herë të parë në historinë e BE, një listë politikash të qarta, megjithëse të përgjithëshme, mbi kriteret politike për anëtarësim u formuluan. Kriteret e Kopenhagenit zgjeruan fushëveprimin e kushtëzimit të BE përtej kriteve formale të përcaktimit të kufizuar të demokracisë (zgjedhje të lira dhe të drejta) dhe në fushat e demokracisë mbi krijimin e një shoqërie civile aktive, të barazisë sociale dhe lirisë (Dimitrova dhe Pridham 2004: 97).

Kushtet politike u shtrinë mbi stabilitetin e institucioneve demokratike, shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë të drejtat e pakicave. Kriteret e Kopenhagenit u përfshinë më pas në të drejtën themelor të BE nëpërmjet nenit 6 (1) të Traktatit të Amsterdemit (1999). Kriteret e Kopenhagenit u shoqëruan me zhvillimin e një politike gjithëpërfshirëse e të drejtave të njeriut, pasi ato nuk përbënin një 'strategji' të drejtpërdrejtë të kushtëzimit në vetëvete. Synimet, qasja, dhe prioritetet e kushtëzimit u zgjeruan në mënyrë të konsiderueshme gjatë procesit të zgjerimit Lindor. Siç theksonte Kochenov: “proçesi i zgjerimit lindor bëri ndarjen midis qasjes së vjetër dhe asaj të re të BE” (Kochenov 2008: 132).

Kriteret e pranimit - të strukturuar rreth *acquis communautaire* - u rritën në një vëllim të konsiderueshëm. Afati kohor për negociatat u bë i dukshëm, dhe monitorimi i progresit më objektiv. Për herë të parë kandidatët duhej të paraqitnin se posedonin kapacitete për pajtueshmëri të lartë (Nicolaidis 2003: 47). Për të siguruar shtrirjen e gjërë me standardet evropiane, gjatë procesit të Zgjerimit ndaj EQL për herë të parë u implementua i gjithë *acquis* i nevojshëm në të drejtën kombëtare të vendeve respektive para nënshkrimit të traktatit të pranimit. Por kjo ndodhi në mungesë të angazhimeve reciproke nga Evropa, një situatë që shpesh shihet si një asimetri fuqie (Grabbe 2006: 34). Me fjalë të tjera sipas Papadimitriou dhe Gateva: “asimetria e thellë e fuqisë midis palëve negociuese krijoi presion masiv për përshtatjen e brendshëm në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore” (Papadimitriou dhe Gateva 2009: 154). Prandaj, fleksibiliteti që karakterizoi procesin e përshtatjes së vendeve kandidate të mëparshme, mungonte tashmë. Sipas Balfour, ky sistem ‘i ri’ u perceptua nga BE si një qasje e vlefshme drejt konsolidimit demokratik dhe zbatimit të brendshëm të standarteve mbi të drejtat e njeriut (Balfour 2006: 119).

Në përgjithësi, tre zhvillime mbi qëllimin dhe formën e politikës së BE mbi të drejtat e njeriut, hapi rrugën për një vlerësim më të plotë të aderimeve aktuale dhe ato të ardhshme, nëpërmjet adoptimit të procedurave normë-depërtuese. Një prej zhvillimeve të para ishte formësimi i një proçedure më parimore dhe të sofistikuar të politikave të cilat shfrytëzohen në një gamë më të gjerë të instrumentave për të formësuar dhe menaxhuar reformën e të drejtave të njeriut në shtetet kandidate. Në analizën e saj mbi kushtëzimin në

Evropën Qendrore dhe Lindore, Grabbe (2002) diferençoi ato instrumenta sipas proceseve të politikave ndërqeveritare dhe transnacionale. Nga njëra anë, BE-ja filloi të zbatojë të drejtat e njeriut nëpërmjet politikave ndërqeveritare, siç janë paketat teknike dhe financiare të ndihmës për çështje të ndryshme, duke mbajtur një rol të drejtpërdrejtë në përcaktimin e ku secili vend kandidat mund të ecë përpara në fazën e ardhshme të pranimi. Ndërsa nga ana tjetër, BE ushtroi politikat e socializimit transnacional, të tilla si bashkëpunimi i shoqërisë civile, nëpërmjet të cilave u përpoq të ushtronte një ndikim indirekt dhe presion mbi mbrojtjen e të drejtat e njeriut (Grabbe 2002: 257).

Bashkëpunimi transnacional i OJQ dhe aktivizmi u shndërruan në një element vendimtar në qasjen të “re” të Unionit ndaj Zgjerimit.²⁰ Megjithatë, kritika serioze janë paraqitur për shkak të një mungese transparence dhe burokratizimi në kuadër të procedurave të politikave të reja. Petrov argumenton se disa nga projektet janë konsideruar jo efektive, pasi nuk janë përshtatura nevojave lokale, dhe pjesëmarrësit e konsultimeve nuk kanë qenë sa duhet të kualifikuar apo të informuar (Petrov 2008: 51). Rëndësia kontekstuale dhe përshtatshmëria e instrumenteve të BE për rastin e Kosovës do të vlerësohen në mënyrë empirike në kapitujt në vijim.

Zhvillimi i dytë ishte në një shkallë performace mjaft të rëndësishme mbi të drejtave e njeriut të shteteve candidate ('monitoruese'), e cila shërbeu për të nxjerrë në pah njohuritë kritike të standarteve të dyfishta në raport me të drejtat e njeriut si politika të brendshme dhe të jashtme të BE (de Burca 2003: 680). Sistemi i monitorimit mbi progresin vjetor të vendit kandidat përfshinte hartimin e progres-raporteve për zbatimin e *acquis* në vendin përkatës, ku të drejtat e njeriut ishin ndër më të rëndësishmet. Kryesisht raportet ngrenin shqetësimin jo vetëm mbi miratimin e ligjeve në fushat kryesore e të drejtave të njeriut, por edhe me realitetin në terren.

Ata gjithashtu vlerësonin kapacitetin administrativ dhe aftësinë institucionale të vendeve candidate për të zbatuar kriteret e të drejtave të njeriut dhe për të shpërndarë dhe për të marrë fonde. Sipas Grabbe, raportet: “nxisin në mënyrë të drejtpërdrejtë politikë-

²⁰ Për më tepër rreth kësaj strategjie shih, European Commission, 'Civil Society Dialogue between the EU and Candidate Countries'. COM(2005) 290 final (Brussels: 29 June 2005)
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/civil_society_conference/civil-society-dialogue-between-the-eu-and-candidate-countries_2005-06-29_en.pdf (parë më 20 Shkurt 2015)

bërjen në vendet candidate duke vënë theksin mbi prioritetet që duhet të zbatohen në kuadër të kushteve afat-shkurta dhe afat-mesme” (Grabbe 2001: 1022). Pavarësisht përpjekjeve të saj për të udhëhequr një reformë thelbësore dhe zgjidhje me bazë, procesi i monitorimit ka qenë vazhdimisht i kritikuar për mungesën e standarteve të qarta të BE, mungesës së qartë ndaj së drejtës së BE, mbështetjes të organeve të jashtme (të tilla si OJQ-të lokale) për të kryer funksionet e monitorimit, promovimin e standardeve të paqarta ndërkombëtare, dhe një standart të dyfishtë që lind nga mungesa e monitorimit të gjendjes së të drejtave të njeriut në vendet antare (Hughes dhe Sasse 2003: 12).

Zhvillimi i tretë në politikën e të drejtave të njeriut të BE përfshiu miratimin e zhvillimit të shoqërisë civile. Zhvillimi i shoqërisë civile është ndërtuar si një instrument i socializimit transnacional në kuadër të zgjerimit të BE. Bazuar në përkufizimin nga Schimmelfennig et al.: “shoqërimi përbën një proces në të cilin vendet candidate janë të detyruar të miratojnë rregullat dhe norma themelore të Bashkimit Evropian 'nga poshtë’” (Schimmelfennig et al 2006: 2). Nëpërmjet Zgjerimit të vendeve të Evropës Qëndrore dhe Lindore, zhvillimi i shoqërisë civile kishte për qëllim nxitjen e reformave nëpërmjet aftësisë së qytetarëve dhe organizatave jo-qeveritare për të ndikuar preferencat e qeverive të EQL, sipas normave të përcaktuara nga morali kolektiv të një komuniteti Evropian 'të bazuar mbi të drejta' (Risse dhe Sikkink 1999: 11). Për këtë qëllim, qasja e BE u drejtua drejt forcimit të kapaciteteve të shoqërië civile për të nxitur reformën në vendet candidate nga 'pasurimi i axhendës politike dhe debatet civile'. Organizatat e shoqërisë civile u qasën nga BE si aktorë që do të kontribonin në zbatimin e normave e të drejtave të njeriut duke ushtruar presion ndaj qeverive për të ndryshuar politikën dhe vetë perceptimin e publikut ndaj përfshirjes së mbrojtjes së të drejtave të njeriut (Petrov 2008: 54).

Kjo qasje e rinovuar për aplikimin e kushtëzimit e të drejtave të njeriut, megjithëse efektive në influencimin e saj për ndryshim në vendet candidate, mund të kritikohet, si në parim ashtu dhe në praktikë. Një kritikë kryesore i referohet karakterit të kontestuar të procesit të promovimit të drejtave të njeriut, e cila lidh idetë e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës për asistencë zyrtare teknike dhe financiare, pa një përkufizim të qartë të marrëdhënieve të tyre, dhe pa një pamje të plotë të demokracisë liberale (Prindham 2007: 351). Megjithatë instrumentat lejojnë BE të shpërblejë ato shtete

që në mënyrë efektive dhe me sukses arrijnë të plotësojnë objektivat e vendosura. Bashkimi Evropian shfaqet duke sugjeruar se çdo lloj mbështetjeje mbi të drejtat e njeriut, si një normë themelore e saj do të kontribuojë për një sistem më demokratik dhe anasjelltas, pa një strategji të qartë konceptuale të asaj se si kjo do të zhvillohet (ibid: 354). Roli i aktorëve jo-shtetërorë dhe organizatave të shoqërisë civile gjithashtu dëshmon të jetë i diskutueshëm. Përfshirja më e gjerë në proces e aktorëve jo-shtetërorë, shërben për të rritur aftësinë e aktorëve lokalë dhe transformimin nga poshtë, por ajo është e paqartë se ndaj kujt mund të konsiderohet si e rëndësishëm në kuadër të shoqërisë civile dhe pse shkak i tyre është përfshirë në asistencë financiare. (Mahoney dhe Beckstrand 2011: 1345).

Një tjetër pikë problematike ka të bëjë me mospërputhjet në aplikimin e kushtëzimit në politikën e të drejtave të njeriut. Mospërputhja mund të kufizojë besueshmërinë dhe efektivitetin e kushtëzimit të Bashkimit Evropian për të drejtat e njeriut. Një shembull i rëndësishëm i mospërputhjes është rishfaqja e 'kushtëzimit të ndikimit' gjatë procesit të aderimeve në vitin 2004. Albi (2009) argumenton se krijimi i gjykatave kushtetuese post-komuniste, të cilat i mbështetën fuqishëm të drejtat e njeriut pas rënies së regjimeve komuniste, arritën të kishin një vlerësim të degraduar mbrojtjeje mbi të drejtat e njeriut pas anëtarësimit, për shkak të kufizimeve që vinin nga përparësia e së drejtës Evropiane. Sipas Albi, gjykatat: “u përballën me vështirësi në ruajtjen e nivelit të para-pranimet e të drejtave themelore të njeriut [...] në lidhje me masat që zbatojnë të drejtën e BE-së” (Albi 2009: 50).

Një tjetër pyetje që lind nga politika ripërtëritëse e BE është çështja e paqartësisë në lidhje me promovimin universal e të drejtave të njeriut kundrejt një detyrimi të veçantë ndaj atyre që konsiderohen ‘njëri prej nesh’. Kriteret e Kopenhagenit pretendojnë se mbështeten në parimet universalisht të pranuara që rrisin objektivitetin dhe besueshmërinë e politikave të BE (Komisioni Evropian 2013). Megjithatë kur e shohim më nga afër, qasja Evropiane e të drejtave të njeriut drejt vendeve të EQL duket e vendosur nga standarti i legjitimitetit dhe përshtatshmëria e fuqisë normative të BE në bazë të normave përbërëse të Unionit dhe të kuptuarit e saj, si një ‘fuqi e së mirës’ (Schimmelfennig 2001: 58). Rrjedhimisht, vendet e EQL të perceptuara se ndanin në mënyrë kolektive identitetin e BE (siç dëshmohet nga retorika ‘kthimit në Evropë’), dhe në këtë mënyrë i përmbahen vlerave të saj, duke u mundësuar të drejtën për tu bërë pjesë e saj. Në të kundërt, qëllimi i politikës së të drejtave

të njeriut ndaj Ballkanit Perëndimor duket se lidhet jo vetëm ndaj së ardhmes integruese por mbi të gjitha ajo përcaktohet mbi terma të sigurisë (Sjursen 2002: 504).

Kushtëzimi i zgjeruar dhe mekanizma më të forta të monitorimit ishin të dukshme në procesin e zgjerimit të Bashkimit European ndaj Bullgarisë dhe Rumanisë në vitin 2007. Kriteret mbi të drejtat e njeriut që vendet kandidate duhet të respektonin u zgjeruan për të përfshirë dispozitat e Kartës Themelore e të Drejtave të Njeriut, e cila u shfrytëzua si një tjetër mënyrë për të vlerësuar performancën e vendit kandidatit. Siç vuri në dukje Phinnemore: “proçesi i monitorimit të Komisionit Evropian u forcua në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me aderimet në vitin 2004” (Phinnemore 2006: 17).

Gjithashtu, për herë të parë BE e vendosi 'kushtëzimin e pas-pranimit'. Kjo solli mundësinë që Komisioni të vazhonte monitorimin e pajtueshmërisë së vendeve me *acquis* edhe pasi ata të kishin aderuar formalisht në BE. Mosrespektimi shkaktonte sanksione të tilla si tërheqja e fondeve të BE dhe pezullimin e bashkëpunimit në çështjet gjyqësore. Imponimi i kushtëzimit të zgjeruar ndaj antarësimeve të 2007 është parë si një mjet politik diskriminimi në duart e shteteve antare (Lazowski 2007: 414). Megjithatë, aplikimi i kushtëzimit të pas zgjerimit mund t'i atribuohet dinamikës më komplekse se sa vetë diskriminimi. Sipas Papadimitriou dhe Gateva, Bullgaria dhe Rumania të influencuar nga eksperiencia e tyre traumatike të komunizmit dhe me një popullsi të konsiderueshme u detyruan të jepnin llogari për ritmin e ngadaltë të reformave dhe për të promovuar pranimin e shpejtë të integritetit të tyre në BE (Papadimitriou dhe Gateva 2009: 160). Promovimi i tyre si kandidat të jashtëzakonshme, e drejtuan BE për të lejuar hyrjen e tyre pavarësisht nga një nivel i ulët papajtueshmërie, në mënyrë që të shmangen shpenzimet e paparashikueshme që do të lindnin në rast të mos pranimit të tyre (Phinnemore 2009: 244).

Si përmbledhje mund të themi se Zgjerimi Lindor shënoi një pikë kthese në zhvillimin e politikës së të drejtave të njeriut të BE-së dhe promovimin e institucionalizuar të tyre. Gjatë proçesit të antarësimit të vendeve të EQL në 2004, BE zhvilloi një strategji shumë më të intensifikuar, të konsoliduar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kuadër të zgjerimit, e cila solli qasjen zyrtare të zgjerimit në përputhje me të drejtat e njeriut.

3.4. Përfundime

Qëllimi i këtij kapitulli ishte të eksplorothe themelet e politikës së promovimit e të drejtave të njeriut të Bashkimit European duke hedhur dritë mbi rëndësinë e tij në kuadër të fuqisë normative të BE. Kapitulli ndoqi trajektoren e politikës nga ndërtimi i saj i brendshëm ligjor të aktiviteteve të jashtme të BE-së që formuan zbatimin e tij. Kështu u argumentua se, në mënyrë që kjo tezë doktrinale të japë një këndvështrim të politikave dhe legjitimitetin e promovimit të drejtave të njeriut në Kosovë, së pari do të duhet të kuptohen dinamikat e brendshme dhe veprimi ndërkombëtar i vetë BE. Pra të kuptuarit e BE si një fuqi normative në promovimin e të drejtave të njeriut është parë duke analizuar dimensionin e ‘brendshëm’ dhe atë ‘të jashtëm’ në një marrëdhënie me njëra-tjetrën. Gjithashtu u vendos theksi se kushtëzimi është i përshtatur në kuadër të politikës më të gjerë të drejtave të njeriut në marrëdhëniet e jashtme.

Pjesa e parë e kapitullit u fokusua në qasjen juridiko-institucionale të fuqisë normative të BE-së nëpërmjet juridiksionit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe aktivitetet të Parlamentit Evropian si aktorë institucional kyç të cilët ndërveprojnë me politikën e të drejtave të njeriut të BE. Gjithashtu u analizua Karta Themelore e të Drejtave dhe traktatet kryesore të integritetit evropian. Duke hulumtuar në vijëmesinë e traktateve u pa qartë zhvillimi progresiv i kushtëzimit e të drejtave të njeriut, dhe si BE ndryshoi qëllimin, drejtimin, dhe kapacitetin për të krijuar dhe zbatuar një ‘politikë e të drejtave të njeriut evropiane’.

Pjesa e dytë e kapitullit analizoi dimensionin e jashtëm të promovimit e të drejtave të njeriut përmes aplikimit të saj gjatë raundeve të njëpasnjëshme të zgjerimit: Britania (1973), zgjerimin e Evropës Jugore (1981, 1985), zgjerimi i vendeve nordike dhe Austrisë (1995) dhe zgjerimet në Europën Lindore dhe Qendrore (2004 dhe 2007). Gjithashtu u argumentua se në bazë të specifikave të secilit vend kandidat në konsideratë, KEE/BE riformuluan një bazë të kërkesave e të drejtave të njeriut që sot mbështesin zbatimin e të drejtave të njeriut të BE në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndërkaq kapitulli në vijim do të diskutojë legjitimitetin e fuqisë normative të BE në prezencën e saj në Kosovë në lidhje me promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

KAPITULLI I KATËRT

TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË DHE ROLI I BASHKIMIT EUROPIAN

4.1. Hyrje

Përgjatë kapitujve të mëparshëm, u njohëm gjerësisht me konceptualizimin teorik dhe analitik ndaj të drejtave të njeriut i cili tashmë do të shërbejë për të zhvilluar analizën empirike. Kështu në këtë kapitull do të analizoj të drejtat e njeriut në Kosovë e parë nga prespektiva e Bashkimit Evropian. Këto dinamika do të shihen në raport të legjitimitetit ku BE si fuqi normative, ‘shpërndan’ normat dhe vlerat e saj në Kosovë dhe pret një përputhshmëri të saj. Kjo përputhshmëri mbështetet në politikën e kushtëzimit që BE ushtron përgjatë procesit të Integritetit.

Kështu në fillim të kapitullit do të analizoj në lidhje me prezencën e BE në Kosovë duke nisur që prej vitit 2008, ku dhe roli i saj mori një mori dimensionesh dhe ku politika mbi të drejtat e njeriut mbeti ndër fushat kryesore të veprimit. Siç e kemi prezantuar që në fillim të kësaj teze, studimi ka marrë në fokus një periudhë 6 vjeçare që prej shpalljes së pavarësisë dhe deri në 2014, por për të kuptuar rëndësinë që BE parqet për Kosovën do të kthehemi shpesh para vitit 2008. Kështu së pari do të analizohet roli i përfaqësuesit special të BE në Kosovë dhe angazhimi i tij në promovimin e të drejtave të njeriut; së dyti zyra e ndërmjetme e Komisionit Evropian dhe së treti nga zyra e EULEX mbi të drejtat e njeriut. Në të treja këto raste të përfshirjes së BE në Kosovë do të analizohen në kuadër të modelit të legjitimitetit të elaboruar në kapitullin e mëparshëm.

Kësisoj do të argumentohet se Zyra Përfaqësimit Special (ZPS) të BE normat dhe vlerat e BE i promovon nëpërmjet politikave mbështetëse për të konsoliduar dhe promovuar paqe, stabilitet dhe shtet ligjor. Ky rol normativ është thelbësisht substancial pasi është në mbështetje me zhvillimin efektiv të Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë (PBMS), dhe për të ndihmuar BE të jetë aktive, koherente dhe një aktor i aftë të përballojë sfidat e reja në skenën globale. Ndërkaq, Zyra e Ndërmjetme (ZN) e Komisionit Evropian nëpërmjet përdorimit të kushtëzimit politik, duke ofruar incentiva financiare, kërkon të arrijë një legjitimitet të politikave të saj duke e shtyrë Kosovën të përfitoj prej tyre vetëm nëse ajo arrin të ketë përputhshmëri me kushtet politike dhe standartet e saj.

Së fundmi, BE nëpërmjet mandatit të EULEX i sheh institucionet e Kosovës mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut si thelbësisht jo-evropiane, ku kërkohet një ndërhyrje për tu përafruar me normat dhe standartet e evropiane dhe kësisoj zbaton më tepër një

marrëdhënie fuqie. Normat e saj duhet të zbatohen pasi legjitimimi nëpërmjet procedurës dhe substancës i jep asaj karakterin e ‘fuqisë së mirë’ dhe kur vendet jo antare të BE - në rastin tonë Kosova - perceptojnë normat e fuqisë si të pranueshme për miratimi dhe sjelljen sipas standarteve të legjitimitetit të tyre.

Në pjesën e dytë do të analizohen tre të drejat dhe liritë themelore të përzgjedhura, ku BE përgjatë këtyre 6 viteve të fundit në progres-raportet por jo vetëm, në publikime, në konferenca për shtyp apo dhe në deklarata ka vendosur theksin si fusha prioritare ku pret pritshmëri nga institucionet qeverisëse të Kosovës. Kështu do të argumentohet mbi të drejtat e grave dhe barazisë gjinore, lirinë e shprehjes dhe të drejtat LGBTI duke e analizuar jo vetëm nga progres-raportete ndër vite por dhe nga vlerësimet e indekseve apo raporteve të organizatave të tjera. Përfundimet nga kjo analizë do të na ofrojnë një tablo më të detajuar të zhvillimeve në Kosovë përgjatë kësaj kohëzgjatjeje dhe lidhjen me analizën dynivelëshe elitat-qeverisëse dhe shoqërinë civile në kapitujt e mëpasshëm.

4.2. Bashkimi Evropian në Kosovë

Sot Bashkimi Evropian në Kosovë, përpos përfaqësimit që ka si një vend ndaj të cilit zhvillon marrëdhënie dypalëshe dhe monitoron rrugëtimin e saj drejt integritit, zhvillon një rol mentorimi dhe deri diku mbiqeverisje dhe bashkëqeverisje në disa sektorë të qeverisjes së vendit.²¹ Por roli i tij nuk ka qenë i njëjtë si sot. Ai ka ardhur duke u forcuar ndër vitë. Kështu që prej dështimit të një rezolute të Këshillit të Sigurimit të OKB në 2007 për të gjetur një zgjidhje të statusit të Kosovës, u propozua miratimi i një plani nga përfaqësuesi special i sekretarit të OKB, Marti Ahtisarit, ku BE do të luante një rol të konsiderueshëm ekzekutiv nën të ashtuquajturën “pavarësi e mbikqyrur”, nëpërmjet Përfaqësuesisë Civile Ndërkombëtare si dhe njëherazi Përfaqësisë Speciale të BE. Në të njëjtën kohë me shpalljen e pavarësisë në 18 Shkurt 2008, u krijua një strukturë monitorimi dhe mentorimi të institucioneve post-pavarësisë nëpërmjet Grupit të Stering-ut, nga disa shtete, ku roli udhëheqës i u la sërsht BE. Edhe pse pavarësia e mbikqyrur përfudnoi në

²¹ Roli bashkëqeverisës dhe mbiqeverisës i referohet përfshirjes së BE nëpërmjet EULEX ku nëpërmjet divizionit të dogana, gjyqësorit dhe policisë ndërvepron me institucionet përkatëse të Kosovës, ndonëse nën një status neutral ndërkombëtar dhe në veriun e Kosovës qëndron si autoriteti i vetëm në mungësë *de facto* të institucioneve të Kosovës. Megjithatë me rezultatet e dialogut Prishtinë-Beograd ky rol do të nisë të zbehet.

2012, BE vazhdon të mbetet aktive me rolin e saj të monitorim/mentorim për forcimin e institucioneve duke u përfaqësuar nga tre shtylla kryesore: Përfaqësuesi i Special i BE, Zyra e Ndërmjetimit të Komisionit Evropian dhe misionit EULEX. Në 2011 zyra e përfaqësisë special dhe zyra e ndërmjetimit të Komisionit Evropian u shkrinë nën të ashtuquajturën zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

4.2.1 Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian

Zyra e përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian u krijua në 4 shkurt 2008, disa ditë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës me një mandat i cili në fillim do të ishte i pacaktuar por sidoqoftë i përkohshëm dhe më pas u paracaktua se do zgjaste deri në 2010. Funksionimi i tij u zgjat deri në 2014 por sërish përfundimi i tij është shtyrë deri në tetor të 2015, me mbarimin e mandatit të kyetarit të saj, Samuel Zbogar.²² Qëllimi kryesor i PSBE është promovimi i politikave dhe interesave të BE dhe një përpjekje për të konsoliduar dhe promovuar paqe, stabilitet dhe shtet ligjor. Gjithashtu me krijimin e saj do të arrihej të mbështetej zhvillimi efektiv të Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë (PBMS), dhe për të ndihmuar BE të jetë aktive, koherente dhe një aktor i aftë të përballoj sfidat e reja në skenën globale (Këshilli i BE 2009).

Mandati i tij përfshin pesë fusha veprimi. Së pari PSBE duhet ti ofrojë institucioneve të BE këshillim dhe suport për vendimarrjet e tyre në procesin politik ndaj Kosovës; së dyti promovim të përgjithshëm të koordinimit të përfaqësimit të BE në Kosovë; së treti, të sigurojë konsistencë dhe koherencë të veprieve të BE kundrejt publikut të gjerë; së katërti, të mundësoj këshillim të politikës lokale dhe drejtuesit të misionit të EULEX në Kosovë; dhe së pesti, të mundësoj zhvillim dhe konsolidim të respektimit e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kosovë.²³ Ky mandat është i bazuar në objektivat e BE në Kosovë mbi kuptimin e gjerë. Ai është i përcaktuar si:

²² Për më tepër shih faqen web të Përfaqësuesit Special i Bashkimit Evropian, http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu_kosovo/political_relations/index_en.htm (Aksesuar më 17 Mars 2015)

²³ Për më tepër shih prezantimin e misionit të PSBE në faqen e saj zyrtare. http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu_kosovo/eu_special_representative/index_en.htm (Aksesuar më 17 Mars 2015).

“zhvillues i një roli kyç në forcimin e stabilitetit në rajon dhe implementimit të një zgjidhjeje që do të përcaktojë statusin e ardhshëm të Kosovës me qëllim mbajtjen e stabilitetit, paqes, demokracisë dhe multi-etnicitetit në Kosovë, duke kontribuar njëherazi në bashkëpunimin rajonal mbi baza të marrëdhënieve të mira të fqinjësisë” (Këshilli i Bashkimit Evropian 2010: 37).

Ndërkaq PSBE, ka patur një gamë të gjërë aktiviteteve të cilat janë përpjekur të influencojnë jo vetëm në politik-bërjen, komunitetet e ndryshme në Kosovë, faktorin e komunitet serb në komunat ‘problematiche’, si dhe ndaj popullsisë së gjërë duke informuar mbi të drejtat e nejtut, prespektivën dhe rrugëtimin e Kosovës në integrimin Evropian si dhe aktivitete të tjera që synojnë përmirësimin e dialogut dhe bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve përbërëse në Kosovë. Këtu nuk duhet të ndalemi thjesht në informim të publikut por të përmendet fakti se PSBE angazhon gjithashtu, të gjithë aktorët kryesorë të shoqërisë civile.²⁴

Kështu një ndër këto aktivitete ka qënë ‘të lexuarit e progres-raporteve’ të Komisionit Evropian për ecurinë e rrugëtimin integruar të Kosovës. Qëllimi i tyre ishte të sillte në vëmendjen e palëve të interesuara përmajtjen e progres-raporteve (PSBE 2010). Në këtë kontekst, tryeza të përbashkëta të organizuara me median, shoqërinë civile por dhe aktorë politikë përgjegjës, janë zhvilluar për të adresuar se cilat do të ishin metodat dhe reformat e përshtashme që qeveria duhet të merrte për të përmbushur rekomandimet e raporteve dhe gjithashtu të shpjegonin pikat e dobëta dhe problematike që progres-raporti evidentonte ndër vite. Këto debate fokusohen kryesisht në çështjet si progresi ekonomik dhe politik, të drejtat e nejtut, mjedisit dhe shtetit të së drejtës. Panelet përbëheshin nga ekspert të shoqërisë civile, institucionet lokale, qëndrore dhe ndërkombëtare, si dhe i hapur për median dhe publikun e gjerë. Ky forum i përbashkët rriste së pari llogaridhënien, qeveri-publik i gjerë, krijonte mundësinë e bashkëpunimit, ku aktorë të shoqërisë civile shpreheshin të gatshëm të bëheshin pjesë e procesit duket propozuar role dhe strategji dhe nga ana tjetër e rriste kohezionin ndër-etnik, çka mund të përktheheshe me një sukses, të paktën në këtë format të qëllimeve kryesore të vetë misionit të kësaj zyre përfaqësimi.

²⁴ Intervistë me znj. Fjolla Çeku, zyrtare për Median dhe Informim Publik në Zyrën e Përfaqësisë së Bashkimit Evropian në Kosovë, Prishtinë më 17 Korrik 2015

Një tjetër rol i rëndësishëm i PSBE ishte bashkëpunimi me organizata jo qeveritare të shoqërisë civile, ku nga njëra anë, nëpërmjet takimeve joformale private merrte informacione të mëtejshme mbi gjendjen e sektorëve të ndryshëm, si ato të mbrojtës së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore ashtu dhe ato të politikave të ndryshme zhvillimore, të cilat do të shërbenin për vlerësimin e progres-raportet; ndërsa nga ana tjetër e rriste rëndësinë e këtyre organizatave, si shoqërisë civile në terësi, nëpërmjet deklaratave politike në mbështetje të tyre.

Nëse do të hedhim një vështrim mbi rolin e PSBE në raport me legjitimitetin e Bashkimit Evropian, do të shohim se ky komponent i përfaqësimit të BE në Kosovë ka qënë i karakterit thelbësisht substancial. Ky argument mbështetet mbi faktin se pesë fushat e veprimtarisë së saj mbeten substanciale në kontekst, pasi veprimtaria e kësaj zyre, mbetet mbi ‘zhvillimin e një rolit kyç të BE në forcimin e stabilitetit në rajon dhe implementimit të një zgjidhjeje që do të përcaktojë statusin e ardhshëm të Kosovës’ - kjo gjer në vitin 2008 dhe pas vitit 2011 mbi dialogun teknik Prishtinë-Beograd ku një zgjidhje me interes të përbashkët do të ishte më afërt; duke vazhduar me një qëllim përtej Kosovës, ‘mbajtjen e stabilitetit, paqes, demokracisë dhe multi-etnicitetit në Kosovë dhe duke kontribuar njëherazi në bashkëpunimin rajonal mbi baza të marrëdhënieve të mira të fqinjësisë’. Ky rol normativ është thelbësisht substancial pasi është në të njëjtën linjë se si BE kërkon të paraqitet së brendshmi por dhe së jashtëmi, mbi një rol aktiv, koherent dhe një aktor i aftë të përballoj sfidat e reja në skenën globale.

Ndërkaq me riformulimin e Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë, nëpërmjet traktatit të Lisbonës, i cili njëherazi krijoi Shërbimin e Veprimit të Jashtëm Evropian (SHVJE) bëri të mundur përfshirjen e dy komponentëve fillestar të përfaqësimit të BE në Kosovë (zyrës së Përfaqësimit Special dhe zyra e Ndërmjetësimit të Komisionit Evropian) në një përfaqësim të vetëm, zyra e BE në Kosovë.

4.2.2 Zyra e Ndërmjetësimit të Komisionit Evropian

Zyra e Ndërmjetësimit të Komisionit Evropian, u krijua si zyra e parë formale e përfaqësimit të BE në Kosovë, që në vitin 2004. Qëllimi kryesor në vitet e para ishte zgjerimi i kontakteve me funksionimin e UNMIK dhe institucioneve të përkohshme të vetë-

qeverisjes në Kosovë, një mënyrë kjo për të patur një angazhim më të mdh në qeverisjen e asokohe të Kosovës dhe në dialogun lokal-ndërkombëtar për statusin që ky etnitet do të merrte në të ardhmen. Angazhimi kryesor në nivel lokal ishte përafrimi i BE në Kosovë nëpërmjet përfshirjes në Proçesin e Stabilizim Asocimit. Ky fakt u institucionalizua mëtej me deklaratën e vitit 2005, e cila përbënte hapin e parë zyrtar të njohjes së prespektivës evropiane të Kosovës dhe kësisoj një mënyrë për të ftuar faktorin e brendshëm të përgatitej për këtë sfidë të re (Komisioni Evropian 2005). Ky dokument, përveç rëndësisë së angazhimit zyrtar që institucionet e BE ndërmerrnin për Kosovën, shërbeu si një udhëzues për mënyrat dhe metodat se do të ishte ky angazhim. Nëpërmjet asistencës teknike, atë financiare dhe se si do të ndërmmerrej vlerësimi për ecurinë e institucioneve të Kosovës në këtë drejtim.

Zyra e Ndërmjetësimit të Komisionit Evropian menaxhon fondet që jepen nga Komisioni për projektet mbi asistencën ndaj Kosovës dhe koordinon marrjen e fondeve nëpërmjet Instrumentit për Stabilitet, Instrumentit i Asistencës së para-Aderimit, i njohur ndryshe si IPA, dhe gjithashtu Instrumentin Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut. Secili prej këtyre instrumentave ka shërbyer në mënyra të ndryshme si për të rritur kapacitetet qeverisëse në mënyrë të drejtpërdrejt si dhe aktorët e tjerë lokalë. Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme e financimeve kanë shkuar për projekte të ndryshme të menaxhuara nga organizata të shoqërisë civile, të cilat për studimin tonë do të trajtohen në kapitullin e gjashtë të këtij punimi në tre liritë dhe të drejtat të cilat janë përckatuar si më prioritare për veprim nga Komisioni Evropian ndër vitë: liria e shprehjes, të drejtat e grave dhe barazia gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGBTI.

Kështu nëse i hedhim një vështrim ndër vite, Instrumenti për Stabilitet ka shërbyer në financime të asistencës ndërkombëtare në Kosovë se sa vetë faktorit lokal qeverisë apo shoqërisë civile. Disa shembuj që mund të përmendim është fondi i akorduar për tranzitimin nga UNMIK në EULEX me vlerë 9 milion euro; 26 milion euro të tjera të dhëna për zyrën civile ndërkombëtare të Kosovës e cila në ato kohë udhëhiqej po nga përfaqësuesi i BE për zyrën e përfaqësisë speciale (Komisioni Evropian, progress-raport 2010: 23). Nga ana tjetër, *Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut* (IEDDNJ), ka qënë financuesi më aktiv. Demokracia dhe të drejtat e njeriut janë shtyllat kryesore të veprimit,

ku fokusi kryesor është demokratizimi i ndërtimit të institucioneve publik. Kjo nënkupton përfshirjen e shoqërisë civile në mënyrë aktive në jetën sociale, politike, ekonomike dhe shtet-ndërtuese, për rastin e Kosovës, ku njëherazi nuk jep thjeshtë mundësi për të mbështetur zhvillimin e shoqërisë civile në mënyrë të përgjithshme, por dhe të mbështesë aktivitetet e saj.

Nëpërmjet asistencës teknike dhe financiare, nëpërmjet IEDDNJ është arritur një kontribut për zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit e të gjithë të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Parlamenti Evropian 2006). Duke patur në fokus rritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile, përgjatë periudhës 2007 – 2013 ka kontribuar me një buxhet prej 11 milion euro e përqëndruar në 5 fusha prioritare veprimi:

- “1) Rritja e respektimit e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;
- 2) Forcimi i rolit të shoqërisë civile dhe promovimin e reformave mbi të drejtat e njeriut dhe demokracisë;
- 3) Mbështetje të veprimit mbi çështjet e të drejtave të njeriut dhe demokracisë në fushat të cilat janë përcaktuar si kryesore nga udhërrëfyesi i BE, duke përfshirë dialogun e të drejtave të njeriut me OJQ nëpërmjet takimeve informale, mbështetje të mbrojtësve e të drejtave të njeriut, kryesisht aktivistëve të komunitetit LGBTI, gazetarëve investigativ dhe aktivistëve e të drejtave të grave;
- 4) Mbështetje dhe forcim e kornizës rajonale dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, zbatimit të ligjit dhe promovimit të institucioneve demokratike;
- 5) Ndërtim e një konfidence në rritjen mbi besueshmërinë dhe transparencën për procesin zgjedhor demokratik, kryesisht nëpërmjet vëzhgimit të zgjedhjeve (Komisioni Evropian 2007).

Ndonëse IEDDNJ përkonte me disa strategji ndërhyrjeje, përfshirja e saj në Kosovë ka qënë vetëm nëpërmjet katër projektesh. Në njërin prej tyre me qëllim rritjen e lirisë së shprehjes dhe forcimit e të drejtave të njeriut, nëpërmjet Rrjetit Raportues Investigativ të Ballkanit (BIRN), lançoi një program televiziv nën titullin, “Jeta në Kosovë” ku janë trajtuar debate televizive, trajnime dhe monitorim të institucioneve publike, duke kapur në shqyrtim probleme që lidheshin me korrupsionin, sigurinë, përgjegjësinë dhe pajtimin ndër-etnik.²⁵ Ky program është ende funksional në Kosovë dhe sot ka një zhvillueshmëri më të

²⁵ Intervistë me znj. Fjolla Çeku, zyrtare për Median dhe Informim Publik në Zyrën e Përfaqësimit të Bashkimit Evropian në Kosovë, Prishtinë më 17 Korrik 2015

madhe duke përfshirë programacione të tjera që rritin dhe forcojnë lirinë e shprehjes në Kosovë, nëpërmjet asistencës së BE, por këto do të trajtohen më të detajuara në kapitullin e gjashtë.

Instrumenti për Asistencë para Aderimit ka nisur të veprojë që prej 2007 dhe në periudhën e parë deri në 2013 ka alokuar rreth 640 milion euro ndaj Kosovës (Komisioni Evropian ‘IPA 2011-2013’, 2009: 2). Nga pesë komponentët që përbëhët IPA, pra fusha kryesore veprimi, Kosova ka përfituar asistencë veç në dy, kjo për shkak se ajo ende është një vend potencial kandidat. Kështu këto dy fusha janë, asistencë, trajnim dhe ndërtim institucionesh dhe bashkëpunim ndër-kufitar. Gjithashtu nga gjithë financimi i shpërndarë ndër vite, vetëm tre milion euro janë akorduar për fushën e dytë (ibid: 5). Kjo tregon se çështjet mbi ndërtimin e demokracisë, nëpërmjet ndërtimit të institucioneve, besimit ndër-etnik si dhe forcimit të respektimit të ligjit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore mbeten parësore për qasjen e BE në Kosovë.

Kështu fondet IPA janë të ndarë në tre shtylla veprimi: kritere politike, ekonomike dhe standartet evropiane. Në përgjithësi, Komisioni ka inkurajuar projekte që kishin në fokus çështjeve të ndërmjetme - multidisiplinare, që përfshin disa fusha veprimi. Këto përfshinin çështjet mbi shoqërinë civile, fuqizimin e saj dhe më shumë efikasitet në menaxhimin e projekteve, mbrojtjen mjedisore, mundësitë e barabarta dhe jodiskriminimin në bazë race, përbërje etnike, shtresëzimi social [...] (Komisioni Evropian ‘MIPD’ 2008: 11).

Nëse do të hedhin një vështrim të alokimit të fondeve IPA (2007-2013) do të vemë re se pjesa më e madhe e tyre i është dhënë institucioneve qeverisëse, ndërsa OJQ e shoqërisë kanë përfituar një pakicë të tyre dhe nga ku pjesa e konsiderueshme e tyre i është ofruar nëpërmjet organizatave të tjera ndërkombëtare si kontraktues. Kjo mbështetje ndaj shoqërisë civile u mundësua kryesisht nëpërmjet alokimit të fondeve IPA të marra nga qeveria e Kosovës, duke krijuar një mundësie varësie ose kontrolli të qeverisë mbi OJQ të ndryshme ose raste korruptive favorizimi, për tu provuar. Kështu për periudhën 2009-2011 vetëm 2 deri në 5% e fondeve IPA u shpërndan projekteve të shoqërisë civile. Ndërsa 40 %

iu shpërndan për kriterin politik të fondeve, ku përfshihej demokratizimi i institucioneve kryesisht, dhe standartet evropiane u rradhitën të tretat me 15%.²⁶

Në favor të dialogut për Stabilizim-Asocim, zyra e ndërmjetësimit të Komisionit Evropian që prej 2009 ka nisur ti japë një rëndësi të veçantë rolit të shoqërisë civile në pasqyrimin e realitetit të Kosovës, ‘nën syrin e tyre’. Kështu në progres-raporte, kjo qasje e re shihet qartazi ku Komisioni, kërkon ta vendosi vëmendjen edhe në çështje që sipas saj mbeten problematike, kryesisht ndaj të drejtave të grave, barazisë gjinore, lirisë së shprehjes dhe të drejtat e komunitetit LGBTI (Zyra e BE në Kosovë 2009). Ndaj dhe takimi i parë konsultativ me OJQ u realizua mbi luftën kundër korrupsionit, lirisë së shprehjes, të drejtat e grave, sfidat ekonomike dhe mjedisore dhe gjendja e përgjithshme e tyre në Kosovë (Zyra e BE në Kosovë 2010).

Në përgjithësi legjitimiteti i Zyrës së Ndërmjetësimit të Komisionit Evropian në Kosovë ka qënë i karakterit proçedural, pasi siç e shpjeguam në hyrje të këtij kapitulli, BE përpiket të ndjekë promovimin e normave dhe vlerve të saj nëpërmjet ndikimit të kushtëzimit politik, duke ofruar incentiva financiare, ajo kërkon të arrijë një legjitimitet të politikave të saj duke e shtyrë Kosovën të përfitoj prej tyre vetëm nëse ajo arrin të ketë përputhshmëri me kushtet politike dhe standartet e saj. Gjithashtu ajo ofron mbështetje shoqërisë civile, por sërish kjo mbështetje nuk mund ti garantojë fuqizim të saj por nga ana tjetër OJQ të cilat marrin financimet e BE nga institucionet e Kosovës apo organizata të tjera si kontraktorë, krijon një lidhje varësie ose fuqie me këta të fundit. Kështu fuqizimi i shoqërisë civile në vetë-kapacitete dhe mbi të gjitha rritjen e ‘kërkesës’ së përgjegjësisë ndaj institucioneve të Kosovës mbetet larg pritshmërive. Ndaj BE, nëpërmjet zyrës së ndërmjetësimit të Komisionit Evropian ndjek një qasje të re duke përfshirë OJQ në proçesin e leximit, dhënies së opinionëve dhe qasjes së tyre subjektive mbi proçesin e reformave në vend në kuadër të proçesit të Stabilizim Asocimit.

²⁶ Për më tepër shih në Webfaqen e PSBE në Kosovë mbi projektet nën programin vjetor IPA 2009 http://www.delprn.ec.europa.eu/repository/docs/Summary_of_projects_under_IPA_Annual_Programme_2009_for_Kosovo.pdf (Aksesuar më 15 Prill 2016)

4.2.3 Zyra e Eulex mbi të drejtat e njeriut: njohje e legjitimitetit ndaj jo-evropianë, 'të tjerët'

EULEX, u krijua në 4 shkurt 2008 dhe shërben që prej asaj kohe, si misioni më i madh i Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes të BE, ku njëherazi mandati i tij ishte për të zëvendësuar institucionet e UNMIK vetëm në tre fusha veprimi: sektori i policisë, doganave dhe gjyqësorit. Si një mision për qëllim zbatimin e ligjit që në definim, qëllimi kryesor i tij mbetet asistimi i autoriteteve të qeverisë së Kosovës dhe agjensive shtetërore ligj-zbatuese në zhvillimin e tyre drejt qëndrueshmërsë dhe llogaridhënien. Në këtë kuptim EULEX përpiqet të sigurojë që nëpërmjet veprimit të tij, të arrij që këto institucione (të Kosovës) të jenë në përputhje me standartet ndërkombëtare të mirë-qeverisjes dhe mbi të gjitha të arrijnë “standartet evropiane” të kërkuara.

Kështu nëse do të hedhin një vështrim të aktiviteteve të saj ndër vitë, *sektori i policisë* ka ndërmarrë një sërë veprimtarish që nisin nga mbrojtja e të drejtës së besimit fetar e deri tek mbrojtja e të drejtave të minoriteteve, ku me marrjen në kontroll mbikqyrjeje dhe ruajtje të vlerave historike, kryesisht serbo-orthodokse por dhe objekteve të tjera të kultit përkatës. Por nga ana tjetër, një fakt i rëndësishëm është se në shumë plane veprimi të sektorit të policisë për vite me rradhë, përfshirja në aktivitetet të përfaqësueseve të shoqërisë civile për të marrë pjesë në fazën e implementimit të tyre, mbetet relative për tu interpretuar objektivisht. Pasi nga OJQ të ndryshme, për shëmbull në rastin e futjes së prespektivës gjinore ose të identitetit seksual, nuk janë marrë fare parasysht nga këto strategji.²⁷

Në të njëjtën mënyrë BE u është qasur dhe sektorit të gjyqësorit, ndërsa ai i doganave nuk do të merret parasysht për tezën tonë pasi së pari nuk përbën ndonjë rëndësi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe së dyti ndikimi i shoqërisë civile në këtë sektor është thuar jo relevant. Sipas Raportit të Programit:

“Funksionimi i institucioneve të zbatimit të ligjit – dhe fushave mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut – qëndron një prioritet i rëndësishëm për shumë organizata joqeveritare; analizimi i raportve dhe rekomandimet e politikave në këto tematika

²⁷ Intervistë me bashkë-drejtesen e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Nicole Farnsworth, Prishtinë 12 Korrik 2015;

Intervistë me aktivistin e të drejtave LGBTI, Liridon Velu Qendra për Emancipim Shoqëror, Prishtinë 11 Korrik 2015.

kanë qënë të shmuta përgjatë dymbëdhjetë muajve të fundit. OJQ-të kanë treguar një kapacitet të lartë në identifikimin e fuqive dhe dobësive në mekanizmat e zbatimit të ligjit” (Program Raport i EULEX, 2014, 10).

Por, po në të njëjtin dokument, nëse hulumtojmë se cilat janë këto strategji për implementim të cilat kanë ardhur nga shoqëria civile, mbetet mjaft e paqartë. Gjithashtu në një intervistë të bërë me koordinatoren e politikave të EULEX,²⁸ ndaj pyetjes në lidhje me përfshirjen e këtyre propozimeve nga shoqëria civile për plan-veprimet e viteve të ardhshme, mbetëm pa përgjigje. Nga këtu mund të kuptojmë se EULEX vazhdon të mbetet një mision që për vetë organizatat ndërkombëtare jo qeveritare si Human Rights Watch, International Crisis Group dhe Freedom House ndajnë mendimin e përbashkët se, “ndonëse EULEX përballlet me mjaft sfida, progresi i tij shpesh nuk e justifikon qëllimin e impenjimit të tij” (Ward 2010; Deda 2010: 273-287; ICG 2010).

Sektori i gjyqësorit paraqitet sektori prioritar i EULEX dhe mbetet fusha ku veprimtaria e saj përballlet me sfida të vazhdueshme. Por sidoqoftë krijimi i këshillit juridik përbën një shembull të rëndësishëm në mënyrën se si EULEX përpiket të ndërveprojë me institucionet lokale të ligjit dhe OJQ, të cilat marrin një rol këshillimi në pjesën më të madhe të Plan Veprimeve të përvitshme të EULEX mbi çështjet juridike që lidhen dhe me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Por ndër problematikat kryesore ndër vite është reforma në gjyqësor e cila kërkon një pjesëmarrje të shoqërisë civile (EULEX 2010: 12). Pavarësisht këtyre zhvillimeve të ndryshme, ndonëse positive në thelb, por problematike në substancë, fusha e drejtësisë mbetet problematike në implementimin e zbatimit të ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kryesisht, mbrojtjen e grave në proceset gjyqësore mbi të drejtat e pronësisë,²⁹ të drejtat për mbrojtje nga dhuna për shkak të identitetit seksual,³⁰ apo të atyre rasteve kur liria e shprehjes së gazetarëve cenohet nga shantazhet e politikanëve.³¹ Kështu për shëmbull, raporti i Freedom House për Kosovën në

²⁸ Intervistë me znj. Dragana Nikolic-Solomon, zv. Drejtore e Zyrës së Shtypit dhe Informimit Publik pranë EULEX, Prishtinë 20 Korrik 2015.

²⁹ Intervistë me bashkë-drejtuesen e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Nicole Farnseeorth, Prishtinë 12 Korrik 2015.

³⁰ Intervistë me aktivistin e të drejtave LGBTI, Liridon Velu Qendra për Emancipim Shoqëror, Prishtinë 11 Korrik 2015

³¹ Intervistë me Mehmet Hajrullahu, Editor pranë BIRN-Kosovë, Prishtinë 13 Korrik 2015

2014 thekson se prezenca e EULEX në Kosovë, për vite me rradhë mbetet problematike, me shumë pak ose aspak rezultat nga vitit në vit (Gashi, 2014: 24).

Ajo çfarë mund të kuptojmë nga kjo performancë ndër vite e EULEX në Kosovë është fakti se ai ushtron një legjitimitet ndërkombëtar ku kërkon të kërkohej një ndërhyrje për tu përafruar me normat dhe standartet evropiane dhe kështu zbaton më tepër një marrëdhënie fuqie. Normat e saj duhet të zbatohen pasi legjitimiteti nëpërmjet procedurës dhe substancës i jap asaj karakterin e ‘fuqisë së mirë’ dhe kur vendet jo antare të BE - në rastin tonë Kosova - perceptojnë normat e fuqisë si të pranueshme për miratimi dhe sjelljen sipas standarteve të legjitimitetit të tyre. Por për të arritur këto objektiva, EULEX do të duhet të bashkëveprojë si me institucionet e qeverisë, i cili është aktori primar por dhe me aktorët e tjerë të shoqërisë civile.

Kështu në përfundim të analizimit të tre institucioneve që kanë funksionuar prej disa vitesh si përfaqësueset kryesore të BE në Kosovë mund të themi se kanë ndjekur strategji të ndryshme për të arritur qëllimet e tyre. Në vijim do të hedh një vështrim analizues të tre fushave e të drejtave të njeriut, të drejtat e grave dhe barazsë gjinore, të drejtat e komunitetit LGBTI dhe të drejtat mbi lirinë e shprehjes të vlerësuar ndër vite si nga progres-raportet e Komisionit Evropian, vlerësimet e *think-tankers* të ndryshme ndërkombëtare si dhe indekset e tjera ndërkombëtare për të kuptuar se si ka ndikuar BE në forcimin e tyre por dhe në elaborimin e problematikave që do të duhet të adresohen nga institucionet e Kosovës dhe shoqëria civile. Këto dy qasje të fundit do të analizohen në kapitujt në vijim ku nëpërmjet të cilëve do të kemi një kornizë më të plotë të qëllimit të kësaj teze.

4.3 Gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë nga një prespektivë e BE

Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë kryesisht të mbrojtura dhe të garantuara në kushtetutën e Kosovës, të miratuar në Qershor 2008. Ky fakt është i njohur edhe në progres raportet e përvitshme të Komisionit Evropian për ecurinë e procesit të integrimit që vendi ka marrë zyrtarisht që në vitin 2013 me fillimin e negociatave për MSA, por të cilat

kanë nisur të realizohen për Kosovën që në vitin 2005.³² Kështu progres-raportet pasqyrojnë gjendjen e vendit përgjatë një viti dhe përmbushjet që ai bën në kuadër të procesit të asocim stabilizimit duke evidentuar arritjet, dobësitë si dhe duke theksuar pritshmëritë, në forma rekomandimesh që BE pret nga vendi në fjalë. Kryesisht progres raportet funksionojnë me logjikën e kushtëzimit, 'karrotë-shkopinj', e cila nënkupton se vendi arrin të marrë përfitime si ndihmë financiare, nëpërmjet fondeve të ndryshme para-aderim, IPA dhe të tjera nëse arrin të ketë përputhshmëri me kërkesat e BE që ia paracakton në çdo progres-raport, por nëse vendi nuk arrin përputhshmëri e kërkesave atëhere, BE vepron me "shkopinj", të cilat nisin në fillim si shtyrje e proceseve që do të shërbejnë si incentiva shtyxe në raste përputhshmërie të vendit, si liberalizimi i vizave ose vënien në përdorim të fushave të tjera të mbështetjes financiare (IPA) nga ato prej të cilat vendi përfiton, e duke vazhduar me bllokim të pjesshëm të këtyre fondeve e deri në ngrirje të vetë procesit. Vendet e Ballkanit Perëndimor paraqesin mjaft shembuj të tillë ku procesi është ngrirë plotësisht, Bosnje Hervegovinë (2011-2015), IRJM (2009 e në vazhdim).

Në këtë mënyrë do të analizoj, gjendjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të Kosovës, nëpërmjet një analize të ushtruar mbi standartin e legjitimitetit të BE nga (jo) përputhshmëria e Kosovës e shprehur në progres-raportet e përvitshme. Periudha në studim do të merren progres raporti i parë pas shpalljes së pavarësisë pra ai i 2008 dhe duke vazhduar me ndër vitë për të arritur në studimin e fizibilitetit të 2012 dhe gjer në raportin e fundit atë të vitit 2014. Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të përcaktuara për këtë studim do të jenë: liria e shprehjes e cila do të analizohet nga aksesit i gazetarëve në dokumentat shtetërore, liria e medias dhe liria e gazetarisë investigative; të drejtat e grave dhe barazia gjinore, e analizuar kjo nga kuadri ligjor të mbrojtjes së dëshmitarit, aksesit në gjykata dhe rritja e barazisë gjinore; të drejtat e komunitetit LGBTI, kuadri ligjor, mbrojtja

³²Komisioni i Bashkimit Europian nisi të përgatis progres raporte për Kosovën që prej vitit 2005. Për më tepër shih: EU Commission, Kosovo Progress Report, Brussels, 9. 11. 2005 COM (2005) 561 final http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1423_final_progress_report_ks_en.pdf (Aksesuar 12 Janar 2015).

Gjithashtu në 20 prill 2005, BE konfirmoi të ardhmen e Kosovës në BE pavarësisht zgjidhjes së çështjes së statusit nëpërmjet një deklarate për shtyp: http://eu-un.europa.eu/articles/en/article_4613_en.htm (Aksesuar 12 Janar 2015).

nga sulmet fizike dhe psikologjike të antarëve dhe dhënia e vendimeve gjyqësore konform ligjit për dëmtuesit, sensibilizim, informim qytetar ndaj komunitetit LGBTI në Kosovë.

4.3.1 Liria e shprehjes

Liria e shprehjes është një e drejtë e sanksionuar dhe e garantuar që në preambulën e kushtetutës së Kosovës (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008: 6, 12), por sidoqoftë ajo mbetet një ndër sfidat për çdo shoqëri që drejtohet drejt një rendi të ri demokratik në procesin e shtet-ndërtimit dhe ndërtimin e institucioneve demokratike. Kështu në progres raportin e vitit 2008, Komisioni Evropian e njeh kushtetutën e vendit si të aftë për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në parim, si dhe ky kuadër ligjor në thelb është mbi parimet dhe standarteve Evropiane (Komisioni Evropian 2008: 7). Më tej Komisioni Evropian shton se:

“Qeveria e Kosovës duhet të krijojë aftësinë e institucioneve që të jenë në të njëjtën linjë me standartet Evropiane, të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve që garantojnë demokracinë, zbatimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Zbatimi i plotë i këtyre prioritetëve si zbatimi i ligjit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si liria e shprehjes, është një prioritet kyç i Partneritetit European për Kosovën³³ (Komisioni Evropian, “raport-progresi” 2008: 8).

Gjithashtu një tjetër problematikë që ngrihej në atë kohë ishte fakti se institucioni ligjvënës, parlamenti, nuk njihte vlerësim të vazhdueshëm mbi draft legjislacionin mbi pajtueshmerinë me standartet mbi të drejtat e njeriut (Komisioni Evropian, “raport-progresi” 2008: 9).

Kështu në fushën e të drejtës së shprehjes, Komisioni nuk shihte ndonjë shqetësim në lidhje me gjuhën e “urrejtjes” ndër-etnike të përdorur nga mediat, pasi duhet të njohim faktin se Kosova sapo kishte shpallur pavarësinë dhe gjasat e përplasjeve ndër-etnike ishin shumë të forta, por sidoqoftë, problematika kryesore qëndronte në çështjen e shpifjes, pasi ajo përbëntë një vepër penale sipas Kodi Penal Provizor, i cili mbetej ende në fuqi (Komisioni Evropian, “raport-progresi” 2008: 18). Ndaj kësaj sipas Komisionit, njerëz të

³³ Partneritetit European për Kosovën ishte marrëdhënia e parë që Kosova kishte ndërmarrë me BE para fillimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim.

veshur me pushtet ‘shantazhonin’ mbi gazetarinë se në raste se gazetarët do të provoheshin se bënë shpifje ata do të përballeshin me fuqinë e ligjit. Kjo në një farë mënyrë i intimidonte, ndaj dhe vlerësimi i disa prej institucioneve ndërkombëtare të pavarura si Freedom House, por dhe të tjera e vlerësonin lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes në përgjithësi në Kosovë të njëjtë me pikë me ato të vendeve plotësisht autoritare (Freedom House 2009).³⁴

Nga ana tjetër, raporti i Komisionit Evropian e vendos theksin dhe tek kuadri organizativ i medias në Kosovë, i ashtuquajtur Komisioni i Pavarur i Medias i cili u krijua në vitin 2005 me një bord drejtues të përbërë prej pesë antarë kosovarë-shqiptarë dhe dy ndërkombëtarë, e cila do të monitoronte tregun e televizioneve dhe radiove të Kosovës. Kështu ky komision i cili duhet të ishte plotësisht i pavarur si nga aspekti i interferencës së politikës por dhe ai financiar, mbetej plotësisht ‘peng’ i elitave politike, pasi në realitet financiarisht ai varej nga vendimarrja e ministrisë së financave, duke patur në vazhdimësi limitime të buxhetit të brendshëm, çka e kufizonte në vetë funksionimin e tij për të marrë dhe paguar staf me kualifikim të lartë (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2008: 19). Komisioni, gjithashtu shprehet i hapur kur vjen fjala mbi përfshirjen e politikës në media dhe mbi aksesin e kufizuar të gazetarëve të komuniteteve të tjera etnike, mbi institucionet e Kosovës. Kjo konfirmohet në të njëjtën mënyrë edhe nga raporti i *Freedom House* (Freedom House 2009). Në përgjithësi viti i parë i shpalljes së pavarësisë së njëanshme të Kosovës, 2008, mbetej i brishtë. Kjo për shkak të mos funksionimit të mirë të institucioneve përkatëse (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2008: 19).

Në dy vitet në vijim, Kosova ndoqi një progres të limituar por megjithatë, një nismë e re reformash dhe nxitje e mekanizmave institucional për të ushtruar funksionimin e tyre në kuadër të mbrojtjes së lirive themelore nisi të vepronte. Kështu Komisioni në 2009, e përgëzon Kosovën për rolin e gjykatës kushtetues në këtë drejtim si dhe qeverinë në vazhdimin e implementimit të strategjisë dhe planit të veprimeve përkatëse për dy vitet në

³⁴Kështu sipas vlerësimi të raportit ‘Liria në Botë 2009’ (perth. Freedom in the World 2009), i cili është një raport për lirinë në përgjithësi duke u bazuar mbi lirinë politike dhe lirinë civile përgjatë vitit 2008, Kosova vlerësohet 5.5 nga një shkallë 1= shumë e lirë dhe 7= plotësisht e kufizuar, me një status ‘jo të lirë’. Vlerësimi mbi lirinë politike ishte 5 ndërsa ai për lirinë civile 6. Për më tepër shih në: www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2009/kosovo#.VdOM0oFyzqB (Aksesuar 17 Janar 2015)

vijim (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2009: 3). Por ndërkohë kjo nuk justifikon situatën në terren që sipas saj linte për të dëshiruar. Kështu raporti vijon se: *“për sa i përket lirisë së shprehjes, progres i limituar mund të raportohet”* (ibid: 15).

Ndërkaq ligjit mbi aksesin e dokumentave publike kishte hyrë në fuqi dhe për komisionin Evropian ai ishte i një rëndësie të madhe për të arritur standartet e kërkuara evropiane, por megjithatë, gazetarët vazhdonin të ishin preh e presioneve, duke përfshirë si zyrtarët e zgjedhur, në reagim të reportazheve të tyre (ibid: 14). Për herë të parë vihet theksi mbi varësinë që media kishte krijuar me elitat qeverisëse, duke u shprehur se: *“autoritetet e Kosovës mbeten një ndër klientët më të mëdhenj të hapësirave publicitare në median vizive dhe të shkruar”* (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2010: 15). Ky fakt tregon qartë për lidhjen midis medias dhe politikës. Gjithashtu këtë e pohon dhe një ndër gazetarët kryesor të Kosovës, Muhamet Hajrullahu i cili e sheh dhe në një këndvështrim tjetër, si një media e cila nuk e ka të qarta pronësinë.³⁵ Vështirësitë mbeten të dukshme si në aksesin e dokumentave zyrtare, edukimin profesional, trajnimet.

Nga ana tjetër, ngrihet një shqetsim në lidhje me mospërputhjen midis ligjit mbi shpifjet dhe atë mbi fyerjen. “Kjo krijon pasiguri juridike mbi dispozitat ligjore të ligjit mbi shpifjen” (ibid: 16). Në të njëjtën vlerësim, mbyllet dy vitet, me një progres të limituar. Megjithatë e vlerësuar nga indeksi i Freedom House, Kosova ka arritur të ketë një përmirësim të dukshëm me një pikë më lart. Kështu ajo vlerësohej me 4.5 nga 1 më mirë dhe 7 më keq dhe respektivisht liria politike 4 e ndërsa ajo civile me 5, duke siguruar kështu një vlerësim pjesërisht të lirë (Freedom House 2011).

Përmirësimi i reflektuar nga Freedom House do të vinte një vit më vonë nga ana e Komisionit Evropian ku në vlerësimin e përgjithshëm për vitin 2011, shprehet me gjuhën e “ka bërë disa progres” (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2011: 17). Kështu Komisioni i pavarur i Mediave, arriti të bënte një monitorim të plotë të fushatës elektorale të vitit 2010 duke e zhvilluar këtë funksion të saj, për herë të parë që nga krijimi. Gjithashtu institucionet qeverisëse kishin nisur të zhvillonin trajnime të ndryshme duke përfshirë aktorë të medias, të shoqërisë civile, në një mënyrë për të plotësuar hendekun që rezultonte një vit më parë për vështirësitë që haseshin (ibid: 13). Rasti i përfshirjes së një kryetari

³⁵ Intervistë me Mehmet Hajrullahu, Editor pranë BIRN-Kosovë, Prishtinë 13 Korrik 2015

bashkie dhe 5 gazetarëve për shpifje dhe abuzimi me detyrën, kishte marrë gjithashtu një vendim gjykim nga gjykata, duke përbërë një arritje për Kosovën, theksohej në raport por nga ana tjetër me shqetësim shiheshin rastet e reja dhe të vazhdueshme të sulmeve ndaj gazetarëve (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2012: 24).

Kjo nevojë ndryshimi e ligjit “për shpifje” erdhi vetëm në 2013. Kështu mund të thuhet se ky vit solli një sërë ndryshimesh positive. Arritjen e marrëveshjes dhe rezultuatet e para të dialogut teknik, Prishtinë-Beograd, nisjen e negociatave për MSA, duke nënkuptuar se kushtëzimi i vendosur nga BE kishte dhënë rezultatet e tij. Rasti i sulmit të revistës “Kosova 2.0” dhe vendimi i gjykatës për dëmtuesit ishte një sukses për lirinë e shprehjes dhe medias së lirë në përgjithësi. Megjithatë ajo që mbetej problematike për Komisionin Evropian ishte kuadri ligjor mbi lirinë e shprehjes, i cili përfshin afërsisht 14 ligje të cilat ishin jo-efektiv dhe pjesa më e madhe pa një kuadër mekanizmesh implementues (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2013: 17). Ndërkaq viti 2014 tregon një rënie të besimit të fituar nga ana e Komisionit, duke e vlerësuar Kosovën me notën, “pak progres” ku problemet që rrjidhnin nga viti në vit nuk kishin arritur të gjenin një zgjidhje (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2014: 17). Megjithatë reflektimi nga Freedom House ka qënë kryesisht i njëjtë që prej përmirësimit të arritur në vitin 2011 (Freedom House 2013; Freedom House 2014; Freedom House 2015).

4.3.2 Të drejtat e grave dhe barazia gjinore

Me mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në Kosovë, do të kuptojmë fuqizimin e statusit të gruas në shoqëri, rrija e rolit të saj politik, jo vetëm në pjesëmarrje fizike në përfaqësimin politik por dhe rritjen e aftësisë në proceset vendimarrëse, zbatim dhe implementim i plotë i rezolutës 1325, marrje e statusit të viktimave të luftës, gratë e dhunuar përgjatë konfliktit 1998-1999 në Kosovë si dhe qasja e prespektivës gjinore në çdo fushë të jetës sociale, ekonomike dhe politike të vendit. Bashkimi Evropian në këtë drejtim i ka parë të drejtat e grave dhe barazisë gjinore si një ndër të drejtat e njeriut më të cënueshme nga ana institucionale, në kuptimin e pafuqisë së institucioneve publike për t’iu përgjigjur nevojave të tyre legjitime.

Kështu që në progres raportin e parë, të marrë në shqyrtim nga analiza jonë, pra ai i vitit 2008, niset me një nxitje e institucioneve qeverisëse për punën e deriatëhershme. Bëhej fjalë për miratim e Programit Kornizë të Barazisë Gjinore, një plan pesëvjeçar (2008-2013),³⁶ i cili do të identifikonte objektivat, politikat dhe institucionet e përfshira në implementimin e ligjit mbi Barazinë Gjinore, i cili ishte miratuar që në vitin 2004. Gjithashtu, edhe pse Kosova nuk ishte antare e OKB dhe rrjedhimisht asnjë konventë ndërkombëtare nuk e detyronte atë të paraqiste raporte apo të sillte në vëmendjen e komisioneve përkatëse, në qershor të 2008, qeveria e atëhershme i paraqiti një raport mbi Profilin Gjinor të Kosovës, komisionit të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, e njohur ndryshe si CEDAW (ang.), për periudhën 1999-2007. Gjithashtu Agjensia e Barazisë Gjinore, sipas Komisionit Evropian për periudhën në fjalë: *“ka mbajtur një raport të mirë me institucionet e Avokatit të Popullit dhe zyrtarët e barazisë gjinore të ministrive, duke rritur bashkëpunimin dhe koordinimin”* (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2008: 13).

Pavarësisht këtij kuadri institucional të organizuar në parim si dhe vullnetit për ti paraprirë raportimeve ndaj CEDAW, Komisioni Evropian thekson ndërkohë dobësitë që lindin pikërisht nga ky sistem i organizuar dhe për më tej rezultat që rrjedhin. Kështu sipas tij egzizton një përplasje institucionale, midis Agjensisë së Barazisë Gjinore³⁷ dhe Zyrës së Qeverisjes së Mirë, pasi kjo e fundit, si një zyrë që kontrollohet direkte nga kryeministri ka në portofolin e saj të gjitha funksionet e Agjensisë e cila, predispozohet se vepron e pavarur nga hierarkia e institucioneve qeverisëse por plotësisht e kontrolluar prej tyre.

Në këtë kuptim ABGJ ka një formë institucioni fantazëm, pasi dhe në vitin 2009, ndonëse e formuar ajo nuk kishte një drejtues dhe se kishte mangësi të mëdha në të dhëna

³⁶ Kjo strategji u përgatit nga grupet e interesit në bashkëpunim me konsulta dhe drejtim të Agjensisë për Barazi Gjinore e cila ishte dhe organi implementues i Ligjit për Barazi Gjinore të 2004. Për më tepër shih: http://www.stopvaw.org/uploads/kosovo_program_for_gender_equality (Aksesuar 16 Shkurt 2015).

³⁷ Agjensia për Barazi Gjinore ishte krijuar në 2005 me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi barazinë Gjinore të 2004, nëpërmjet një iniciative të shoqatave të grave, avokatit të popullit dhe mbështetjës të UNMIK si shembulli më i mirë i funksionimit shoqëri civile - institucione qeverisëse - institucione të pavarura mbi rastin në fjalë, por që në lidhje me promovimin e barazisë gjinore binte ndesh me vetë zyrën për qeverisje të mirë. Për më tepër shih *“Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325”*, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, ed. Nicole Farnsworth Prishtinë, Kosovë 2011

dhe resurse. Një tjetër problematikë që vihej re ishte fakti se zyrtarët e secilës ministri që kishin pjesë të aktiviteteve të tyre barazinë gjinore nuk ishin gjithnjë operativ, çka nënkupton se ata ishin të angazhuar në të njëjtën kohë me funksione të tjera dhe formalisht ishin të ngarkuar dhe me përkujdesin e barazisë gjinore duke mbuluar të gjithë ministrinë. Gjithashtu, nuk kishte koordinim real midis nivelit qendror dhe atij lokal për barazinë gjinore dhe kështu nuk kishte promovim në publik të rëndësisë së barazisë gjinore (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2008: 11).

Si rezultat i këtij mos-koordinimi institucionesh, të krijuar thjesht në parim Komisioni Evropian përmbledhte disa nga aspektet negative të cilat vazhdonin të ishin prezente në disfavor të grave dhe barazisë gjinore në përgjithësi:

“Dhuna ndaj të drejtave të grave mbetet e vazhdueshme; Kosova mbetet një pikë tranziti dhe destinacioni për trafikun ndërkombëtar të qënieve njerzore. Nuk ekzistojnë dokumenta strategjike apo mekanizma ligjor për të adresuar dhunën në familje. Strehëzat kanë mungesë burimesh bazike dhe ata do të duhen të bëhen funksionale për terma afat-gjatë ndaj viktimave të trafikut dhe/ose dhunës në familje. Përfaqësimi i barabartë mbetet një sfidë e madhe në të gjitha nivelet, ndonëse sipas ligjit mbi Barazinë Gjinore të 2004, Kosova duhet të kishte minimalisht 40% përfaqësim të grave, ky rezultat nuk është rritur”(Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2009: 15-16).

Ky këndvështrim i parë do të refleктоhej në vitet vitet në vijim me disa ndryshime dhe problematika të reja që Komisioni Evropian do të evidentonte. Kështu përgjatë dy viteve 2009-2010, mosfunksionimi i mirë i sistemi gjyqësor dhe vendimeve të gjykatave do të krijonte mungesë besimi dhe një intimidim indirekt të grave dhe femrave të trafikuar dhe viktimave të dhunës në familje. Progresi i limituar do të shoqëronte këto dy vite, ndonëse sipas Komisionit disa arritje ishin bërë. Kështu një ligj i ri për mbrojtjen kundër dhunës në familje ishte miratuar. ABGJ i kishte rritur kompetencat e saj dhe kishte nisur të funksiononte më mirë dhe po promovonte dhe monitoronte programin pesë vjeçar për barazi gjinore (2008-2013).³⁸ Kjo tregonte se rekomandimet e vendosura nga Komisioni

³⁸ Për më tepër shih në Planin e Veprimit të Implementimit të rezolutës 1325 në Kosovë të ABGJ, <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ%20Plani%20i%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Implementim%20t%C3%AB%20Rezolut%C3%ABs%201325%20tre%20gjuh%C3%AB.pdf> (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

Evropian në progres raportet e mëparshme, të cilat në gjuhën e BE përkthehen si “kushtet” ishin marrë parasysh duke përfutur në të njëjtën kohë “shpërblimet” ose “karrotat”.

Por megjithatë, mbetet një problematikë e ndërlidhur me sistemin gjyqësor; vështirësitë që paraqiste aksesimi në gjyqësor për viktimat e dhunës familjare. Kështu komisioni shprehej se,

“ndonëse kodi penal shprehet se krimet me pasoja dëmtime fizike të ndodhura brenda marrëdhënies familjare duhet të gjykohen *ex officio*, por gjykata shpesh dështojnë ti procedojnë ato. Investigim i pambaruar, bashkëpunim i dobët midis policisë dhe prokurorisë dhe dështimit për të arrestuar dëmtuesit e viktimave të dhunës e ka rritur vulnerabilitetin ndaj kësaj kategorie dhe shtuar intimiditetin për të procesuar penalisht raste të reja të dhunës në familje” (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2010: 13).

Sërisht vihet re problematika që përfshin çdo fushë të qeverisjes, kryesisht kjo dukuri e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ekziston një vullnet për forcimin e kuadrit ligjor, por mekanizmi implementues dhe mënyrën se si kuadër ligjor mund të zbatohet në realitet mbeten thuajse e paprekur dhe ndaj krijon një impakt minimal në jetët e grave dhe të drejtat e tyre në përgjithësi.

Progresi i vitit 2011, mbi të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, e vendos theksin në rradhë të parë tek vështirimi i përgjithshëm e kësaj fushe. Sipas saj, “është arritur progres në fushën e të drejtës së grave dhe barazisë gjinore” (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2011: 11). Mund të themi se zgjedhja e Atifete Jahjaga si kryetare e parë femër e shtetit të Kosovës i rriti mjaft pikët për këtë vlerësim. Një tjetër dëshmi ishte përzgjedhja e tre ministrave me drejtuese femra dhe mbi të gjitha kryenegociatorja e “dialogut teknik” Prishtinë-Beograd ishte përzgjedhur Edita Tahiri. Në një intervistë për RRGK, ajo shprehet se “kjo ishte një fitore për të gjitha gratë e Kosovës” (Farnsworth, 2011: 61).

Kështu ky ‘progres’, vijonte mbi të drejtën e lejes së mëmësisë. Gjithashtu në implementimin e ligjit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje ishte rritur. Ndaj këtij rezultati, Agjencia për Barazi Gjinore në funksionimin e saj, së bashku me Institutin Juridik të Kosovës, një bashkëpunimin ky shoqëri civile-institucion shtetëror, kishte arritur të kryente një sërë aktivitete trajnuese aq shumë të nevojshme dhe të këshilluara dhe në progres raportet e mëparshme. Debate publike dhe informim publik ishte shtuar. Gjithashtu nëpërmjet një programi të UNDP për riaktivizimin e ish-forcave të UÇK, ku 8% e tyre ishin

femra, rreth 247 femra u riaktivizuan në jetën civile dhe 47 prej tyre u përfshinë në Forcën e Sigurisë së Kosovës (ibid 2011: 87).

“Por sidoqoftë dhuna në familje me bazë gjinore mbetet e pranishme dhe një sfidë për Kosovën. Shërbim për viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit në përgjithësi janë pjesërisht të financuara nga qeveria por mbeten kryesisht të varura nga donatorët e huaj. Ri-integrimi afat-gjatë e viktimave, dke përfshirë stabilitetin e tyre ekonomik dhe aksesin në gjyqësor duhet të rritet” (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2012: 17).

Në këtë kuptim Kosova duhet të mbështetet më shumë në vetë-financim të gjeneruar nga të ardhurat e brendshme, duke pakësuar ndihmën/asistencën ndërkombëtar, pra pakësuar kontrollin ndërkombëtar dhe rritur vetë-aftësimin dhe nga ana tjetër rritur luftën ndaj evazionit fiskal, korrupsionit dhe kështu më rradhë. Kjo në vetvete përbën dhe vetë strategjinë e Evropianizimit që BE ndërmerr në proceset e integrimit në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë në dy progres-raportet e fundit atij të vitit 2013 dhe 2014, vihet re një përmirësim i aftësisë së qeverisë për të adoptuar implementimet e nevojshme mbi ligjin për mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare. Kjo nënkuptonte amendimin e këtij ligji në vitin 2013 dhe të një sërë ligjesh të tjera në të ashtuquajturën Paketa e të Drejtave të Njeriut. Plane Veprimi një vjeçare, ishin një risi dhe një hap mjaft i rëndësishëm kur bëhej fjalë për implemtimin e plotë institucional të rezolutës 1325 dhe të gjitha rezolutave të tjera nën përkujdesin e Agjensisë së Barazisë Gjinore. Gjithashtu në vitin 2014 u krijua Plan Veprimi që do të adresonte forcimin e rolit të gruas në procese vendimarrëse në nivel qendror por dhe atë lokal; mundësinë e njohjes së mbijetuarve të dhunës seksuale në rastet e konfliktit dhe në të njëjtën kohë akses i plotë në sistemin gjyqësor për këto çështje ndaj të mbijetuarve duke përfshirë kompensim, rehabilitim dhe integrim (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2013: 16). Kjo nënkuptonte se tashmë ishte një përparësi dhe vullnet politik për implementimin e çdo segmenti të rezolutës 1325 çka reflektonte në rezultate që për Komisionin Evropian shiheshin me nota positive.

Një risi ose një rivëmendje për progres-raportin e vitit 2014 ishte krijimi i një *database* kombëtar mbi mbledhjen e të dhënave për dhunën në familja me baza gjinore. Propozime për një *database* të tillë ishin hedhur dhë dy vite më pare, por problemi

qëndronte se kush do ti kontrollonte këto të dhëna dhe sa do të ruhej parimi i privatësisë.³⁹ Gjithashtu akses i praktik i grave në trashëgimin e pronësisë,⁴⁰ mbetet një sfidë më vete edhe pse ligji e parashikon atë (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2014: 18). Megjithatë në të dy vitet e fundit progresi ndaj mbrotjes së të drejtave të grave dhe barazisë gjinore mbeti e pandryshuar, progres i limituar. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se, përderisa Kosova kishte nisur negociatat për MSA, pritshmëritë e BE ishin rritur dhe procesi i reformave dhe vullnetit politik të nisur në 2011 nuk duhej të ndalej për ta çuar procesin në një hap të ri.

4.3.3 Të drejtat e komunitetit LGBTI

Të drejtat ndaj komunitetit lezbik, gej, biseksual, transgjinnor dhe ndërseksual të njohur shkurtimisht LGBTI (ang.), përbëjnë një ndër strategjitë më të reja të veprimit të ndërhyrje së BE në kushtëzimin politik ndaj vendeve potenciale (kandidate). Gjithashtu, tashmë që prej krijimit të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian në 2009 dhe me hyrjen në fuqi të traktatit të Lisbonës, ato janë bërë pjesë e pandashme e politikës së jashtme të BE nëpër botë. Në fakt theksimi i nevojës për ndërhyrje dhe vëmendje në progres raportet ndaj Kosovës kanë nisur që me raportin e parë në 2005. Në vitin 2008, Komisioni Evropian si në çdo fushë tjetër të vlerësimit për këtë vit, vinte në dukje gjendjen e përgjithshme nga ana institucionale, kuadrit ligjor dhe të drejtat praktike të këtij komuniteti në Kosovë, ku shihe se ekzistonte një praktikë bashkëpunimi midis sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve të Kosovës me seksione informuese mbi ligjin kundër diskriminimit. Në fakt ky ligj ishte në fuqi që prej vitit 2004 por njësoj si në ligjin për barazi gjinore krijonte shtigje për implementimin në praktikë. Raporti e vinte theksin se nevoja e krijimit të një shoqërie pa diskriminim mbetej një prioritet për Partneritetin Evropian për Kosovën, pra marrëveshjen e parë BE-Kosovë para nisjes së MSA por dhe vetë të ardhmes së saj në rrugëtimin e plotë për tu antarësuar në BE. Kësisoj ftohej që vëmendja e institucioneve të Kosovës ta trajtonte problematikën e diskriminimit dhe

³⁹ Intervista me zyrtaren e lartë për çështje të barazisë gjinore dhe të drejtat e gruas, znj. Luljeta Domaniku Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë Korrik 2015. Për më tepër shiko seksion e dytë të kapitullit të gjashtë.

⁴⁰ Për më tepër shih kapitullin e shtatë.

mbrojtjen e nevojshme të LGBTI me të njëjtën rëndësi përkundrejt prioritetëve të tjera (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2008: 20).

Kështu, progresi ishte mjaft i limituar në implementimin e ligjit. Kjo si pasojë e kapaciteteve të ulat të burimeve njerëzore në nivele lokale dhe qendrore mbi të drejtat e njeriut mbeteshin shumë të ulta. Bashkëpunimi qeveri-avokat i popullit ishte problematik.

“Personat e komunitetit LGBTI që jetonin në zona rurale janë krejtësisht të pa informuar për kuadrin ligjor i cili i mbron ato, pavarësisht problematikave në mekanizmin implementues të këtij të fundit. Homofobia është një aspekt i rëndomtë në publik dhe median e gjërë. Gjykimet që lidhen me çështje të dhunës homofobike nuk e specifikojnë dhunën si motivim të saj” (Komisioni Evropian 2008: 21).

Në vitin 2010, implementimi dhe monitorimi i kuadrit ligjor kundër diskriminimit do të duhej të sigurohej, pasi edhe pse rastet e dhunës fizike ose psikologjike që raportoheshin në organet e rendit, mbeteshin në dyert e gjykatave për shkak të keqinterpretimit ose hendeikut që parashikonte vetë kuadri ligjor. Ndërgjegjësimi ndaj çështjeve LGBTI ishte shumë i dobët saqë debatet mbi homoseksualitetin në sferën publike dhe private përbënin raste të jashtëzakonshme kur ndodhin (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2010: 19). Ashtu si në ligjet e tjera, mekanizmi implementues ishte inekzistent dhe ndaj Komisioni vazhdonte ta rikthesonte në çdo progres raport.

Një vit më vonë gjendja shfaqej më e përmirësuar. Ky vit në fakt siç u shprehëm dhe më lart, në pjesën më të madhe të fushave të veprimit ka qënë përgëzuar për progresin e arritur. Nga çka mund të kuptohet se procesi në vetvete është së pari politik, që nënkupton se në raste kur vendi në fjalë arrin të ketë pëlqimin e BE në disa fusha të tjera, siç është rasti i Kosovës në 2011, fillimi i negociatave Prishtinë-Beograd, për këtë qëllim ofrim i karrotave dhe incentivave në të njëjtën mënyrë është i lartë. Kështu sipas raportit, vendi kishte shfaqur një interes të madh në rritjen e ndërgjegjësimit për ligjin anti-diskriminim. Por ndërkohë, niveli i ulët i besimit në gjykata - që në fakt përbën të drejtën e aksesit të gjykatave, i cili në këtë progres raport ngrihej si shqetësim dhe për viktimat e dhunës në familje ashtu dhe ndaj lirisë së shprehjes – i dekurajon viktimat e dhunës së diskriminimit. Të njëjtin fakt e mbështet dhe aktivisti i organizatës QESH në një interviste ku shprehet se

në shumicën e rasteve, individët e dhunuar nuk e ndjekin më tëj procesin pasi ndjehen të papërfaqësuar nga sistemi i drejtësisë.⁴¹

Ndër problematikat që ky raport nënvizon janë:

“zbatimi në praktikë e legjislacionit të nevojshëm për mbrotjen nga diskriminimi mbetet një sfidë; Mbetet ende një mungesë ndërgjegjësimit ndaj çështjeve LGBTI, të cilat nuk diskutohen hapur; Ekziston një njohje dhe kuptim i ulët në atë pjesë të zbatimit të ligjit nga zyrtarët shtetëror mbi të drejtat e komunitetit LGBTI – pra nevojitet trajnim i vetë funksionarëve shtetërore mbi të drejtat e LGBTI. Mungesë e theksuar e tolerancës së mjedisit social ndaj individëve që identifikohen se kanë një orientim seksual të ndryshëm”(Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2011: 18). Në dy progres raportet e fundit, të vitit 2013 dhe 2014 ligji kundër diskriminim mbeti një sfidë. Zyra për Qeverisje të Mirë, në 2013 nisi një bashkëpunim më të madh me OJQ që përfaqësonin komunitetin LGBTI. Ndërkaq po atë vit një organizatë që ishte thellësisht anti LGBTI u ndalua të formohej si një parti politike, duke provuar kështu një rast mjaft pozitiv në funksionimin e kuadrit ligjor kundër ‘gjuhës së urrejtjes’ që do të institucionalizohej me një parti politike që parashikonte të garonte në zgjedhjet e përgjithshme. Problematika e ‘gjuhës së urrejtjes’ që kishin në shënjestër anëtar të komunitetit LGBTI por jo vetëm shfaqte mjaft vështirësi në proceset e hetimeve. Shumica e ‘gjuhës së urrejtjes’ përdorej në rrjetet sociale. Masat parandaluese të tilla si rritja e ndërgjegjësimit publik, politik apo institucional ishin mjaft të ulta. Megjithatë Kosova për herë të parë organizoi në maj të 2014 një marshim krenarie kundër homofobisë çka tregon një impakt më të përmirësuar nga vitet e mëparshme (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2013; Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2014:19).

4.4. Përfundime

Përgjatë këtij kapitulli hodhëm një vështrim mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë e parë nga një prespektivë e Bashkimit Evropian. Kështu së pari u analizua nga ana institucionale, pra e politikave që zhvillon BE në Kosovë - zyra e përfaqësisë special të Bashkimit Evropian, zyra e ndërmjetësimit të Komisionit Evropian që tashmë janë në një

⁴¹ Intervistë me aktivistin e të drejtave LGBTI, Liridon Velu Qendra për Emancipim Shoqëror, Prishtinë 11 Korrik 2015

kornizë zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe EULEX me në fokus të drejtat e njeriut. Ndërsa së dyti analizimi i tre të drejtave të njeriut dhe liri themelore - liria e shprehjes, të drejtat e grave dhe barazia gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGBTI - nën vlerësimin e progress-raporteve nga vitit 2008 deri në 2014 duke shtuar të dhëna nga indekse të organizatave ndërkombëtare apo opinione të aktivistëve dhe sepecialistëve të organizatave jo qeveritare në Kosovë mbi këto tre të drejta të përcaktuara. Përzgjedhja e tyre nuk ishte e rastësishme, por se ato mbivendosen me fusha të tjera veprimi: kështu në mungesë të lirie të shprehjes do të kemi një investigim më të ulët të rasteve korruptive në nivel shtetëror por dhe qytetar, një nivel mjaft të ulët të gazetarisë profesionale dhe humbje e mendimit kritik duke i shndërruar elitat qeverisëse plotësisht autoritare. Në të njëjtën kohë në mungëse e të drejtave të grave do të humbim një trashëgimi thajse shekullore të emancipimit të gruas në shoqërinë moderne, një shoqëri tërësisht maskiliste në vendimarrje dhe zbatim dhe liri politike, civile, kulturore dhe ekonomike të cinguar për të gjithë qytetarët. Dhe nëse do të vazhdojmë të kemi një kufizim të lirive ndaj personave që kanë një identitet apo orientim seksual të ndryshëm, kjo do të na bënte të kishimim një mungesë tolerance dhe humbje të vetë natyrës së ndryshme njerëzore, por jo prej faktin se të drejtat që ne gëzojmë rrjedhin nga vetë kjo natyrë.

Hulumtimi i seksionit të parë të këtij kapitulli, ai institucional, pra i politikave që zhvillon BE në Kosovë, zyra e përfaqësisë special të Bashkimit Evropian, zyra e ndërmjetësimit të Komisionit Evropian që tashmë janë në një kornizë zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe EULEX me në fokus të drejtat e njeriut, u analizua në raport me legjitimitetin që BE arrin të ushtrojë ndaj secilit rast. Kështu Zyra Përfaqësimit Special të BE shihet se ka ushtruar një legjitimitet substancial, pasi normat dhe vlerat e BE i promovon nëpërmjet politikave mbështetëse për të konsoliduar dhe promovuar paqe, stabilitet dhe shtet ligjor. Ky rol normativ është thelbësisht substancial pasi është në mbështetje me zhvillimin efektiv të Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë (PBMS), dhe për të ndihmuar BE të jetë aktiv, koherent dhe një aktor i aftë të përballoj sfidat e reja në arenën ndërkombëtare.

Ndërkaq, zyra e ndërmjetme e Komisionit Evropian ushtron një legjitimitet proçedural, pasi legjitimiteti i promovimit të drejtave të njeriut varet jo vetëm në baza

ligjore apo relacionale, por dhe në atë të zhvillimit të efektshme që një zgjidhje kërkon praktikisht. Kështu duke përdorur kushtëzimin politik, duke ofruar incentiva financiare, ajo kërkon të arrijë një legjitimitet të politikave të saj duke e shtyrë Kosovën të përfitoj prej tyre vetëm nëse ajo arrin të ketë përputhshmëri me kushtet politike dhe standartet e saj. Së fundmi, nëpërmjet zyrës së EULEX mbi të drejtat e njeriut, ajo ushtron një legjitimitet të ndryshëm nga dy të parët, duke e karakterizuar me legjitimitetin si një njohje të jo-evropianëve – “të tjerët”. Ky fakt argumentohet se BE nëpërmjet mandatit të EULEX i sheh institucionet e Kosovës mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut si thelbësisht jo-evropiane, ku kërkohet një ndërhyrje për tu përafuar me normat dhe standartet e evropianëve dhe kështu zbaton më tepër një marrëdhënie fuqie. Normat e saj duhet të zbatohen pasi legjitimiteti nëpërmjet procedurës dhe substancës i jep asaj karakterin e ‘fuqisë së mirë’ dhe kur vendet jo antare të BE - në rastin tonë Kosova - perceptojnë normat e fuqisë si të pranueshme për miratimi dhe sjelljen sipas standarteve të legjitimitetit të tyre.

Mund të themi se rezultat e kësaj analize përgjatë këtij kapitulli të parë empirik do të na ndihmojnë duke i zgjeruar çështje të ndryshme prej të cilave prezantuar problematikën, së pari të pari nga ana e institucioneve qeverisëse të Kosovës, pra procesit të forcimit dhe zbatimit të mbrojtjes e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga elitat, përgjatë kapitullit të rradhës dhe në kapitullin e fundit do të shohim se si ky proces ndërmerret nga shoqëria civile.

KAPITULLI I PESTË

TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË NGA NJË PRESPEKTIVË INSTITUCIONALE: PROCESI I DREJTUAR NGA LARTË- POSHTË

5.1. Hyrje

Kosova ka një kuadër ligjor mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut mjaft të mirë në aspektin e miratimit formal të ligjeve, duke marrë eksperiencat më të mira e vendeve perëndimore dhe shpesh dhe duke i tejkaluar. Megjithatë Bashkimi Evropian dhe aktorë të tjerë të brendshëm si shoqëria civile tërheqin vëmendjen për një mungesë të theksuar implementimi të këtij kuadri ligjor në mënyrë që të ketë një impakt real në jetën sociale të Kosovës. Në këtë mënyrë kjo shihet si një mos realizim i të drejtave dhe mos respektimi nga ana e institucioneve të vetë dispozitave ligjore që parashihen në kushtetutë duke na bërë të ushtrojmë këto pyetje: Pra a është ky një mos respektimi i vetë kushtetutës apo një mungesë vullneti politik?

Unë do të argumentoj se edhe pse Kosova gëzon një kuadër të mjaftueshëm normativ dhe ka krijuar disa mekanizma të marra *apriori* nga eksperiencia e ligjeve themelore të vendeve të tjera mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, institucionet qeverisëse të Kosovës mbetin peng e një vullneti politik të munguar i cili ndërmerr reforma vetëm kur ‘në tavolinë e negociatave’ është një incentivë e madhe. Ndonëse vendi arrin të ketë një implementim të mirë normativ të kuadrit ligjor që mbron të drejtat e njeriut dhe lirive themelore, ai nuk është në gjendje ta forcojë mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Përgjatë analizës së këtij kapitulli tre burimet e legjitimitetit pra indikatorët e përzgjedhur për studimin e legjitimitetit të promovimit e të drejtave të njeriut të BE në Kosovë do të operacionalizohen. Së pari analiza mbi kuadrin ligjor e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe ndryshimet e këtij kuadri në ligje të posaçme. Duke vijuar më pas do të analizoj institucionet kushtetuese dhe ato ligj-zbatuese të cilat kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut në tërësi dhe në disa raste, fusha të caktuara e të drejtave të njeriut, siç është rasti i Zyrës për Barazi Gjinore dhe më pas të mekanizmave implementues. Këto dy fokuse shërbejnë për të analizuar legjitimitetin si ligjshmëri, pra aftësisë së institucioneve të Kosovës – qasjes lartë-poshtë – për të arritur një përputhshmëri me standartet evropiane e të drejtave të njeriut nëpërmjet elementi të fortë konstucional: parimet dhe normat kryesore juridike në nivel universal dhe në vecanti ato evropiane.

Së dyti do të analizoj se si ka ndikuar procesi i reformave të ndërmarra nga institucionet qeverisëse të Kosovës në kuadër të mbrojtjes dhe forcimit e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Këtu do të operacionalizohet burimi i dytë i legjitimitetit të promovimit të BE në kuadër e të drejtave të njeriut – legjitimitetit procedural. Kështu nëpërmjet një prespektive që dominohet jo vetëm në baza ligjore apo relacionale, por dhe në atë të zhvillimit të efektshme që një zgjidhje kërkon praktikisht, pra procedurës. Me përdorimin e kushtëzimit politik dhe duke ofruar incentiva financiare, Bashkimi Evropian kërkon një përputhshmëri të standarteve të saj nëpërmjet një procesi reformash të thella në Kosovë. Ky proces zgjatet në tre të drejtat dhe liritë themelore e marra në shqyrtim dhe tregon se vendi arrin të ketë përputhshmëri me kushtet politike dhe ndaj vetë standartet e saj.

Së treti do të analizoj se si ka ndikuar mbështetja financiare IPA nëpërmjet kushtëzimit politik në këtë proces të drejtuar nga lart poshtë. Pra në pak fjalë kërkohet të kuptohet se në çfare mënyre kanë indikuar incentivat inkurajuese të BE ndaj Kosovës në përmirësimin e kësaj të fundit të performancës mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut (e vlerësuar më herët nga BE dhe orgaizma të tjera ndërkombëtare të pavarura). Ky raport vlerëson dimension e fuqisë “së mirë” të BE ndaj Kosovës e cila kërkon të riformësojë standartet normale në kuadër e të drejtave të njeriut. Përdorimi I këtij indikator të trete të legjitimitetit të promovimit e të drejtave të njeriut do të mundësojë të kuptojmë më gjerësisht efektet ndër vite që ka patur ky rol I BE dhe në termat e përgjithshëm përgjatë kohës së marrë për të këtë studim.

5.2. Të drejtat e njeriut: kuadri ligjor, institucionet dhe mekanizmat implementuese

Kushtetuta e Kosovës sanksionon që në preambulën e saj se, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë të pandashme, të patjetërsueshme të pacënueshme dhe janë bazat e rendit juridik të Kosovës (Kushtetuta e Kosovës 2008: 1). Gjithashtu vazhdon më tej duke shtuar se:

“të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të garantohen nga marrëveshjet dhe instrumentat ndërkombëtar të cilët kanë aplikueshmëri të drejtpërdrejt në

republikën e Kosovës dhe në raste konfliktesh kanë prioritet kundrejt dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike”. (ibid: 2)

Këto marrëveshje dhe instrumenta ndërkombëtarë janë:

“1) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; 2) Konventa Evropiane e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore së bashku me Protokollet përkatëse; 3) Marrëveshja Ndërkombëtare e të Drejtave Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj; 4) Korniza e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare; 5) Konventa për Eliminimin e çdo lloji Forme të Diskriminimit Racial; 6) Konventa e Eliminimit të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas” (ibid: 2)

Këto dokumenta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut janë të aplikueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë duke mos patur nevojë të përfshihen në kuadrin ligjor kombëtar. Kjo nënkupton se të gjitha institucionet publike që ushtrojnë fuqi brenda territorit të Kosovës, duke përfshirë dhe gjykatat, kanë detyrim kushtetues për ti aplikuar këto instrumenta. Ndërkaq përveç këtij kuadri të përgjithshëm ligjor për mbrojtjen e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut të marra në shqyrtim nga analiza e kësaj teze doktrinale, ekzistojnë ligje të posaçme të cilat i mbrojnë këto të drejta të sanksionuara në kushtetutë. Kështu nëse do të hedhim një vështrim në kohë, para kushtetutës së 2008, në Kosovë ishin miratuar dy ligje që në vitin 2004, ai Anti Diskriminim i vitit 2004 dhe ligji për Barazi Gjinore.

Ligji Anti-Diskriminim, që sipas emërimit në vitin 2004 - Kundër Diskriminim, ishte një ligj i cili sanksiononte se individët në Kosovë, brenda juridiksionit nga të ashtuquajturat Institucionet e Parakohshme të Qeverisjes së Kosovës⁴² do të duhet të kishin një trajtim të barabartë pavarësisht: “gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera”.⁴³ Nga ky ligj mund të shohim qartë se ai thjesht thekson një parim të përgjithshëm kushtetues që

⁴² Institucionet e Parakohshme të Qeverisjes së Kosovës kishin nisur të funksiononin që prej zgjedhje të para që ishin zhvilluar pas nisjes së administrimit ndërkombëtar të saj, në 2001 dhe zgatën deri në shpalljen e pavarësisë në 2008.

⁴³ Asambleja e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Ligji Antidiskriminim, (Prishtinë 19 Shkurt 2004), Ligji Nr.2004/ 3, hyrë në fuqi më 21 Mars 2004, neni 2/a

mund të gjendet në çdo kushtetutë moderne të ditëve të sotme, ndaj deri në amendimin e tij në vitin 2015 funksionueshmëria e tij ishte thjesht formale. Ai nuk shihte asnjë mekanizëm mbrojtjeje nëse do ti referohemi orientimit seksual por thjesht sanksiononte se nëse do të kryhej diskriminim në punësim apo shërbime të tjera shtetërore si dhe nëse do të kishte dëmtime fizike apo morale çështja do të kalonte pranë organeve kompetente dhe do të kishte një masë gjobe që varionte nga 500 euro deri në 10 mijë euro duke variuar nga statusi juridik i të dëmtuarit (Ligji Antidiskriminim 2004: 5).

Gjithashtu nëse do ti referohemi kushtetutës aktuale të republikës së Kosovës të vitit 2008, sipas organizatës QESH: “në atë kohë është lobuar fuqishëm që orientimi seksual të përfshihej në preambulë pra, ku të gjithë qytetarët do të ishin të barabartë para ligjit dhe do të mbrohenin njësoj prej tij pavarësisht [...] duke përfshirë vetë orientimin seksual dhe identitetin gjinor”.⁴⁴ Në këtë kuptim nevoja për një amendim të ligjit kushtetues ishte e një nevojë urgjente, pasi me përfshirjen në vetë kushtetutën e vitit 2008, vlera e ligjit kundërdiskriminim zhbëhej dhe për të arritur ato standarte evropiane dhe ndërkombëtare, siç parashikohej në ligjin e 2004 do të duhej një mekanizëm mbrojtjeje për të parandaluar atë kategori sociale në fjalë dhe mbi të gjitha të shihej jo thjesht si një shkelje administrative apo dëmtim imazhi personal por të trajtohej si një kufizim i mirëfilltë i lirisë së individëve dhe dëmtim me pasoja që sanksionohen nga kodi penal.

Ndaj në amendimet e vitit 2015,⁴⁵ nëpërmjet një ‘presioni’ ndërkombëtar kryesisht të BE, por dhe aktorët e shoqërisë civile, kryesisht palët e interesuar, organizatat joqeveritare me në fokus të drejtat e komunitetit LGBTI u bë shfuqizimi i ligjit të kaluar dhe nëpërmjet amendimit u miratua ligji aktual. Ndërkaq ligji mbi mbrojtjen dhe barazinë gjinore i vitit 2004 i cili që në nenin e parë sanksiononte se:

“Me këtë Ligj mbrohet, trajtohet dhe vendoset, barazia ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqëror. Ky Ligj

⁴⁴ Intervistë me aktivistin e të drejtave LGBTI, Liridon Veliu Qendra për Emancipim Shoqëror, Prishtinë 11 Korrik 2015

⁴⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji mbi Mbrojtjen Kundër Diskriminimit (Prishtinë, 28 Maj 2015) Nr. 05/L-021, hyrë në fuqi më 12 Qershor 2015

përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për garantimin e të drejtave të barabarta si dhe përcakton subjektet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre”.⁴⁶

Nëpërmjet këtij ligji parashikohej se qeveria e Kosovës do të duhej të krijonte një plan veprimi me kohëzgjatje dy vjeçare të ripërsëritshëm dhe gjithashtu implementimi i tij duhet të ishte si në nivel qendror ashtu dhe lokal. Gjithashtu parashikohej krijimi i një organi mbikqyrës siç do të ishte Zyra për Barazi Gjinore⁴⁷ e cila do të vepronte si një organ i pavaraur qeveritar. E ndërsa ligji i ri i amenduar në 2015 e shton gamën e mbrojtjes duke futur për herë të parë konceptin e identitetit gjinor:

“*Identiteti gjinor* - kjo karakteristikë e mbrojtur mbulon identitetin që ka të bëjë me gjininë e një personi dukjen apo karakteristikat e tjera që lidhen me gjininë e një personi (qoftë përmes ndërhyrjes kirurgjike apo jo) duke mos marrë parasysh seksin që personi e ka pasur në lindje”.⁴⁸

Gjithashtu shton funksionet e mbrojtjes së diskriminimit me baza gjinore. Në të njëjtën kohë ky ligj shprehet fuqimisht se është: “në përputhshmëri me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrës (CEDAW)”⁴⁹ si dhe me të gjitha instrumentat dhe standartet e tjera ndërkombëtare, secili “garanton, mbron dhe

⁴⁶ Asambleja e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë (Prishtinë, 19 Shkurt 2004) Ligji Nr. 2004/2, hyrë në fuqi më 21 Mars 2004. Neni 1, par.1, fq.1

⁴⁷ Kjo zyrë do të kishte këto funksione: “a) zbaton dhe monitoron dispozitat e këtij Ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të tij; b) i propozon Qeverisë dhe ministrive hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe rregulloreve, si dhe miratimin e masave të tjera; c) përpilon dhe propozon politikën për promovimin e barazisë gjinore dhe mbikëqyrë zbatimin e saj; d) mbikëqyr zbatimin e marrëveshjeve dhe akteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me barazinë gjinore; e) përgatit raporte për Kosovën mbi përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore, të cilat miratohen nga Qeveria; f) koordinon punën rreth përgatitjes së Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, dhe monitoron zbatimin e tij; g) bashkëpunon me Zyrtarët për Barazi Gjinore në ministri dhe qeveritë lokale; h) bashkëpunon me organizatat jo-qeveritare të cilat janë aktive në fushën e barazisë gjinore dhe siguron financimin e pjesshëm për projekte apo aktivitetet e tyre; i) bashkëpunon me institucionet publike dhe siguron financim të pjesshëm për projekte apo aktivitetet e tyre; j) propozon kushtet dhe kriteret për financim të pjesshëm të cilin e përcakton Qeveria; k) koordinon aktivitetet e drejtuara në zbatimin e normave të përgjithshme të barazisë gjinore, duke përfshirë afrimin e ndihmës profesionale për zhvillimin e metodave dhe teknikave të përshtatshme, etj. (Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë (Prishtinë, 19 Shkurt 2004) Ligji Nr. 2004/2, hyrë në fuqi më 21 Mars 2004. Neni 5, par. 2. Për më tepër shih në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_2_al.pdf (Aksesuar më 15 Maj 2015)

⁴⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji mbi Barazinë Gjinore (Prishtinë, 28 Maj 2015) Nr. 05/L-020, hyri në fuqi më 12 Qershor 2015 Neni 3, pika 9, fq. 3.

⁴⁹ Ibid. Neni 1 par. 2, fq. 1.

promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë”.⁵⁰

5.2.1 Gjykatat

Një ndër institucionet e tjera të cilat ushtrojnë një funksion mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë edhe gjykatat. Megjithatë, sistemi gjyqësor në Kosovë mbetet i dobët dhe lipset të forcohet (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2014: 17). Ky fakt shihet nga humbja e besimit të qytetarëve në vetë sistemin por dhe problematika që haste shpesh në aksesin e limituar të disa kategorive sociale që kanë në sistemin gjyqësor. Ndër arsyt kryesore mund të përmenden: mos-funksionueshmëria e fuqisë juridike në të gjithë territorin e Kosovës, tejkalimi i afateve të procedurave civile apo kriminale, një numër gjithnjë e në rritje çështjesh të mbartura, niveli i ulët i mbrojtjes së vendimeve juridike, numri i lartë i çështjeve gjyqësore të cilat ndryshojnë pas apelit, elemente korruptive, praktika patriarkale në vendimet e çështjeve (kryesisht ato që lidhen me pronësinë ndaj grave), mos-implementim në praktikë të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, pamundësia e dërgimit të çështjeve në gjykatën Evropiane e të drejtave të njeriut - për shkak se Kosova nuk është pjesë e saj. Kështu sipas institucionit të Avokatit të Popullit numri më i lartë i çështjeve të sjella pranë këtij institucioni, në masën 33%, ishin ankesa ndaj sistemit të drejtësisë.⁵¹

Gjithashtu sipas një zyrtareje të lartë të ministrisë së Drejtësisë,⁵² mungesa e një Gjykate Administrative, do të arrinte ti thjeshtëzonte procedurat si dhe do të krijonte mundësinë, që shqyrtimi i çështjeve në lidhje me të drejtat e njeriut të zgjidheshin brenda këtij kuadri administrativ, ç’ka do të lehtësonte dhe vetë gjykatat aktuale. Ndërkaq një tjetër problematikë që haset në mënyrë të vazhdueshme, është mungesa e njohurive mbi standartet ndërkombëtare e të drejtave të njeriut. Kjo pasi stafet që merren me çështjet e të drejtave të njeriut janë ose të pakta në numër por edhe më mungesën e trajnime përkatëse

⁵⁰ Ibid. Neni 1 par. 1, fq. 1.

⁵¹ Intervistë me Merita Syla, zyrtare e lartë në Institucionin e Avokatit të Popullit për departamentin e mbrojtjes kundër diskriminimit, Korrik 2015, Prishtinë.

⁵² Intervistë me zyrtare të lartë (pa pëlqim për tu identifikuar) të Ministrisë së Drejtësisë, Departamenti i Integritetit Evropian dhe Koordinimit të Politikave/Divizioni i Koordinimit të Politikave, Prishtinë 17 Korrik 2015

(Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2010: 13). Nga ana tjetër edhe pse Kosova nuk është një palë nënshkruese e Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, sipas kushtetutës – neni 53⁵³ dhe 22⁵⁴ – obligon të gjitha autoritetet shtetërore të interpretojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të garantuara nga ligji dhe kushtetuta, në mënyrë që të jenë në harmoni me vendimet e gjyqësorit si dhe nëse ka një përplasje midis instrumentave dhe standarteve ndërkombëtare me dispozita ligjore kombëtare, atëherë këto të fundit i nënshtrohen plotësisht këtyre të parave duke u tejkaluar nga ato.

5.2.2. Institucioni i Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), është një institucion me mandat kushtetues, i pavarur nga organet e tjera të shtetit dhe vepron me të gjithë fuqinë juridike që ia garanton kushtetuta e Kosovës. I krijuar në 2000 pas vetë ligjit mbi avokatin e popullit, statusi dhe funksionimi i tij kanë qënë objekt i vazhdueshëm debati politik ku institucionet ndërkombëtare, kryesisht BE, kanë mbështetur krijimin e një institucioni të fortë dhe plotësisht të pavarur për të monitoruar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve në Kosovë nga organet shtetërore në nivel lokal dhe qendror (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2010: 12)

IAP vepron nëpërmjet parimit të barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.⁵⁵ Ai gjithashtu ka kompetenca për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.⁵⁶ Institucioni i Avokatit të Popullit e ushtron aktivitetin e tij kushtetues nga kuadri ligjor përkates, ligji për Avokatin e Popullit - i vitit 2004 dhe amenduar në 2010 dhe

⁵³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Interpretimi i Dispozitave për të drejtat e njeriut, neni 53, fq. 16

⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, neni 22, fq. 6

⁵⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Avokatin e Popullit, (Prishtinë 22 Korrik 2010), Nr. 03/ L-195, hyri në fuqi më 27 Gusht 2010. Neni 16, par. 1.3, fq. 6.

⁵⁶ Ibidem, neni 15, par. 1. Fq.5.

2015 - dhe trajton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Pra ai shërben si institucioni kryesor i mekanizmit implementues për mbrojtjen në nivel shtetëror e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të qytetarëve të Kosovës. Ankesat në institucion vijnë me kërkesën e palës por ekzistojnë dhe hetime të veçanta *ex officio*.⁵⁷

Gjithashtu sipas funksioneve të tij ai parasheh rishikimin e të gjitha projektligjeve apo ligjeve që mund të evidentojnë shkelje e të drejtave të njeriut apo lirive themelore të individit, duke e ngritur këtë problem dhe në gjykatën kushtetues, duke i dërguar për interpretim kushtetues përkatës dhe duke dëshmuar kështu një shembull të veçantë në krahasim me praktikën e vendeve të tjera.⁵⁸ Gjithashtu IAP, bën raportime vjetore në Parlamentin e Kosovës për raste kur ka elemente diskriminuese apo shkelje e të drejtave të njeriut, dhe e rekomandon këtë të fundit për të ndryshuar ato nene të ligjeve ku vihet re “problemtatikë” apo projektligjeve në proceset përkatëse.⁵⁹

Institucioni i Avokatit të Popullit drejton hetime, bën rekomandime, publikon raporte (kryesisht vjetore) dhe mundëson shërbim të lirë dhe advokim publik ndaj të gjithë qytetarëve të Kosovës. Në rastet kur hetimi është ndërmarrë nga këshillues juridik të IAP do të rezultojë me rezultatin e përfundimeve se dhunimi i të drejtave të njeriut ka ndodhur, dhe se institucioni mund të kërkojë informacione shtesë ndaj autoriteteve publike.⁶⁰ Ai gjithashtu mund të japë rekomandime për autoritetet publike që kanë të bëjnë me raportin për arsye të nryshme. Institucioni i Avoktit të Popullit është i shpërndarë në pesë rajone të tjera të Kosovës, Pejë, Prizren, Gjilan, Graçanicë dhe Mitrovicë. Ky institucion mbart mbi vete mjaft sfida që lidhen si me aftësinë funksionale, buxhet i limituar, personel i kufizuar ashtu dhe me marrëdhëniet ndër-institucionale, raport i dobët me Zyrën për Qeverisje të Mirë, Agjensinë për Barazi Gjinore, gjykatat, sektorët e të drejtave të njeriut në ministritë e ndryshme, nivelin lokal dhe të tjera. Edhe pse IAP ka detyrim të mbikqyr dhe monitoroj këto institucione, shpesh aftësia e këyre të fundit për t’iu përgjigjur këtij detyrimi konform

⁵⁷ Për më tepër shih në ëebfaqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit, <http://www.ombudspersonkosovo.org/en/mission> (Aksesuar më 19 Qershor 2015)

⁵⁸ Intervistë me Merita Syla, zyrtare e lartë në Institucionin e Avokatit të Popullit për departamentin e mbrojtjes kundër diskriminimit, Korrik 2015, Prishtinë.

⁵⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji i Avokatit të Popullit, (Prishtinë 18 Maj 2015), Nr. 05/L - 019, hyri në fuqi 15 Qershor 2015.

⁶⁰ Për më tepër shih në ëebfaqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit, <http://www.ombudspersonkosovo.org/en/mission> (Aksesuar më 25 Qershor 2015)

ligjit mbetet neglizhente.⁶¹ Megjithatë me amendimet e fundit të këtij ligji në qershor të 2015, këto kompetenca janë rritur edhe më tej.

Një element tjetër për tu theksuar është bashkëpunimi shoqëri civile dhe IAP, i cili sipas zyrtarës së lartë të departamentit kundër diskriminimit dhe zyrtarës së lartë mbi çështjet e së drejtës së gruas dhe barazisë gjinore theksuan se me kalimin e viteve ai është forcuar. Nga ana tjetër, në të dyja rastet ka patur disa iniciativa të përbashkët në kuadrin e mbrojtjes dhe forcimit e të drejtave përkatëse. Kështu është punuar ngushtësisht për krijimin e një baze të dhënash për regjistrimin e viktimave të dhunës në familja me baza gjinore por që nuk është arritur të finalizohet në rang kombëtar pasi shtrohen një sërë çështjesh delikate si nga ana e privatësisë (cili do të ketë akses) por dhe nga ajo praktike. Megjithatë në amendimet e ligjit kundër dhunës në familje dhe barazisë gjinore, janë marrë në konsideratë sygjerimet e bëra nga palët e interesuara të cilat janë prezantuar dhe në raportet vjetore para parlamentit si dhe në komisionet parlamentare përkatëse.⁶²

Në të njëjtën frymë është vepruar dhe me organizatat jo qeveritare me në fokus të drejtat e komunitetit LGBTI por jo vetëm. Pjesmarrje në çdo event apo tryeza pune të inicuar nga OJQ e komunitetit LGBTI, pjesmarrje në marshimin e krenarisë në vitin 2014 dhe në vitin 2015, bashkëpunim mbi rastet e dhunës fizike dhe psikologjike ndaj antarëve të komunitetit LGBTI, asistencë e plotë në këtë drejtim. Çështja e LGBTI ka qënë e tajtuar për vite nga Institucioni i Avokatit të Popullit ku ankesat e para janë marrë prej vetë OJQ-ve (Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut) në vitin 2005 e cila nuk ka patur drejtim të mirëfilltë LGBTI.⁶³ Gjithashtu ato kanë një rol monitorues në Këshillin për Komunitetin LGBTI në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Sipas IAP rastet e raportimeve janë shtuar pasi është bërë një punë më e madhe ndaj sensibilizimit të komunitetit për mbështetje më të

⁶¹ Intervistë me Merita Sylja, zyrtare e lartë në Institucionin e Avokatit të Popullit për departamentin e mbrojtjes kundër diskriminimit, Korrik 2015, Prishtinë.

⁶² Intervista me zyrtaren e lartë për çështje të barazisë gjinore dhe të drejtat e gruas, znj. Luljeta Domaniku Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë Korrik 2015

⁶³ Për më tepër shih në ëebfaqen e Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut <http://democratic-youth.net/yihr/country/kosovo/> (Aksesuar më 21 Korrik 2015).

madhe që Institucioni i Avokatit të Popullit ofron në këtë drejtim, duke respektuar parimin e konfidencialitetit është shtuar edhe besim i ndërsjelltë.⁶⁴

5.2.3. Zyra për Qeverisje të Mirë

Zyra për Qeverisje të Mirë funksionon si një institucion pranë zyrës së kryeministrit të Kosovës, pra në varësi të tij, e krjuar që në vitin 2002 me një mandat të gjërë në lidhje me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në Kosovë. Përkatësisht kjo zyrë ka për qëllim të zhvillojë politika zhvillimore dhe të përgatisë udhëzues në fushat e qeverisjes së mirë, të drejtat e njeriut, shanset e barabarta, dhe barazi gjinore. Ajo gjithashtu rishikon draft-legjislacionet për tu siguruar se janë në përputhshmëri me aplikueshmërinë e standarteve e të drejtave të njeriut dhe praktikave të qeverisjes së mirë, duke patur një mbivendosje të pjesshme me monitorimin ligjor dhe kushtetues që e ndërmerr institucioni i Avokatit të Popullit. Ndërkaq, nëpërmjet këshillimeve dhe rekomandimeve që i jep zyrës së kryeministrit nga e cila varet drejtpërsëdrejti – institucionalisht, politikisht dhe financiarisht – në të njëjtën mënyrë këto këshilla i jepen edhe ministrave që kanë në fokus forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Asiston në zhvillimin dhe implementimin e fushatave ndërgjegjëse të informimit publik dhe promovimi të tjera të skemës së rritjes së ndërgjegjësimin publik për standartet mbi të drejtat e njeriut.⁶⁵

Një ndër risitë e viteve të fundit është krijimi i njësive mbi të drejtat e njeriut nëpërmjet të cilave ajo jep rekomandime dhe sygjerime të mëtejshme të cilat janë të vendosura pranë çdo dikasteri ministrior por dhe mbi qeverisjen lokale. Në fakt nëse e shohim nga ana institucionale, të gjitha këto njësi kanë detyrimin të raportojnë apo kontrollohen nga institucioni i Avokatit të Popullit, por në këtë drejtim ZQM mbivendos këtë mbikqyrje me IAP, duke krijuar përplasje kompetencash kushtetuese. Pra nëse IAP është i vetmi institucion më i lartë i hierarkisë, me rend kushtetues, të monitorojë, rekomandojë dhe mentorojë çdo funksionim institucionesh publike në Kosovë në lidhje me zbatimin e ligjit për të gjithë pa dallim gjinore apo diskriminime të tjera, pra mbrojtjen e

⁶⁴ Intervista me zyrtaren e lartë për çështje të barazisë gjinore dhe të drejtat e gruas, znj. Luljeta Domaniku Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë Korrik 2015

⁶⁵ Për më tepër shih në faqen zyrtare të Zyrës për Qeverisje të Mirë: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,51> (Aksesuar më 17 Prill 2015)

respektimit e të drejtave të njeriut, atëhere ky funksion nuk mund të jetë i mbivendosur nga një institucion i dytë i cili për më tepër është i varur nga ekzekutivi. Për më tepër rreth kësaj problematike do të diskutohet në seksionet e ardhshme të këtij kapitulli duke evidentuar dobësitë që paraqit sot qasja nga lartë poshtë në mbrotjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kosovë.

Në këtë kuptim institucionet që garantojnë mbikqyrjen apo implementimin e mbrotjes së të drejtave të njeriut në Kosovë mund të themi se kanë një koordinim të dobët. Në të njëjtën linjë qëndron edhe komenti nga progres raporti i fundit i Bashkimit Evropian i cili shton më tej se:

“Shumëllojshmëria e institucioneve dhe organeve të cilat ndërmarrin veprime ndaj mbrojtjes së të drejtave të njeriut në nivel qëndror dhe lokal është shumë e shpërqëndruar dhe shpesh me mbivendosje institucionale. Komunikimi dhe koordinimi midis institucioneve dhe organeve të ndryshme që merren me të drejtat e njeriut është mjaft i dobët. Këto organe do të duhen të ridrejtohen dhe mandatet e tyre të qartësohen në mënyrë që të kenë një përdorim më të mirë brenda eksperimentit të tyre të limituar por dhe burimeve të ndryshme po aq të limituara” (Komisioni Evropian ‘progres-rapori’, 2014: 19).

Bazuar në një intervistë me një zyrtar të lartë të zyrës për Qeverisje të Mirë, në lidhje me pyetjen nëse kjo zyrë ka ndërmarrë hapat e nevojshme në lidhje strukturën aktuale për të mbrojtur të drejtat e njeriut, ai theksoi se:

“ata i marrin në konsideratë si rekomandimet që vijnë nga partnerët ndërkombëtarë si BE ashtu dhe nga institucioni i Avokatit të Popullit për nevojën e ristrukturimit të niveleve të ndryshme të operimit të njësisë mbi të drejtat e njeriut, por megjithatë brenda limiteve burimore dhe funksioneve kompetente që ia garanton vetë baza ligjore që ato janë formuar, nuk mund të tejkalohet kjo pozitë. Megjithatë si ZQM ashtu dhe zyra Juridike e kryeministrit janë në një proces ku po përpiqen të krijojnë një rregullore të re dhe për këtë do të ketë një strukturë e re organizacionale mjaft më efektive se ajo aktuale”.⁶⁶

Duke vështruar në të gjitha institucionet apo organet të cilat garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, mund të themi se qeveria e Kosovës i ka krijuar këto mekanizma në mënyrë formale, duke i parë kryesisht si një mënyrë për të përmbushur disa

⁶⁶ Intervistë me Habit Hajredini, Zyra e Qeverisjes së Mirë pranë Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Prishtinë 8 Korrik 2015

kritere politikash mbi standarte ndërkombëtare e kryesisht evropiane duke e lënë procesin e mekanizmave implementuese të mënjanuar për të vepruar në këtë kuadër. Në të njëjtën linjë, nga intervistat e zhvilluara në nivel ekspertësh ashtu dhe aktivistësh të shoqërisë civile, mbi sektorin e të drejtave të njeriut kanë pohuar se institucionet e Kosovës kanë aftësi mjaft të mira në përshtatjen dhe përfshirjen e kuadrit ligjor përkatës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore por se, në aspektin implementues, pra mekanizmave institucional, ka një vullnet mjaft të dobët politik. Për këtë arsye ushtrimi i një legjitimiteti të jashtëm, për rastin tonë BE nëpërmjet kushtëzimit politik, i detyron elitat udhëheqëse të qasen në mënyrë nga lartë-poshtë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo strategji do të analizohet nëpërmjet dy seksioneve pasardhëse, ku në fillim do të analizohet si kanë ndikuar reformat mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga institucionet e Kosovës dhe së dyti se si ka ndikuar Evropianizimi nëpërmjet kushtëzimit për arritjen e standarteve të kërkuara.

5.3. Reformat ndaj mbrojtjes e të drejtave të njeriut: procesit nga lartë-poshtë

Gjatë këtyre viteve të fundit, Kosova ka ndërmarrë një sërë reformash mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të individit duke përfshirë dhe tre të drejtat që janë përzgjedhur për këtë studim, duke përmirësuar kuadrin ligjor – amendimin e ligjit mbi Barazinë Gjinore, ligjin kundër Diskriminimit, ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, ligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe të tjera; përmirësim i strukturave implementuese dhe mbrojtëse e të drejtave të njeriut – fuqizimi i rolit të institucioneve agjensive me në fokus të drejta të njeriut si, Avokati i Popullit, Agjencia për Barazi Gjinore, zyra për Qeverisje të mirë, Këshilli për mbrojtjen e LGBTI, Këshilli Kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës.⁶⁷ Kështu në këtë seksion do ta nisim duke analizuar impaktin e ndryshimeve të kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe më tej mbi qasjen institucionale nga lartë-poshtë të institucioneve dhe angjensive

⁶⁷ Mbledhja e katërt e Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale, Prishtinë 1 Korrik 2015 Për më tepër shih: www.president-ks.gov.net/?page=1,8,3945#.Vdhlp4FyzqA (Aksesuar më 18 Korrik 2015)

kombëtare me në fokus forcimin e mbrotjes së të drejtave të grave dhe barazisë gjinore, të drejtat e komunitetit LGBTI dhe lirinë e shprehjes.

5.3.1. Fushata e amendimeve të kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut: nisja e procesit nga lartë-poshtë

Kushtetuta e re e Kosovës e vitit 2008, mbarte një kuadër ligjor prej afro një dekadë nga korniza kushtetuese për institucionet e parakohshme të vetëqeverisjes së Kosovës së vitit 2001, nën bashkëqeverisje me një sërë oraganizatash dhe organesh ndërkombëtare ku UNMIK mbante rolin kryesor dhe një sërë mekanizmesh ligjore të miratuara vite më parë të marra nga eksperiencat më të mira ndërkombëtare. Pjesë e tyre ishin edhe ligjet kundër diskriminimit, barazisë gjinore, institucionin e avokatit të popullit, etj., por duke qënë se ato ishin miratuar brënda një kuadri institucionesh të përkohshme dhe për të ndërtuar shtetin e ri, do të duheshin forcim i mëtejshëm i këtyre mekanizmave. Kjo nevojë për ndryshime të ligjeve me në fokus mbrotjen e një sërë të drejtash të njeriut dhe lirive themelore të cilat ishin dhe të sanksionuara në preambulën e kushtetutës së re, nuk u panë si primare nga elitat e post-pavarësisë, pasi vëmendja e tyre ishte e fokusuar ndaj njohjes së pavarësisë nga shtete të tjera, vendimi i gjykatës ndërkombëtare për aktin e pavarësisë si dhe shtrirjen e autoritetit të institucioneve të reja në të gjithë territorin e Kosovës.

Në këtë drejtim do të duhej të kalonin afro tre vjet nga të cilat do të kishim nisjen e një të ashtuquajture fushatë amendimesh të kuarit ligjor mbi mbrotjen e të drejtave të njeriut. Unë argumentoj, se ky fakt u detyrua më së shumti nga faktori i jashtëm, Bashkimi i Evropian në këtë kontekst, e cila nëpërmjet ushtrimit të legjitimitetit të saj substancial dhe proçedural nga ana e Komisionit Evropian dhe Këshillit të BE – zyrës së BE në Kosovë – për të avancuar nga një marrëveshje partneriteti me Kosovën drejt një marrëveshje asociativ-stabilizim, kërkonte nga kjo e fundit arritjen e standarteve ‘evropiane’ në mënyrë që të arrinte përputhshmërinë e nevojshme për synimet e vetë procesit. Nga ana tjetër, nëpërmjet legjitimitetit të ushtruar nga EULEX, si një organ monitorues, mentorues dhe bashkëqeverisës *de facto* në disa fusha të veprimtarisë qeverisëse, vendoste për arritjen e këtyre standarteve të ‘larta’, ndaj një vendi ‘jo evropian’.

Në këtë mënyrë nëse do të hedhim një vështrim kuadrit ligjor para vitit 2008 do të vemë re se për ligjin Kundër Diskriminimit i 2004, sanksionohej veprimi e një parimi të përgjithshëm kushtetues i cili ndonëse ishte konform disa ekpëriencave të vendeve të tjera, praktikisht nuk kishte asnjë mekanizëm të qartë për të treguar mbrotjen ndaj komunitetit LGBTI, ndaj dhe funksionueshmëria e tij ishte thjesht formale. Gjithashtu nëse do ti referohemi kushtetutës aktuale të republikës së Kosovës të vitit 2008, sipas aktivistit të QESH, “në atë kohë është lobuar fuqishëm që orientimi seksual të përfshihej në preambulë pra, ku të gjithë qytetarët do të ishin të barabartë para ligjit dhe do të mbrohenin njësoj prej tij pavarësisht, duke përfshirë vetë orientimin seksual dhe identitetin gjinor.”⁶⁸

Në këtë kuptim nevoja për një amendim të ligjit kushtetues ishte urgjente, pasi me përfshirjen në vetë kushtetutën e vitit 2008, vlera e ligjit kundër-diskriminim zhbëhej dhe për të arritur ato standarte evropiane dhe ndërkombëtare, siç parashikohej në ligjin e 2004 do të duhej një mekanizëm mbrojtjeje për të parandaluar atë kategori sociale në fjalë dhe mbi të gjitha të shihej jo thjesht si një shkelje administrative apo dëmtim imazhi personal por të trajtohej si një kufizim i mirëfilltë i lirisë së individëve dhe dëmtim me pasoja që sanksionohen nga kodi penal. Ndaj në amendimet e vitit 2015, nëpërmjet ushtrimit të legjitimitetit substancial të BE – pra adaptimin e normave dhe vlerave evropiane ndërmjet standarteve normative, por dhe aktorët e shoqërisë civile, kryesisht palët e interesuar, organizatat jo qeveritare me në fokus të drejtat e komunitetit LGBTI u bë shfuqizimi i ligjit të kaluar dhe nëpërmjet amendimit u miratua ligji aktual.

Por ndikim nuk pati vetëm ligji kundër diskriminimit por dhe vetë institucioni kushtetues për mbrotjen e të drejtave të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit. Sipas Merita Sylas, zyrtare e lartë në IAP kundër Diskriminimit, tregon se procedurat e rasteve që raporteleshin për dhunë fizike ndaj personave LGBTI, pranë këtij institucioni ndryshuan me amendimet e vitit 2015 të ligjit.

“Kështu në procedurën e vjetër çështjet janë trajtuar në mënyrë konforme brenda kompetencave që ofronte kuadri ligjor i veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit. Ndërsa nëpërmjet ligjit të ri këto kompetenca janë rritur dhe për pasojë

⁶⁸ Intervistë me aktivistin e të drejtave LGBTI, Liridon Velu Qendra për Emancipim Shoqëror, Prishtinë 11 Korrik 2015

dhe mbulimi i mbështetjes nga ana e institucionit për raste e veçanta abuzuese është më i madh”.⁶⁹

Po kështu me ligjin e ri palët e interesuar e njohin procedurën se si mund të bëjnë ankimin pra mekanizmin, ndërsa më herët nuk kishte një mekanizëm të parashikuar në ligj duke lënë këssoj mundësi interpretimi në implementim dhe nga vetë funksionet juridike që institucionet shtetërore kishin për të vepruar. Ajo shton gjithashtu se, me ligjin e ri në një formë e fuqizon Institucionin e Avokatit të Popullit, si institucioni kryesor i mbrojtjes dhe forcimit e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për ti ndjekur të gjitha procedurat deri në një vendim përfundimtar i gjykatës. IAP mund të bëjë rekomandime përkatëse gjykatës për çështje të caktuar duke i ofruar ndihmë juridike.⁷⁰

Gjithashtu për të rritur aspektin e identitetit gjinor në kuadër të zgjerimit të mbrojtjes së të drejtave të personave të komunitetit LGBTI, në ligjin e ri për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, i miratuar në 01.08.2013 dhe hyrë në fuqi në 19.08.2013, përcakton në nenin 1 dhe pika 2: “mbrojtjen e viktimave të trafikuar, përfshirjen e të drejtave si ndihmë juridike, ndihmë mjekësore [...] që identifikohen si të trafikuar pavarësisht gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paafësisë fizike ose mendore, orientimit seksual [...]”.⁷¹ Ndërkaq mekanizmi implementues i këtij ligji garantohej nga neni 7, Autoritetin Kombëtar kundër trafikimit me njerëz i emëruar nga qeveria, i cili zbaton ligjin mbi mbrojtjen e trafikimit të qenieve njerzore, koordinon këtë mbrojtje dhe promovon praktikat sensibilizues në komunitet.⁷² Ky ligj shërben dhe ndaj mbrojtjes së të drejtave të grave dhe forcimit të kësaj mbrojtjeje në kuadër kundër trafikimit.

Kështu nëse do ti referohemi ligjit për Barazinë Gjinore të amenduar në vitin 2015, do të shohim se kjo reformë e ndërmarrë nga qeveria e Kosovës si dhe bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare me në fokus ë drejtat e gruas dhe barazisë gjinore, e rriti mbrojtjen

⁶⁹ Intervistë me Merita Sylja, zyrtare e lartë në Institucionin e Avokatit të Popullit për departamentin e mbrojtjes kundër diskriminimit, Korrik 2015, Prishtinë.

⁷⁰ ibid

⁷¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Viktimave të Trafikimit, (Prishtinë, 31 Korrik 2013), Nr. 04/L-218 hyri në fuqi më 15 Shtator 2013, neni 1, par.2, fq.2.

⁷² Ibid, neni 4. Par.2, fq.4

duke përfshirë për herë të parë konceptin e identitetit gjinor,⁷³ si dhe shtoi funksionet e mbrojtjes së diskriminimit me baza gjinore. Në të njëjtën mënyrë ky ligj është konform të gjitha instrumentave dhe standarteve ndërkombëtare për të promovuar barazinë gjinore dhe i referohet CEDAW që në nenin e parë.⁷⁴

Për sa i përket ligjit për Barazi Gjinore, zytarja e lartë për çështje për Barazi Gjinore pranë IAP shprehet se:

“ligji në fjalë dhe ai në kuadër të anti-dsikriminim kanë qënë në procedurë amendimi dhe janë miratur në një paketë e suportuar të miratohej si një e tërë nga BE⁷⁵ - (Paketa Ligjore e të Drejtave të Njeriut) por vetë IAP i ka ofruar rekomandime përkatëse ndaj këtyre dy ligjeve të cilat janë marrë pjesërisht parasysht”⁷⁶

Kështu për ta konkretizuar, nëse marrim rastin për Ligjin e Institucionit të Avokatit të Popullit, ku rekomandimet për pavarësinë e stafit të IAP nuk janë marrë parasysht por është lënë një hapësirë në formë pavarësie por jo plotësisht. Në këtë kuadër as rekomandimet nga organizata joqeveritare të shoqërisë civile dhe as më tepër ato nga BE, të cilët kanë shprehur rekomandimet e tyre, rezultatet kanë konfirmuar se vullneti politik ka qënë i tillë saqë këto rekomandime nuk janë marrë kurrë parasysht.

Gjithashtu duke iu referuar ligjit për ‘statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalid veteran [...] viktimave të dhunës seksuale’, kishte për qëllim të amendonte dhe plotësonte ligjin ekzistues, ku duke iu referuar nenit të parë ai shton, “viktimat e dhunës seksuale”.⁷⁷

Duke vazhduar në nenin 2:

“në titullin e ligjit bazik pas fjalës pjestarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës shtohet fjalia dhe të dhunës seksuale të luftës dhe vazhdon si në tekstin e ligjit bazik”, duke e specifikuar në nenin 4 pika 11 se viktimë e dhunës seksuale gjatë

⁷³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji mbi Barazinë Gjinore (Prishtinë, 28 Maj 2015) Nr. 05/L-020, hyri në fuqi më 12 Qershor 2015 Neni 3, par. 1. 9, fq. 3.

⁷⁴ Ibid, neni 1, fq.1

⁷⁵ Nëse do t’iu referohemi progres-raporteve të Komisionit Evropian, adoptimi I të ashtuquajturës Paketa Ligjore e të Drejtave të Njeriut, ishte i shtyrë për tu implementuar nga qeveria për disa vjet me radhë dhe që prej 2014 e në vazhdim shumë ligje ishin amenduar nën këtë strategji të paketës ligjore.

⁷⁶ Intervista me zyrtaren e lartë për çështje të barazisë gjinore dhe të drejtat e gruas, znj. Luljeta Domaniku Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë Korrik 2015

⁷⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Mbi Amendimin dhe Supplementimin e Ligjit Nr.04/L-054 mbi Statusin dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, Antarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale në Luftë, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, (Prishtinë 20 Mars 2014) Nr. 04/L-172, hyri në fuqi më 6 Prill 2014, neni 4 par .11 fq.3.

luftës konsiderohet personi i cili i ka mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit brenda periudhës 27.02.1998 – 20.06.1999”.⁷⁸

Po ashtu nëpërmjet nenit 17 pika 2.2, “parashikohet mbrotja e të dhënave për personat që kanë mbijetuar abuzimit seksual”.⁷⁹

Megjithatë sipas zyrarës së lartë të Institucionit të Avokatit të Popullit, çështja e viktimave të luftës, e cila kur i referohen të dëmtuarve, përmenden si kategori, që në vërtetë nuk mund të konsiderohen si të tillë, pra kategorizimi i të dhunuarve bie ndesh me rekomandimet e rezolutës 1325, prej së cilës vetë ky ligj i bën referencë për mbështetje si instrument ndërkombëtar.⁸⁰ Nëpërmjet këtij amendimi që iu bë ligjit, ekziston një hapësirë e madhe me implementimin e tij ku viktimat e luftës si kategori të grave janë të papërfshira. Këshilli Kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës u krijuar si një forum posaçërisht për këtë qëllim me përfshirjen e IAP, OJF me në fokus të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, etj si dhe më pjesmarrjen e presidentes së republikës Ahtifete Jahjaga, nëpërmjet takimeve të njëpasnjëshme – takimi i fundit i zhvilluar në 31 Qershor 2015, është përpjekur të koordinojë në implementimin e këtij ligji.⁸¹

Ndërkaq ndryshimet e kuadrit ligjor në kuadër të rritjes së mbrotjes së lirisë së shprehjes ndaj profesionit të gazetarisë dhe profesionistëve në tërësi, por jo vetëm, në risitë e ndërmarra si pjesë e paketës për të drejtat e njeriut ishte dhe amendimi i ligjit të vitit 2005 që rregullonte autoritetin e lartë të mediave audiovizive dhe radiove të Kosovës, pra Komisionin e Pavarur të Mediave me qëllimin “për të përcaktuar kompetencat e këtij komisioni për të promovuar zhvillimin e një shërbimi mediatik të shëndoshë”.⁸² Gjithashtu ky ligj i ri do të kishte për qëllim përgatitjen e strategjisë së Kosovës për kalimin nga transmetimi analog në atë dixhital. Sipas nenit 6 atij i garantohej pavarësi e plotë nga politika dhe qeveria, duke iu siguruar një buxhet vjetor që miratohej nga parlamenti i Kosovës.⁸³ Sipas gazetarit të mirënjohur dhe editor në (BIRN-Kosovë) Mehmet Hajrullahu:

⁷⁸Ibid, neni 6, fq.4.

⁷⁹ Ibid neni 19A, fq. 5

⁸⁰ Intervista me zyrarën e lartë për çështje të barazisë gjinore dhe të drejtat e gruas, znj. Luljeta Domaniku Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë Korrik 2015

⁸¹ Mbledhja e katërt e Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale, Prishtinë 1 Korrik 2015 Për më tepër shih: www.president-ksgov.net/?page=1,8,3945#.Vdhlp4FyzqA (Aksesuar më 18 Korrik 2015)

⁸² Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, (Prishtinë 2 Mars 2012), Nr. 04/ L-044, hyri në fuqi më 17 Mars 2012, neni 1 fq.1.

⁸³ Ibid.neni 6, fq.6.

“krijimi i këtij komisioni tregon më përgjegjshmëri në kuadër të rregullimit të tregut medial në Kosovë, pasi përveç se koordinon mbarëvajtjen e këtij medium mediatik, shërben si arbitër në mosmarrëveshjet e ndryshme ndërmjet palëve të interesuar. Kështu ai mund të marrë ankesa të palëve dhe të japë, vendime që jo gjithmonë janë të mira dhe pa ndikuara”.⁸⁴

Megjithatë si një organ mbi mediat, ai ka arritur të krijojë një kredibilitet pozitiv. Gjithashtu bordi drejtues dhe antarët janë të zgjedhur nga vetë media por kryetari i komisionit (komisioneri) zgjidhet direkte nga parlamenti. Kësisoj për Mehmetin, edhe pse politika është jashtë ndërhyrjes të parashikuar me ligj, ajo ushtron një legjitimitet indirekt në përzgjedhjen e kandidatëve dhe votimin që i bëhet në parlament. Megjithatë ky fakt nuk përbën shqetësimin kryesor që sipas Mehmetit gjenden mediat e sotme në Kosovë dhe performance e lirisë së shprehjes.⁸⁵

Përmirësimi i dytë i kuadrit ligjor ndaj fockimit të mbrotjes ndaj lirisë së shprehjes vjen nëpërmjet ligjit për mbrotjen e burimeve të gazetarisë, i cili ka për qëllim të rregullojë çështjen e të drejtës së gazetarisë për të ruajtur burimin e informacionit të përcaktuar nga nenet 40⁸⁶ dhe 42⁸⁷ të kushtetutës. Shpesh gazetarët dhe shprehja e liri në këtë kuptim vihej nën presionin, shantazhimin dhe kërcënimin e vazhdueshëm të politikës e cila akuzohej nga kjo e fundit për veprime të kundraligjshme që cënonin shoqërinë në Kosovë, duke iu sulmuar për shpifje dhe denigrim të imazhit publik të këtyre funksionarëve.

Nëpërmjet këtij ligji siguria e informacionit që merret është e rregulluar me ligj dhe përmban limite të pranueshmërisë dhe pacënueshmërisë së çdo individi. Kështu neni 4, përcakton se është e drejta e gazetarëve apo profesionistëve të heshtin rreth burimeve të tyre të informacionit, me përjashtim të rasteve të referuara nga neni 5. Ky i fundit sanksionon se, “burimi i informacionit është i detyruar të zbulohet, vetëm me kërkesë të gjykatës kompetente dhe vetëm nëse zbulimi i identitetit është i nevojshëm. Për të

⁸⁴ Intervistë me Muhamet Hajrullahu, editor pranë BIRN, Prishtinë 19 Korrik 2015.

⁸⁵ ibid

⁸⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Liria e Shprehjes, fq.13

⁸⁷ Ibid, Liria e Mediave, fq.13

parandaluar një kërcënim serioz të integritetit fizik me pasojë vdekjen e një apo më shumë personave”.⁸⁸

Në këtë mënyrë këto amendime dhe ligje të reja që erdhën në një farë mënyrë si pasojë e kushtëzimit politik të BE pas vitit 2011 do të shqyrtohen në seksionin e mëposhtëm duke pyetur se si ka ndikuar evropianizimi në qasjen nga lartë poshtë për promovimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga institucionet e Kosovës?

5.4. Ndikimi i ‘Europianizimit’⁸⁹ në arritjen e standarteve të legjitimitetit

Evropianizmi është një term i përdorur shpesh për të shpjeguar aftësinë e një vendi për të arritur të implementojë dhe përfshijë në kuadrin ligjor, institucional, ekonomik dhe shoqëror të gjithë ato norma apo vlera të cilat ‘importohen’ - në kuptimin e tezës tonë ushtrohen nga Bashkimi Evropian. Kështu për rastin tonë – Kosovën – arritja e disa standarteve që implikojnë në ndryshime rrënjësore në sferën shoqërore, ekonomike dhe sociale do tënfluençojnë që një proces të ecë më tej – në rastin afat-shkurtër hyrja në fuqi e MSA, afat-mesëm liberalizimi i vizave dhe afat-gjatë integrimi i plotë në BE. Për këtë qëllim ky seksion do të analizojë mbi efektet e ushtrimit të legjitimitetit substancial të BE nëpërmjet politikës së Zgjerimit ndaj Kosovës.

Kështu nëse hedhim një vështrim në të gjithë progres-raportet ndaj Kosovës prej vitit 2008 deri në 2014, do të vlerësohet progresi i arrirë ndaj përputhshmërisë së vendit në kuadër të reformave dhe strategjive institucionale të përdorura në kuadër të mbrojtjes dhe forcimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në kuadër të të drejtave të gruas dhe barazisë gjinore, të drejtat e komunitetit LGBTI, dhe të lirisë së shprehjes. Në tabelën e mëposhtme do të paraqitet vlerësimi nga këto progres-raporte ndër vite dhe më pas do të paraqitet mbështetja nga BE nëpërmjet fondeve IPA I (2008-2013) dhe IPA II për vitin 2014.

⁸⁸Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave të Burimeve të Gazetarisë, (Prishtinë 31 Korrik 2015) Nr. 04/L-137, hyri në fuqi më 16 Shtator 2013. Neni 5. Fq. 3.

⁸⁹ Këtu me termin ‘Europianizimi’ do të nënkuptojmë efektet e politikës së Zgjerimit nëpërmjet mbështetjes tekniko-financiare të fondeve IPA I dhe II.

	Të drejtat dhe liritë themelore në Kosovë (2008-2014)		
Progres raportet ndër vite	Të drejtat e grave dhe barazia gjinore	Të drejtat e komunitetit LGBTI	Liria e shprehjes
	Vlerësimi nga progres raportet për secilën të drejtë apo liri individuale		
2008	Nuk është bërë progres	Pak progres është bërë	Nuk është bërë progres
2009	Nuk është bërë progres	Nuk është bërë progres	Nuk është bërë progres
2010	Pak progres është bërë	Nuk është bërë progres	Pak progres është bërë
2011	Disa progres është bërë	Nuk është bërë progres	Pak progres është bërë
2012	Pak progres është bërë	Pak progres është bërë	Pak progres është bërë
2013	Pak progres është bërë	Pak progres është bërë	Pak progres është bërë
2014	Disa progres është bërë	Disa progres është bërë	Disa progres është bërë

Tabela 5.1⁹⁰

Nëse do të shohim vlerësimet ndër vite ndaj të drejtave të grave dhe barazisë gjinore, të drejtat LGBTI dhe lirinë e shprehjes, në periudhën 2008-2011 progresi është kryesisht: “nuk është bërë progres” dhe “pak progres është bërë”, ku me vlerësimin e parë nënkuptohet se nuk ka patur iniciativa në nivel shtetëror për të përmirësuar mbrotjen e të drejtave të njeriut por nga ana tjetër përpjekje sa do të vogla të cilat kërkojnë për më tepër mbështetje. Këto rezultate ndjekin të njëjtën linjë të argumentimit që parashtruam në analizën e mësipërme. Kështu në vitet e para pas shpalljes së pavarësisë, elitat udhëheqëse [institucionet e Kosovës] ishin të fokusuar më së shumti mbi njohjen ndërkombëtare dhe tranzitimit të asaj ‘pjesë’ të qeverisjes ndërkombëtare në pushtetin e brendshëm politik. Ndaj mund të thuhet se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore shiheshin si çështje të “dorës së dytë”, edhe pse rekomandohej dhe ushtrohej presion në mënyrë të vazhdueshme nga aktorë ndërkombëtar si BE për ti prioritetuar ato.

E ndërsa, duke interpretuar të dhënat nga 2011 deri në 2014, vlerësimi nis me një “progress të limituar është arritur” në “disa progress është bërë”, duke nënkuptuar se Kosova gjatë kësaj kohe kishte nisur të forconte të drejtat e njeriut, duke patur një nivel më të lartë përputhshmërie me kërkesat e BE. Për atë kohë sa vendi ishte duke arritur nisjen e hapjes së Proçesit për Stabilizim Asocim, BE ushtroi presion ndaj disa kërkesave, ndër të

⁹⁰ Këtu vlerësimi i referohet progres raporteve të Komisionit Evropian për Kosovën, nga vitit 2008 deri në 2014. Për secilën të drejtë, BE shprehet sipas progresit që vendi ka arritur për vitin e caktuar.

cilat ishte dhe Paketa e të Drejtave të Njeriut. Në këtë mënyrë, elitat udhëheqëse, nëpërmjet ushtrimin të presionit të jashtëm, nisën të amendonin disa nga ligjet kryesore të cilat në efektin juridik të tyre kishin karakter më tepër përshkrues se sa forcues, duke mos patur një kuadër të qartë mekanizmash mbrojtës. Kështu, arritja e ndryshimeve në të këtylla ligje, solli një rezultat të menjëhershëm në vlerësimin e BE për këto tre të drejta të përzgjedhura për studimin tonë.

Ndërkaq, nëse këto gjetje do ti vendosim në një tabelë të duke interpretuar vlerën e gjuhës me vlera numerike ato do të merrnin këtë paraqitje në tabelën në vijim: Aspak progres – 0; Nuk ka bërë progres – 1; Pak progres është bërë– 2; Disa progres është bërë – 3;

Të drejtat dhe liritë themelore në Kosovë (2008-2014)			
Progres raportet ndër vite	Të drejtat e grave dhe barazia gjinore	Të drejtat e komunitetit LGBTI	Liria e shprehjes
	Vlerësimi nga progres raportet për secilën të drejtë apo liri individuale të shprehur në vlerë numerike		
2008	1	2	1
2009	1	1	1
2010	2	1	2
2011	3	1	2
2012	2	2	2
2013	2	2	2
2014	3	3	3

Tabela 5.2

Ndërkohë, duke marrë mesataren e secilës vlerë numerike për secilën të drejtë të marrë në studim, përgjatë kohëzgjatjes prej shtatë viteve, do të arrijmë një vlerë të përafërt me dy (2), ç’ka nënkupton se progresi i limituar është arritur thuajse në çdo vit. Kështuqë kushtëzimi i përdorur, ka treguar në një farë mase një përputhshmëri ndaj mbrojtës dhe forcimit të drejtave të njeriut në Kosovë. Gjithashtu duke përllogaritur mesataren e secilit vit të progresit ndaj tre të drejtave, do të na shfaqet se viti më i “keq” është 2009, ku asnjë progress nuk ishte arritur për secilën të drejtë dhe viti i fundit, 2014, si viti që shënoi progresin më të mirë për tre të drejtat.

Nëpërmjet këtij vlerësimi, do të arrijmë të kuptojmë trendin e progresit që Kosova ka arritur përgjatë kësaj kohëzgjatje të studimit mbi të drejtat e njeriut. Ndaj për tu thelluar më tej rreth ndikimit të Evropianizimit do të duhet të vlerësojmë progresin e bërë në raport me fondet IPA I dhe IPA II. Këto rezultate prezantohen në tabelën 5.3.

Progres raporte ndër vite	Të drejtat e grave dhe barazia gjinore	Të drejtat e komunitetit LGBTI	Liria shprehjes	Asistenca financiare IPA I ⁹¹ dhe IPA II ⁹²
	Vlerësimi nga progres raportet për secilën të drejtë apo liri individuale të shprehur në vlerë numerike			
2008	1	2	1	184,700,000 €
2009	1	1	1	106,100,000 €
2010	2	1	2	67,300,000 €
2011	3	1	2	68,700,000 €
2012	2	2	2	70,000,000 €
2013	2	2	2	73,700,000 € + 38,500,000 € ⁹³ (112,200,000 €)
2014	3	3	3	83,800,000 € + 38,500,000 € ⁹⁴ (123,300,000 €)

Tabela 5.3

Kështu duke parë këtë tabelë të kompletuar (5.3), do të vëmë re se impakti i fondeve IPA në mbështetjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë është e variueshme. Në fazën e parë edhe pse rezultati nuk ishte mjaftueshëm pozitiv – përputhshmëri e ulët e progresit me kërkesat e BE – shuma e ndihmës financiare ishte më e lartë se në fazën e

⁹¹ Fondet IPA i që përfshijnë periudhën nga studimi ynë 2008 deri në 2013 kapin vlerën e 570.5 milion euro. Për më shumë shih: http://ec.europa.eu/enlargement/instruments/overview/index_en.htm (Aksesuar më 16 Shtator 2015). Duhet ta shenoj ne bibliografi

⁹² Fondet IPA II i referohen vetëm vitit 2014, I cili në të njëjtën kohë është dhe viti I fillimit të vetë kësaj paketë fianciare të BE. Për më shumë shih: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20140919-csp-kosovo.pdf (Aksesuar më 16 Shtator 2015)

⁹³ Shtesa prej 38.5 milion euro u dha nga BE për të implementuar marrëveshjen Prishtinë-Beograd duke e çuar vlerën totale të asistencës në 112,200,000 euro

⁹⁴ Shtesa prej 38.5 milion euro u dha nga BE për të implementuar marrëveshjen Prishtinë-Beograd duke e çuar vlerën totale të asistencës në 123,300,000 euro

dytë. Pra nga viti 2008 deri në 2011, vlera e IPA për Kosovën ishte € 406,800,000 dhe për periudhën nga 2012 në 2014 ishte € 305,500,000. Duke i marrë së bashku këto dy vlera, Bashkimi Evropian çdo vit e ka suportuar Kosovën me afro njëqind million euro.

Ndërkaq nëse do ti referohemi programit të asistencës për Kosovën IPA II (2014-2020), në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, tregon veç të tjerave se qëllimi i kësaj asistence do të fokusohet në forcimin e kapaciteteve për të mbështetur institucionet e Kosovës që janë përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e politikave me në fokus të drejtat e njeriut. Ndër fushat e reja të veprimit janë edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit për të promovuar mbrojtje të komuniteteve, ndaj lirive themelore dhe duke suportuar anti-diskriminimin, duke përfshirë rolin e pazëvendësueshëm të shoqërisë civile (Komisioni Evropian, Komunikatë 2012: 20).

Rezultatet që pritet të japë kjo ndërhyrje e re strategjike nëpërmjet asistencës financiare të IPA II, janë implementimi i të gjithë kuadrit ligjor të anti-diskriminimit, duke përfshirë dhe ndaj komunitetit LGBTI (Komisioni Evropian, ‘progres-raport’, 2014: 20). Gjithashtu ngritjen e strukturave të përgjegjshme për mbrojtjen, promovimin, forcimin dhe raportimin e lirive themelore, si në nivel lokal ashtu dhe atë qendror. Por nga ana tjetër strategjia parasheh përballjen e risqeve për rezultatete pozitive ku ndër më kryesorët përmend, “risku kryesor është vullneti politik dhe angazhim për të implementuar reformat e nevojshme” (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2014: 25).

Nga çfarë mund të kuptojmë është se mbështetja financiare nuk ka luajtur një rol kryesor në përmirësimin e vlerësimit që ka shënuar Kosova në raport me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ndaj mund të supozohet se kanë qënë edhe faktorë të tjerë si nisja e negociatave Prishtinë-Beograd, që të cilët e kanë shtyrë vlerësimin nga pikëpamje realpolitike. Megjithatë ky studim nuk do ndalet në këtë vështrim të analizës.

Për BE përputhshmëria ndaj standarteve evropiane ua arrit nëpërmejt vullnetit politik për të bërë ndryshimin, dhe ky dialog shërbeu një mënyrë për ta ilustruar angazhimin politik. Ndërkohë kushtëzimi për hapjen e negociatave shërbeu dhe si një faktor i rëndësishëm. Kështu në progres raportin e vitit 2011, Komisioni Evropian shprehet i hapur në rëndësinë që kishte shprehja e angazhimit të politikës së Kosovës për të arritur standartet që kërkoheshin nga BE (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2011: 23). Një tjetër element i

rëndësishëm është përfundimi i pavarësisë së mbikqyrur në 2012 e cila i dha një dimension të ri Kosovës edhe pse institucionet e BE, ende sot operojnë kryesisht konform një statusi neutral ndaj saj. Implementimi i paketës mbi të drejtat e njeriut, amendimet e ligjeve mbi mbrojtjen dhe forcimin e mbrojtjes e të drejtave të njeriut në periudhën 2012 dhe vazhdim i dhanë një shtysë tjetër të rëndësishme.

5.5. Përfundime

Në këtë kapitull u analizuan të drejtave të njeriut në Kosovë, duke u fokusuar në të drejtën e gruas dhe barazinë gjinore, të drejtat e komunitetit LGBTI dhe lirisë së shprehjes, nëpërmjet procesit të mbrojtjes nga lartë poshtë pra të institucioneve qeverisëse të saj. Kjo analizë u mbështet në tre burimet e legjitimitetit që përdoren në kuadër të promovimit e të drejtave të njeriut të BE – legjitimiteti si ligjshmëri, legjitimiteti procedural dhe legjitimiteti si njohje ndaj jot ë tjerëve. Në secilin rast u vu re një përputhmëri ndaj normave dhe vlerave europiane me në fokus të drejtat e njeriut dhe aftësia e institucioneve të Kosovës për të arritur standartet europiane.

Më konkretisht, nëpërmjet analizimit të kuadrin ligjor e të drejtave të njeriut në Kosovë, ndryshime e këtij kuadri në ligje të posaçme dhe më pas institucionet kushtetues dhe ato ligjzbatuese të cilat kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut u vu re se BE zbatonte një legjitimiteti në substancë. Pra kërkohej nga Kosova të arrihej afrimi me standartet europiane nëpërmjet një dimensionit të fortë konstitucional i cili sigurisht ishte i shprehur në kuadrin e mësipërm. Megjithatë mekanizmat implementuese të kësaj mbrojtjeje – kryesisht ndaj të drejtave të komunitetit LGBTI – nuk kishin efikasitet në terren ndaj vendit i nevojitej ndërmarrja e disa reformave të cilat kërkonin një ndërhyrje mbi procedurat që do të garantonin mbrojtjen.

Në këtë kuptim, vijnë tek burimi i dytë i legjitimitetit pra, ai procedural. Këtu analiza u përqëndrua të evidentonte ndikimin e procesit të reformave të ndërmarrja nga institucionet qeverisëse të Kosovës, në kuadër të mbrojtjes dhe forcimit e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Kështu nëpërmjet një prespektive që dominohet jo vetëm në baza ligjore apo relacionale, por dhe në atë të zhvillimit të efektshme që një zgjidhje kërkon praktikisht, pra procedurës. Me përdorimin e kushtëzimit politik dhe duke ofruar incentiva

financiare, Bashkimi Evropian kërkonte një përputhshmëri të standarteve të saj nëpërmjet një procesi reformash të thella në Kosovë. Ky proces u fokusua në tre të drejtat dhe liritë themelore e marra në shqyrtim dhe tregoi se vendi arrin të ketë përputhshmëri me kushtet politike dhe ndaj vetë standartet e saj.

Së fundmi, për të kuptuar efikasitetin e këtyre reformave dhe nivelin e përputhshmërisë me kërkesat e BE, u vlerësua raporti që ekziston midis asistencës tekniko-financiare dhe impaktit të forcimit të drejtat të njeriut në Kosovë. Duke praqitur në mënyrë grafike fondet vjetore IPA dhe vlerësimin e BE për secilën të drejtë të marrë për shqyrtim në këtë punim, u krahasua në kohë efektet që mund të kishte kjo marrëdhënie. Qasja që u zhvillua në këtë seksion vuri re se indikator i legjitimitetit të përdorur nga BE – legjitimiteti ndaj “të tjerëve” ka arritur të ndikonte në formësimin e një prespektive institucionalo-juridike mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Kjo analizë tregoi se institucionet e Kosovës pavarësisht se gëzojnë një kuadër të mjaftueshëm normativ - prej të cilit ka zhvilluar një sërë mekanizmash mbrojtjeje të drejtave të njeriut dhe lirive themelore – përvetësimi i tyre ndodh zakonisht *apriori*. Kështuqë institucionet ligjbërëse dhe ligjzbatuese ngelen të pafuqishme, duke u varur gjerësisht nga vullneti politik për të ndërmarrë reforma dhe kjo ndodh vetëm kur BE ushtron një incentivë shpërblyese – rasti i hapjes së negociatave për Marrëveshje e Tabilizim Asocimi ose miratimi i MSA – dhe kur BE ushtron një shtrëngim karshi palës që negocion, vonësat për arritjen e një marrëveshje të caktuar apo bllokimi i marrëveshjes së lëvizjes së lirë në zonën Schengen. Në këtë mënyrë edhe pse vendi arrin të ketë një implementim të mirë kuadrit ligjor normative që mbron të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, ai mbetet i pafuqishëm për të forcuar mbrojtjen e këtyre të drejtave.

KAPITULLI I GJASHTË

TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË NGA NJË PRESPEKTIVË E SHOQËRISË CIVILE: PROCESI I DREJTUAR NGA POSHTË- LARTË

6.1. Hyrja

Fuqizimi dhe anagzhimi i shoqërisë civile në procesin e shtet-ndërtimit dhe rrugëtimit të integritetit evropian të Kosovës mbetet e një rëndësie mjaft të madhe. Nëpërmjet saj qasja nga poshtë-lartë mbi promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore e fuqizon ndërgjegjësimin për veprim aktiv i këtij faktori mjaft të rëndësishëm në forcimin e një shoqërie demokratike dhe të konsoliduar. Pasi analizuam rolin e institucioneve qeverisëse dhe shtetërore të Kosovës nëpërmjet qasjes nga lartë-poshtë mbi promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të marra në shqyrtim nga kjo tezë doktorale dhe duke evidentuar modelin e veprimit që këto institucione kanë arritur në këtë drejtim, do të na duhet të shohim dhe nivelin e ‘përmbysur’ të kësaj analiza, pra nga poshtë lartë.

Kështu në këtë kapitull do të analizohet legjitimitimi i promovimit e të drejtave të njeriut të BE në kuadër të qasjes nga poshtë lartë duke u përqëndruar në tre burimet kryesore të legjitimitetit: legjitimiteti si ligjshmëri (substancial), legjitimiteti si procedurë dhe legjitimiteti ndonjë njohjes së jo evropianëve. Diskutimet e kuadrit ligjor që sot ekziston në kuadër të shoqërisë civile, rrjetin e organizatave jo qeveritare që llobojnë dhe advokojnë në mënyrë aktive në kuadër e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore, të drejtat e komunitetit LGBTI dhe të lirisë së shprehjes janë pikërisht evidencat empirike nëpërmjet së cilës BE mbështet legjitimitetin e saj.

Së dyti do të analizoj qasjen nga poshtë-lartë për secilën të drejtë dhe liri themelore të marrë në shqyrtim duke argumentur mbi aftësimin e përdorimit të legjitimitetit procedural. Ndërsa së treti qasjen e Bashkimit Evropian në këtë kuadër duke evidentuar në të dy seksionet e fundit iniciativat lobuese që kanë evidentuar ndryshim ligjesh rritje të ndërgjegjësimin qytetar dhe një përvojë më të madhe të bashkëpunimit shoqëri civile dhe institucione qeverisëse. Pra me fjalë të tjera aftësinë e BE për të formësuar standartet mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë nëpërmjet ushtrimit të legjitimitetit si njohje ndaj të tjerëve.

6.2. Kuadri ligjor, organizatat jo qeveritare dhe rëndësia e tyre në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë

Në Kosovë janë të regjistruara afro 8200 organizata të shoqërisë civile, nga të cilat 7744 janë lokale, pra me status të brendshëm të Kosovës dhe rreth 450 të tjera ndërkombëtare.⁹⁵ Pak më shumë se gjysma e këtyre organizata joqeveritare janë të angazhuara në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Kuadri ligjor i republikës së Kosovës për organizata joqeveritare i referohet së pari ligjit për Lirinë e Asocimit në Organizata JoQeveritare i vitit 2011, i cili pas më shumë se një dekade operimi i vrullshëm i shoqërisë civile në Kosovë rregullon themelimin, regjistrimin, udhëheqjen e brendshme, veprimtarinë, shuarjen dhe çregjistrimin e tyre si dhe marrëdhënien midis shtetit dhe vetë shoqërisë civile.⁹⁶ Ky ligj u miratua si paraprijë e paketës mbi të drejtat e njeriut dhe kishte qënë një kërkesë prej disa vitesh nga Bashkimi Evropian për miratim, pasi kërkohej një monitorim dhe menaxhim më i mirë i shoqërisë civile dhe marrëdhënies së tij me shtetin e Kosovës.

Institucioni shtetëror mbikqyrëse dhe monitoruese mbi funksionimin e organizatave joqeveritare të shoqërisë civile në Kosovë i është atashuar Ministrisë së Administrimit Publik dhe përkatësisht një prej departamenteve të saj – departamenti i OJQ-ve. Ky department administron politikat që lidhen me regjistrimin, raportimin financiar dhe bashkëpunimin me institucionet përkatëse dhe OJQ-ve. Ai funksionon mbi ndarjen institucionale si divizioni i regjistrimeve të OJQ-ve dhe ai i raportimit financiar.⁹⁷ Në këtë mënyrë qeveria e Kosovës në vitin 2014 miratoi një VKM të posaçme e cila do ti jepte më tepër kompetenca departamentit në fjalë dhe plotëson ligjin e vitit 2011. Ky udhëzimi administrativ kishte për funksion,

“regjistrimin dhe funksionimin e organizatave jo qeveritare i cili përcakton rregullat dhe procedurat e regjistrimit, përtiditësimin e të dhënave në Regjistrin

⁹⁵ Ministria e Administratës Publike nëpërmjet Departamentit për Regjistrimin dhe ndërmjetësimit me oragnizata joqeveritare, është niveli më i lartë i adimistratës shtetërore që merret me sektorin e shoqërisë civile në fushat e regjistrimit dhe kontrollit të tyre. Për më tepër shih Webfaqen e ministrisë në linkun që vijon: <https://map.rks.gov.net/Departments/DOJQ.aspx?lang=sq-AL> (Aksesuar më 15 Shtator 2015).

⁹⁶ Kuvendi i republikës së Kosovës, Ligji për Lirinë e Asocimit për Organizatat Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës (Prishtinë 29 Gusht 2011), Nr. 04/ L-057, hyri në fuqi më 13 Shtator 2011, neni 1, par.1, fq.1.

⁹⁷ Ministria e Administratës Publike, Departamenti për Organizatat e Jo Qeveritare
Për më tepër shih: www.map.rks.gov.net/Departments/DOJQ.aspx (Aksesuar më 25 Maj 2015)

Publik, shuarjes dhe ç’regjistrimin e OJQ konform ligjit për lirinë e asociimit në organizata jo qeveritare si dhe mënyrat se parashikohet mbështetja financiare nëpërmjet subvencioneve të programuar vjetore”⁹⁸.

Megjithatë një ndër shqetësimet kryesore të ngritura në porgres raportet e Komisionit Evropian ndër vite, qëndron varësia financiare thuajse e plotë e shoqërisë civile nga donatorë dhe organizata ndërkombëtare dhe mos angazhimi i qeverisë së Kosovës për tu bërë një mbështetës real i subvencioneve shtetërore ndaj tyre (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2014: 17).

Ndërkaq nga një vështrim i përgjithshëm në Regjistrin Publik të organizatave jo qeveritare të regjistruara në Kosovë vëmë re se të regjistruara në njësitë e ndërmjetme të monitorimit të subvencioneve shtetërore janë 280 organizata jo qeveritare të cilat përfitojnë pjesërisht mbështetje financiare në aktivitetet e tyre nga qeveria e Kosovës.⁹⁹ Disa prej këtyre organizatave kanë patur një bashkëpunim përveç aspektit financiar dhe kjo është një ndër elementet për tu përgëzuar në këtë drejtim. Megjithatë shoqëria civile mbetet me një ekspertizë të limituar në fusha përkatëse të veprimtarisë së tyre dhe ndaj transferimi i eksperiencës dhe ekspertizës ndërkombëtare nga OJQ ndërkombëtare në ato lokale, nëpërmjet partneritetit apo mbështetjes së drejtpërdrejt krijon një mundësi për rivitalizuar shoqërinë civile në Kosovë nga mbështetja financiare thuajse e plotë ndër vite nga donatorë ndërkombëtar.

Organizatave jo qeveritare dhe format e tjera të asociimit që janë marrë për studimin e kësaj teze doktrinale janë tre: për sa i përket të drejtave të gruas dhe barazisë është përzgjedhur Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës; të drejtave të komunitetit LGBTI është Qendra për Emancipim Shoqëror dhe për sa i përket lirisë së fjalës është BIRN – rrjeti i hetimit ballkanik. Të tri këto OJQ ofrojnë modelin e advokimit dhe lobimit të çështjeve të tyre specifike sipas qasjes nga poshtë-lartë, në mënyrë për ta kuptuar se si vepron procesi i mbrotjes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Në seksionin që vijon do të analizoj rolin e secilës organizatë ndaj të drejtave të njeriut në Kosovë duke na bërë të kuptojmë se pa qasjen nga lartë-poshtë nuk mund të ketë një proces të mirëfilltë mbi mbrotjen dhe forcimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në çdo shoqëri demokratike.

⁹⁸ Republika e Kosovës, Vendimi i Kryeministrit të Kosovës nr. 01/195 datës 03.09.2014.

⁹⁹ Për më tepër shih në webfaqen e ministrisë së administratës publike: <https://map.rks-gov.net/Home.aspx> (Aksesuar më 14 Maj 2015)

6.3. Iniciativat nga poshtë-lartë

Roli i shoqërisë civile në jetën e një shoqërie që rend drejt demokratizimit dhe konsolidimit të saj është mjet i rëndësishëm, ndaj dhe Kosova përbën një rast shumë të mirë për tu studiuar. Me eksperiencën e saj post-konfliktuale dhe procesin e shtet-ndërtimit i cili nisi që pas ngjarjeve të 1999, por në mënyrë më të veçantë pas shpalljes së pavarësisë në 2008, nëpërmjet ndërtimin të institucioneve të shëndosha demokratike, aftësisë për të patur një zbatim të mirë të ligjit territorialisht dhe strukturalisht. Por nga ana tjetër pranimi, mbrojtja dhe forcimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore i japin vlefshmërinë kësaj marrëdhënieje shumë-faktorëshe të mjedisit politik dhe social që po zhvillohet në Kosovë. Pavarësisht numrit tejet të madh të organizatave jo qeveritare të regjistruara, funksionale apo jo në Kosovë, problemet në lidhje me mënyrën e financimit apo atë rregullimit të marrëdhënieve midis nivelit shtetëror-qeverisës dhe atij të shoqërisë civile, secili rast që do të analizohet më poshtë përbën *par excellence* një model që tregon që është i aftë të superojë problematikat dhe mbase paragjykimet, duke dhënë rezultate të prekshme dhe me një rezonancë afat-gjatë.

6.3.1. Të drejta të garantuara - liri të mohuara: të drejtat e grave dhe barazia gjinore

Shumëkush sot, mund të shprehet se gratë në Kosovë janë të barabarta me burrat pasi kushtetuta u'a garanton këto të drejta të gjithë qytetarëve. Por nga ana tjetër disa progres raporte të Komisionit Evropian (2010, 2014), vedosin theksin mbi dhënien e vendime absurde nga gjykatat, të cilat ia pengojnë të drejtat e pronësisë, dhunim i tyre në familje, apo dhe trafikim si dhe mos njohje e të drejtave të tjera ekonomike apo sociale. Megjithatë realiteti në Kosovë është kompleks dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës përbën një ndër organizimet më funksionale të shoqërisë civile mbi të drejtat e gruas dhe barazisë gjinore në vend. Ky forum apo rrjet organizatash është i përbërë nga 88 OJQ, dhe ka nisur të funksionojë që në vitin 2000 me qëllim për të advokuar për të drejtat e grave në Kosovë në nivel lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar. Bazuar në strategjinë e tij të veprimit, aktiviteti i saj shtrihet në pesë fusha kryesore: ndërtim kapaciteti e organizatave e të drejtave të grave, rritja e përfshirjes së gruas në jetën politike dhe përfaqësimin e saj në

proçeset vendimarrëse, shëndeti i gruas, dhuna në familje dhe trafikime dhe fuqizimi ekonomik i gruas.

Përfshirja e RRGK në jetën politike dhe sociale në Kosovë nis që prej fundit të luftës kur roli i shoqërisë civile ishte thuajse inekzistent dhe ato pak organizata që vepronin kërkonin rritje të kapaciteteve të brendshme. Megjithatë sfidat për ‘gratë’ nisën që me ardhjen e të ashtuquajturëve ‘ndërkombëtarëve’ në Kosovë ku organizatat e grave kërkonin që gratë të kishin një rol në proçesin e tranzitimit post-konfliktual por për ndërkombëtarët Kosova shihej si një terren ‘patriarkal’ (Farnsworth 2011: 22). Hapat e parë të kësaj iniciative i gjejmë në advokimin për implementimin e rezolutës 1325, ku sipas Frod Mouring, ish-udhëheqës i UNDP,

“e gjithë administrata ndërkombëtare e udhëhequr nga OKB kishte për detyrë implementimin e rezolutës. Si bartës i përgjegjësi për Kosovën obligimi i OKB ishte të siguronte respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare por fatkeqsisht jo të gjithë e kuptonin këtë në të njëjtën mënyrë” (ibid 2011: 13).

Në të njëjtën mënyrë shton Edita Tahiri, “se pas luftës, ekzistonte tendenca e marginalizimit të grave në politikë, përkundër faktit se gratë në Kosovë ishin pjesë e proçesit të çlirimit, pavarësimit dhe ndërtimit të demokracisë” (ibid 2011: 67). Ndërkohë kalvari i gjatë i advokimit për rezolutën 1325 nuk u nda vetëm në periudhën e parë por ai vazhdoi dhe në proçesin për statusin e Kosovës. Kështu dhe në planin e Ahtisarit, rezoluta nuk përkonte me asnjë pikë por vetëm përmendej konventa e (CEDAW) si referencë. Në këtë mënyrë pas shpalljes së pavarësisë qajsa e RRGK u intensifikua dhe sot e gjejmë në arritjet e një sërë implementimesh ligjesh të cilat kanë ardhur si pasojë edhe e advokimit të saj. Megjithatë Nicole Farnsworth shprehet se “marrëdhënia qeveri-shoqëri civile mbetet pa një vazhdimësi por gjithnjë me koordinim *ad hoc*”.¹⁰⁰ Kë të fakt e pohon gjërësisht dhe progres raporti i fundit i komisionit Evropian ku vë theksin se “marrëdhënia ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë mbetet në angazhim rastësore ndaj dhe institucionet inkurajohen të ndërmarrin hapa për të ndërtuar një besim për të punuar sëbashku në vazhdimësi” (Komisioni Evropian ‘raport-progres’, 2014: 19).

¹⁰⁰ Intervistë me bashkë-drejtuesen e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Nicole Farnsworth, Prishtinë 12 Korrik 2015

Megjithatë ekzistojnë hapa pozitivë të arritjes së kësaj marrëdhënie, duke treguar rastin e projektit të “*UNSCR Initiative*”, i cili financohej nga UNDP krijoi bashkëpunimin midis Agjensisë për Barazi Gjinore dhe RRGK në 2008 për një hulumtimin mbi perceptimin e dhunës në familjes dhe për të vlerësuar reagimin e institucioneve në mbrojtjen e viktimave, ndjekejn e autorëve, dhe parandalimin e dhunës (UNDP Kosovo 2013: 21). Kjo strategji që ishte plotësisht e përputhshme me konferencën e Stambollit të 2005 të Këshillit të Evropës për dhunën në familje.¹⁰¹ Pas kryerjes së këtij hulumtimi, grupi i punës ka prezantuar një raport i cili është marrë në propozim më pas nga qeveria për tu inkorporuar në vetë ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje i vitit 2010.¹⁰² Ky ligj reflekton të gjithë rekomandimet e RRGK si dhe përmban rekomandimet shtesë që janë dhënë për mekanizmin implementues dhe monitorues, duke treguar në një farë mënyrë një arritje e mirë të bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile.¹⁰³ Ndërkaq sipas Nicole, ky bashkëpunim pritet të vazhdoj duke kryer një hulumtim të rradhës për të evidentuar çfarë ka sjellë ligji në fjalë dhe sa efikas ka qënë zbatimi i tij, duke evidentuar dobësitë e mundshme dhe për të parë përmirësimet që ku ligj ka sjell në rastet e dhunës në familje. Pra në një farë mënyrë RRGK është duke kërkuar një amendim të ligjit ekzistues nga çfarë pritet një advokim në vijim ndaj çështjes.

Ndërkaq nëse hedhim një vështrim në veprimtarinë e RRGK do të shohim se bashkëpunimi ka qënë i fokusuar dhe në vetë miratimin e Paketës Ligjore për të Drejtat e Njeriut, që për Nicole organizata e saj ka qënë iniciatorja. Këtu ajo ndalet në disa nisma të tjera të cilat lidhen dhe me ligjin e ri për Barazi Gjinore i miratuar sëfundmi në 2015, përfshirjen e CEDAW në kushtetutën e Kosovës, lobimi ndaj ligjit kundër diskriminimit dhe po ashtu amendimet të tij në 2015 por dhe ligjin e ri të Institucionit të Avokatit të Popullit.¹⁰⁴ Qasja e RRGK në punën advokuese të kuadrit ligjor në Kosovë mbetet për të forcuar mbrojtjen e grave dhe nga ana tjetër përfshirjen e prespektivës gjinore në çdo

¹⁰¹ Për më tepër shih në webfaqen e Këshillin e Europës, <http://www.coe.int/en/ëeb/istanbul-convention/home> (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

¹⁰² Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje Nr. 03/L-182 Prishtinë, 1 Korrik 2010) hyri në fuqi më 16 Korrik 2010.

¹⁰³ Intervistë me bashkë-drejtuesen e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Nicole Farnseöorth, Prishtinë 12 Korrik 2015

¹⁰⁴ ibid

inciativë apo ligj të ri duke rritur ndërgjegjësimin e elitave të procesit të vendim-marrjes për barazinë gjinore.

Duhet të përmendim dhe dy nismat prej të cilave RRGK ka bërë një punë advokuese mjaft të madhe por pa patur ndikim në procesin e vendim-marrjes dhe si për pasojë forcimin e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile kanë qënë të pakta në këto raste. Këtu bëhet fjalë për të drejtat e pronave dhe regjistrin kombëtar të dhunës në familje. Në raportin e fundit të Komisionit Evropian përmendet gjërësisht fakti se gjykatat në Kosovë nuk janë të afta ose veprojnë në mënyrë korruptive për ti mohuar të drejtat e pronësisë grave, duke krijuar një realitet absurd ndaj zbatimit të ligjit (Komisioni Evropian ‘raport-progres’, 2014: 24). Për Nicole çështja nuk mbetet aq e thjeshtë. Në një studim të ndërmarrë nga RRGK në bashkëpunim me USAID ‘Property Rights Programme’ është zhvilluar një hulumtim për të drejtat e pronësisë së gruas nga organizata koordinues ‘TETRATECH’.¹⁰⁵ Ajo tregon se ndaj kësaj çështje ekzistojnë tre faktorë frenues. Së pari ekziston një mendësi patriarkale gjërësisht e përhapur në opinionin publik, se gratë nuk duhet të kërkojnë të drejta pronësie ndaj familjes që ato vijnë, gjithashtu dhe në rastet kur kërkojnë prishje të kontratës martesore me bashkëshortin e tyre. Së dyti kjo mendësi shpesh-herë është reflektuar dhe në vendimet absurde të gjykatave të cilët ‘fshihen’ pas refuzimit që vetë palët e interesuara (gratë) bëjnë ndaj çështjeve në fjalë, duke u tërhequr nga kjo e drejtë. Së treti lidhet me aksesin e grave në punësim. Sipas disa hulumtimeve jo zyrtare të ndërmara nga shoqëria civile rreth 80 për qind e grave nuk janë të punësuar.¹⁰⁶ Në kuadrin e një regjistri kombëtar ndaj dhunës kundër grave në familje, siç u përmend dhe në kapitullin e kaluar nga qasja institucionale (lartë-poshtë), problematika mbetet në lidhje me çështje teknike. Aktualisht ekziston një bashkëpunim me donator si qeveria e Luksemburgut dhe koordinues në projekt RRGK, nëpërmjet së cilës po zhvillohej një përpjekje për të krijuar një *database* në gjykatë por problematika kryesore mbetet e njëjta, se kush do të ketë akses në këto *database* dhe kush do të zhvilloj raportimet. Në një këndvështrim të përgjithshëm sipas Nicole dhe Zana, pavarësisht se ka një kuadër ligjor i

¹⁰⁵ Për më tepër rreth këtij program shih në: www.tetrattech.com/en/projects/property-rights-program-kosovo (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

¹⁰⁶ Intervistë me bashkë-drejtuesen e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Nicole Farnsworth, Prishtinë 12 Korrik 2015

cili e ka rritur mbrotjen e të drejtave të grave dhe ka nisur të qasi prespektivën gjinore në nivel institucional në Kosovë, karakteri i këtyre ligjeve mbetet më tepër deklarativ, pa një mekanizëm të mirëfilltë raportim-implementim-përgjegjësie.

Ndërkaq ka shumë pak raste kur ka nisma nga lartë-poshtë për të bërë shqyrtimin e ligjeve ekzistuese në mënyrë që të evidentohen arritjet por më tepër për të parë mundësitë për ndryshim në përmirësimin e mbrotjes. Kështu duke marrë ligjin Antidiskriminim, nëse raportohet diskriminimi në baza gjinore, mekanizmi që duhet të veprojë nuk është i qartë si dhe nuk parashikon asnjë rezultat. Sipas tyre në përgjithësi Kosova ka një implementim të cunguar të ligjeve që miraton pasi shpesh mungon vullneti politik, nganjëherë mbetet çështje e mëndësisë, shpesh është çështje resursesh financiare dhe shpesh mungon prioriteti.¹⁰⁷

6.3.2 Të drejtat e komunitetit LGBTI në Kosovë nga një qasje poshtë-lartë

Të drejtat e komunitetit LGBTI, shihen si një ‘risi’ për disa¹⁰⁸, por për aktivistët e shoqërisë civile ata janë të drejtat më të marginalizuara të cilat do të duhet të garantohen dhe respektohen nga të gjithë.¹⁰⁹ Ndaj këtij fakti, referimi kryesor për gjendjen e të drejtave LGBTI në Kosovë e gjejmë nga progres raportet e komisionit Evropian ndër vite të cilat që në progres raportin e parë të vitit 2005, vendosin theksin në nevojën institucionale dhe opinionit të gjërë publik ti shohin të drejtat e komuniteteve më të marginalizuara si ai LGBTI si një nevojë për ti pranuar dhe garantuar të njëjtin trajtim që e gëzon çdo qytetar nga kushtetuta.¹¹⁰

Për të analizuar qasjen nga poshtë-lartë të drejtuar nga organizatat jo qeveritare të shoqërisë civile do ti referohemi aktivizmit të Qendrës për Emancipim Shoqëror

¹⁰⁷ ibid

¹⁰⁸ Intervistë me zyrtare e lartë për çështje gjinore në Ministrinë Punës dhe Mirëqënies Sociale, znj. Ferinaze Isufe Prishtinë 18 Korrik 2015

¹⁰⁹ Intervistë me aktivistin e të drejtave LGBTI, Liridon Velu Qendra për Emancipim Shoqëror, Prishtinë 11 Korrik 2015

¹¹⁰ Ndaj kësaj çështje mund ti referohemi në çdo progres raport prej vitit 2005 të Komisionit Evropian, ku ai i fundit i vitit 2014 kërkon një bashkëpunim më të madh ndërmjet institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile. Shih progres raportin e Komisioni Evropian për Kosovën 2014, (Bruksel, 8 Tetor 2014).

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

(Aksesuar më 10 June 2015)

(QESH)¹¹¹. Kjo organizatë e krijuar në vitin 2004, si një grup aktivistësh dhe më pas e regjistruar si një organizatë në vitin 2005, ka qënë një ndër advokueset dhe lobueset kryesore për të drejtat e komunitetit LGBTI në Kosovë, në nivel lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar. Qëllimi i saj është është angazhimi për një frymë të re të një shoqërie tolerante nga diversiteti dhe respekti ku të gjithë qytetarët pa dallime identiteti gjinor, orientimi seksual dhe shprehje gjinore të gëzojnë të drejta të barabarta, përgjegjësi dhe mundësi të barabartë në punësim dhe jetën shoqërore në komunitet.¹¹²

Advokimi i saj ka qënë në nivel institucional, në lobimin për ligjin Antidiskriminim të vitit 2004 ndaj institucioneve ndërkombëtare të UNMIK duke propozuar përfshirjen në diskriminim, në terma të orientimit seksual dhe duke paraqitur një mbështetje për mekanizmin implementues, që në fakt ky ligj nuk e kishte mjaft të qartë.¹¹³ Gjithashtu prej mëse tetë viteve ajo ka krijuar mundësinë e konsultave ligjore për të gjitha rastet e paraqitura nga individë për dhunë fizike apo shkelje të drejtave të komunitetit LGBTI të sanksionuara nga kuadri ligjor përkatës në Kosovë. Depozitimi i ankesave bëhet në mënyrë online ku më pas ato shqyrtohen dhe me miratimin e palëve të interesuar i referohen organeve kompetenteve.¹¹⁴ Por ekziston dhe një mënyrë tjetër nëpërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit i cili gëzon një ekspertizë më të detajuar në këtë drejtim.

Lidhur me këtë drejtim, aktivisti i QESH Liridon Velu shprehet se: “rastet e dhunës apo shkeljes së të drejtave të individëve të komunitetit LGBTI shpesh nuk vazhdojnë në organet e mëtejshme të hetimit por edhe kur arrijnë në prokurori ato thjeshtë nuk procedohen, mbeten aty”.¹¹⁵ Por nga ana tjetër vërehet gjithashtu një fakt se në shumicën e rasteve të dërguara në polici, rastet në fjalë mbeten si statistika për shkak se vetë palët e interesuar intimidohen për të vazhduar më tej procesin. Po ndërkohë gjatë vitit të fundit, 2014 janë ndërmarrë iniciativa të zhvilluara për të bërë trajnime në organet ligj-zbatuese si

¹¹¹ Aktivizmi i subjekteve apo individëve për të mbrojtur dhe promovuar minoritet si LGBTI në Kosovë janë kryesisht të pakët dhe të rezervuar karshi studimeve të ndryshme. Në këtë kontekst përzgjedhja e kësaj organizate për këtë studim është bërë në kushtet e mundësisë së vetme të disponueshme.

¹¹² Për më tepër shih në webfaqen e QESH: www.qeshkosova.org/rrethnesh/ (Aksesuar më 12 Qershor 2015)

¹¹³ Për më tepër shih në seksionin 6.2 dhe 6.3.2 të kapitullit të gjashtë.

¹¹⁴ Për më tepër shih në webfaqen e QESH ku ankesat bëhen të ndara sipas dy gjuhëve zyrtare të Kosovës duke i ndarë gjithashtu në raportues si palë e dhunuar ose palë dëshmitare: www.qeshkosova.org/raporto/ (Aksesuar më 12 Qershor 2015)

¹¹⁵ Intervistë me aktivistin e të drejtave LGBTI, Liridon Velu Qendra për Emancipim Shoqëror, Prishtinë 11 Korrik 2015

me punonjës të policisë së Kosovës, me prokurorë, gjykatës dhe grupe avokatësh.¹¹⁶ Këto trajnime janë ndërmarrë në kuadër të bashkëpunimit të ri që ka nisur tashmë të implementohet në kuadër të strategjisë kombëtare dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës 2013-2017 të miratuar në Gusht të 2013.¹¹⁷

Iniciativat e mëtejshme në kuadër të lobimit përfshijnë inkorporimin në kushtetutën e republikës së Kosovës të vitit 2008, barazinë para ligjit pavarësisht gjinisë, gjuhës [...] dhe orientimin seksual.¹¹⁸ Duke vazhduar me përfshirjen e orientimit seksual dhe identitetit gjinor në ligjin e ri anti-Diskriminim, i cili u arrit të amendohej pas një procesi lobimi dy vjeçar me suport dhe të vetë Bashkimit Evropian. Plan i Veprimi 1-vjeçar kundër Homofobisë me Zyrën për Qeverisje të Mirë (2015-2016) në Këshillin Anti-Diskriminim është lobuar për përfshirjen e identitetit gjinor dhe orientimit seksual dhe në kuadret e tjera ligjore që nuk kanë një implementim të drejtpërdrejt me komunitetin LGBTI, por për faktin se tashmë të drejtat LGBTI po konsiderohen si të drejta të njeriut, kjo prespektivë e re ashtu si ajo gjinore duhet të integrohet (Këshilli i Bashkimit Evropian, 2014). Gjithashtu QESH ka marrë pjesë në grupet e punës së komisioneve parlamentare për përfshirjen e identitetit gjinor në ligjin mbi trafikimin njerëzor, dhe vetë ligjin anti-diskriminim. Poashtu, nëpërmjet rekomandime të bëra në kuadër të mekanizmave implementuese për vetë ligjin në fjalë.

6.3.3 Liria e shprehjes në Kosovë nëpërmjet një prespektive nga poshtë-lartë

Liria e shprehjes është një e drejtë e sanksionuar dhe e garantuar që në preambulën e kushtetutës së Kosovës,¹¹⁹ por sidoqoftë ajo mbetet një ndër sfidat për çdo shoqëri që drejtohet drejt një rendi të ri demokratik në procesin e shtet-ndërtimit dhe ndërtimin e institucioneve demokratike. Kështu për të kuptuar gjëndjen e lirisë së shprehjes në Kosovë ky studim ka marrë në analizë gjëndjen e mediave dhe rolin e gazetarisë nga një prespektivë e shoqërisë civile. Oranizata e përzgjedhur në këtë drejtim është BIRN (përkth.

¹¹⁶ Për më tepër shih në faqen e ëebfaqen të QESH: www.qeshkosova.org/aktivitetet/trajnime-me-punonjes-te-institucioneve-ligjzbatuese/ (Aksesuar më 12 Qershor 2015)

¹¹⁷ Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, “Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2013-2017”. Prishtinë, Gusht 2013.

¹¹⁸ Shih Kushtetuta e republikës së Kosovës 2008.

¹¹⁹ Ibid, Neni 40, fq.12.

Rrjeti i Raportimit Investigativ të Ballkanit) e cila është një grupim gazetarësh profesionist me qëllim për të promovuar momentum ndaj procesit të tranzicionit demokratik, duke promovuar llogaridhënien nga niveli qëndror e lokal ndaj opinionit publik zbatimit të ligjit dhe për më tepër forcimin e reformave në kuadër të lirisë së shprehjes në Kosovë.¹²⁰

Duke marrë shkas nga raportet e organizatave ndërkombëtare si Freedom Watch apo Amnesty International por dhe progres raporteve të Komisionit Evropian mbi gjendjen e lirisë së shprehjes në Kosovë (Komisioni Evropian ‘raport-progresi’, 2014: 16; Freedom Watch Report 2014: 471; Amnesty International Report 2014: 321; EU Human Rights Report – World 2014: 143), Mehmet Hajrullahu pohon se nga viti në vit gjendja ka filluar të përkeqësohet por dhe mënyra e kërcënimeve ka qënë e ndryshme.

“Ndonëse kërcënimet verbale mund të jenë ulur nga statistika zyrtare, problemi ngelet tek kërcënimi institucional, por dhe ai që vjen nga klane apo biznese. Kështu ka ndryshuar edhe mënyra e kërcënimeve duke mënjeluar atë verbal dhe fizik në ato të tipit shantazhuese dhe intimiduese”.¹²¹

Sipas Mehmetit, ky intimidim ka ndikuar keq dhe në profesionalizmin e gazetarëve pasi pas marrjes së këtij “frikësimi” ato nuk e kanë marrë më atë guxim për të bërë një punë më të mirë investiguese me tema të caktuara dhe kryesore. Kjo mund të shihet si një problematikë me tre faktorë ndikues, që për Mehmetin është dukshëm e pranishëm në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, “mënyra se si shoqëria e sheh çështjen e lirisë së shprehjes, se si e sheh punën e profesionit të gazetarisë por dhe një faktor i tretë mbetet mënyra e financimeve të vetë medave”.¹²²

Ndaj këtij fakti *BIRN Kosovo* ka qënë aktive në lobimin në kuadër të ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave të vitit 2011 si amendim i ligjit ekzistues të vitit 2005 që rregullonte autoritetin e lartë të mediave audiovizive dhe radiove të Kosovës, pra Komisionin e Pavarur të Mediave. Sipas nenit 6, atij i garantohej pavarësi e plotë nga politika dhe qeveria, duke iu siguruar një buxhet vjetor që miratohej nga parlamenti i Kosovës.¹²³ Sipas Hajrullahu, lobimi ndaj këtij ligji është bërë për të sanksionuar

¹²⁰ Për më tepër shih faqen e webit të BIRN Kosovo: www.birn.eu.com/en/network/birn-kosovo-about (Aksesuar më 13 Qershor 2015)

¹²¹ Intervistë me Muhamet Hajrullahu, editor pranë BIRN, Prishtinë 19 Korrik 2015

¹²² ibid

¹²³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, (Prishtinë 2 Mars 2012), Nr. 04/ L-044, hyri në fuqi 17 Mars 2012, neni 6, fq. 6.

shprehimisht pavarësinë e plotë nga politika dhe qeveria dhe së dyti, që të shërbejë si një arbitër në mosmarrëveshjet e ndryshme ndërmjet palëve të interesuar. Por pavarësisht faktit se këshilli nuk ka një ndërhyrje direkte nga politika, ajo ushtron një legjitimitet indirekt në përzgjedhjen e kandidatëve dhe votimin që i bëhet në parlament, ndaj nevojiten mekanizma të reja të cilat ta largojnë plotësisht dhe përzgjedhjen e të gjithë antarëve të këtij këshilli në mënyrë që të bëhet ndarja e plotë dhe mos të lihet vend për keqinterpretime.

Ndërkohë nëpërmjet nismave të brendshme si emisioni “*Jeta në Kosovë*”, i cili nisi nga një projekt i Bashkimit Evropian për një periudhë një vjeçare ai vazhdon të jetë një forum i mirënjohur mediatik në promovimin e lirisë së shprehjes në Kosovë, duke u zgjeruar nëpërmjet një emisioni më specifik në kuadër të zbatueshmërisë së ligjit me emisionin “*Drejtësia në Kosovë*”. Nga ana tjetër një ndër iniciativat më të rëndësishme mbetet web-faqja raportuese (*kallzo.com*)¹²⁴, ku qytetarët mund të raportojnë lirshëm dhe në këtë mënyrë të gjenin një dritare për të ushtruar lirinë e shprehjes duke nisur që nga problemet bazike të përditshme e deri tek rastet e korrupsionit, prokurimet publike, etj.

Projekt i Monitorimit të Gjykatave është një projekt që ka filluar tanimë dhe ka për synim të zhvillojë një monitorim të çdo seancave gjyqësore në komunat e ndryshme të Kosovës duke përfshirë gazetarët lokalë dhe monitorimin e shërbimeve publike ku përfshihen shëndëtesia, arsimi, dhe institucionet publike lokale.¹²⁵

6.4. Roli i BE në forcimin e angazhimit të shoqërisë civile në Kosovë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut

Iniciativa nga Bashkimi Evropian që përfshijnë rritjen e angazhimit të shoqërisë civile në Kosovë nuk kanë qënë të shumta në numër por megjithatë ato përbëjnë një strategji të ndërhyrjes së BE në Kosovë ndaj këtij drejtimi. Shpesh nëpërmjet deklaratave mbështetëse dhe shpesh nëpërmjet bashkëfinancimeve Bashkimi Evropian ka treguar se është një partner i sigurtë në mbrojtjen dhe zgjerimin e të drejtave të njeriut dhe lirive

¹²⁴ Intervistë me Muhamet Hajrullahu, editor pranë BIRN, Prishtinë 19 Korrik 2015

¹²⁵ Për më tepër shih në webfaqen e BIRN Kosovë. http://www.drejtësiakosove.com/repository/docs/Bim_Monitorimi_i_gjykatave2222_327124.pdf

themelore. Kështu nëse do të vështrojmë qasjen e tij në Kosovë do të përzgjedhim disa nga projektet e realizuar apo ato në proces.

Në kuadër të të drejtave të gruas dhe barazisë gjinore, RRGK ka qënë i përfshirë në projektin “*Sector Planning Document*”, i cili vinte si një iniciativë e BE në kuadër të procesit të integritimit të Kosovës në aftësimin e institucioneve për të aplikuar në fondet IPA I dhe IPA II. RRGK kishte një rol trajnuesi dhe monitoruesi me zyrtarë të institucioneve, ku kryesisht bëhej fjalë për ministrinë, të cilat nëpërmjet përpilimit të strategjive sektoriale afat-shkurtra apo afat-mesme do të duhej të integronin një prespektivë gjinore dhe më tej të ishin të aftë për të konkuruar në fondet IPA. Ndonëse ky proces tashmë ka nisur dhe është në vazhdimësi, një problematikë që vihet re nga RRGK por dhe nga çdokush është mungesa e aksesit të dokumentacionit të këtyre strategjive. Sipas Nicole, “qytetarët nuk mund të kenë akses dhe ajo çka është më e rëndësishme njohja e popullatës me konceptimin e prespektivës për barazi gjinore nuk është i arritshëm”.¹²⁶

Projekti ose bashkëpunimi ndër vitet me interpretimin e një prespektive gjinore në progres raportet vjetore të Komisionit Evropian. Ndonëse bëhen rekomandime të ndryshme dhe në fund të procesit përpilohet një raport, evidentimi i problematikave të qasura dhe të interpretuara nga një prespektivë gjinore nuk reflektohet nga progres raportet e viteve në vazhdim apo nga ndonjë deklaratë e përfaqësisë në Kosovë. Në këtë mënyrë për Nicole,

“ndonëse BE kërkon që institucionet qeverisëse të Kosovës ta implementojnë plotësisht rezolutën 1325 dhe atë 1820 si dhe të rrisin prespektivën gjinore në politik-bërje por dhe në inkuadrim shoqëror, kur ajo përballet me nevojë për tu qasur nga prespektiva gjinore bën një hap pas. Pra mund të themi se në këtë kuptim ekziton parimi i dy standarteve”.¹²⁷

Ndërkohë bashkëpunimi BE dhe organizata të shoqërisë civile me në fokus të drejtat e komunitetit LGBTI në Kosovë, si QESH ka patur disa përparësi më të mira për të integruar më tej këto të drejta në kuadrin ligjor të Kosovës. Kështu është krijimi i një tradite komunikimi nëpërmjet takimeve informale por dhe takimeve formale të zyrtarëve të përfaqësisë së Bashkimit Evropian në Kosovë por mbi të gjitha dhe të zyrtarëve të lartë të

¹²⁶ Intervistë me bashkë-drejtuesen e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Nicole Farnsworth, Prishtinë 12 Korrik 2015

¹²⁷ ibid.

institucioneve të BE. Një shembull pozitiv për këtë rast është me përfaqësuesen e dialogut parlamentar PE-Kosovë Ulrike Lunacek në vitin 2012,¹²⁸ për përfshirjen e orientim seksual dhe identitet gjinor në ligjin e amenduar kundër Diskriminimit të vitit 2014. Shqetësimet dhe rëndësia e kësaj qasje u ngritën dhe në raportin e *Feasibility Study* që Komisioni Evropian ndërmoi në 2012 për Kosovën për hapjen e negociatave për Proçesin e Stabilizimi Asocimit. Kështu në këtë raport-studim, theksohej se nevoja e mbrojtjes së komunitetit LGBTI në Kosovë nëpërmjet amendimit të ligjit Anti-Diskriminim është në përputhje me angazhimet e Kosovës për proçesin e integritit në BE, duke nënkuptuar qartësisht se ky lobim pati efikasitet të shprehej në kusht për Kosovën (Komisioni Evropian ‘raport-progres’, 2012: 21).

Gjithashtu, zbatimi i programeve të binjakëzimit kanë qënë një ndër strategjitë më të suksesshme që ka ndërmarrë BE ndaj vendeve potencial (kandidate). Në këtë mënyrë ka funksionuar dhe projekti – *Twining Program* përgjatë vitit 2014, kundër homofobisë i zhvilluar në bashkëpunim me QESH nëpërmjet zyrës së Qeverisjes së Mirë, duke lançuar trajnime me aktivistë të tjerë të shoqërisë civile, student, profesionistë të fushave të ndryshme si të gazetarisë etj. Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik për të drejtat e komunitetit LGBTI si një strategji veprimi të theksuar dhe në progres-raportet e Komisionit Evropian është ndërmarrë nga një iniciativë bashkëvepruese midis zyrës së BE dhe aktivistëve të QESH në dhënien e leksioneve të hapura prej më shumë se 6 viteshe në institucionet e arsimit universitar publik në Kosovë.¹²⁹

Projekti i ashtuquajtur “*Media for All*” fokusohet në bashkëpunimin midis BIRN si një ndër organizatat kryesore të shoqërisë civile që promovon lirinë e shprehjes në Kosovë dhe Bashkimit Evropian.¹³⁰ Ky projekt i cili ka nisur që nga viti 2014 dhe është në vazhdimësi konsiston në rritjen e kapaciteteve të gazetarisë profesionale hulumtuese dhe intestiguese në nivel lokal, ku BIRN ka një rol mentorimi dhe trajnimi për të ndihmuar grupe gazetarësh dhe raportuesisht në komunat e ndryshme të Kosovës, ku niveli i

¹²⁸ Intervistë me aktivistin e të drejtave LGBTI, Liridon Velu Qendra për Emancipim Shoqëror, Prishtinë 11 Korrik 2015

¹²⁹ Intervistë me Fjolla Çeku, përgjegjëse për Shtypin dhe Informimin Publik pranë Zyrës së BE në Kosovë, Prishtinë, 25 Korrik 2015.

¹³⁰ Për më tepër shih faqen në webfaqen e BIRN Kosovë: www.birn.eu.com/en/netëork/birn-kosovo-about (Aksesuar më 22 Korrik 2015)

gazetarisë dhe ai i kredibilitetit i lajmit është jo mjaft profesional, kjo e lidhur ngushtë dhe me skarsitetin e burimeve financiare që media në Kosovë përballet sot.¹³¹ Kështu BIRN do të jetë dritarja e këtyre raportimeve të gazetarisë ë do të zhvillohet gjatë këtij projekti.

Ndërkohë monitorimi i gjykatave lokale në komunat e ndryshme të Kosovës mbetet një iniciativë e bashkëfinancuar nga një ndër instrumentat financiare të Komisionit Evropian – IEDDNJ (Këshilli i BE, Raport Vjetor 2015: 143). Një iniciativë e tretë do të mund ta gjejmë në partneritetin e krijuar midis BE dhe BIRN Kosovë për krijimin e programit “Jeta në Kosovë”, i cili nisi të shfaqej që prej vitit 2006 për një periudhë dy vjeçare, por që mbetet ende sot mjaft i ndjekur. Qëllimi ishte ngritja e debatit publik për diskutimin e çështjeve të ndryshme në Kosovë, si ato që lidhen dhe me tema disi “tabu” komuniteti LGBTI dhe të drejtat e tij, që në medium të tjera do të ishin të pamundura të diskutoheshin.¹³²

Ndërkohë, mbështetja e BE në lidhje me organizatat e shoqërisë civile mbeti dhe vazhdon të jetë tepër e ulët, në krahasim me mbështetjes ndaj nivelit të institucioneve të Kosovës. Sipas vendimit të Komision Evropian të 2011, mbi një Dokument Planifikimi Indikativ Shumë-vjeçar (DPISH) 2011-2013 për Kosovën, vetëm 2 deri në 5 % e buxhetit të përgjithshëm të programit IPA përgjatë tre viteve (Komisioni Evropian, Vendim, 2011: 20). Kjo tregon se BE mbetet pa një strategji të mirëfilltë ndaj asistencës së shoqërisë civile mbi mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të njeriut, Gjithashtu kontributi i përgjithshëm në të tre të drejtat e marra përgjatë këtij studimi treguan se ka patur vetëm disa raste kur BE ka ushtruar një rol aktiv nëpërmjet pjesmarrjes së shoqërisë civile edhe pse duhet të theksohet niveli pozitiv i bashkëpunimit shoqëri civile – institucione shtetërore.¹³³

Megjithatë asistenca e re IPA II thekson mbi rëndësinë që duhet të marrë përfshirja e shoqërisë civile dhe në asistencën e saj të përgjithshëm vjetore – në ato fusha dhe çështje ku parashikon të aplikohet – shpalos se për katër vitet e para të ndërhyrjes 2014-2017 parashikohen të jepen 67 milion euro për shoqërinë civile në fokus liritë themelore dhe të

¹³¹ Intervistë me Muhamet Hajrullahu, editor pranë BIRN, Prishtinë 19 Korrik 2015

¹³² ibid

¹³³ Në lidhje me ndërtimin e besimit dhe bashkëpunimit midis qasjes nga lart-poshtë dhe poshtë-lart të Komisionit Evropian, përgjatë secilit progres-raport. Për lexime shih progres-raportin e fundit të 2014 për Kosovën: Komisioni Evropian, Progres Raporti Kosovë, Bruksel 8 Tetotor 2014: 22)

drejtat e njeriut (Komisioni Evropian, ‘Strategjia 2014-2020’, 2014: 37). Gjithashtu vë theksin dhe mbi rolin e përfshirjes së mundshme të aktorëve të shoqërisë civile në të gjitha aspektet dhe aktivitetet që financohen nga BE, kryesisht ato në lidhje me shtetin e së drejtës, shërbimi public, çështje legislative dhe programe mbështetjeje socio-ekonomike në mënyrë për të mbështetur organizatat e shoqërisë civile për të forcuar kapacitetet dhe profesionilizmin e tyre, duke i lejuar të ndërveprojnë në një dialog efektiv me aktorë të tjerë si public ashtu dhe privatë dhe të monitorojnë zhvillimet në liritë themelore (Komisioni Evropian, “IPA II”, 2014: 8-10).

6.5. Përfundime

Promovimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore mbeten një ndër sfidat aktuale për çdo shoqëri në proceset demokratike dhe ato shtet-ndërtuese që rendin njëkohësisht pas një procesi integrimi ndaj disa strukturave komplekse supranacionale dhe ndërqeveritare si BE. Kosova paraqet një ndër rastet më të mira për tu marrë në konsideratë për hulumtim në këtë drejtim. Qasja nga poshtë-lartë na tregon për emancipimin dhe rëndësinë që sheh komuniteti në drejtim të këtyre sfidave.

Kështu, sektori i shoqërisë civile në Kosovë tregon se ka një numër jashtëzakonisht të madh organizatash joqeveritare të regjistruara, çka përkon me një dukuri thuajse normale po ta krahasojmë me vende fqinje si Bosnja dhe Hercegovina, por funksionueshmëria praktike e tyre mbetet e dyshimtë. Ndërkohë ky nuk është i vetmi këndvështrim i shoqërisë civile. Thuajse të gjitha OJF varen nga iniciativa dhe donacione të huaja dhe nga ndonjëherë pa një program të mirëfilltë veprimtarie. Kësisoj sfidohet roli i tyre për të ndërvepruar të pavarura në vetë shoqërinë.

Në këtë kuptim përpos problematikave që evidentoi kjo analizë e këtij seksioni duhet të përmendet fakti se promovimi i të drejtave të njeriut të BE ndaj Kosovës në nivel të shoqërisë civile legjitimohet nëpërmjet legjitimitetit si substancë. Kosova arrin të ketë një përputhshmëri me standartet thellësisht konsitucionale, duke lejuar aplikimin e praktikave më të mira që rregullojnë aktivitetin e shoqërisë civile. Megjithatë ky indikator

tregon se efektshmëria ndaj standartizimit të normave dhe vlerave Europiane është i pamjaftueshëm të arrihet për shkak të aftësisë së pavarur që ajo ka.

Megjithë këto problematika dhe sfida që përballen sot kjo shoqëri civile, përgjatë kësaj analize treguan se kanë arritur të korrin një sërë suksesesh në pjesën më të madhe të iniciativave që kanë ndërmarrë ndaj mbrojtjes dhe rritjes së ndërgjegjësimit e të drejtave të njeriut në Kosovë. Nëpërmjet aktiviteteve nga më të ndryshme, bazuar kryesisht në strategji advokimi, kanë arritur të kenë një rol të rëndësishëm në amendimin e një sërë ligjesh mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me mekanizmat e implementimit. Gjithashtu ndërveprimi me institucionet e Kosovës, më së shumti gjatë dy viteve të fundit, ku dhe procesi i reformave qeverisëse ishte në vazhdimësi, e rriti kredibilitetin e tyre si karshi komunitetit të brendshëm ashtu dhe partnerëve ndërkombëtar, të tillë si BE.

Pikërisht këto strategji veprimi dhe rritje të aksesueshmërisë në proceset vendimarrëse tregojnë se qasja nga poshtë-lartë ka arritur të ketë një përputhshmëri karshi promovimit e të drejtave të njeriut të BE. Legjitimiteti që ushtron këtë promovim pra ai procedurial arrin të suportoje procesin e reformave dhe impenjon aktorët e shoqërisë civile të jenë kontribues më aktiv në rritjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

Në këtë drejtim BE ndërveproi në një sërë rastesh me organizata të shoqërisë civile në mënyrë që të forconte kapacitetet e tyre, asistim financiar të projekteve të tyre por në anën tjetër, nuk përfshiu si aktor në partneritetin për proceset vendimarrëse dhe ato implementuese. Megjithatë në situata të ndryshme, ajo ngurroi të bashkëpunonte me aftësitë e tyre, të tilla si në rastin e prespektivës gjinore në progres-raportet e Komisionit European, ku për vite me rradhë nuk implementoi asnjë prej rekomandimeve nga OJF respektive nga e cila iu kërkua t'ia mundësonte. Gjithashtu, përsa i përket asistencës financiare përgjatë IPA I (2007-2013), kontribuoi në më pak se 2% të *portfolios* së saj qindra milionëshe për aktivitetet e shoqërisë civile. Në këtë drejtim legjitimimi i politikës së promovimit e të drejtave të njeriut të BE nëpërmjet qasjes nga poshtë-lartë në kuadër të përdorimit të legjitimitetit si njohje ndaj jo evropianëve ishte i pjesshëm. Ndonëse BE u përpoq të afronte standartet evropiane dhe të formësonte një qasje veprimit të aktorëve të shoqërisë civile pikërisht sipas një modeli evropian, ajo nuk arriti ti përgjigjej vetë

kërkesave të saj në disa raste të caktuara. Në këtë kuptim përdorimi i legjitimitetit si njohje ndaj jo evropianëve në kuadër të shoqërisë civile nuk ishte i suksesshëm.

Pavarësisht kësaj, kapitull arriti të parashtronte një analizë me njohuri e diskutime mbi rolin e BE në përfshirjen e shoqërisë civile të Kosovës në kuadër të mbrojtjes e të drejtave të njeriut. Ky rol ka një aplikueshmëri mjaft të rëndësishëm pavarësisht mënyrës apo intensitetit që kërkohet të përdoret dhe nëpërmjet së cilës kërkohet të kuptohet legjitimiteti i politikës europiane mbi promovimin e të drejtve të njeriut.

KAPITULLI I SHTATË

PËRFUNDIMET

7.1. Hyrje

Ky studim doktoral kërkoi të hulumtojë mbi suksesin e mundshëm të promovimit e të drejtave të njeriut të Bashkimi Evropian - si një fuqi normative - në Kosovë në raport me ushtrimin e legjitimitetit të saj duke u bazuar në nivelin e institucioneve shtetërore, dhe duke e krahasuar në nivelin e angazhimit të shoqërisë civile.

Teza kryesor mbi të cilën u ndërtua struktura konceptuale dhe argumentuese e këtij studimi për t'iu përgjigjur pyetjes kërkimore ngrihet mbi premisën se: ***BE si një strukturë e ndërtuar mbi bazën e vlerave dhe normave të demokracisë, sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, e sheh angazhimin në arenën ndërkombëtare dhe në veçanti drejt vendeve me të ardhme në antarësim, si arritje e standardeve të caktuara në mënyrë që të vazhdohet me hapin e mëtejshëm të procesit të integrimit.***

Promovimi i të drejtave të njeriut të BE në Kosovës arrin të legjitimohet pjesërisht si në nivel institucionesh qeverisëse ashtu dhe angazhimin e shoqërisë civile.

Kështu në nivel të institucioneve qeverisëse, legjitimimi i promovimit të BE në kuadër të shpërndarjes së normave mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të jetë sipërfaqësore pasi reformat lidhur me to do të jenë të varura nga përlllogaritja e kosto-përfitimeve.

Ndërsa në nivel të angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile, legjitimimi i promovimit të BE në kuadër të arritjes së standarteve do të jetë i suksesshëm pasi BE shihet si një forcë e mirë.

Në këtë drejtim kjo temë u përqëndrua të zhvillonte një teorizim të promovimit e të drejtave të njeriut nga konceptimi i fuqisë normative të BE, pra të një modeli ndërveprimi në marrëdhëniet ndërkombëtare të fokusuar në analizë të politikës së jashtme. Nga një vështrim i përgjithshëm i literaturës të përqëndruar ndaj BE si fuqi normative në raport me ushtrimin e legjitimitetit të saj, u vu re se ekziston një mungesë të studimeve sasiore dhe cilësore në këtë drejtim, ndonëse mund të themi se vitet e fundit ka patur një shtim të tyre. Por nga ana tjetër studimet që marrin në rast studimor Kosovën përqëndrohen pak ose shumë pak në analizimin e rolit të BE në proceset e integrimit në raport me ushtrimin e legjitimitetit të saj në nivel të përputhshmërisë së institucioneve shtetërore dhe në nivel të

përfshirjes/angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile. Në këtë mënyrë kjo tezë doktrale solli një risi në studimin kësaj marrëdhënie midis BE dhe Kosovës si në aspektin teorik ashtu dhe atë praktik. Përfundimet do të përmbledhin gjetjet kryesore të rrafshit teorik dhe atij empirike, duke diskutuar vlerën dhe zbatimin e kuadrit analitik të sugjeruar përgjatë studimit, do të nxjerrë konkluzione më të thelluara në lidhje me promovimin e të drejtave të njeriut të Bashkimit Evropian në kuadër të procesit të zgjerimit ndaj një vendi me të ardhme në të, dhe duke argumentuar mbi nevojën e thellimit dhe zgjerimit mbi hulumtime të mëtejshme.

7.2. Përfundime teorike dhe empirike

Kështu ky punim doktoral u strukturua në pesë kapituj teorik dhe empirik së bashku, ku dy kapitujt e parë, përkatësisht kapitulli i dytë dhe i tretë zhvilluan një argumentim dhe analizë të konceptualizimit teorik, modelit analitik dhe zhvillimit historik e promovimit e të drejtave të njeriut të fuqisë normative të BE në raport me ushtrimin e legjitimitetit të saj. Kapitulli i dytë nisi me një prezantim të përgjithshëm të konceptualizimit e të drejtave të njeriut në debatet teorike e të kuptuarit politike ku u vu re se të drejtat e njeriut nuk mund të formësohen dhe gëzohen vetëm prej faktit të njerëzores sonë por ato krijohen dhe arrihen nga ndërveprimi i individëve në një komunitet të caktuar.

Kështu duke e zgjeruar mendimin mbi të drejtat e njeriut përtej kufijve të një komunitetit të caktuar shoqëror-politik gjejmë se të drejtat e njeriut ndonëse “premtohen” se kanë një aplikueshmëri universale, modeli i mbrojtjes dhe promovimit të tyre mbetet në dorë të vetë konstruktit politiko-social të komuniteteve. Ndaj modeli i Bashkimi Evropian përbën një shembull mjaft të mirë kozmopolit mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Kjo pasi BE paraqet një model të brendshëm politiko-hibrid me nivele të ndërthurura supranacionale dhe ndërqeveritare dhe nga ana tjetër të paturit e një të drejtë publike demokratike, të bazuar në norma dhe vlera të përbashkëta midis vendeve antare si të drejtat e njeriut, demokracia dhe shteti i së drejtës dhe nga ku ushtron një aplikueshmëri si së brendshmi ashtu dhe së jashtëmi.

Ky model konstruktohet mbi fuqinë normative të saj dhe nga ku ushtron legjitimitet ndaj vendeve të treta për të arritur të përmbushë qëllimet e saj. Në këtë drejtim legjitimiteti duhet të jetë një pjesë e rëndësishme për të hulumtuar çdo studim që kërkon të shpjegojë veprimin e jashtëm të fuqisë normative të BE dhe përkatësisht të promovimit e të drejtave të njeriut. Kësisoj ushtrimi i legjitimitetit të saj ndërkombëtar do të mund të analizohej nëpërmjet mënyrës përshkruese ose asaj përcaktuese, përgjatë kapitullit të tretë. Mënyrat përshkruese për studimin e legjitimitetit janë të rëndësishme për shkak se ata janë të bazuara në idenë e përshtatshmërisë së procedurave, ndërsa mënyra përcaktuese, përshkruan atë që duhet bërë ose se si mund të bëhet diçka më mirë.

Fuqia normative e Bashkimit European zbuloi tre burime legjitimiteti në kuadër të promovimit e të drejtave të njeriut në Kosovë. Së pari si një standart legjitimitetit procedural, i cili e bazonte fokusin në rëndësinë që merrnin politikat e saj nëpërmjet pjesmarrjes dhe efektshmërisë. Së dyti nga legjitimiteti substancial, ku normat dhe vlerat e BE të promovuara nëpërmjet politikave mbështetëse kërkonin të konsolidonin dhe promovonin paqe, stabilitet dhe shtet ligjor. Dhe së treti legjitimitetit si njohje nga ‘të tjerët’ ku nëpërmjet një ndërhyrje në sovranitetin e vendit në fjalë, kërkohej të përafrohej me normat dhe standartet e evropiane. BE shihet si një fuqi e “së mirës” ku kërkon të përhap/eksportoje normat dhe vlerat e saj ndaj një vendi të tretë dhe nga ku formon një marrëdhënie asimetrike fuqie.

Kështu gjithë ky kapitull u përpoq të theksoj se legjitimiteti përbën një rol të rëndësishëm në aplikimin e analizës së fuqisë normative dhe më specifikisht promovimin e të drejtave të njeriut. Një studim i legjitimitetit në analizën e fuqisë normative të BE na ndihmon të kuptojmë se të qënurit ‘normativ’ dhe ‘formësimit të koncepteve të normales’ nuk janë thelbësisht pjesë të BE. Ndërkaq fuqia normative e saj është konstruktuar në një mënyrë të zgjatur në kohë dhe hapësirë dhe normat e saj reflektojnë mbi strukturën e fuqisë së komuniteteve politike perëndimore. Ndaj është e rëndësishme të studiohet fuqia normative si një fuqi në kontekst. Ky model i ushtrimit të legjitimitetit të fuqisë normative të BE në kuadër të promovimit e të drejtave të njeriut në Kosovë u studiua në kapitujt empirik, por në vazhdim të kapitullit të tretë, kapitulli i mëpasshëm eksploroj themelet e politikës së promovimit e të drejtave të njeriut të BE.

Kësisoj në kapitullin e tretë, të drejtat e njeriut të Bashkimit Evropian u analizuan në kuadër të analizës së fuqisë normativ të BE. Kapitulli ndoqi trajektoren e politikës nga ndërtimi i saj i brendshëm ligjor (traktatet, *acquis communautaire*, institucionet) në aktivitetet të jashtme të BE (politika e përbashkët e sigurisë dhe e jashtme, shërbimi i veprimt të jashtëm evropian, politika e kushtëzimit, procesi i zgjerimit dhe marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare me shtetet e tjera). Këtu u argumentua se BE si një aktor normativ që në konceptimin e saj të hershëm, ka zhvilluar një proces zgjerimi (antarësimi me vende të reja) dhe në të njëjtën kohë një proces thellimi (në të drejtën evropiane apo *acquis communautaire*). Të drejtat e njeriut janë zhvilluar në të njëjtën linjë me këto procese politike dhe ekonomike nga ku ato janë kodifikuar së brendëshmi në standarte të përbashkëta dhe sanksionojnë ndërveprimin e brendshëm midis vendeve antare dhe atë të jashtëm të BE me vende të treta.

Duke patur këtë kuadër teorik, konceptual dhe model analitik mbi promovimin e të drejtave të njeriut të BE si një aktor me fuqi normative në raport me ushtrimin e legjitimitetit të saj, punimi doktoral u drejtua për të elaboruar rastin e Kosovës përgjatë tre kapitujve empirik. Kështu në kapitullin e katërt u studiuu gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë nga një prespektivë e Bashkimit Evropian, e parë nga legjitimiteti institucional, pra e politikave që zhvillon BE në Kosovë, zyra e përfaqësisë special të Bashkimit Evropian, zyra e ndërmjetësimit të Komisionit Evropian që tashmë janë në një kornizë zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe EULEX me në fokus të drejtat e njeriut. Së dyti qasja e tre të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si liria e shprehjes, të drejtat e grave dhe barazia gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGBTI, u analizuan nën vlerësimin e progres raporteve nga vitit 2008 deri në 2014 duke shtuar evidencat empirike me të dhëna nga indekse të organizatave ndërkombëtare apo opinione të aktivistëve dhe sepcialistëve të organizatave jo qeveritare në Kosovë.

Kështu u argumentua se politikat që zhvillon BE në Kosovë, nëpërmjet përfaqësimit institucional, Zyra Përfaqësimit Special të BE shihet se ka ushtruar një legjitimitet substancial, pasi normat dhe vlerat e BE i promovon nëpërmjet politikave mbështetëse për të konsoliduar dhe promovuar paqe, stabilitet dhe shtet ligjor. Ky rol normativ është thelbësisht substancial pasi është në mbështetje me zhvillimin efektiv të Politikës së

Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë (PBMS), dhe për të ndihmuar BE të jetë aktiv, koherent dhe një aktor i aftë të përballoj sfidat e reja në skenën globale. Ndërkaq, zyra e ndërmjetme e Komisionit Evropian ushtron një legjitimitet procedural, pasi legjitimiteti i promovimit e të drejtave të njeriut varet jo vetëm në baza ligjore apo relacionale, por dhe në atë të zhvillimit të efektshme që një zgjidhje kërkon praktikisht. Kështu duke përdorur kushtëzimin politik, duke ofruar incentiva financiare, ajo kërkon të arrijë një legjitimitet të politikave të saj duke e shtyrë Kosovën të përfitoj prej tyre vetëm nëse ajo arrin të ketë përputhshmëri me kushtet politike dhe standartet e saj. Së fundmi, nëpërmjet zyrës së EULEX mbi të drejtat e njeriut, ajo ushtron një legjitimitet të ndryshëm nga dy të parat, pra legjitimitetin si një njohje ndaj jo-evropianëve – “të tjerët”. Ky fakt argumentohet se BE nëpërmjet mandatit të EULEX i sheh institucionet e Kosovës mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut si thelbësisht jo-evropiane, ku kërkohet një ndërhyrje për tu përafëruar me normat dhe standartet e evropianëve dhe kështu zbaton më tepër një marrëdhënie fuqie. Normat e saj duhet të zbatohen pasi legjitimiteti nëpërmjet procedurës dhe substancës i jep asaj karakterin e ‘fuqisë së mirë’ dhe kur vendet jo antare të BE - në rastin tonë Kosova - perceptojnë normat e fuqisë si të pranueshme për miratimi dhe sjelljen sipas standarteve të legjitimitetit të tyre.

Rezultati i kësaj analize përgjatë këtij kapitulli të parë empirik ndihmoi jo vetëm për të kuptuar mënyrën se si BE ushtron legjitimitetin e saj në Kosovë, por dhe për ta testuar këtë legjitimitet që do të duhet të përdorej në ndërtimin e një analizë të mbështetur në dy nivel. Së pari e parë nga roli i institucioneve qeverisëse, ligjbërëse dhe ligjzbatuese dhe së dyti nga roli i aktorëve të shoqërisë civile në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Këtu u përdoren tre indikatorët për të vlerësuar legjitimitimin e promovimit të BE. Së pari, u përdor indikator i përputhshmërisë së kuadrit ligjor, që në kontekstin e legjitimitetit ai shihet si ligjshmëri ose të qënurit substancial. Pra aftësia juridiko-institucionale e Kosovës për të patur një përputhshmëri kuadrit juridik të BE mbi mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të njeriut. Në analizën e nivelit të shoqërisë civile do të jetë përputhshmëria e kuadrit ligjor përkatës për të fuqizuar rolin e kësaj të fundit në pjesëmarrjen

Së dyti, indikator i aftësisë për të ndërmarrë dhe miratuar politikën e nevojshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë që janë në koherencë me standartet e BE. Këtu

u ndala në shtjellimin e pikëpamjes procedurale që merr procesi i politikave transformuese, të cilat janë në kuadrin e negociatave BE-Kosovë për MSA. Në këtë drejtim, legjitimimi i promovimit të drejtave të njeriut të BE merr një karakter thelbësisht procedural. Ndërsa në analizën e nivelit të organizatave të shoqërisë civile ai u analizua nga aftësia e tyre për të influencuar në proceset e shqyrtimit të politikave dhe iniciativat e pavarura për këto politika që forcojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Analiza përgjatë dy nivele – lartë-poshtë dhe poshtë-lartë – u përqëndrua në të tre të drejtat dhe liritë themelore të marra në shqyrtim në këtë tezë doktrinale: të drejtat e grave dhe barzia gjinore, të drejtat e komunitetit LGBTI dhe lirinë e shprehjes.

Së treti, indikator i që vlerëson nivelin e implementimit të normave dhe vlerave të standarteve të BE mbi të drejtat e njeriut në Kosovë nëpër dy nivelet e analizës. Ky indikator vlerësoi legjitimitetin e promovimit të të drejtave të njeriut të BE nga aftësia e kësaj të fundit për të “ndryshuar” apo formësuar standartet e normales përkundrejt vendeve “jo-evropiane”. Në nivelin e institucioneve qeverisëse, u analizua legjitimiteti i promovimit në kuadër të mbështetjes finaciare dhe infrastrukturore nga fondet IPA I dhe II, instrumentit european për demokraci dhe të drejta të njeriut dhe mbështetjeve të tjera *ad hoc*. Ndërsa në nivelin e aktorëve të shoqërisë civile, legjitimiteti i promovimit u analizua në kuadër të mbështetjes politike dhe financiare të BE ndaj shoqërisë civile, duke u ndalur në fondet IPA I dhe II, instrumentit european për demokraci dhe të drejta të njeriut. Gjithashtu u analizua raporti i ndërsjelltë midis institucioneve qeverisëse dhe këtyre aktorëve sociale në rritjen e bashkëpunimit të ndërsjelltë dhe gjithpërfshirjen përgjatë proceseve vendimarrëse që influencojnë në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë në kuadër të procesit të integritetit.

Kësisoj në kapitullin e pestë u argumentua se Kosova në kohë ka patur një miratim mjaft të mirë të kuadrit ligjor në nivel kushtetues dhe ligjeve zbatuese mbi të drejtat e njeriut, por u vu re se në periudhën para shpalljes së pavarësisë së 2008, ky kuadër ligjesh kishte thjeshtë një karakter përshkrues duke mos përcaktuar mekanizma implementimi për një mbrojtje efikase. Nëpërmjet kushtëzimit politik të BE dhe propozimeve që vinin nga shoqëria civile, pra një “presion” i përbashkët së jashtëmi dhe së brendshmi, ndonëse asimetrik midis tyre, përgjatë periudhës 2012-2014 Kosova nis një miratim dhe amendim të

një sërë ligjesh duke zgjeruar kuadrin implementues dhe përcaktuar një mbrojtje më të madhe.

Në këtë mënyrë mund të themi se ushtrimi i legjitimitetit të BE mbi promovimin e të drejtave të njeriut ka qënë kryesisht efektiv pasi në kuadrin e kushtëzimit politik ka qënë pozitiv, vendi ka arritur të nisë procesin e stabilizim asocimit në 2013, çka përkthehet me një përputhshmëri të kushteve të BE por nga ana tjetër BE nuk ka arritur të tërheqi një vëmendje me asistencën financiare. Kështu mund të themi se institucionet e Kosovës pavarësisht se gëzojnë një kuadër të mjaftueshëm normativ nga i cili kanë krijuar disa mekanizma të marra *apriori* nga eksperiencia e ligjeve themelore të vendeve të tjera evropiane mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, institucionet qeverisëse të Kosovës mbetin peng e një vullneti politik të cunguar, i cili vepron në mënyrë *ad hoc* dhe ngushtësisht i varur nga përllogaritja e kosto-përfitimeve, duke ndërmarrë reforma vetëm kur “në tavolinë e negociatave” është një incentivë e madhe. Ndonëse vendi arrin të ketë një implementim të mirë normativ të kuadrit ligjor që mbron të drejtat e njeriut dhe lirive themelore, ai nuk është në gjendje ta forcojë mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Por për të kuptuar përfshirjen dhe forcimin e rolit të aktorëve të tjerë të brendshëm pra shoqërisë civile në Kosovë u nevojiti të zhvillohej një analizë në këtë nivel, nga ku argumentua se qasja nga poshtë-lartë, tregon për emancipimin dhe rëndësinë që shihet komuniteti në drejtim të këtyre sfidave. Shoqëria civile në Kosovë, me të metat që rendin nga numri i lartë i organizatave jo funksionale, thuhet të jetë tërësisht e varura nga nisma dhe donatorë të huaj dhe shpesh pa strategji të mirëfillta veprimi, të cilat u evidentuan gjatë kësaj analize të mësipërme, tregoi nga ana tjetër se mund të arrijë disa suksese të cilat ndryshojnë së pari politikën, proceset e vendim-marrjes, por mbi të gjitha emancipimin e shoqërisë për ti parë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore si të secilit dhe ndaj të gjithëve.

Promovimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore mbeten një ndër sfidat aktuale për çdo shoqëri në proceset demokratike dhe ato shtet-ndërtuese që rendin njëkohësisht pas një procesi integrimi ndaj disa strukturave komplekse supranacionale dhe ndërqeveritare si BE. Megjithatë, angazhimi i aktorëve të shoqërisë civile, e legjitimon promovimin e të drejtave të njeriut të BE dhe kështu ai është i suksesshëm pasi BE shihet si një forcë e mirë.

Por nga ana tjetër mund të themi se Bashkimi Evropian vepron me dy standarte në raport me shoqërinë civile në Kosovë. Kështu nga njëra anë ajo ushtron një nivel kushtëzimi përkundrejt institucioneve të Kosovës që të kenë një bashkëpunim më të thelluar me aktorët e brendshëm të shoqërisë civile, por nga ana tjetër ajo nuk paraqet asnjë strategji konkrete veprimi me këta aktorë dhe mbështetja me instrumenta financiare është thuajse e limituar në krahasim me mbështetjen që jepet ndaj aktorëve institucional të brendshëm.

Duke parë këtë model të veprimit strategjik të BE në Kosovë në kuadër të promovimit e të drejtave të njeriut do të mund të nxjerrim disa përfundime konçize mbi studimin e ndërrmarë gjatë këtij punimi doktoral:

Së pari – Bashkimi Evropian paraqet modelin më të përshtashëm dhe më efikas në mbrotjen, zgjerimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar.

Së dyti – Studimi i saj nga koncepti i fuqisë normative dhe ushtrimit të legjitimitetit, tregon mënyrën se si ta kuptojmë këtë promovim dhe në të njëjtën kohë krijon hapësira për të menduar se në çfarë mënyrë mund të përmirësohet ky promovim. Kështu nëpërmjet analizës së fuqisë normative mund të kuptojmë aftësinë e BE të formësojë politikbërjen ndërkombëtare në përputhje me ‘standartin e legjitimitetit’ të saj të zhvilluar së brendshmi, me fjalë të tjera të paturit e një mënyrë qeverisjeje liberale të bazuar në të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

Së treti – Bashkimi Evropian përdor një model legjitimiteti proçedural, substancial dhe ‘të tjerëve’ në kuadër të promovimit e të drejtave të njeriut në Kosovë duke ushtruar kushtëzim politik në nivel institucionesh shtetërore (ligjbërëse dhe ligjzbatuese) dhe kështu e afron proçesin e integritetit të saj politik por dhe të standarteve.

Së katërti – Por nga ana tjetër fuqia normative e BE duhet të trajtohet si një çështje e veçantë nga të pranuarit e vendeve të saj partnere, të cilët mund ose jo të ndajnë të njëjtin përcaktim në lidhje me ‘normalen’.

Së pesti – Fuqia normative e BE *vis-à-vis* të ‘tjerëve’, perceptohet nga këto të fundit si një magnet. Duke e marrë të mirëqënë faktin e asimetrisë në marrëdhëniet e fuqisë midis BE dhe vendeve të treta që gëzojnë një të ardhme integrimi në të - pra shtete kandidate ose

potencial kandidate, Bashkimi Evropian shihet si normë-krijues, ndërsa vendet e treta si ‘normë-marrëse’.

Së gjashti – Kështu ky studim vërejtë se Kosova paraqet një rast të qartë asimetrie në marrëdhënie me BE dhe e sheh këtë të fundit si magnet.

Së shtati – Kështu në nivel të institucioneve qeverisëse, legjitimimi i promovimit të BE në kuadër të shpërndarjes së normave mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të jetë i relativisht i suksesshëm, ndonëse ai mbetet i varur ngushtësisht nga vullneti politik i mbështetur në metodën e përlogaritjeve kosto-përfitime.

Së teti – Institucionet e Kosovës veprojnë në mënyrë *ad hoc* dhe *apriori* në kuadër të zgjerimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut me mekanizmat implementues, duke bërë që procesi i reformave të thellohet vetëm kur ushtron një presion kushtëzohesh për miratim ose kur ofron një incentivë të madhe.

Së nënti – Ndërsa në nivel të angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile, legjitimimi i promovimit të BE në kuadër të arritjes së standarteve do të jetë i suksesshëm pasi BE shihet si një forcë e mirë.

Së fundmi – aktorët e shoqërisë civile i qasen mbrojtjes së të drejtave të njeriut në nivel nga poshtë-lartë duke kërkuar gjithnjë e më shumë pjesë në proceset vendimarrëse në Kosovë. Roli i tyre mbetet në dorë të pranimi të tyre nga ana e elitave qeverisëse dhe nga mbështetja politike dhe financiare e aktorëve ndërkombëtar si BE.

Pra duke riformuluar argumentin kryesor të paraqitur si përgjigje e pyetjes kryesore të ngritur për këtë studim: Sa i suksesshëm është promovimi i të drejtave të njeriut të Bashkimi Evropian – si një fuqi normative – në Kosovë në raport me ushtrimin e legjitimitetit të saj në nivel institucionesh shtetërore dhe në nivel të angazhimit të shoqërisë civile? – do të kemi këtë riformulim: BE si një aktor normativ ndërkombëtar promovon vlera dhe norma të demokracisë, sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut ndaj vendeve të treta. Megjithatë, suksesi i saj varet ngushtësisht me legjitimin e kësaj politike në aktorët e brendshëm lokalë. Kështu promovimi i të drejtave të njeriut të BE në Kosovës arrin të legjitimohet pjesërisht si në nivel institucionesh qeverisëse ashtu dhe angazhimin e shoqërisë civile, pavarësisht rolit të saj influencojë në proceset shet-formuese të vendit.

Në nivel të institucioneve qeverisëse, legjitimimi i promovimit të BE në kuadër të shpërndarjes së normave mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të jetë pjesërisht i suksesshëm pasi reformat lidhur me to do të jenë të varura nga përllogaritja e kosto-përfitimeve.

Ndërsa në nivel të angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile, legjitimimi i promovimit të BE në kuadër të arritjes së standarteve do të jetë i suksesshëm pasi BE shihet si një forcë e mirë.

Ky rezultat lidhet ngushtësisht me qasjen që BE vepron në rastin e Kosovës, e cila shihet si një qasje *apriori* dhe me dy standarte në promovimin e reformave ligjore të cilat përmirësojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vend. Në rastin e parë ajo kushtëzon aktorët e elitave qeverisëse të kenë bashkëpunim në të gjitha proceset me aktorët e shoqërisë civile dhe në rastin e dytë ajo ushtron një mbështetje të pjesshme në mënyrë që të rrisë angazhimin e tyre në terma të mbështetjes financiare dhe aftësisë politike. Megjithatë Kosova mbetet një model i suksesshëm i angazhimit të BE në politikën e saj të promovimit e të drejtave të njeriut gjatë procesit të zgjerimit.

7.3. Rekomandime

Në përmbledhje të këtyre përfundimeve na nevojitet të adresojmë disa rekomandime ndaj aktorëve kryesorë të procesit të jashtëm – Bashkimit Evropian – dhe aktorëve të brendshëm – institucionet qeverisëse të Kosovës. Kështu këto rekomandime i drejtohen, Komisionit Evropian, Parlamentit Evropian, Qeverisë së Kosovës, Zyrës për Qeverisje të Mirë, Parlamentit të Kosovës dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.

- Për Komisionin Evropian

Komisioni do të duhet të përforcojë strategjitë e saj të veprimit në kuadër të promovimit të normave dhe vlerave të përbashkëta të unionit – të drejtat e njeriut – duke ushtruar më shumë trysni institucioneve qeverisëse në implementimin e kërkesë-rekomandime për çështje specifike. Për të arritur një implementim gjithëpërfshirës dhe efikas në promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, Komisioni, do të duhet të inkurajojë më tepër përfshirjen e

aktorëve të shoqërisë civile në këto proçese duke i mundësuar më shumë incentiva financiare dhe mbështetje politike.

- Për Parlamentin Evropian

Parlamenti do të duhet të vazhdojë të ushtrojë tryzni ndaj institucioneve të Kosovës, nëpërmjet strukturave të saj si grupi ndërparlamentar BE-Kosovë dhe në këshillimet e posaçme mbi të drejtat e njeriut. Gjithashtu politika e të drejtave të njeriut do të duhet të forcohet në kuadër të promovimit të jashtëm duke inkuadruar jo vetëm njësi të përkohshme por dhe struktura në plan afat-gjatë.

- Për Qeverinë e Kosovës

Qeveria e Kosovës do të duhet të tregojë një vullnet më të madh në implementimin e mekanizmave institucionale të cilat lejojnë një mbrojtje dhe forcim të drejtë të lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara nga kushtetuta e vendit. Ajo do të duhet të rrisë bashkëpunimin me aktorët e shoqërisë civile nëpërmjet ngritjes së strukturave të posaçme nën shembullin e zyrës së qeverisjes së mirë dhe për të drejtat e komunitetit LGBTI të shoqëruar me plane veprime dhe strategji afat shkurtër dhe afat-mesëm. Gjithashtu strukturat ekzistuese do të duhet të rritin kapacitetet e burimeve njerëzore dhe fushëveprimet.

- Për Parlamentin e Kosovës

Parlamenti do të duhet të ushtrojë të gjithë rolin e saj në mbrojtjen e forcimit e të drejtave të njeriut në Kosovë për të gjithë qytetarët e saj, duke u mbështetur në nevojat e tyre. Ai do të duhet të iniciojë miratimin e një kuadri ligjor të posaçëm me në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, nëpërmjet një strategjie shtetërore afat-mesëm dhe afat-gjatë dhe plane veprimi afat-shkurtër. Gjithashtu do të duhet ti mundësojë institucioneve dhe agjensive shtetërore që varen prej tij, me në fokus mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Kosovës, më shumë autonomi financiare dhe më pak ndërhyrje të politikës.

- Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM)

ZQM do të duhet të forcojë bashkëpunimin me aktorët e shoqërisë civile, duke adresuar problematikat e tyre, rekomandimet dhe të impenjohet më shumë në gjetjen e zgjedhjeve. Gjithashtu është e rëndësishme rritja e bashkëpunimit me agjenci dhe institucione të tjera që varen nga pushteti ligjvënës dhe ai qeverisës.

- Institucioni i Avokatit të Popullit

Si një ndër institucionet kushtetuese të Kosovës, IAP do të duhet të të ushtrojë të plotë veprimtarinë e tij në funksion të mbrojtjes dhe forcimit e të drejtave të njeriut në Kosovë. Ai do të duhet të rritë kapacitetet njerzore, financiare dhe të jetë ndër aktorët kryesorë në implementimin e strategjisë shtetërore mbi të drejtat e njeriut në Kosovë.

- Shoqëria Civile

Aktorët e ndryshëm të shoqërisë civile të përfaqësuar në grupe civile, interesi apo organizata joqeveritare do të duhet të forcojnë bashkëpunimin mbi mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të qytetarëve të Kosovës. Do të duhet të rritin kapacitetet e tyre njerzore dhe të rritin vetë-financimin e brendshëm duke u larguar sadopak nga trysnia e donaconeve të huaja. Nga ana tjetër do të duhet të ushtrojnë gjithnjë e më shumë trysni qytetare me mjete demokratike institucioneve qeverisëse, ligjvënëse dhe sistemit të gjyqësorit për garantimin e të drejtave dhe lirive për të gjithë qytetarët e vendit.

7.4. Drejt një konceptimi të ndryshëm të promovimit e të drejtave të njeriut të BE kundrejt Kosovës

Qëllimi kryesor që udhëhoqi këtë tezë ishte të përcaktonte se si duhet të kuptohej legjitimiteti i Bashkimit Evropian në kuadër të promovimit të drejtave të njeriut dhe cilat janë sfidat kryesore që ai përballlet në aplikimin e saj në Kosovë. Rezultatet e paraqitura mësipër paraqesin tre përmbledhje të gjera empirike. Së pari, na duhet të njohim se promovimi i të drejtave të njeriut të BE përgjatë procesit të Zgjerimit nuk paraqitet gjithnjë si një ‘mundësi e artë’ për vetë BE. Ndaj na nevojitet të kemi një këndvështrim më të hollësishëm të vizionit të nënkuptuar politik dhe ekonomik brenda kuadrit të gjerë moral të promovimit e të drejtave të njeriut të Bashkimit Evropian. Retorika e politikës së BE tenton të theksojë nevojat njerëzore dhe i përfaqëson ato si vlerat parësore në rolin e saj si një aktor që promovon paqe dhe stabilitet në arenën ndërkombëtare. Kështu pavarësisht se politik-bërësit europian e vendosin theksin mbi aplikimin e një ‘kushtëzimi rigoroz’ dhe duke e vendosur promovimin e të drejtave të njeriut në qendër të veprimit të jashtëm të BE, nëpërmjet studimit të kësaj teze u njohëm me problemet reale që ky projektim Evropian

përballet sot dhe në rastin e Kosovës gjithashtu. Përveç të qënurit një katalizator për të gjeneruar *momentum* për ndryshime legjislative në rastin e Kosovës, BE i largohet zgjidhjes së problemeve që lindin si pasojë e disa aspekteve historike, politike, ekonomike apo sociale në vend.

Përfundimi i dytë lidhet me literaturën e ndryshme mbi marrëdhëniet BE-Kosovë. Pavarësisht kontributit gjithnjë në rritje, shumë botime fokusohen mbi raportin e fuqisë – asimetrike në këtë rast – pa i atribuar evidenca teorike dhe empirike siç mund të ishte njohja e burimeve të legjitimitetit. Pikërisht qasja e legjitimitetit e marrë për këtë studim ofron një këndvështrim më të përgjithshëm dhe më të përshtatshëm për të kuptuar dinamikat e marrëdhënies BE-Kosovë në fushën e të drejtave të njeriut, dhe zbulon se si praktikrat dhe principet e BE mund të jenë të nevojshme për ta çuar përpara procesin e reformave në kuadër të mbrotjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

Ndërkaq një përfundim i tretë nga studimi i kësaj teze, se promovimi i të drejtave të njeriut në procesin e zgjerimit nuk ka patur në vëmendje të konsiderueshëm në literaturën mbi fuqinë normative të BE edhe pse ato mbeten një ndër fushat kryesore të modelit të demokracisë dhe qeverisjes liberale që promovohet sot në arenën ndërkombëtare. Kështu siç u argumentua dhe në kapitujt e parë të këtij studimi në lidhje me literaturën që trajton procesin e zgjerimit dhe atë të kushtëzimit të BE, u vu re se të aplikuarit e fuqisë normative të BE në kuadër të legjitimitetit ka qënë mjaft e vogël. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se politika e zgjerimit e BE është konsideruar si politika e jashtme më e suksesshme normë promovuese, duke i shtyrë kërkimet të fokusohen më tepër në promovimin e të drejtave të njeriut dhe demokracisë në marrëdhëniet e jashtme me vende të treta.

Nga paraqitja e këtyre përfundimeve teorike, empirike dhe konceptuale ky studim u përpoq të paraqiste një hulumtim specifik mbi rolin e Bashkimit Evropian në promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë duke e analizuar nga fuqia normative dhe ushtrimi i legjitimitetit. Por nga ana tjetër hapësirat për studime të mëtejshme nuk mungojnë ndaj na duhet të propozojmë disa prej tyre. Kështu një studim i ri mund të hulumtojë promovimin e të drejtave të njeriut të BE duke e marrë nga konceptimi i ‘standartit të civilizimit’, ndryshe nga ai i propozuar përgjatë studimit tonë, standarti i legjitimitetit. Në këtë mënyrë do të mund të eksplorohej se si ndikon promovimi i të drejtave të njeriut ndaj një dialogu

asimetrik përdorimi strategjik të normave të cilat mund të harmonizohen me idetë e të ashtuquajturit 'proçes civilizues' të BE.

Në këtë drejtim ky konceptim nuk është i panjohur për literaturën e gjërë të analizës së politikës së jashtme ku studime të ngjashme i trajtojnë organizatat ndërkombëtare apo shtetet si promovues të proçeseve civilizuese ndaj rajoneve të ndryshme ose ndaj shteteve specifike. Në këtë mënyrë ky model hulumtimi ndihmon për të kuptuar ndryshimet e gjera që mund të ekzistojnë nga promovuesi i normave dhe marrësi i tyre, duke përfshirë variabla të tjera shpjeguese si faktorë social, kulturor apo historik.

Nëpërmjet kësaj prespektivë do të mund të kemi studime të cilat do të përpiqen të arrijnë një kuptueshmëri më të qartë të lidhjes midis civilizimit – kulturave dhe vlerave që formësojnë një shoqëri të caktuar - dhe të drejtave të njeriut në kontekstin e politikës promovuese së të drejtave të njeriut të Bashkimit Evropian. Kjo lloj qasjeje e propozuar, jep një kuptim më të gjerë mbi të kuptuarit moral dhe politik e të drejtave të njeriut midis normave të brendshme dhe standarteve ndërkombëtare e të drejtave të njeriut.

Së dyti, ekziston një lëm i gjërë studimesh të cilat mund të aplikohen se si promovimi i të drejtave të njeriut në proçesin e zgjerimit mund të ketë një ndikim analitik dhe empirik ndaj mbrojtës së brendshme e të drejtave të njeriut të BE. Duke patur parasysh që debati së brendshmi dhe së jashtëmi ka dominuar prej gati dy dekada si politik-bërësit ashtu dhe studiesit, në lidhje me përmirësimin e të drejtave themelore dhe qytetarinë aktive, ajo nuk është limituar vetëm në aspektin e brendshme por është zgjeruar dhe ndaj rolit ndërkombëtar të BE si promovues e të drejtave të njeriut dhe qeverisjes së mirë. Për këtë arsye, politikat e zgjerimit kanë qënë shumë pak koherente më këto debate pasi ato kryesisht janë fokusuar në faktorë politik dhe ekonomik. Në këtë mënyrë kërkime më të thelluara mund të drejtohen në vlerësimin se si ndikojnë politikat e zgjerimit dhe mënyra e tyre e aplikimit në mbrojtjen më të qëndrueshme e të drejtave të njeriut në një Bashkim Evropian më të zgjeruar. Hulumtime të tilla mund sfidojnë mënyrën se si BE vlerëson veprimin e saj afat-shkurtër në mbështetjen e të drejtave të njeriut - përgjatë një proçesi të caktuar marrëdhënie, MSA, liberalizim vizash, partneritet tregëtar/ekonomik, etj., - përgjatë proçesit të zgjerimit përkundrejt qëllimeve afat-gjata të integritit dhe rolit të saj mëpasshëm.

Secili nga këto propozime hulumtimesh më të thelluara duke u bazuar në studimin e paraqitur përgjatë kësaj teze doktorale, do të lejojnë një kuptim më të qartë të BE si një aktor ndërkombëtar i promovimit e të drejtave të njeriut në një rend botëror gjithnjë e më të globalizuar. Këto këndvështrime do të nxisin në njohuri të mëtejshme si në teori ashtu dhe në praktikë të përdorimit e kushtëzimit politik në të drejtat e njeriut në kushtet e ushtrimit të legjitimitetit dhe në lidhje me plotësueshmërisë midis kriterëve të jashtme e të drejtave të njeriut dhe praktikave të brendshme të promovimit.

Bibliografia

Libra

- Barnard, Chatherine. "The Substantive Law of the EU: the Four Freedoms" (Oxford: Oxford University Press, 2007)
- Bartels, Lorand. "Human Rights Conditionality in the EU's International Agreements" (Oxford: Oxford University Press, 2005)
- Beetham, David. "The Legitimation of Power" (Basingstoke: Macmillan, 1991)
- Beetham, David. "Parliament and Democracy in the Twenty-First Century: a Guide to Good Practice" (Geneva: Inter-Parliamentary Union, 2006)
http://www.ipu.org/PDF/publications/democracy_en.pdf (aksesuar më 20 Nëntor 2014)
- Beetham, David and Lord, Christopher. "Legitimacy and the European Union" (Harlow: Longman, 1998)
- Beitz, Richard. "The idea of Human Rights" (Oxford: Oxford University Press 2009)
- Béné, Christophe and Neiland, Arthur. "From Participation to Governance: a Critical Review of the Concepts of Governance, Co-management and Participation" (Penang: Penang Publications, 2006)
- Birmingham, David. "A Concise History of Portugal" (Cambridge: Cambridge University Press, 1993)
- Bogdani, Mirela and Loughlin, John. "Albania and the European Union" (London: IB Tauris, 2007)
- Brown, Chris. "Understanding International Relations" (Macmillan 1997)
- Cohen, Jean L. "Rethinking Human Rights, Democracy, and Sovereignty in the Age of Globalization", New York: Columbia University 2008.
- Clark, Ian. "Legitimacy in International Society" (Oxford: Oxford University Press, 2005)
- Chandler, David. "Rethinking Human Rights: Critical Approaches to International Politics" Palgrave Macmillan 2003
- Craig, Paul and De Burca, Grainne. "EU Law: Texts, Cases, and Materials" (Oxford: Oxford University Press, 2003)

Duchêne, Francois. 'Europe's Role in World Peace'. In *Europe Tomorrow: Sixteen Europeans Look Ahead* (London: Fontana, 1972)

Erman, Eva. "Human Rights and Democracy: Discourse Theory and Global Rights Institutions" (The Hague: Kluwer Law International, 1998)

Faucompret, Erik and Könings, Joep. "Turkish Accession to the EU: Satisfying the Copenhagen Criteria" (Abingdon: Routledge, 2008)

Farnsworth, Nicole. "Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325" (Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, Prishtinë, Kosovë 2011)

Follesdal, Andreas. 'EU Legitimacy and Normative Political Theory'. In *Palgrave Advances in European Studies*. ed. by M. Cini and A. Bourne (London: Palgrave, 2006)

Freeman, Michael A. "Human Rights: An Interdisciplinary Approach" (Wiley, 2002)

Grabbe, Hughes. "The EU's Transformative Power: Europeanization through Conditionality in Central and Eastern Europe" (Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2006)

Galtung, Johan. "The European Community: a Superpower in the Making" (London: Allen and Unwin, 1973)

Goodhart, Michael "Democracy as Human Rights: Freedom and Equality in the Age of Globalization" (New York: Routledge, 2005).

Griffin, James. "On Human Rights" (Oxford: Oxford University Press 2008)

Hurd, Ian. "After Anarchy: Legitimacy and Power in the United Nations Security Council" (Princeton: Princeton University Press, 2007)

Held, David. "Democracy and the Global Order. From the Modern State to Cosmopolitan Governance" (Cambridge: Polity Press, 1995)

Ignatieff Michael, "Human Rights as Politics and as Idolatry" (Princeton: Princeton University Press 2001)

Joseph, Nye. "Soft Power: The Means to Success in World Politics" (PublicAffairs, 2004)

Kagan, Robert. "Of Paradise and Power. America and Europe in the New World Order" (New York: Knopf, 2003)

Kochenov, Dimitry. "EU Enlargement and the Failure of Conditionality: Pre-Accession Conditionality in the Fields of Democracy and the Rule of Law" (Hague: Kluwer Law International, 2008)

- Langlois, Anthony J. "The Politics of Justice and Human Rights: Southeast Asia and Universalist Theory" (Cambridge: Cambridge University Press, 2001)
- Mommsen, Wolfgang J. The Political and Social Theory of Max Weber: Collected Essays (Chicago: University of Chicago Press, 1989)
- Noutcheva, Gergana. "European Foreign Policy and the Challenges of Balkan Accession: Conditionality, Legitimacy and Compliance" (London and New York: Routledge, 2012)
- Pace, Michell. (ed.) Europe, the USA and Political Islam: Strategies for Engagement (Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2011)
- Preston, Christopher. Enlargement and Integration into the European Union (London: Routledge, 1997)
- Royo, Sebastian and Manuel, Christopher P. "Spain and Portugal in the European Union: the First Fifteen Years" (Abingdon: Routledge, 2003)
- Schimmelfennig Frank et.al., "International Socialization in Europe: European Organizations, Political Conditionality and Democratic Change" (Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2006)
- Schimmelfennig, Frank and Sedelmeier, Ulrich (eds). "The Politics of European Union Enlargement: Theoretical Approaches" (London: Routledge, 2005)
- Simmons John A., "Justification and Legitimacy: Essays on Rights and Obligations" (Cambridge: Cambridge University Press 2001)
- Tocci, Nathalie. "Who is a normative foreign policy actor? The European Union and its Global Partners" (Center for European Policy Studies, Brussels 2008)
- Tocci, Nathalie. "The European Union, Civil Society and Conflict" (Routledge, New York 2011)
- Tocci, Nathalie. "Imagining Europe: Towards a More United and Effective EU" (Edizioni Nuova Cultura IAI, Roma 2014)
- Torres Perez, Aida. "Conflicts of Rights in the European Union: a Theory of Supranational Adjudication" (Oxford: Oxford University Press, 2009)
- Telò Mario. (ed.) "The European Union and New Regionalism: Regional Actors and Global Governance" (London: Ashgate, 2001)

Whitman, Richard. "From Civilian Power to Superpower? The International Identity of the European Union" (Basingstoke: Macmillan, 1998)

Zurcher, Erik J. "Turkey: a Modern History" (London: I.B. Tauris, 2007)

Kapituj Libri

Alston, Philip and Weiler, Joseph. 'An Ever-Closer Union in Need of a Human Rights Policy: The European Union and Human Rights'. In "The EU and Human Rights", ed. by P. Alston (Oxford: Oxford University Press, 1999)

Balfour, Rosa. 'Principles of Democracy and Human Rights'. In "Values and Principles in EU Foreign Policy", ed. by S. Lucarelli (London: Routledge, 2006) f.114-129

Bickerton, Christopher. 'Legitimacy through Norms: The Political Limits to Europe's Normative Power'. In Normative Power Europe: Empirical and Theoretical Perspectives, ed. by R.G. Whitman (Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2001) f.25-45

Bauer, Joanne R. and Bell, Daniel A. 'Introduction', in The East Asian Challenge for Human Rights, edited by J.R. Bauer and D.A. Bell (Cambridge: Cambridge University Press 1999) f.3-23

Camporesi, Federico. 'The European Parliament and the EU Charter of Fundamental Rights'. In The EU Charter of Fundamental Rights: From Declaration to Binding Instrument, ed. by G. Federico (London: Springer, 2011) f.77-94

Deda, Ilir. 'Kosovo', in: L. Mootz red., Nations in Transit 2010. Democratization from Central Europe to Eurasia (Freedom House, Washington/Budapest 2010) Për më tepër shih: http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/pnaeb468.pdf (Aksesuar më 4 Prill 2015)

Diez, Thomas and Manners, Ian. 'Reflecting on Normative Power Europe'. In Power in World Politics, ed. by Berenskoetter, F. and Williams, M.J. (Abingdon: Routledge, 2007) f.173-188.

Ficchi, Luisa. 'Candidate Countries Facing a Binding Charter of Fundamental Rights: What's New?'. In The EU Charter of Fundamental Rights: from Declaration to Binding Instrument, ed. By G. Di Federico (London: Springer, 2011) f.109-124.

Hayward, Katy and Wiener, Antje. 'The Influence of the EU towards Conflict Transformation on the Island of Ireland'. In The European Union and Border Conflicts: the

Power of Integration and Association, ed. by Tomas. Diez, M. Albert and S. Stetter (Cambridge: Cambridge University Press, 2008) f. 33-63

Hillion, Christophe. 'The Copenhagen Criteria and their Progeny'. In EU Enlargement: a Legal Approach, ed. by C. Hillion (Portland: Hart Publishing, 2004) f.1-22

Koller, Peter. 'International Law and Global Justice'. In Legitimacy, Justice, and Public International Law, ed. by L.H. Meyer (Cambridge: Cambridge University Press, 2009) f.186-206.

Lord, Christopher. 'Accountable and Legitimate? The EU's International Role'. In International Relations and the European Union, ed, by C. Hill and M. Smith (Oxford: Oxford University Press, 2005) f.113-133

Lucarelli, Sonia. 'Introduction'. In S. Lucarelli and I. Mannes (eds.), Values and Principles in European Union Foreign Policy (Abingdon: Routledge, 2006) f. 1-18

Leino, Päivi. 'The Journey towards All that is Good and Beautiful: Human Rights and Common Values as Guiding Principles of EU Foreign Relations Law'. In EU Foreign Relations Law: Constitutional Fundamentals, ed. by M. Cremona and B. de Witte (Oxford: Hart Publishing, 2008)

Miles, Lee. 'The Nordic countries and the Fourth EU Enlargement'. In The European Union and the Nordic Countries, ed. by L. Miles (London: Routledge, 1996)

Muntarbhorn, Vitit. 'Asia and Human Rights at the Crossroads of the New Millennium: Between the Universalist and the Particularist?', in Universal Human Rights?, edited by R.G. Patman, Basingstoke: Macmillan, (2001) f.81-95.

Nicolaides, Papadimitriou. 'Preparing for Accession to the EU: How to Establish Capacity for Effective and Credible Application of EU Rules'. In The Enlargement of the European Union, ed. by Cremona M. (Oxford: Oxford University Press, 2003) f.43-78.

Othman, Norani. 'Grounding Human Rights Arguments in Non-Western Culture: Shari'a and the Citizenship Rights of Women in a Modern Islamic State', in The East Asian Challenge for Human Rights, edited by J.R. Bauer and D.A. Bell, Cambridge: Cambridge University Press, 1999 f.169-192.

Risse, Thomas and Sikkink, Kathryn. 'The Socialisation of International Human Rights Norms into Practices: Introduction'. In The Power of Human Rights: International Norms

and Domestic Change, ed. By T.Risse, S. Ropp and K. Sikkink (Cambridge: Cambridge University Press, 1999) f.1-38

Rosecrance, Robert. 'The European Union: a New Type of International Actor'. In Paradoxes of European Foreign Policy, ed. by J. Zielonka (The Hague: Kluwer Law International, 1998) f. 15-23.

Rack, R. and Lausseger, S. 'The Role of the European Parliament: Past and Future'. In The EU and Human Rights, ed. by P. Alston (Oxford: Oxford University Press, 1999) f.801-838

Ward, Angela. 'Access to Justice'. In The EU Charter of Fundamental Rights, ed. by S. Peers and A. Ward (Portland: Hart Publishing, 2004)

Weiler, Joseph. 'Fundamental Rights and Fundamental Boundaries: on Standards and Values in the Protection of Human Rights'. In The European Union and Human Rights, ed. by N. Neuwahl and A. Rosas (The Hague: Martinus Nijhoff, 1995) f.51-76

Wolff, Sarah. 'The New EU Internal Security Architecture Implementation Challenges'. In The EU's Lisbon Treaty: Institutional Choices and Implementation, ed. by F. Laursen (Farnham: Ashgate, 2012) f.63-80

Artikuj akademik në periodik shkencor

Antibugi, Daniele. "Cosmopolitan Democracy and its Critics: A Review" ed. European Journal of International Relations SAGE Publications and ECPR-European Consortium for Political Research, Vol. 10(3): 2004. f. 437-473

Amos, Merris. "Transplanting Human Rights Norms: The case of the United Kingdom's Human Rights Act" Human Rights Quarterly 35(2) (2013) f. 386-407.

Albi, Anneli. 'Ironies in Human Rights Protection in the EU: Pre-Accession Conditionality and Post- Accession Conundrums'. European Law Journal, vol.15 no: 1 (2009) f.46-69

Andreassen, Bård, A. and Sano, Hans-Otto. 'What's the Goal? What's the Purpose? Observations on Human Rights Impact Assessment'. International Journal of Human Rights, vol.11 no: 3 (2007) f.275-292

Bolleyer, Nicole and Reh, Christine. 'EU Legitimacy revisited; the Normative Foundations of a Multi-level Polity'. Journal of European Public Policy, vol.19 no: 4 (2012) f.472-490

Bicchi, Federica. 'Dilemmas of Implementation: EU Democracy Assistance in the Mediterranean'. *Democratization*, vol.17 no: 5 (2010) f.976-996.

Birchfield, Vicki. 'A Normative Poëer Europe Framework for Transnational Policy Formation'. *Journal of European Public Policy*, vol.20 no: 6 (2013) f. 907-922

Besson Samantha and Utzinger Andre R. "Future Challenges of European Citizenship—Facing a Wide-Open Pandora's Box" ed. *European Law Journal* Volume 13, Issue 5, September 2007, f. 573–590.

Berstein, Steven. 'The Elusive Basis of Legitimacy in Global Governance: Three Conceptions'. *Institute of Globalisation and the Human Condition Working Paper* 04/2 (2004) f.1-30.

Buchanan, Allen. 'Reciprocal Legitimation: Reframing the Problem of International Legitimacy'. *Politics, Philosophy & Economics* vol.10 no: 1 (2011) f.5-19.

Bellamy, Richard. "Evaluating Union citizenship: belonging, rights and participation within the EU", *Citizenship Studies* Vol.12, No.6 December 2008 f. 597-611

Buchanan, Allen and Keohane, Robert O. 'The Legitimacy of Global Governance Institutions'. *Ethics and International Affairs*, vol.20 no: 4 (2006) f. 405-437.

Cruft, Rowan. 'Human Rights, Individualism and Cultural Diversity', *Critical Review of International Social and Political Philosophy*, Vol.8, No.3, 2005 f.265-287

Clark, Ian. 'Legitimacy in a Global Order'. *Review of International Studies*, vol.29 no: 1 (2003) f. 75-95

Caron, David D. 'The Legitimacy and Collective Authority of the Security Council'. *American Journal of International Law*, vol.87 no: 4 (1993) f.552-588.

Coufoudakis, Van. 'The EEC and the Freezing of the Greek Association, 1967-1974', *Journal of Common Market Studies*, vol.16 no: 2 (1977) f.114-131

Checkel, Jeffrey T. 'Why Comply? Social Learning and European Identity Change'. *International Organization*, vol.55, no: 3 (2001) f.553-588.

Dimitrova, Antoaneta and Pridham, Geoffrey. 'International Actors and Democracy promotion in Central and Eastern Europe: the Integration Model and its Limits'. *Democratization*, vol.11 no: 5 (2004) f.91-112

Deroose, Servaas. et al., 'The Legitimation of the EMU: Lessons of the Early Days of the Euro'. *Review of International Political Economy*, vol.14 no: 5 (2007) f.800-819.

De Zuter, Elisabeth. 'Normative Power Spotting: an Ontological and Methodological Appraisal'. *Journal of European Public Policy*, vol.17 no: 8 (2010) f.1106-1127

Diez, Thomas. 'Normative Power as Hegemony'. *Cooperation and Conflict*, vol.48 no: 2 (2013) f.194-210

De Burca, Grainne. 'The Road Not Taken: the European Union as a Global Human Rights Actor'. *American Journal of International Law*, vol.105 no: 2 (2011) f.649-693.

Dunne, Tim. 'Good Citizen Europe'. *International Affairs*, vol.84 no: 1 (2008) f.13-28

De Burca, Grainne. 'Beyond the Chapter: How Enlargement has Enlarged the Human Rights Policy of the European Union'. *Fordham International Law Journal*, vol.27 no: 2 (2003) f.679-714.

Doğan, Yaşar. 'The Fundamental Rights Jurisprudence of the European Court of Justice'. *Ankara Law Review*, vol.6 no: 1 (2009) f.53-81

Diez, Thomas. 'Constructing the Self and Changing Others'. *Millennium- Journal of International Studies*, vol.33 no: 3 (2005) f.613-636.

Eriksen, Erik and Fossum, John. 'Europe in Search of Legitimacy: Strategies of Legitimation Assessed'. *International Political Science Review*, vol.25 no: 4 (2004) f.435-459

Eriksen, Erik. 'The EU - a Cosmopolitan Polity? *Journal of European Public Policy*. vol.13 no:2 (2006) f. 252-269.

Eeckhout, Piet. 'The EU Charter of Fundamental Rights and the Federal Question'. *Common Market Law Review*, vol. 39 no: 4 (2002) f.945-994;

Flockhart, Trine. 'Europeanisation or EU-isation? The Transfer of European Norms across Time and Space'. *Journal of Common Market Studies*, vol.48 no: 4 (2010) f.787-810.

Franck, Thomas M. 'Legitimacy in the International System'. *American Journal of International Law*, vol.82 no: 4 (1988) f.705-759.

Forst, Reiner. "The Basic Right to Justification: Toward a Constructivist Conception of Human Rights." *Constellations* 6, no. 1: 1999, f. 35–60

- Grabbe, Hughes. 'European Union Conditionality and the Acquis Communautaire'. *International Political Science Review* vol.23 no: 3 (2002) f.249-268
- Grabbe, Hughes. 'How does Europeanization affect CEE governance? Conditionality, diffusion and diversity'. *Journal of European Public Policy*, vol.8 no: 6 (2001) f. 1013-1031.
- Goodhart, Michael 'Origins and Universality in the Human Rights Debates: Cultural Essentialism and the Challenge of Globalization', *Human Rights Quarterly*, Vol.25, (2003) f.935-946.
- Hughes, James and Sasse, Gwendolyn. 'Monitoring the monitors: EU Enlargement Conditionality and Minority Protection in the CEECs'. *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, vol.4 no: 1 (2003) f.1-36.
- Hilson, Chris. 'Legitimacy and Rights in the EU: Questions of Identity'. *Journal of European Public Policy*, vol.14 no: 4 (2007) f.527-543
- Hurd, Ian. 'Legitimacy and Authority in International Politics'. *International Organization*, vol.53 no: 2 (1999) f. 379-408.
- Habermas, Jurgen. "Why Europe needs a constitution?" *New Left Review* 11, September-October 2001 Për më tepër shih: <http://newleftreview.org/II/11/jurgen-habermas-why-europe-needs-a-constitution> (Aksesuar më 11 Tetor 2014)
- Hyde-Price, Adrian. 'Normative Power Europe: a Realist Critique'. *Journal of European Public Policy*, vol.13 no: 2 (2006) f. 217-234
- Ivanov, Kalin. 'Legitimate Conditionality? The European Union and Nuclear Power Safety in Central and Eastern Europe'. *International Politics*, vol.45 no: 1 (2008) f. 146-167
- Klintman, Mikael. and Kronsell, Annica. 'Challenges to Legitimacy in Food safety Governance? The Case of the European Food Safety Authority'. *Journal of European Integration*, vol.32 no: 3 (2010) f.309-327.
- Kavalski, Emilian. 'The Struggle for Recognition of Normative Powers: Normative Power Europe and Normative Power China in Context'. *Cooperation and Conflict*, vol.48 no: 2 (2013) f.247-267.
- Kahraman, Sevilay E. 'Rethinking Turkey-European Union Relations in the Light of Enlargement'. *Turkish Studies*, vol.1 no: 1 (2000) f.1-20.

- Kvist, John. 'Does EU Enlargement Start a Race to the Bottom? Strategic Interaction among EU Member States in Social Policy'. *Journal of European Social Policy*, vol.14 no: 3 (2004) f.301-318.
- Lenz, Tobias. 'EU Normative Power and Regionalism: Ideational Diffusion and its Limits'. *Cooperation and Conflict*, vol.48 no: 2 (2013) f.211-228
- Lazowski, Adam. 'And Then There Were Twenty-Seven... a Legal Appraisal of the Sixth Accession Treaty'. *Common Market Law Review*, vol.44 no: 2 (2007) f.401-430
- Manners, Ian. 'Normative Power Europe: a Contradiction in Terms?' *Journal of Common Market Studies*, vol.40 no: 2 (2002) f.235-258.
- Manners, Ian. 'The Normative Ethics of the European Union'. *International Affairs*, vol.84 no: 1 (2008) f.45-60.
- Manners, Ian. 'Normative Power Europe Reconsidered: Beyond the Crossroads'. *Journal of European Public Policy*, vol.13 no: 2 (2006) f.182-199.
- Manners, Ian. 'Assessing the Decennial, Reassessing the Global: Understanding European Union Normative Power in Global Politics'. *Cooperation and Conflict*, vol.48 no: 2 (2013) f.304-329.
- Menke, Christoph. "The "Aporias of Human Rights" and the "One Human Right": Regarding the Coherence of Hannah Arendt's Argument" Ed. Alien Mack in *Social Research – An International Quarterly of the Social Science* Vol 74: No 3: Fall 2007
- Mulligan, Shane. 'Questioning the Question of Legitimacy in IR'. *European Journal of International Relations*, vol.10 no: 3 (2004) f.475-484
- Menon, Anand and Weatherill, Stephen. 'Transnational Legitimacy in a Globalised World'. West Mahoney, Christine and Beckstrand, Michael. 'Following the Money: European Union Funding of Civil Society Organisations'. *Journal of Common Market Studies*, vol.49 no: 6 (2011) f.1339-1361.
- Mercer, Claire. 'NGOs, Civil Society, and Democratisation: a Critical Review of the Literature'. *Progress in Development Studies*, vol.2 no: 5 (2002) f.5-22
- Nogueras, Diego and Martinez, Liñán. 'Human Rights Conditionality in the External Trade of the European Union: Legal and Legitimacy Problems'. *Columbia Journal of European Law*, vol.7 no: 3 (2001) f.307-336. *European Politics*, vol.31 no: 3 (2008) f.397-416.

- Niemann, Ante and Bretherton, Christopher. 'EU External Policy at the Crossroads: the Challenge of Actorness and Effectiveness'. *International Relations*, vol.27 no: 3 (2013) f. 261-275.
- Pogge, Thomas. 'The International Significance of Human Rights', *The Journal of Ethics*, Vol.4, (2000) f. 45-69.
- Petrov, Roman. 'Exporting the Acquis Communautaire into the Legal Systems of Third Countries'. *European Foreign Affairs Review*, vol.13 no: 1 (2008) f. 33-52
- Pace, Michelle. 'Paradoxes and Contradictions in EU Democracy Promotion in the Mediterranean: the Limits of EU Normative Power'. *Democratization*, vol.16 no: 1 (2009) f.39-58
- Pridham, Geoffrey. 'Change and Continuity in the European Union's Political Conditionality: Aims, Approach, and Priorities'. *Democratization*, vol.14 no: 3 (2007) f.446-471.
- Preston, Christopher. 'Obstacles to EU Enlargement: the Classical Community Method and the Prospects for a Wider Europe'. *Journal of Common Market Studies*, vol.33 no: 3 (1995) f. 451-46
- Pace, Michell. 'The Construction of EU Normative Power'. *Journal of Common Market Studies*, vol.45 no: 5 (2007) f.1041-1064
- Papadimitriou, Dimitris and Gateva, Eli. 'Between Enlargement-led Europeanisation and Balkan Exceptionalism'. *Perspectives on European Politics and Society*, vol.10 no: 2 (2009) f.152- 166
- Phinnemore, David. 'Beyond 25 – the Changing Face of EU Enlargement: Commitment, Conditionality, and the Constitutional Treaty'. *Journal of Southern Europe and the Balkans*, vol.8 no: 1 (2006) f.7-26
- Phinnemore, David. 'From Negotiations to Accession: Lessons from the 2007 Enlargement'. *Perspectives on European Politics and Society*, vol.10 no: 2 (2009) f.240-252
- Risse, Thomas. 'International Norms and Domestic Change: Arguing and Communicating Behaviour in the Human Rights Area'. *Politics and Society*, vol.27 no: 4 (1999) f.529-559

Raz, Joseph. "The Problem of Authority: Revisiting the Service Conception" *Minnesota Law Review* vol. 90 (2006) f. 1003-1044. Për më tepër shih: <http://ssrn.com/abstract=999849> (Aksesuar më 15 Prill 2015)

Radaelli, Claudio M. 'Policy Transfer in the European Union: Institutional Isomorphism as a Source of Legitimacy'. *Governance*, vol.13 no: 1 (2000) f. 25-43.

Sasse, Gwendolyn. 'The Politics of EU Conditionality: the Norm of Minority Protection during and beyond EU Accession'. *Journal of European Public Policy*, vol.15 no: 6 (2008) f.842-860.

Schimmelfennig, Frank. 'EU Political Accession Conditionality after the 2004 Enlargement: Consistency and Effectiveness'. *Journal of European Public Policy*, vol.15 no: 6 (2008) f.918-937.

Simmons, John A. 'Justification and Legitimacy'. *Ethics*, vol.104 no: 4 (1999) f.739-771.

Smith, Michael E. 'Researching European Foreign Policy: Some Fundamentals'. *Politics*, vol.28 no: 3 (2008) f. 177-187.

Schimmelfennig, Frank and Sedelmeier, Ulrich 'Governance by Conditionality: EU Rule Transfer to the Candidate Countries of Central and Eastern Europe'. *Journal of European Public Policy*, vol.11 no: 4 (2004) f.661-679.

Schimmelfennig, Frank. 'Strategic Calculation and International Socialisation'. *International Organisation*, vol.59 no: 4 (2005) f.827-860.

Smith, Michael. 'Between 'Soft Power' and a Hard Place: European Union Foreign and Security Policy between the Islamic World and the United States'. *International Politics* vol.46 no: 5 (2009) f. 596-615

Scheipers, Sibylle and Sicurelli, Daniela. 'Normative Power Europe: A Credible Utopia?' *Journal of Common Market Studies*, vol. 45, no: 2 (2007) f.435-457.

Seeberg, Peter. 'The EU as a Realist Actor in Normative Clothes: EU Democracy Promotion in Lebanon and the European Neighbourhood Policy'. *Democratization*, vol.16: no. 1 (2009) f.81-99

Smith, K.E. 'The European Parliament and Human Rights: Norm Entrepreneur or Ineffective Talking Shop?' *Dossier El Parlamento Europeo en la Política Exterior*, no: 11 (2004)

Sjursen. Helene. 'Why Expand? The Question of Legitimacy and Justification in the EU's Enlargement Policy'. *Journal of Common Market Studies*, vol.40 no: 3 (2002) f. 491-513

Sjursen. Helene. 'The EU as a Normative Power: How can this Be?' *Journal of European Public Policy*. vol.13 no: 2 (2006a) f. 235-251

Sjursen, Helene. 'What Kind of Power?' *Journal of European Public Policy* vol.13 no: 2 (2006b) f.169-181

Schimmelfennig, Frank. 'The Community Trap: Liberal Norms, Rhetorical Action, and the Eastern Enlargement of the European Union'. *International Organisation*, vol.55 no: 1 (2001) f. 47-80

Tannam, Etain. 'The European Commission's Evolving Role in Conflict Resolution: the Case of Northern Ireland 1989-2005'. *Cooperation and Conflict*, vol.42 no: 3 (2007) f.337-356

Von Bogdandy, Armin. 'The EU as a Supranational Federation: a Conceptual Attempt in the Light of the Amsterdam Treaty'. *Columbia Journal of European Law*, vol.6 no: 1 (2000) f.27-54

Whitman, Richard. 'The Neo-Normative Turn in Theorising the EU's International Presence'. *Cooperation and Conflict*, vol.48 no: 2 (2013) f.171-193

Wetzel, Joseph R. 'Improving Fundamental Rights Protection in the European Union'. *Fordham Law Review*, vol.71 no: 6 (2003) f.2823-2862

Dokumenta juridike (traktate, ligje, etj.,)

Asambleja e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Ligji Antidiskriminim, (Prishtinë 19 Shkurt 2004) , Ligji Nr.2004/ 3, hyrë në fuqi më 21 Mars 2004. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_3_al.pdf (Aksesuar më 1 Prill 2015)

Asambleja e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë (Prishtinë, 19 Shkurt 2004) Ligji Nr. 2004/2, hyrë në fuqi më 21 Mars 2004. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_2_al.pdf (Aksesuar më 3 Prill 2015)

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut”, Paris më 10 Dhjetor 1948 http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf (Aksesuar më 3 Prill 2015).

Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Europiane, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, (Nicë, 7 Dhjetor 2000) (2000/C 364/01) hyrë në fuqi më 18 Dhjetor 2000. (përkth.) Charter of Fundamental Rights of the European Union. OJ C 364/1 (Brussels: 18 December 2000) Për më tepër shih: http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf (Aksesuar më 11 Shtator 2014)

Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian, Traktati i Lisbonës, amendimi i Traktatit të Bashkimit Europian dhe të Traktatit krijues të Komunitetit Europian, nënshkruar në Lisbonë, 13 Dhjetor 2007 (2007/C 306/01) (përkth.) “Treaty of Lisbon amending the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community, signed at Lisbon, 13 December 2007 (Brussels: 17 December 2007)”. Për më tepër shih: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:C:2007:306:FULL&from=EN> (Aksesuar më 11 Shtator 2014)

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Avokatin e Popullit, (Prishtinë 22 Korrik 2010), Nr. 03/ L-195, hyri në fuqi më 27 Gusht 2010. http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Ligji_per_Avokatine_LIGJI_Nr._03_L_195_shqip_.pdf (Aksesuar më 25 Qershor 2015)

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji i Avokatit të Popullit, (Prishtinë 18 Maj 2015), Nr. 05/L -019, hyri në fuqi më 15 Qershor 2015. http://www.mdks.net/repository/docs/LIGJI_PER_AVOKATIN_E_POPULLIT_shqip.pdf (Aksesuar më 28 Korrik 2015).

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Barazinë Gjinore (Prishtinë, 28 Maj 2015) Nr. 05/L-020, hyri në fuqi më 12 Qershor 2015. <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20sh.pdf> (Aksesuar më 10 Korrik 2015)

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji mbi Mbrojtjen Kundër Diskriminimit (Prishtinë, 28 Maj 2015) Nr. 05/L-021, hyrë në fuqi më 12 Qershor 2015

<https://mapl.rksgov.net/getattachment/165dc3a6-5295-4d24-8437-a50f8ed4e237/LIGJI-NR--05-L-020-PERBARAZI-GJINORE.aspx> (Aksesuar më 25 Qershor 2015)

Këshilli i Bashkimit Europian, Traktati i Nizës 2000 (titulli origj. European Council, Presidency Conclusions, Nice: 7-10 December 2000) Për më tepër shih në: Draft Traktati i krijimit të Komunitetit Politik Evropian 1953, (titulli original, Draft Treaty embodying the Statute of the European Community SECRETARIAT OF THE CONSTITUTIONAL COMMITTEE PARIS) Për më tepër shih në: http://aei.pitt.edu/991/01/political_union_draft_treaty_1.pdf (Aksesuar më 13 Mars 2015)

Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008. Për më tepër shih: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf> (Aksesuar më 19 Dhjetor 2014)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, (Prishtinë, 2 Mars 2012), Nr. 04/ L-044, hyri në fuqi më 17 Mars 2012. Për më tepër shih në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20KPM.pdf> (Aksesuar më 14 Prill 2015)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Lirinë e Asocimit për Organizatat Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës (Prishtinë 29 Gusht 2011), Nr. 04/ L-057, hyri në fuqi më 13 Shtator 2011. Për më tepër shih: www.map.rks-gov.net/getattacheement/2516f59d-d96a-4426-a4a9-be4e6b3cce92/LIGJI-PER-LIRINE-E-ASOCIMIT-NE-ORGANIZATAT-JOQEVE.aspx (Aksesuar më 15 Maj 2015)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave të Burimeve të Gazetarisë, (Prishtinë 31 Korrik 2013) Nr. 04/L-137, hyri në fuqi më 16 Shtator 2013. Për më tepër shih në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20mbrojtjen%20e%20burimeve%20te%20gazetarise.pdf> (Aksesuar më 10 Prill 2015)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje Nr. 03/L-182 (Prishtinë, 1 Korrik 2010) hyri në fuqi më 16 Korrik 2010. Për më tepër shih: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-182-alb.pdf> (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Viktimave të Trafikimit, (Prishtinë, 31 Korrik 2013), Nr. 04/L-218 hyri në fuqi më 15 Shtator 2013. Për më tepër shih në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20parandalimin%20dhe%20luftimin%20e%20trafikimit%20me%20njerez.pdf> (Aksesuar më 4 Prill 2015)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Statusin dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, Antarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, (Prishtinë, 8 Dhjetor 2011), nr. 04/ L-054, hyri në fuqi më 1 Janar 2012. Për më tepër shih në: <http://www.kpm-ks.org/materiale/dokument/1335165851.7107.pdf> (Aksesuar më 14 Prill 2015)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Mbi Amendimin dhe Suplementimin e Ligjit Nr.04/L-054 mbi Statusin dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, Antarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale në Luftë, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, (Prishtinë 20 Mars 2014) Nr. 04/L-172, hyri në fuqi më 6 Prill 2014. <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-172%20a.pdf> (Aksesuar më 25 Korrik 2015)

Republika e Kosovës, Vendimi i Kryeministrit të Kosovës nr. 01/195 datës 03.09.2014 Për më tepër shih: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_195-te_te_Qeverise_2014.pdf (Aksesuar më 24 Maj 2015)

Traktati i Amsterdimit 1997 (titulli original: TREATY OF AMSTERDAM AMENDING THE TREATY ON EUROPEAN UNION, THE TREATIES ESTABLISHING THE EUROPEAN COMMUNITIES AND CERTAIN RELATED ACTS Amsterdam on 2 October 1997. Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities, 1997 Për më tepër shih në: <http://www.europarl.europa.eu/topics/treaty/pdf/amst-en.pdf> (Aksesuar më 11 Shkurt 2015)

Traktati i krijimit të Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian (tekst i konsoliduar) 2006 (titulli origjinal, Consolidated Version of the Treaty on European Union) Për më tepër shih në: http://www.basiclaw.net/Appendices/eu_cons_treaty_en.pdf (Aksesuar më 10 Mars 2015)

Traktati i themelimit të Bashkimit Evropian 1992, (titulli original, Treaty of the European Union, Maastricht on 7 February 1992 Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities, 1992. Për më tepër shih në: http://europa.eu/eu-law/decision-making/treaties/pdf/treaty_on_european_union/treaty_on_european_union_en.pdf

(Aksesuar më 11 Shkurt 2015)

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, “Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2013-2017”. Prishtinë, Gusht 2013. Për më tepër shih:

[http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Pjesa_Narrative_e_Draft_Strategjise_per_te_Drejtat_e_Njeriut_\(2013-2017\)_05_gusht_2013_EN.pdf](http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Pjesa_Narrative_e_Draft_Strategjise_per_te_Drejtat_e_Njeriut_(2013-2017)_05_gusht_2013_EN.pdf) (Aksesuar më 13 Gusht 2015).

Raporte

Amnesty International Report 2014/2015, The State of the World’s Human Rights, London 2015. Për më tepër shih në:

<https://www.google.it/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=2&cad=rja&uact=8&ved=0CC8QFjABahUKEwjNiNDsn5PIAhXKfRoKHSItDvY&url=https%3A%2F%2Fwww.amnesty.org%2Fdownload%2FDocuments%2FPOL1000012015ENGLISH.PDF&usg=AFQjCNE5IWADEdELeKXfSVmkjBGTwoPYow&bvm=bv.103627116,d.bGQ> (Aksesuar më 17 Korrik 2015)

Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit 2008, “Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2008-2013 Për më tepër shih në: http://www.stopvaw.org/uploads/kosovo_program_for_gender_equality (Aksesuar më 1 Maj 2015)

Birkelbach, Willi. Report on the Political and Institutional Aspects of Accession to or Association with the Community (19 December 1961) http://www.ena.lu/report_willi_birkelbach_political_institutional_aspects_accession_association_with_community_december_1961-020006013.html (Aksesuar më 10 Shkurt 2015)

Commission of the European Communities “EUROPEAN GOVERNANCE: A White Paper” Brussels 25.07.2001 COM 2001 (428) final. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=URISERV:l10109> (Aksesuar më 16 Maj 2015)

Commision of European Communities - Communication from the Commission of the European Union, “A European Future for Kosovo”, Brussels, 20.04.2005 COM (2005) 156 final. Për më tepër shih: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52005DC0156&from=EN> (Aksesuar më 17 Shkurt 2015)

Commission of the European Communities, Kosovo Progress Report Brussels COM(2008) 674 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/key_documents/reports_nov_2008/kosovo_progress_report_en.pdf (Aksesuar më 16 Gusht 2015)

Commission of the European Communities, Kosovo Progress Report Brussels COM (2009) 533 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/ks_rapport_2009_en.pdf (Aksesuar më 16 Gusht 2015)

Commission of the European Communities, Kosovo Progress Report Brussels COM (2010) 660 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf (Aksesuar më 16 Gusht 2015)

Commission of the European Communities, Kosovo Progress Report Brussels COM (2011) 666 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf (Aksesuar më 16 Gusht 2015)

Commission of the European Communities, Kosovo Feasibility Study Brussels COM (2012) 339. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf (Aksesuar më 16 Gusht 2015)

Commission of the European Communities, Kosovo Progress Report Brussels COM (2013) 700

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/ks_rapport_2013.pdf

(Aksesuar më 16 Gusht 2015)

Commission of the European Communities, Kosovo Progress Report Brussels COM (2014)

700 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf (Aksesuar më 16 Gusht 2015)

Council of the European Communities ‘Council decision 2010/446/DFSP of 11 August 2010 extending the mandate of the European Union Special Representative in Kosovo’, Official journal of the European Union, 211 (2010/C 211) <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2010:211:0036:0038:EN:PDF>

(Aksesuar më 16 Maj 2015)

Council of the European Union, EU Annual Report on Human Rights and Democracy in the World in 2014. Luxembourg, 22 June 2015. Për më tepër shih: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10152-2015-INIT/en/pdf> (Aksesuar më 13 Gusht 2015).

EU Commission, Indicative Strategic paper for Kosovo (2014-2020) Brussels 20 August 2014 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20140919-csp-kosovo.pdf (Aksesuar më 16 Gusht 2015)

EU Commission, “Instrument for Pre-Accession IPA (II) Kosovo, Facility for Implementing of Political Priorities Including Pristina-Belgrade Dialogue”, Brussels, 27 October 2014.

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/kosovo/ipa/2015/05_ipa_2014_pristina_belgrade_dialogue_implementation_20141027.pdf (Aksesuar më 16 Gusht 2015)

EU Commission, Kosovo Progress Report, Brussels, 9. 11. 2005 COM (2005) 561 final http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1423_final_progress_report_ks_en.pdf (Aksesuar 12 Janar 2015).

EU Delegation to the United Nations, “A European Future for Kosovo”, 20 March 2005 http://eu-un.europa.eu/articles/en/article_4613_en.htm (Aksesuar 12 Janar 2015).

EULEX, “Compact Progress Report 2014” June 2014 Për më tepër shih: http://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/CPReport_2.pdf (Aksesuar më 22 Prill 2015)

EULEX, “Programme Report 2010” Për më tepër shih: http://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/EPR_2010_2.pdf (Aksesuar më 14 Prill 2015)

European Commission Communication, Brussels, 10 October 2012. COM (2012) 581 final http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/miff_adopted10-10-12_en.pdf (Aksesuar më 13 Maj 2015)

European Parliament, ‘Human Rights in the World in 2009 and EU Policy on the Matter’. OJC 169 E/81 (16 December 2010) <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:C:2012:169E:FULL&from=EN> (Aksesuar më 11 Prill 2015)

European Commission, ‘Enlargement Strategy and Main Challenges 2013-2014’. COM (2013) 700 final (Brussels: 16 October 2013) http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/strategy_paper_2013_en.pdf (Aksesuar më 11 Prill 2015)

European Commission, ‘European Governance: a White Paper’. COM (2001) 428 final (Brussels: 25 July 2001) Për më tepër shih në: http://www.ab.gov.tr/files/ardb/evt/1_avrupa_birligi/1_6_raporlar/1_1_white_papers/com2_001_white_paper_european_governance.pdf (Aksesuar më 22 Shkurt 2015)

European Commission, European Governance: Preparatory Work for the White Paper (Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities, 2002) Për më tepër shih në: http://ec.europa.eu/governance/docs/comm_rapport_en.pdf (Aksesuar më 16 Mars 2015)

European Commission, ‘Value for Citizens: A Vision of Public Governance in 2020’ (Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities, 2009) Për më tepër shih në: http://www.gnksconsult.com/site/images/stories/value_for_citizen_final.pdf (Aksesuar më 7 Mars 2015)

European Commission, ‘Equal Rights vs. Special Rights? Minority Protection and the Prohibition of Discrimination’ (Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities, 2007) Për më tepër shih në: <https://www.google.it/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&cad=rja&uact=8&ved=0CCYQFjAAahUKEwivs7238fjHAhVFVhQKHQGOD6A&url=http%3A%2F%2Fec.>

europa.eu%2Fsocial%2FBlobServlet%3FdocId%3D1684%26langId%3Den&usg=AFQjCNFcWbFWd31RX1xm7Kyhi-RKZ0WbAQ&bvm=bv.102537793,d.d24 (Aksesuar më 2 Mars 2015)

European Commission, 'European Instrument for Democracy and Human Rights (EIDHR) Strategy Paper 2007-2010'. Për më tepër shih në: https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/thematic-strategy-paper-eidhr-2007_en_1.pdf (Aksesuar më 11 Mars 2015)

European Commission 'Speech on 'Copenhagen Accession Criteria: 20 Years that Changed Europe' (14 May 2013) Për më tepër shih në: http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-13-409_en.htm (Aksesuar më 16 Nëntor 2014)

European Commission, 'Civil Society Dialogue between the EU and Candidate Countries'. COM (2005) 290 final (Brussels: 29 June 2005) Për më tepër shih në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/civil_society_conference/civil-society-dialogue-between-the-eu-and-candidate-countries_2005-06-29_en.pdf (Aksesuar më 10 Mars 2015)

European Commission, 'Communication on the European Union's Role in Promoting Human Rights and Democratisation in Third Countries'. COM (2001) 252 final (Brussels: 8 May 2001) Për më tepër shih në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52001DC0252&from=EN> (Aksesuar më 16 Nëntor 2014)

European Commission, "Newsletter calls on Kosovo civil society to contribute to 2009 progress report", ECLO Press Release no. 11 (18 March 2009) Për më tepër shih në: http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/newsletter/eu_newsletter_11_en.pdf (Aksesuar më 25 Maj 2015)

European Commission Implementing Decision, Brussels 27 June 2011 COM (2011) 4381 final. Për më tepër shih në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/mipd_kosovo_2011_2013_en.pdf (Aksesuar më 13 Gusht 2015).

European Commission, "2014 Annual Report on the Application of the EU Charter of Fundamental Rights", Brussels 22 May 2015. Për më tepër shih në:

http://ec.europa.eu/justice/fundamental-rights/files/2014_annual_charter_report_en.pdf

(Aksesuar me 12 Qershor 2015)

European Council, 'A Secure Europe in a Better World' (Brussels: 12 December 2003). Për më tepër shih në: <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/78367.pdf> (Aksesuar 11 Prill 2015)

European Instrument for Democracy and Human Rights (EIDHR) Strategy Paper 2007 – 2010, The Commission of the European Communities DG RELEX/B/1 JVK 70618 (Brussels 2007). Për më tepër shih në: https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/thematic-strategy-paper-eidhr-2007_en_1.pdf (Aksesuar më 17 Shkurt 2015)

European Parliament, 'Resolution on Human Rights in the World in 2009 and EU Policy on the Matter'. OJ C 169 E/81 (16 December 2010) Për më tepër shih në: http://www.ab.gov.tr/files/ardb/evt/1_avrupa_birligi/1_6_raporlar/1_3_diger/Human_Rights_and_the_EU.pdf (Aksesuar më 17 Mars 2015)

European Parliament Subcommittee on Human Rights, 'Annual Report on Human Rights and Democracy in the World 2012 and the European Union's Policy on the Matter' (Brussels: 29 November 2013). Për më tepër shih në: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//NONSGML+REPORT+A7-2013-0418+0+DOC+PDF+V0//EN> (Aksesuar më 10 Mars 2015)

European Parliament Subcommittee on Human Rights, 'Annual Report on Human Rights and Democracy in the World 2013 and the European Union's Policy on the Matter' (Brussels: 28 November 2014) Për më tepër shih në: http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2014_2019/documents/afet/pr/1042/1042061/1042061en.pdf (Aksesuar më 9 Mars 2015)

European Parliament, Delegation for relations with the countries of South-East (13 July 2009). Për më tepër shih në: https://polcms.secure.europarl.europa.eu/cmsdata/upload/83519997-b621-4594-9d03-a869585c05d4/att_20090811ATT59534-32834469860954250.pdf (Aksesuar më 20 Mars 2015)

European Parliament, ‘Human Rights Conditionality in Development Policy’ (Brussels: 11 October 2011) Për më tepër shih në: <http://www.europarl.europa.eu/webnp/cms/pid/1675> (Aksesuar 11 Prill 2015)

European Union Special Representative in Kosovo ‘Summary of Projects under IPA Annual Programme 2009 for Kosovo’ Për më tepër shih: http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/summary_of_projects_under_ipa_annual_programme_2009_for_kosovo_en.pdf (Aksesuar më 11 Prill 2015)

EUR-LEX, “Regulation (EC) No 1889/2006 of the European Parliament and of the Council of 20 December 2006 on establishing a financing instrument for the promotion of democracy and human rights worldwide” (Brussels 2006) Për më tepër shih: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:l14172> (Aksesuar më 1 Prill 2015)

Freedom House, “Report Freedom in the World 2014” Për më tepër shih: <https://freedomhouse.org/sites/default/files/FIË2014%20Booklet.pdf> (Aksesuar më 24 Prill 2015)

Freedom House World Report 2009 – Kosovo Overview. Për më tepër shih: www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2009/kosovo#.VdOM0oFyzqB (Aksesuar më 24 Maj 2015)

Freedom House World Report 2011 – Kosovo Overview. Për më tepër shih: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2011/kosovo> (Aksesuar më 24 Maj 2015)

Freedom House World Report 2013 – Kosovo Overview. Për më tepër shih: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2013/kosovo> (Aksesuar më 24 Maj 2015)

Freedom House World Report 2014 – Kosovo Overview. Për më tepër shih: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2014/kosovo> (Aksesuar më 24 Maj 2015)

Freedom House World Report 2015 – Kosovo Overview. Për më tepër shih: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2015/kosovo> (Aksesuar më 24 Maj 2015)

Gashi, Krenar. “Freedom House Kosovo 2014”. Për më tepër shih: https://freedomhouse.org/sites/default/files/NIT2015_Kosovo.pdf (Aksesuar më 20 Qershor 2015)

Instrument for Pre-accession Assistance (IPA) multi-annual indicative planning document (MIPD) 2008-2010 Kosovo (under UNSCR 1244/99), Commission of the European

Communities (Brussels 2008). Për më tepër shih: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/mipd_kosovo_2009_2011_en.pdf (Aksesuar 12 Janar 2015).

Instrument for Pre-accession Assistance (IPA) multi-annual indicative financial framework for 2011-2013, Commission of the European Communities COM (2009) 543 Final (Brussels 2009). Për më tepër shih: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52009DC0543&from=EN> (Aksesuar 12 Janar 2015).

International Crisis Group ‘The rule of law in independent Kosovo’, International Crisis Group Europe Report 204 (19 May 2010). Për më tepër shih: <http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/204%20The%20rule%20of%20Laë%20in%20Independent%20Kosovo.pdf> (Aksesuar më 4 Prill 2015)

Tetrattech, “Property Rights Program in Kosovo” Për më tepër shih: www.tetrattech.com/en/projects/property-rights-program-kosovo (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

UNDP, “Mapping of local initiatives on Women, Peace Security in Kosovo 1999-2012” Mission report. Për më tepër shih: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/womenPub/UNDP_ENG_FINAL.pdf (aksesuar më 29 Maj 2015)

Ward, Benjamin. ‘Slow Progress on Rights in Kosovo’, The European Voice / Human Rights Watch (24 February 2010). Për më tepër shih: http://www.hrw.org/sites/default/files/reports/kosovo1010webwcover_1.pdf (Aksesuar më 22 Prill 2015)

Webfaqe

Agjensia Europiane e të Drejtave Themelore, webfaqe: <http://fra.europa.eu/en> (Aksesuar më 27 Prill 2015)

Agjensia për Barazi Gjinore webfaqe: <http://abgj.rks-gov.net> (Aksesuar më 27 Prill 2015)

BIRN, webfaqe: <http://birn.eu.com/en/network/birn-kosovo-home> (aksesuar më 29 Maj 2015)

EULEX webfaqe: <http://www.eulex-kosovo.eu/> (aksesuar më 29 Maj 2015)

Këshilli Europian, webfaqe: <http://www.consilium.europa.eu/en/home/> (aksesuar më 29 Maj 2015)

Këshilli i Europës, webfaqe: <http://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/home> (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

Komisioni Europian, webfaqe: http://ec.europa.eu/index_en.htm (aksesuar më 29 Maj 2015)

Komisioni Europian, Politika Europiane e Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit (Kosovë) (titulli origj. "EU Commission, European Neighborhood Policy and Enlargement Negotiations - Kosovo), webfaqe: http://ec.europa.eu/enlargement/instruments/funding-bycountry/kosovo/index_en.htm (aksesuar më 29 Maj 2015)

Ministria e Administratës Publike, Departamenti për Organizatat e Jo Qeveritare, webfaqe: www.map.rks-gov.net/Departments/DOJQ.aspx (Aksesuar më 25 Maj 2015)

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, webfaqe: <http://democratic-youth.net/yihr/country/kosovo/> (Aksesuar më 10 Maj 2015)

Parlamenti Europian, webfaqe: <http://www.europarl.europa.eu/portal/en> (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

Parlamenti Europian, Komitetit për të Drejtat e Njeriut, webfaqe: <http://www.europarl.europa.eu/committees/en/droi/home.html#menuzone> (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

Përfaqësuesi Special i Bashkimit Europian, webfaqe: http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu_kosovo/eu_special_representative/index_en.htm (Aksesuar më 17 Mars 2015).

Qendra për Emacipim Shoqëror, webfaqe: www.qeshkosova.org/rrethnesh/ (aksesuar më 29 Maj 2015)

Republika e Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, <http://www.ombudspersonkosovo.org/en/mission> (Aksesuar më 19 Qershor 2015)

Republika e Kosovës, Zyra për Qeverisje të Mirë, webfaqe: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,51> (Aksesuar më 10 Maj 2015)

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, webfaqe: <http://www.womensnetwork.org/> (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

Shërbimi i Veprimeve të Jashtëm Europian, webfaqe: http://eeas.europa.eu/enlargement/index_en.htm (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

Tetratex, webfaqe: <http://www.tetratex.com/en/about> (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

UNDP, webfaqe: <http://www.ks.undp.org/> (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

Zyra e BE në Kosovë, webfaqe: http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/index_en.htm (Aksesuar më 16 Korrik 2015)

Të tjera

European Commission Liaison Office to Kosovo, “A snapshot of activities 2008-2009” (Pristina 2008)

http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/publications/eu_liaison_office_to_kosovo_a_snapshot_of_activities_2008_2009_en.pdf (Aksesuar më 17 Shkurt 2015)

European Commission ‘Speech on ‘Copenhagen Accession Criteria: 20 Years that Changed Europe’ (14 May 2013) http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-13-409_en.htm (Aksesuar më 19 Prill 2015).

Parlamenti Europian, “Mbledhja e Komitetit Ndërparlamentar me Parlamentet Kombëtare” (25 Shtator 2013) (përkth. Ang. European Parliament, ‘Interparliamentary Committee Meeting with National Parliaments’ (25 September 2013) <http://www.europarl.europa.eu/webnp/cms/pid/11> (Aksesuar më 11 Prill 2015)

Përfaqësuesit Special i Bashkimit Evropian në Kosovë (European Union Special Representative in Kosovo) http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu_kosovo/political_relations/index_en.htm (Aksesuar më 17 Mars 2015)

Presidenti i republikës së Kosovës, “Këshillit Kombëtar për të Mbijeturit e Dhunës Seksuale” (Prishtinë, 1 Korrik 2015). Për më tepër shih në: www.president-ksgov.net/?page=1,8,3945#.Vdhlp4FyzqA (Aksesuar më 4 Korrik 2015)

Raz, Joseph. ‘Human Rights without Foundations’, Minerva Lecture (2006), Tel Aviv, <http://josephnrz.googlepages.com/HumanRightswithoutfoundations.pdf> (Aksesuar më 19 Prill 2015).

Intervista

Intervistë me znj. Dragana Nikolic-Solomon, zv. Drejtore e Zyrës së Shtypit dhe Informimit Publik pranë EULEX, Prishtinë 20 Korrik 2015.

Intervistë me znj. Ferinaze Isufe, zyrtare e lartë për çështje gjinore në Ministrinë Punës dhe Mirëqënies Sociale, Prishtinë 18 Korrik 2015

Intervistë me znj. Fjolla Çeku, zyrtare për Median dhe Informim Publik në Zyrën e Përfaqësisë së Bashkimit European në Kosovë, Prishtinë më 17 Korrik 2015

Intervistë me z. Habit Hajredini, Zyra e Qeversjes së Mirë pranë Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Prishtinë 8 Korrik 2015

Intervista me znj. Luljeta Domaniku, zyrtaren e lartë për çështje të barazisë gjinore dhe të drejtat e gruas, Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë 15 Korrik 2015

Intervistë me z. Liridon Velu, drejtor i Qendrës për Emancipim Shoqëror, Prishtinë 11 Korrik 2015

Intervistë me z. Mehmet Hajrullahu, Editor pranë BIRN-Kosovë, Prishtinë 13 Korrik 2015

Intervistë me znj. Merita Syla, zyrtare e lartë në Institucionin e Avokatit të Popullit për departamentin e mbrojtjes kundër diskriminimit, 14 Korrik 2015, Prishtinë.

Intervistë me znj. Nicole Farnsworth, bashkë-drejtuese e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Prishtinë 12 Korrik 2015

Intervistë me zyrtare të lartë (pa pëlqim për tu identifikuar) të Ministrisë së Drejtësisë, Departamenti i Integritetit European dhe Koordinimit të Politikave/Divizioni i Koordinimit të Politikave, Prishtinë 17 Korrik 2015